



REPUBLIKA E SHQIPËRISE
MINISTËR SHTETI PËR
ADMINISTRATËN PUBLIKE
DHE ANTIKORRUPSIONIN

**KOORDINATORI KOMBËTAR
KUNDËR KORRUPSIONIT**

RAPORTI I MONITORIMIT

PËR PERIUDHËN JANAR-DHJETOR 2024

**STRATEGJIA NDËRSEKTORIALE
KUNDËR KORRUPSIONIT
2024 - 2030**

Tiranë më, 6.5.2025

II. Progresi i Strategjisë Ndërsektoriale Kundër Korrupsionit 2024-2030 dhe i Planit të Veprimit 2024-2026

- 2.1 Reforma të implementuara me sukses në vitin përkatës
- 2.2 Impakti i implementimit të strategjisë në përputhje me agjendën e integritetit evropian
- 2.3 Komponentët që kanë nevojë për adresim me qëllim përmirësimin e implementimit
- 2.4 Ekzekutimi i përgjithshëm i buxhetit

III. Progresi i lidhur me qëllimet politike, objektivat specifike dhe masat

- 3.1 Vlerësimi i arritjeve kryesore duke përdorur treguesit
- 3.2 Vlerësimi i sfidave, boshllëqeve dhe joefikasitetit
- 3.3 Konkluzione dhe rekomandime

IV. Progresi lidhur me objektivat, rezultatet dhe impaktin

- 4.1 Vlerësimi i arritjeve kryesore duke përdorur treguesit
- 4.2 Vlerësimi i sfidave, boshllëqeve dhe joefikasitetit
- 4.3 Konkluzione dhe rekomandime

V. Risqet dhe hapat për t'u adresuar

- 5.1 Vlerësimi i riskut duke përdorur dhe treguesit
- 5.2 Hapat e radhës

Aneks

LISTA E SHKURTIMEVE

AAPSK	Agjencia e Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe Konfiskuara
ADB	Agjencia për Dialog dhe Bashkëqeverisje
AIF	Agjencia e Inteligjencës Financiare
AMP	Agjencia e Mbikëqyrjes Policore
AK	Autoritetet Kontraktore
AKD	Agjencia Kombëtare e Diasporës
AKFAL	Agjencia Kombëtare e Financimit të Arsimit të Lartë
AKR	Agjencia Kombëtare e Rinisë
AKSHI	Agjencia Kombëtare e Shqërisë së Informacionit
AKVMB	Autoritetit Kombëtar të Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve
AMSHC	Agjencia për mbështetjen e Shoqërisë Civile
AKU	Autoriteti Kombëtar i Ushqimit
AKVMB	Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve
AMVV	Agjencia për Mbështetjen e Vetëqeverisjes Vendore
APP	Agjencia e Prokurimit Publik
ASPA	Shkolla Shqiptare e Administratës Publike
ASHK	Agjencia Shtetërore e Kadastrës
ATP	Agjencia e Trajtimit të Pronës
ATRAKO	Agjencia e Trajtimit të Koncesioneve
AS	Akademia e Sigurisë
AZHBR	Agjencia për Zhvillim Bujqësor dhe Rural
BE	Bashkimi Evropian
BKH	Byroja Kombëtare e Hetimit
DAP	Departamenti i Administratës Publike
DPAK	Drejtoria e Përgjithshme Antikorrupsion
DPB	Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve
DPD	Drejtoria e Përgjithshme e Doganave
DPPSH	Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit
DPT	Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve
DSHPA	Drejtoria e Shërbimit të Peshkimit dhe Akuakulturës
EKB	Enti Kombëtar i Banesave
ERRE	Enti Rregullator i Energjisë
GJKKO	Gjykata kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar
ILD	Inspektori i Lartë i Drejtësisë
ILDKPKI	Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave
INSTAT	Instituti i Statistikave
IQ	Inspektorati Qendror
ISUV	Instituti i Sigurisë Ushqimore dhe Veterinare
KDIMDP	Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale
KKKK	Koordinatori Kombëtar Kundër Korrupsionit
KLJG	Këshilli i Lartë Gjyqësor
KLP	Këshilli i Lartë i Prokurorisë
KLSH	Kontrolli i Lartë i Shtetit
KM	Këshilli i Ministrave
KMSHC	Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil
KPP	Komisioni i Prokurimit Publik
KSHZ	Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve
KSH	Kuvendi i Shqipërisë
MAPA	Ministër Shteti për Administratën Publike dhe Antikorrupsionin
MAS	Ministria e Arsimit dhe Sportit
MB	Ministria e Brendshme
MBZHR	Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural
MD	Ministria e Drejtësisë
MEKI	Ministria e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit
MEPJ	Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme
MF	Ministria e Financave
MSHMP	Ministër Shteti për Marrdhëniet me Parlamentin
MSHMS	Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale
MSHPV	Ministër Shteti për Pushtetin Vendor
MSHSKB	Ministër Shteti për Sipërmarrjen dhe Klimën e Biznesit
OSHC	Organizatat e Shoqërisë Civile
PDS	Porti Detar Sarandë Sh.a
PDV	Porti Detar Vlorë Sh.a
PP	Prokuroria e Përgjithshme
PSH	Posta Shqiptare
QKTGJ	Qendra Kombëtare e Transfuzionit të Gjakut
QTTB	Qendrat e Transferimit të Teknologjive Bujqësorë
RTSH	Radio Televizioni Shqiptar
SASPAK	Agjencia Shtetërore e Programimit Strategjik dhe Koordinimit të Ndihmës
SNTIN	Sekretariati i Nismës për Transparencë në Industrinë Nxjerrëse
SPAK	Struktura e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar
SHM	Shkolla e Magjistraturës
UAT	Universiteti i Arteve Tiranë
UPT	Universiteti Politeknik i Tiranës
UT	Universiteti i Tiranës
ZRA	Zyra e Rikuperimit të Aseteve

Përmbledhje ekzekutive

Strategjia Ndërsektorale Kundër Korrupsionit 2024–2030 përfaqëson angazhimin më të lartë politik dhe institucional të Shqipërisë për parandalimin dhe luftimin e korrupsionit, një ndër sfidat më të ndjeshme për funksionimin e shtetit të së drejtës, zhvillimin demokratik dhe mirëqenien e qytetarëve. Hartuar në përputhje me parimet e integritetit, transparencës, përgjegjshmërisë dhe efikasitetit, strategjia synon ndërtimin e një mjedisi të qëndrueshëm institucional dhe shoqëror, ku funksionet publike ushtrohen me ndershmëri dhe në shërbim të interesit publik.

Vizioni i strategjisë është: *“Institucione publike që ushtrojnë funksionet në përputhje me standardet më të larta të integritetit, transparencës dhe llogaridhënies publike dhe ofrojnë shërbime efikase ndaj qytetarëve”*. Kjo qasje konkretizohet nëpërmjet tri shtyllave kryesore: parandalimi, ndëshkimi dhe ndërgjegjësimi.

Edhe pse miratuar në dhjetor 2024, zbatimi i strategjisë ka nisur menjëherë, me angazhim intensiv të institucioneve përgjegjëse gjatë gjithë vitit. Ky raport paraqet vlerësimin e parë zyrtar të zbatimit për periudhën janar–dhjetor 2024, duke përmbledhur rezultatet e para dhe përpjekjet institucionale të ndërmarra në këtë fazë fillestare.

Gjatë vitit 2024, fokusi ka qenë te **parandalimi i korrupsionit**, përmes masave që synojnë forcimin e kuadrit ligjor dhe kapaciteteve institucionale, rritjen e transparencës dhe llogaridhënies në të gjitha nivelet e qeverisjes, si dhe ndërhyrjeve të synuara në sektorët me risk të lartë. Vëmendje e veçantë i është kushtuar forcimit të mekanizmave parandalues në nivel vendor, mbrojtjes së financave dhe asetëve publike, promovimit të rolit të sinjalizuesve, si dhe përgatitjes për rritjen e transparencës financiare të partive politike dhe rregullimit të lobimit. Gjithashtu, është nxitur bashkëpunimi me sektorin privat për të promovuar integritetin në marrëdhëniet publike dhe ekonomike.


Në drejtim të ndëshkimit, strategjia ka synuar përmirësimin e efektivitetit të hetimit administrativ dhe penal, përmes forcimit të kuadrit ligjor, rritjes së kapaciteteve njerëzore dhe përmirësimit të bashkëpunimit ndër-institucional, përfshirë edhe atë ndërkombëtar, në fushën e ndjekjes së korrupsionit, krimit ekonomik dhe pastrimit të parave.

Ndërgjegjësimi dhe edukimi për integritet mbeten një komponent kyç i strategjisë. Janë ndërmarrë hapa për sensibilizimin e qytetarëve mbi pasojat e korrupsionit dhe rëndësinë e raportimit të tij, si dhe për edukimin e brezit të ri në vlerat e etikës dhe integritetit. Shoqëria civile, sektori privat dhe komuniteti akademik janë përfshirë në mënyrë aktive në këto përpjekje. Po ashtu, një theks i veçantë i është dhënë fuqizimit të rolit të grave në parandalimin dhe identifikimin e korrupsionit në të gjitha nivelet.

Çfarë përmban raporti?

Raporti vjetor i monitorimit, 2024 analizon progresin e 16 objektivëve specifikë, zbatimin e 35 masave dhe 83 aktiviteteve si dhe matjen e performancës përmes 24 treguesve, nëpërmjet një procesi të strukturuar monitorimi dhe raportimi, të udhëhequr nga Drejtoria e Përgjithshme Antikorrupsion, nën drejtimin e Koordinatorit Kombëtar Kundër Korrupsionit.

Plani i Veprimit Antikorrupsion ka arritur një nivel zbatimi prej 87.5%, dhe i ndarë sipas shtyllave, është:



Çfarë përmban Raporti?

Raporti vjetor i monitorimit për vitin 2024 paraqet një analizë të thelluar të progresit në zbatimin e Strategjisë Ndërsektoriale Kundër Korrupsionit 2024–2030, bazuar në një proces të strukturuar monitorimi dhe raportimi, të koordinuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Antikorrupsionit, nën drejtimin e Koordinatorit Kombëtar Kundër Korrupsionit.

Raporti vlerëson zbatimin e:

- 16 objektivave specifike të strategjisë;
- 35 masave dhe 83 aktiviteteve të parashikuara në Planin e Veprimit për vitin 2024;
- 24 treguesve të performancës, të ndarë sipas shtyllave prioritare.

Niveli i përgjithshëm i zbatimit

Nga monitorimi rezulton se:

- 22 masa dhe 63 aktivitete janë plotësisht të realizuara;
- 10 masa dhe 14 aktivitete janë pjesërisht të realizuara;
- 3 masa dhe 6 aktivitete kanë mbetur të porealizuara.

Në total, Plani i Veprimit për vitin 2024 ka arritur një nivel zbatimi prej **87.5%**.

Rezultatet kryesore të vitit 2024:

1. Parandalimi i korrupsionit

- U realizua analiza gjithëpërfshirëse e kuadrit ligjor dhe institucional antikorrupsion, si bazë për harmonizimin e legjislacionit (konflikti i interesit, sinjalizimi, lobimi, financimi i partive politike, donacionet dhe sponsorizimet, rikuperimi i aseteve).
- U ngrit dhe operacionalizua Rrjeti i Pikave të Kontaktit Antikorrupsion në 119 institucione publike dhe u vendosën 734 njësi përgjegjëse për sinjalizimin në sektorin publik dhe privat.
- U rishikuan dhe miratuan Planet e Integritetit në të gjitha ministrinë dhe kabinetet e ministrave të Shtetit; 13 bashki miratuan plane të reja, duke çuar totalin në 28 bashki me plane në zbatim.
- U zgjerua Regjistri Elektronik i Kërkesave dhe Përgjigjeve në 247 autoritete publike; 99.4% e subjekteve raportuese të pasurisë dhe konfliktit të interesit dorëzuan deklaratat në mënyrë elektronike dhe në afat.

- Platforma e-Albania arriti në 3,166,983 përdorues aktivë.
- Kontrolli i Lartë i Shtetit realizoi 195 auditime dhe dha 5,759 rekomandime, prej të cilave 99.6% u pranuan; ndërsa auditimi i brendshëm pranë MF dha 6,935 rekomandime, prej të cilave 53.5% janë zbatuar.
- U zgjerua bashkëpunimi me sektorin privat, përmes promovimit të kodeve të sjelljes, programeve të përputhshmërisë, trajnimeve mbi etikën dhe ngritjes së kanaleve të sigurta për raportim.

2. Ndëshkimi i korrupsionit

- U verifikuan nga Drejtoria e Antikorrupsionit dhe koordinatorët kundër korrupsionit 163 ankesa dhe raste, që prodhuan 7 raporte përfundimtare, 6 masa administrative dhe 16 rekomandime.
- U ngrit Zyra teknike për Rikuperimin e Aseteve pranë Policisë së Shtetit.
- U hetuan 186 çështje për korrupsion nga SPAK dhe 140 nga prokuroritë e juridiksionit të përgjithshëm.
- U regjistrua një rritje prej 40% e hetimeve proaktive dhe 33% e arrestimeve në flagrancë; u realizuan 7 herë më shumë inspektime në sektorët me risk të lartë korrupsioni në polici.
- U aktivizuan 10 skuadra të reja hetimore të përbashkëta me autoritetet e huaja dhe u vijua puna me 27 skuadra aktive ekzistuese.
- ILDKPKI vendosi 101 masa administrative (gjobë) dhe bëri 23 referime penale/administrative, nga të cilat 1 rast u dërgua në SPAK.

3. Ndërgjegjësimi dhe edukimi antikorrupsion

- U organizua Java e VI e Integritetit, me mbi 15 aktivitete sensibilizuese në mbarë vendin, në bashkëpunim me institucione arsimore, media dhe OSHC.
- U zhvilluan trajnime dhe orë të hapura për mekanizmat antikorrupsion në shkolla dhe universitete; u shpërnda buletini "Antikorrupsioni" dhe u zhvilluan fushata informuese në rrjetet sociale.
- U pilotua programi "Edukimi kundër korrupsionit" në 12 shkolla të mesme në Tiranë, Durrës, Shkodër, Vlorë, Korçë dhe Gjirokastrë.
- U zhvilluan forume dhe konsultime publike mbi nismat strategjike dhe projektaktet antikorrupsion.

Sfida dhe përfundime:

Gjatë vitit të parë të zbatimit të Strategjisë Ndërsektoriale Kundër Korrupsionit 2024–2030 janë identifikuar një sërë sfidash që ndikojnë në ritmin dhe cilësinë e progresit, por njëkohësisht kanë shërbyer si indikatorë të vlefshëm për orientimin e përmirësimeve të ardhshme.

Ndër sfidat kryesore evidentohet vonesa në miratimin e projektligjeve të reja, si ai për konfliktin e interesave dhe rikuperimin e asetëve, të cilat janë thelbësore për ngritjen e mekanizmave të kontrollit në përputhje me standardet ndërkombëtare. Zbatimi në praktikë i planeve të integritetit, veçanërisht në nivel vendor, mbetet një proces në zhvillim, i ndikuar nga mungesa e burimeve të mjaftueshme, kapaciteteve të brendshme dhe instrumenteve të qarta për matjen e performancës.

Gjithashtu, mungesa e një platforme të përbashkët ndërinstitucionale për komunikimin antikorrupsion kufizon mundësitë për shkëmbim të koordinuar informacioni, ndarje të praktikave të mira dhe përfshirje më të strukturuar të qytetarëve në proceset e parandalimit të korrupsionit. Po ashtu, vlerësimi i impaktit të

masave antikorruption mbetet i përqendruar në nivel institucional, duke nënvizuar nevojën për zhvillimin e mekanizmave më gjithëpërfshirës dhe të pavarur për monitorim dhe matje të rezultateve.

Në terma përfundimtarë, viti 2024 shënon fillimin e një cikli strategjik të orientuar drejt harmonizimit të masave me Konventën e Kombeve të Bashkuara Kundër Korrupsionit, si dhe me aktet dhe standardet e Bashkimit Evropian dhe Këshillit të Evropës. Ky proces synon ndërtimin e një administrate me kompetenca të forta parandalimi, të shoqëruar nga edukimi i vazhdueshëm publik mbi integritetin, si dhe nga forcimi i kapaciteteve dhe mjeteve të organeve ligjzbatuese.

Raporti vjetor i monitorimit për vitin 2024 shërben si një pasqyrë gjithëpërfshirëse e rezultateve të arritura, por edhe si pikë reflektimi mbi përmirësimet që duhen ndërmarrë në vijimësi. Me një orientim të qartë drejt transparencës, integritetit dhe llogaridhënies, zbatimi i strategjisë vijon të jetë një instrument kyç për forcimin e besimit të qytetarëve në institucionet publike, në funksion të objektivave të Agjendës 2030 – Shqipëria Evropiane.

I. INFORMACION PËRMBLEDHËS MBI STRATEGJINË NDËRSEKTORIALE KUNDËR KORRUPSIONIT 2024-2030 DHE PLANIT TË VEPRIMIT 2024-2026

1.1 Hyrje

Strategjia Ndërsektoriale Kundër Korrupsionit 2024–2030 përfaqëson angazhimin më të lartë politik dhe institucional të Shqipërisë në luftën kundër korrupsionit, si një nga sfidat më të ndjeshme për shoqërinë dhe zhvillimin demokratik të vendit. Ky dokument strategjik është hartuar në përputhje me parimet e shtetit të së drejtës, transparencës, përgjegjshmërisë dhe integritetit, dhe synon krijimin e një mjedisi më me integritet dhe më efektiv në funksionimin e administratës publike dhe në ofrimin e shërbimeve për qytetarët.

Vizioni i strategjisë është: *“Institucione publike që ushtrojnë funksionet në përputhje me standardet më të larta të integritetit, transparencës dhe llogaridhënies publike dhe ofrojnë shërbime efikente ndaj qytetarëve”*, dhe ai konkretizohet nëpërmjet tre qëllimeve kryesore: **parandalimit, ndëshkimit dhe ndërgjegjësimit.**

Strategjia Ndërsektoriale Kundër Korrupsionit 2024–2030, e miratuar me Vendim të Këshillit të Ministrave nr. 859, datë 26.12.2024, përfaqëson vijimësinë dhe njëkohësisht qasje të qendrueshme e të drejtpërdrejtë të angazhimeve të Shtetit Shqiptar në drejtim të politikave antikorrupsion. E bazuar në një analizë të kujdesshme të progresit të arritur, në vlerësimin e sfidave të hasura dhe në domosdoshmërinë për të harmonizuar më tej politikat qeveritare me prioritetet e procesit të integritetit evropian, strategjia e re është konsoliduar si një dokument gjithëpërfshirës, i mbështetur në evidenca, konsulta të gjera dhe standarde ndërkombëtare. Ajo përfaqëson një hap cilësor drejt rritjes së efektivitetit institucional, përmes një qasjeje kombëtare të koordinuar dhe mekanizmave të matshëm për monitorim dhe vlerësim.

Strategjia dhe Plan i Veprimit 2024–2026 janë hartuar në përputhje të plotë me standardet ndërkombëtare në fushën e luftës kundër korrupsionit, duke reflektuar angazhimet e Shqipërisë si shtet palë në Konventën e Kombeve të Bashkuara kundër Korrupsionit, rekomandimet e GRECO-s në kuadër të Këshillit të Evropës, si dhe me PKIE-në & *acquis* të BE-së. Konkretisht, Kapitulli 23: Gjyqësori dhe të Drejtat Themelore, një kapitull thelbësor në procesin e negociatave për anëtarësim. Strategjia përmban 16 objektiva specifike, të shoqëruar nga një plan veprimi me 53 masa të bazuara në rezultate dhe 24 tregues performance. Në veçanti, ajo mbështetet mbi parimet e transparencës, integritetit, llogaridhënies, mbrojtjes së sinjalizuesve, forcimit të mekanizmave antikorrupsion në sektorin publik dhe promovimit të edukimit dhe ndërgjegjësimit qytetar. Këto elementë përbëjnë boshtin tematik të strategjisë dhe janë në përputhje të plotë me praktikatat më të mira ndërkombëtare.

Procesi i zbatimit mbështetet gjithashtu nga partnerët ndërkombëtarë teknikë, të cilët kontribuojnë në forcimin e cilësisë së instrumenteve të politikave dhe në monitorimin e progresit të vendit.

Ky raport monitorimi pasqyron ecurinë e zbatimit të masave të parashikuara për periudhën janar–dhjetor 2024, duke përfaqësuar vlerësimin për vitin e parë të zbatimit të strategjisë. Ai mbështetet

në një proces të gjerë të mbledhjes dhe analizimit të të dhënave të administruara nga institucionet publike zbatuese në nivel qendror dhe vendor, si dhe nga aktorë të tjerë institucionalë. Vlerësimi është kryer në përputhje me kuadrin e matjes së performancës dhe me metodologjinë e miratuar për monitorimin e strategjisë, duke u fokusuar në treguesit e performancës dhe vlerat e synuara për vitin në fjalë.

Zbatimi i strategjisë është mbështetur në një sistem të konsoliduar koordinimi dhe bashkëpunimi ndërinstitucional, i qendëruar pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Antikorrupsionit si një strukturë teknike e dedikuar për monitorimin, analizën dhe vlerësimin e zbatimit të strategjisë.

Në raportin e monitorimit të vitit 2024 janë përfshirë zhvillimet e rëndësishme të qëndrueshme, në drejtim të forcimit të instrumenteve të kuadrit ligjor dhe të integritetit institucional kundër korrupsionit, mekanizmave të sinjalizimit dhe mbrojtjes së sinjalizuesve, përmirësimit të transparencës, rritjes së ndërgjegjësimit publik dhe edukimit qytetar përmes platformave të komunikimit dhe fushatave të dedikuara. Vëmendje e veçantë i është kushtuar përmbushjes së angazhimeve ndërkombëtare, veçanërisht rekomandimeve të dhëna nga GRECO dhe zbatimit të standardeve të përafritit me direktivat e BE-së në fushën e antikorrupsionit.

Në raportin e monitorimit të vitit 2024 janë evidentuar progrese dhe zhvillime domethënëse edhe në drejtim të forcimit të qasjes ndëshkuese ndaj korrupsionit, përmes masave që synojnë përmirësimin e kapaciteteve për hetim administrativ dhe penal, si dhe rritjen e burimeve për ndjekjen e rasteve të korrupsionit në të gjitha nivelet e qeverisjes dhe sektorëve të administratës publike. Janë përfshirë zhvillimet për forcimin e rolit të institucioneve ligjzbatuese dhe të drejtësisë, si dhe për nxitjen e bashkëpunimit ndërkombëtar me autoritetet homologe, rrjetet dhe mekanizmat, si një dimension i pandarë i luftës kundër korrupsionit parë në një kontekst ndërkombëtar.

Në këtë kuadër, raporti i monitorimit për vitin 2024 përfaqëson një instrument kyç vlerësimi duke ofruar një panoramë të qartë mbi ecurinë dhe impaktin e masave të zbatuara.

Procesi i monitorimit është udhëhequr nga Ministri i Shtetit për Administratën Publike dhe Antikorrupsionin, në rolin e Koordinatorit Kombëtar Kundër Korrupsionit dhe është zbatuar në bashkëpunim të ngushtë me Drejtorinë e Përgjithshme të Antikorrupsionit, si struktura teknike përgjegjëse për përgatitjen e raportit. Përmes një rrjeti funksional të pikave të kontaktit antikorrupsion, në bashkëveprim me koordinatorët antikorrupsion dhe angazhimit të gjerë të shoqërisë civile dhe aktorëve të tjerë jo-qeveritarë, monitorimi ka përfshirë të gjitha hallkat e rëndësishme të administratës publike në të gjitha nivelet e qeverisjes.

Ky raport paraqet gjithashtu një përmbledhje të progresit për secilin nga objektivat specifike, për çdo masë dhe aktivitet të planifikuar, duke vlerësuar në mënyrë të qartë përmbushjen e tyre sipas treguesve përkatës të performancës. Në përfundim, raporti jep një analizë të arritjeve, sfidave të hasura dhe rekomandime të nevojshme për përmirësimin e mëtejshëm të zbatimit të strategjisë dhe të planit të veprimit në vitet në vijim.

Ky dokument është një instrument themelor për transparencën dhe llogaridhënien në procesin e zbatimit të politikave antikorruption dhe një dëshmi konkrete e vullnetit të institucioneve shqiptare për të ndërtuar një administratë publike më të drejtë, efikase dhe të besueshme për qytetarët e saj.

Për këtë periudhë *janar - dhjetor 2024*, janë mbledhur dhe analizuar të dhëna për 24 tregues performance, të shpërndarë përkatësisht në 15 tregues për objektivat specifike në qasjen parandaluese, 5 tregues për objektivat specifike në qasjen ndëshkuese dhe 4 tregues për objektivat specifike në qasjen ndërgjegjësuese.

Në vijim, paraqitet realizueshmëria e objektiveve të strategjisë sipas shkallës së realizimit të treguesve të performancës¹:

Objektivët specifikë		Shkalla e realizimit sipas treguesve të performancës
Parandalimi	1.1 Forcimi i kornizës ligjore dhe kapaciteteve institucionale në parandalimin e korrupsionit	100 %
	1.2 Forcimi i transparencës, llogaridhënies dhe integritetit të institucioneve publike në të gjitha nivelet e qeverisjes	100 %
	1.3 Zhvillimi i një qasjeje të qëndrueshme për parandalimin e korrupsionit në sektorët me risk (prevalencë të lartë korrupsioni)	Nuk matet ²
	1.4 Forcimi i mekanizmave të parandalimit të korrupsionit në njësitë e vetëqeverisjes vendore	100%
	1.5 Mbrojtja e financave dhe asetëve publike nga keqpërdorimi gjatë ushtrimit të funksionit public	100%
	1.6 Forcimi i kornizës së sinjalizuesve për zbulimin e hershëm të korrupsionit	100%
	1.7 Forcimi i transparencës financiare dhe integritetit të partive politike	100%
	1.8 Ngritja e kuadrit legjislativ dhe institucional për lobimin si instrument parandalimi korrupsioni	100%
	1.9 Promovimi i integritetit në sektorin privat	100%
Ndëshkimi	2.1 Forcimi i kuadrit legjislativ, institucional dhe i kapaciteteve profesionale për hetimin efektiv administrativ të korrupsionit	100%
	2.2 Forcimi i kapaciteteve, burimeve dhe performancës për hetim penal efektiv dhe ndjekjen penale të korrupsionit	100%
	2.3 Forcimi i bashkëpunimit ndërkombëtar i agjencive ligjzbatuese dhe organeve gjyqësore në luftën kundër korrupsionit	100%
Ndërgjegjësi	3.1 Rritja e ndërgjegjësimit të qytetarëve për pasojat negative të korrupsionit dhe nxitja e tyre për të kundërshtuar, denoncuar dhe raportuar korrupsionin	100%

¹ Mbështetur në matjen e vlerave të synuara për treguesit e performancës, sipas aneks 2 i SNKK.

² Treguesit e performancës, 1.3.1 dhe 1.3.2, nuk kanë mundësi objektive matjeje dhe si rezultat objektivi 1.3 nuk do të ketë një vlerësim bazuar tek treguesit.

3.2 Edukimi i të rinjve mbi etikën, integritetin dhe angazhimin proaktiv në luftën kundër korrupsionit	50%
3.3 Përfshirja e opinionit publik, veçanërisht sektorit privat, organizatave të shoqërisë civile dhe akademisë në luftën kundër korrupsionit	100%
3.4 Forcimi i pjesëmarrjes së grave për të identifikuar dhe luftuar korrupsionin në nivele dhe sektorë të ndryshëm	0%

Për këtë periudhë *janar - dhjetor 2024*, janë mbledhur dhe analizuar të dhëna për 35 masa dhe 83 aktivitete, të shpërndara përkatesisht në: 16 masa dhe 43 aktivitete për qasjen parandaluese, 9 masa dhe 21 aktivitete për qasjen ndëshkuese dhe 10 masa dhe 19 aktivitete për qasjen ndërgjegjëse.

Në vijim, paraqitet realizueshmëria e planit të veprimit për secilin objektiv të strategjisë sipas shkallës së realizimit të masave³.

Objektivët specifikë	Shkalla e realizimit sipas masave të Planit të Veprimit
1.1 Forcimi i kornizës ligjore dhe kapaciteteve institucionale në parandalimin e korrupsionit	86 në 110 për qind e masave të realizuara
1.2 Forcimi i transparencës, llogaridhënies dhe integritetit të institucioneve publike në të gjitha nivelet e qeverisjes	51 në 85 për qind e masave të realizuara
1.3 Zhvillimi i një qasjeje të qëndrueshme për parandalimin e korrupsionit në sektorët me risk (prevalencë të lartë korrupsioni)	51 në 85 për qind e masave të realizuara
1.4 Forcimi i mekanizmave të parandalimit të korrupsionit në njësitë e vetëqeverisjes vendore	86 në 110 për qind e masave të realizuara
1.5 Mbrojtja e financave dhe aseteve publike nga keqpërdorimi gjatë ushtrimit të funksionit public	86 në 110 për qind e masave të realizuara
1.6 Forcimi i kornizës së sinjalizuesve për zbulimin e hershëm të korrupsionit	86 në 110 për qind e masave të realizuara
1.7 Forcimi i transparencës financiare dhe integritetit të partive politike	Nuk ka masa për zbatim ⁴
1.8 Ngritja e kuadrit legjislativ dhe institucional për lobimin si instrument parandalimi korrupsioni	Nuk ka masa për zbatim ⁵
1.9 Promovimi i integritetit në sektorin privat	Nuk ka masa për zbatim ⁶
2.1 Forcimi i kuadrit legjislativ, institucional dhe kapaciteteve profesionale për hetimin efektiv administrativ të korrupsionit	86 në 110 për qind e masave të realizuara
2.2 Forcimi i kapaciteteve, burimeve dhe performancës për hetim penal efektiv dhe ndjekjen penale të korrupsionit	51 në 85 për qind e masave të realizuara
2.3 Forcimi i bashkëpunimit ndërkombëtar i agjencive ligjzbatuese dhe organeve gjyqësore në luftën kundër	86 në 110 për qind e masave të realizuara

³ Mbështetur në vlerësimin e zbatimit të masave dhe aktiviteteve të Planit të Veprimit, sipas aneks 1 i SNKK.

⁴ Nuk matet mbështetur tek masat dhe aktiviteti i Planit të Veprimit, sepse nuk ka pasur për zbatim në vitin 2024.

⁵ Nuk matet mbështetur tek masat dhe aktiviteti i Planit të Veprimit, sepse nuk ka pasur për zbatim në vitin 2024.

⁶ Nuk matet mbështetur tek masat dhe aktiviteti i Planit të Veprimit, sepse nuk ka pasur për zbatim në vitin 2024.

3.1 Rritja e ndërgjegjësimit të qytetarëve për pasojat negative të korrupsionit dhe nxitja e tyre për të kundërshtuar, denoncuar dhe raportuar korrupsionin	51 në 85 për qind e masave të realizuara
3.2 Edukimi i të rinjve mbi etikën, integritetin dhe angazhimin proaktiv në luftën kundër korrupsionit	86 në 110 për qind e masave të realizuara
3.3 Përfshirja e opinionit publik, veçanërisht sektorit privat, organizatave të shoqërisë civile dhe akademisë në luftën kundër korrupsionit	31 në 50 për qind e masave të realizuara
3.4 Forcimi i pjesëmarrjes së grave për të identifikuar dhe luftuar korrupsionin në nivele dhe sektorë të ndryshëm	31 në 50 për qind e masave të realizuara

Përsa më sipër, nga analiza e kryer rezulton se progresi i arritur për secilin prej qëllimeve të politikave, parandalim – ndëshkim – ndërgjegjësim, paraqitet:

Politika Parandaluese (I)	100%
Politika Ndëshkuese (II)	100 %
Politika Ndërgjegjësuere (III)	62.5%

Për këtë periudhë *janar - dhjetor 2024*, janë shënuar arritje të mira në politikat parandaluese, ndëshkuese dhe ndërgjegjësuere të zbatimit të strategjisë, përmendim:

Parandalim:

- Gjatë vitit 2024, është realizuar një vlerësim i thelluar i kuadrit ligjor dhe institucional kundër korrupsionit në Shqipëri, në kuadër të nismave për reformim dhe përafrim me standardet e BE-së. Raportet e vlerësimit analizojnë mangësitë dhe rekomandojnë përmirësime në fusha kyçe si sinjalizimi, konflikti i interesave, rikuperimi i aseteve dhe inspektimet, duke reflektuar analiza dhe rekomandime se brendshmi dhe përfshirë ato të partnerëve ndërkombëtarë. U rikonfirmua Rrjeti i Pikave të Kontaktit me 119 institucione dhe u emëruan 22 Koordinatorë Antikorrupsion; në 355 autoritete publike janë të emëruar koordinatorët për të drejtën e informimit.
- Gjatë vitit 2024 është vijuar me identifikimin e procedurave për t'u digjitalizuar dhe është nisur bashkëpunimi me AKSHI, për kryerjen e tyre, kryesisht për ato në fushën e shërbimeve të bujqësisë. U instalua Regjistri Elektronik i Kërkesave dhe Përgjigjeve në 25 autoritete të reja, duke arritur në 247 autoritete gjithsej. KDIMDP ka vijuar me trajnime për koordinatorët për të drejtën e informimit dhe për të dhënat e hapura. ILDKPKI koordinoi dhe monitoroi rregullisht përdorimin dhe funksionalitetin e sistemit EACIDS. Subjektet deklaruese, vijuan me plotësimin e deklaratave private, në masën 99.4%, brenda afatit. Të gjitha ministritë dhe ministrat e shtetit hartuan (rishikuan) e miratuan plane integriteti e caktuan koordinatorë integriteti. Platforma e-albania ka shënuar rritje të numrit të përdoruesve në total 3.166.983 (trend rritës).
- Gjatë vitit 2024 ka nisur hartimi i Metodologjisë për Vlerësimin e Riskut të Korrupsionit në Sektorin Publik. Paralelisht me të ka nisur përgatitja e metodologjisë sektoriale në fushën e prokurimeve publike. Po ashtu, janë ndërmarrë hapa për hartimin e planit të integritetit në kadastër dhe forcimin e kapaciteteve përmes trajnimeve, si dhe për integrimin e edukimit antikorrupsion në sistemin parauniversitar.

- Gjatë vitit 2024, AMVV ka asistuar 13 bashki në hartimin e planeve të integritetit, ndërsa 4 bashki të tjera (Shkodër, Fushë-Arrëz, Përrenjas, Vlorë) i kanë miratuar ato, duke e çuar në 28 numrin total të planeve në zbatim të integritetit. Janë përmirësuar ndjeshëm transparenca dhe llogaridhënia në të gjitha bashkitë.
- Gjatë vitit 2024, KLSH ka zhvilluar 195 auditime në sektorë dhe autoritete publikë të ndryshëm, ka përforcuar raportimin dhe transparencën përmes publikimeve dhe bashkëpunimeve me institucione vendase e ndërkombëtare. Është rritur cilësia e statistikave dhe dokumentimit të auditimeve, si dhe janë promovuar auditime me ndjeshmëri të lartë.
- Gjatë vitit 2024 janë ngritur dhe funksionojnë në total 734 njësi përgjegjëse të sinjalizimit, nga këto 36 njësi të reja përgjegjëse në sektorin privat dhe 4 në sektorin publik. ILDKPKI monitoron dhe koordinon informacionin për funksionimin e tyre. Ka nisur rishikimi i ligjit për sinjalizimin në përputhje me direktivën e BE, bazuar në një analizë të thelluar të 21 standardeve ndërkombëtare.

Ndëshkim:

- Në vitin 2024, u ngrit (riorganizua) Drejtoria e Përgjithshme e Antikorrupsionit, në cilësinë e një autoriteti të pavarur, administrativ me kompetenca në fushën e parandalimit të korrupsionit. Filloi përgatitja e rregullores së re të brendshme të saj dhe u intensifikua bashkëpunimi me koordinаторët antikorrupsion dhe institucione të tjera për parandalimin e korrupsionit. DPAK ka organizuar trajnime dhe aktivitete për rritjen e kapaciteteve të stafit dhe koordinimin ndër-institucional. Janë shqyrtuar 163 ankesa e denoncime dhe janë dhënë 6 masa administrative e 16 rekomandime. Ka vijuar koordinimi me ILDKPKI për shkëmbim informacioni dhe për raportimin e rasteve.
- Në vitin 2024 është përgatitur projektligji për ngritjen e Zyrës së Rikuperimit të Aseteve dhe janë hedhur bazat e ngritjes së zyrës përgjegjëse. Ky kuadër ligjor do të forcojë hetimin, ndjekjen penale dhe bashkëpunimin ndër-institucional duke përmirësuar rezultatet në luftën kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar. Pjesë e këtij procesi është edhe një raport vlerësimi që analizon nevojat për ndërhyrje dhe përmirësim të luftës kundër krimit dhe pastrimit të parave.
- Në vitin 2024, Prokuroria e Posaçme ka zhvilluar aktivitete trajnime dhe bashkëpunimi ndërkombëtar për forcimin e kapaciteteve të saj. Trajnime të vlefshme janë organizuar për hetuesit financiarë, prokurorët dhe oficerët e policisë gjyqësore, me fokus në luftën kundër korrupsionit, pastrimit të parave dhe krimeve financiare, luftës kundër financimit të terrorizmit, trajnime për përgjegjësinë penale dhe krimet e kryera nga zyrtarët publikë. Prokuroria e Posaçme gjithashtu ka qenë aktive në fushën e komunikimit dhe transparencës, duke organizuar takime me median dhe publikuar njoftime të rregullta për aktivitetet e saj. Janë 4422 kërkesa për informacion të marrë nga institucione shtetërore, media dhe qytetarë.
- Në vitin 2024, në Prokurorinë e Përgjithshme, është ngritur Zyra e Ekspertizës për të asistuar hetimet komplekse, për çështje që lidhen me korrupsionin dhe/apo shpërdorimin e detyrës.
- Në vitin 2024 është miratuar Strategjia e Burimeve Njerëzore në Prokurorinë e Posaçme, 2024-2026.
- Gjatë vitit 2024, Prokuroria e Posaçme ka nënshkruar marrëveshje të reja bashkëpunimi ndërkombëtar me Mbretërinë e Bashkuar, Spanjën, Malin e Zi, Belgjikën dhe Azerbajxhanin, për të forcuar luftën kundër krimit të organizuar dhe korrupsionit. Janë regjistruar 5 kërkesa për verifikime pasurore dhe një rritje e konsiderueshme e kërkesave për ndihmë juridike, si dhe kërkesave për ekstradim. Prokuroria e Posaçme ka ngritur 10 skuadra të përbashkëta hetimore me autoritete homologe dhe Policia e Shtetit ka realizuar 7 operacione bashkëpunimi

ndërkombëtar, përfshirë ato kundër falsifikimit të dokumenteve, trafikimit të drogave dhe krimeve kibernetike.

- Agjencia e Mbikëqyrjes Policore ka pasur një vit me rritje të aktiviteteve hetimore, duke regjistruar një rritje të numrit të referimeve dhe hetimeve proaktive dhe ka goditur veprimtarinë e paligjshme në radhët e policisë. Gjatë vitit janë zhvilluar hetime që kanë përfshirë individë me pozita të larta në strukturat e policisë, duke përfshirë raste të shpërdorimit të detyrës dhe korrupsionit.

Ndërgjegjësim:

- Gjatë vitit 2024, Ministri i Shtetit për Administratën Publike dhe Antikorrupsionin dhe Drejtoria e Përgjithshme e Antikorrupsionit kanë zbatuar në mënyrë të suksesshme aktivitete ndërgjegjëse dhe informuese kundër korrupsionit përmes Planit të Komunikimit dhe Vizibilitetit dhe edicionit të VI të Javës së Integritetit. Aktivitetet kanë përfshirë leksione të hapura, konferenca, publikime, kronika mediatike dhe partneritete ndërinstitucionale.
- Gjatë vitit 2024, Drejtoria e Përgjithshme e Antikorrupsionit ka intensifikuar përpjekjet për ndërgjegjësimin publik kundër korrupsionit përmes pjesëmarrjes në media, leksioneve të hapura në universitete publike dhe jopublike. Fokus i veçantë iu kushtua edukimit të të rinjve mbi integritetin dhe mekanizmat e parandalimit të korrupsionit, ndërsa u theksua rëndësia e rolit të DPAK si organi ekzekutiv parandalues. Aktivitetet janë promovuar gjerësisht edhe në rrjetet sociale zyrtare të DPAK.
- Gjatë vitit 2024, janë zhvilluar bashkëpunime me sektorin privat, shoqërinë civile dhe akademinë për rritjen e integritetit dhe denoncimin e korrupsionit. Janë organizuar forume, tryeza dhe aktivitete ndërgjegjëse, ku u përfshinë aktorë nga biznesi, OSHC-të dhe universitetet pasi edhe strategjia antikorrupsion 2024-2030 u hartua me kontributin e gjerë të këtyre partnerëve.

1.2 Metodologjia e monitorimit

Raporti i monitorimit për zbatimin e Strategjisë Ndërsektoriale Kundër Korrupsionit 2024 - 2030, dhe të Planit të Veprimit, për vitin 2024, është përgatitur nga Drejtoria e Përgjithshme e Antikorrupsionit, në cilësinë e autoritetit përgjegjës për ndjekjen dhe koordinimin ndërinstitucional të politikave në këtë fushë. Në zbatim të vendimit të Këshillit të Ministrave, Nr.436, datë 26.6.2024, dhe urdhrit të Kryeministrit Nr.146, datë 1.8.2024, është strukturuar Sektori i Monitorimit dhe Koordinimit të Politikave Prioritare, i cili ka ndjekur të gjithë ciklin teknik dhe institucional të hartimit të raportit për periudhën *1 janar – 31 dhjetor 2024*.

Procesi është zhvilluar në përputhje me manualin e raportimit në sistemin IPSIS, duke garantuar koherencë me strukturën logjike të strategjisë, përfshirë vlerësim për qëllimet e politikës, objektivet specifike, masat konkrete dhe treguesit e performancës për secilin institucion përgjegjës. Raporti ndërtohet mbi bazën e një metodologjie të qartë për mbledhjen, analizimin dhe klasifikimin e të dhënave sipas tri shtyllave kryesore: (1) realizimi i masave të planit të veprimit, (2) arritja e vlerave të synuara për treguesit e performancës dhe (3) përputhshmëria me parimet e mirëqeverisjes dhe efektiviteti i burimeve.

Në përputhje me qasjen e re të integruar ndërsektoriale, monitorimi është ndërlidhur me Mekanizmin e Integruar të Politikave, përmes funksionimit të Grupit Tematik Antikorrupsion dhe dialogut të rregullt me aktorët publikë, partnerët për zhvillim dhe shoqërinë civile.

Analiza është shtrirë edhe në komponentët financiarë, duke evidentuar lidhjen midis programeve buxhetore dhe realizimit të masave të strategjisë dhe ka përfshirë vlerësime të riskut sipas standardeve të menaxhimit financiar dhe kontrollit. Raporti është ndërtuar mbi baza analitike dhe me të dhëna të krahasueshme përmes grafikëve, tabelave, treguesve SMART dhe kategorizimeve të performancës në pesë shkallë (i dobët, i mjaftueshëm, i mirë, shumë i mirë, i tejkaluar).

Ky dokument do të shërbejë jo vetëm për të matur progresin vjetor, por edhe për të udhëhequr vendimmarrjen, planifikimin buxhetor dhe përmirësimin e mëtejshëm të politikave antikorrupsion, në funksion të rritjes së integritetit, transparencës dhe llogaridhënies në administratën publike dhe në shërbim të qytetarëve. Gjeni të detajuar metodologjinë e monitorimit të ndjekur, në aneks 1 të këtij raporti.

1.3 Konsultimi publik i raportit të monitorimit

Në përputhje me kriteret ligjore për konsultimin publik, pas hartimit të raportit, Drejtoria e Përgjithshme e Antikorrupsionit, konsultoi draftin e parë të raportit në datë 21.2.2025 me institucionet zbatuese të Strategjisë Ndërsektoriale Kundër Korrupsionit 2024-2030 nëpërmjet pikave të kontaktit antikorrupsion. Në vijim, me marrjen e informacionit të shtuar për masat dhe aktivitetet e planit të veprimit, vlerat e synuara vjetore për treguesit e performancës, u plotësua informacioni statistikor dhe i vlerësimit të progresit të arritur.

Drafti i dytë i raportit u dërgua për vlerësim dhe konsultim pranë institucioneve të zbatuese të Strategjisë Ndërsektoriale Kundër Korrupsionit 2024-2030 në datë 24.4.2025, si dhe pranë SASPAC, që shërben si njësi përgjegjëse për koordinimin qendror të Grupeve të Integruara të Menaxhimit të Politikave.

Në datë 6.5.2025 u zhvillua takimi i Ekipit Tematik Teknik Antikorrupsioni, me pjesëmarrjen e pikave të kontaktit antikorrupsion pranë institucioneve zbatuese të Strategjisë Ndërsektoriale Kundër Korrupsionit 2024-2030, në të cilin u prezantua raporti, u diskutua dhe dakordësua përmbajtja e tij.

Në datë 12.5.2025, ky raport u paraqit zyrtarisht pranë Ministrit të Shtetit për Administratën Publike dhe Antikorrupsionin në rolin e Koordinatorit Kombëtar Kundër Korrupsionit që drejton njëkohësisht edhe Ekipin Tematik Antikorrupsion.

Në vijim, Ekipi Tematik Antikorrupsion morri në diskutim raportin e përgatitur dhe e miratoi atë në takimin e datës 10.6.2025.

II. PROGRESI I STRATEGJISË NDËRSEKTORIALE KUNDËR KORRUPSIONIT, 2024-2030 DHE TË PLANIT TË VEPRIMIT, 2024-2026

Strategjia Ndërsektoriale Kundër Korrupsionit 2024 - 2030 ka si synim arritjen e objektivave madhorë të kësaj strategjie nëpërmjet realizimit të masave konkrete antikorrupsion, me qëllim zhvillimin e një shoqërie në të cilën ekziston një sistem i përgjegjshëm dhe efikas kundër korrupsionit, i cili është në gjendje për të përfituar rezultate të prekshme dhe të tregojë tendencë drejt eliminimit maksimal të kërcënimeve të korrupsionit, si dhe vullnetit për të parandaluar dhe luftuar korrupsionin. Për të monitoruar ecurinë e SNKK 2024 - 2030, është hartuar raporti i monitorimit, në kuadër të zbatimit të Planit të Veprimit 2024 - 2026, i cili mbulon periudhën *1 janar 2024 deri më 31 dhjetor 2024*.

2.1 Reforma të implementuara me sukses në vitin përkatës

Zbatimi i SNKK kontribuon në zbatimin e Strategjisë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim (SKZHI) i cili është dokumenti kryesor strategjik kombëtar që mbështet zhvillimin e qëndrueshëm social dhe ekonomik të vendit, duke siguruar përmbushjen e standardeve dhe progresin në procesin e integritetit evropian.

SNKK ka identifikuar tre qëllime kryesore politikash përmes të cilave synon të përmbushë vizionin e saj dhe 16 objektiva specifike, si më poshtë:

Politika Parandaluese ka për qëllim forcimin e integritetit dhe parandalimin e korrupsionit në administratën publike dhe të gjithë segmenteve shtetërore. Fokus i veçantë i dedikohet institucioneve që ofrojnë shërbime publike për qytetarët.

Kjo politikë përbëhet nga objektivat e mëposhtme:

- 1.1 Forcimi i kornizës ligjore dhe kapaciteteve institucionale në parandalimin e korrupsionit.*
- 1.2 Forcimi i transparencës, llogaridhënies dhe integritetit të institucioneve publike në të gjitha nivelet e qeverisjes.*
- 1.3 Zhvillimi i një qasjeje të qëndrueshme për parandalimin e korrupsionit në sektorët me risk (prevalencë të lartë korrupsioni).*
- 1.4 Forcimi i mekanizmave të parandalimit të korrupsionit në njësitë e vetëqeverisjes vendore.*
- 1.5 Mbrojtja e financave dhe aseteve publike nga keqpërdorimi gjatë ushtrimit të funksionit publik.*
- 1.6 Forcimi i kornizës së sinjalizuesve për zbulimin e hershëm të korrupsionit.*
- 1.7 Forcimi i transparencës financiare dhe integritetit të partive politike.*
- 1.8 Ngritja e kuadrit legjislativ dhe institucional për lobimin si instrument parandalimi korrupsioni.*
- 1.9 Promovimi i integritetit në sektorin privat.*

Politika Ndëshkuese ka për qëllim të forcojë zbatimin e ligjit dhe sundimin e shtetit të së drejtës, të ndëshkojë aktet korruptive në të cilat zyrtarët publikë mund të përfshihen dhe të garantojë integritetin e organeve shtetërore.

Kjo politikë përbëhet nga objektivat e mëposhtme:

- 2.1 Forcimi i kuadrit legjislativ, institucional dhe kapaciteteve profesionale për hetimin efektiv administrativ të korrupsionit.*
- 2.2 Forcimi i kapaciteteve, burimeve dhe performancës për hetim penal efektiv dhe ndjekjen penale të korrupsionit.*
- 2.3 Forcimi i bashkëpunimit ndërkombëtar i agjencive ligjzbatuese dhe organeve gjyqësore në luftën kundër korrupsionit, krimit ekonomik dhe pastrimit të parave.*

Politika Ndërgjegjësuere ka për qëllim përfshirjen e publikut në luftën kundër korrupsionit, duke e informuar mbi veprimtarinë shtetërore kundër korrupsionit dhe nxitur atë për të përdorur në mënyra aktive mënyra dhe kanalet për ta denoncuar atë.

Kjo politikë përbëhet nga objektivat e mëposhtme:

- 3.1 Rritja e ndërgjegjësimin të qytetarëve për pasojat negative të korrupsionit dhe nxitja e tyre për të kundërshtuar, denoncuar dhe raportuar korrupsionin.*

3.2 Edukimi i të rinjve mbi etikën, integritetin dhe angazhimin proaktiv në luftën kundër korrupsionit.

3.3 Përfshirja e opinionit publik, veçanërisht sektorit privat, organizatave të shoqërisë civile dhe akademisë në luftën kundër korrupsionit.

3.4 Forcimi i pjesëmarrjes së grave për të identifikuar dhe luftuar korrupsionin në nivele dhe sektorë të ndryshëm.

Realizueshmëria e objektivave specifike të të tre qëllimeve të politikave të SNKK në nivel objektiv, paraqitet si vijon:

Duke aplikuar të njëjtën formulë të nxjerrjes së shkallës së realizimit të objektivave – duke mbledhur realizueshmërinë në përqindje të qëllimeve të politikës dhe pjesëtar me numrin e tyre – realizueshmëria e qëllimit strategjik ndërinstitucional kundër korrupsionit, për vitin 2024 është **87.5%**.

Politika I	Realizueshmëria
1.1	100%
1.2	100%
1.3	Nuk matet
1.4	100%
1.5	100%
1.6	100%
1.7	100%
1.8	100%
1.9	100%

Politika II	Realizueshmëria
2.1	100%
2.2	100%
2.3	100%

Politika III	Realizueshmëria
3.1	100%
3.2	50%
3.3	100%
3.4	0%

Numri i institucioneve të përfshira në zbatimin të Planit të Veprimit, 2024-2026, vetëm për vitin 2024, është 35, si përkatësisht: Të gjitha Ministrat e Linjës dhe ministrat e shtetit; institucionet në nivel qendror me kompetenca administrative: Agjencia Shtetërore e Kadastrës, Agjencia e Trajtimit të Pronës, Agjencia e Prokurimit Publik, Agjencia e Administrimit të Paurive të Sekuestruara dhe Konfiskuara, Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit, Agjencia për Mbështetjen e Vetëqeverisjes Vendore, Shkolla Shqiptare e Administratës Publike, Policia e Shtetit, Agjencia e Mbikqyrjes Policore dhe, institucionet e pavarura: Këshilli i Lartë Gjyqësor, Këshilli i Lartë i Prokurorisë, Prokuroria e Përgjithshme, Shkolla e Magjistraturës, Struktura e Posaçme kundër Krimit të Organizuar dhe Korrupsionit, Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesit, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, Komisioneri i Mbikqyrjes së Shërbimit Civil.


Zbatimi i SNKK realizohet përmes Planit të Veprimit 2024 - 2026, dhe periudhës raportuese 1 janar - 31 dhjetor 2024, konsiston në 35 masa dhe 83 aktivitete, të ndara përkatësisht në: 16 masa dhe 43 aktivitete për qasjen parandaluese, 9 masa dhe 21 aktivitete për qasjen ndëshkuese, dhe 10 masa dhe 19 aktivitete për qasjen ndërgjegjëse.

Statusi i realizueshmërisë së tyre paraqitet si vijon:

Qëllimet e Politikës	Masat dhe Aktivitetet	Realizimi i Masave dhe Aktiviteteve për vitin 2024			
		Masa dhe aktivitete të parashikuara për vitin 2024	Masa dhe aktivitete plotësisht të realizuara	Masa dhe aktiviteteve pjesërisht të realizuara ⁷	Masa dhe aktivitete të përcaktuara ⁸
Parandaluese (I)	Masa	16	12	2	2
	Aktivitete	43	33	8	2
Ndëshkuese (II)	Masa	9	5	4	-
	Aktivitete	21	16	4	1
Ndërgjegjësuere (III)	Masa	10	5	4	1
	Aktivitete	19	14	2	3
Total	Masa	35	22	10	3
	Aktivitete	83	63	14	6

Rezulton se nga totali prej 35 masash e 83 aktiviteteve të parashikuara për zbatim në planin e veprimit për periudhën *janar - dhjetor 2024*, statusi i tyre për të tre qëllimet e politikave rezulton të jetë si më poshtë:

- 22 masa e 63 aktivitete të realizuara;
- 10 masa e 14 aktivitete pjesërisht të realizuara (ende në proces zbatimi);
- 3 masa e 6 aktivitete të përcaktuara.



⁷ Aktivitet "pjesërisht i realizuar" është ai aktivitet që është realizuar në shkallën nga 50 deri në 100 për qind.

⁸ Aktivitet "i përcaktuar" është ai i cili është realizuar në një shkallë nga 0 në 50 për qind.

Përsa më sipër, nga **22 masa e 63 aktivitete të realizuara**, për *janar-dhjetor 2024*, konkretisht 12 masa e 33 aktivitete i përkasin politikës parandaluese (I), 5 masa dhe 16 aktivitete i përkasin politikës ndëshkuese (II), si dhe 5 masa dhe 14 aktivitete i përkasin politikës ndërgjegjëse (III).

Nga **10 masa e 14 aktivitete pjesërisht të realizuara**, për *janar-dhjetor 2024*, konkretisht 2 masa e 8 aktivitete i përkasin politikës parandaluese (I), 4 masa dhe 4 aktivitete i përkasin politikës ndëshkuese (II), si dhe 4 masa dhe 2 aktivitete i përkasin politikës ndërgjegjëse (III).

Nga **3 masa e 6 aktivitete të porealizuara**, për *janar-dhjetor 2024*, konkretisht 2 masa e 2 aktivitete i përkasin politikës parandaluese (I), vetëm 1 aktivitet i përket politikës ndëshkuese (II), si dhe 1 masë dhe 3 aktivitete i përkasin politikës ndërgjegjëse (III).

Për këtë periudhë *janar-dhjetor 2024*, janë mbledhur dhe analizuar të dhëna për 24 tregues performance, të shpërndarë përkatesisht në 15 tregues për objektivat specifike në politikën parandaluese, 5 tregues për objektivat specifike në politikën ndëshkuese dhe 4 tregues për objektivat specifike në politikën ndërgjegjëse. Gjatë vitit 2024, janë arritur vlerat e synuara për 20 tregues performance, pjesërisht për 1 tregues performance dhe nuk janë arritur për 3 tregues performance.

Statusi i arritjes së vlerave të synuara të tyre paraqitet si vijon:

Qëllimet e Politikës	Treguesit e performancës	Realizimi i Treguesve të Performancës		
		Vlera e synuar është realizuar plotësisht ⁹	Vlera e synuar është realizuar pjesërisht ¹⁰	Vlera e synuar nuk është e realizuar ¹¹
Parandaluese (I)	15	13	-	2 ¹²
Ndëshkuese (II)	5	5	-	-
Ndërgjegjëse (III)	4	2	1	1
Total	24¹³	20	1	1

Rezulton se nga totali prej 24 tregues performance, me vlera të synuara vjetore për arritje, për periudhën *janar - dhjetor 2024*, statusi i tyre për të tre qëllimet e politikave, rezulton të jetë si më poshtë:

- 20 tregues performance të realizuar;
- 1 tregues performance pjesërisht i realizuar;
- 1 tregues performance i porealizuar.


⁹ Që është realizuar në shkallën 100 për qind.

¹⁰ Që është realizuar në shkallën nga 50 deri në 100 për qind.

¹¹ Që nuk është realizuar dhe tregues për të cilin nuk janë mbledhur ose nuk ka qenë e mundur të mblidhen të dhëna.

¹² Treguesi 1.3.1 dhe 1.3.2 nuk mund të maten për vitin 2024.

¹³ Treguesit 1.3.1 dhe 1.3.2 nuk janë bërë pjesë e vlerësimit.



Përsa më sipër, për **20 tregues performance me vlera të synuara të realizuara**, për *janar-dhjetor 2024*, konkretisht 13 i përkasin politikës parandaluese (I), 5 i përkasin politikës ndëshkuese (II), si dhe 2 i përkasin politikës ndërgjegjësuere (III).

1 tregues performance, pjesërisht i realizuar për *janar-dhjetor 2024*, i përket politikës ndërgjegjësuere (III).

1 tregues performance me vlerë të synuar të parealizuar, për *janar-dhjetor 2024*, konkretisht që i përket politikës ndërgjegjësuere (III). Për 2 tregues performance, që i përkasin politikës parandaluese (I) nuk është bërë matja e vlerës së synuar për vitin 2024.

2.2 Impakti i implementimit të strategjisë në përputhje me agjendën e integritetit evropian

Zbatimi i Strategjisë Ndërsektoriale Kundër Korrupsionit 2024 - 2030 dhe konkretisht i Planit të Veprimit gjatë vitit 2024 ka kontribuar në mënyrë të drejtpërdrejtë në përmbushjen e angazhimeve të Shqipërisë në kuadër të procesit të integritetit evropian, me fokus të veçantë në forcimin e shtetit të së drejtës dhe përmbushjen e kriterëve të kapitujve 23 (Gjyqësori dhe të Drejtat Themelore) dhe 24 (Drejtësia, Liria dhe Siguria).

Masat e ndërmarra në kuadër të strategjisë kanë mbështetur rekomandimet e përsëritura të Komisionit Evropian dhe të aktorëve të tjerë ndërkombëtarë në lidhje me nevojën për të përforcuar kuadrin ligjor, integritetin institucional, për të rritur transparencën dhe përgjegjshmërinë në administratën publike, si dhe për të luftuar korrupsionin në mënyrë efektive në të gjitha nivelet e qeverisjes.

Gjatë vitit 2024, ecuria në drejtim të përgatitjes së ngritjes së mekanizmave për vlerësimin e riskut të korrupsionit, miratimi i planeve të integritetit në institucione kyçe, rritja e kapaciteteve të koordinimit ndërinstitucional dhe fuqizimi i rolit të koordinatorëve antikorrupsion në institucionet publike nëpërmjet forcimit të kapaciteteve organizative të Drejtorisë së Përgjithshme të Antikorrupsionit, të dhëna të hetimit dhe ndjekjes penale kundër korrupsionit përbëjnë rezultate konkrete që kanë kontribuar në rritjen e besueshmërisë ndërkombëtare të Shqipërisë. Këto ndërhyrje lidhen ngushtë me përmbushjen e standardeve të kërkuara për hapjen e kapitujve

negociues dhe me progresin e kërkuar nëpërmjet rekomandimeve të dhëna në raportet e progresit të Komisionit Evropian.

Për më tepër, harmonizimi i masave të parashikuara në strategji me mekanizmat e parandalimit të korrupsionit të përcaktuara në Konventën e Kombeve të Bashkuara kundër Korrupsionit, si dhe në Direktivën e BE-së për sinjalizuesit, dëshmon për orientimin e strategjisë drejt përafrimit me *acquis* në fushën e sundimit të ligjit, antikorrupsionit dhe të qeverisjes së mirë.

Nga zbatimi dhe monitorimi i Planit të Veprimit të Strategjisë Ndërsektoriale Kundër Korrupsionit 2024 - 2020, për vitin 2024, ka rezultuar se janë bërë përparime të dukshme në disa fusha të cilat prekin politikën parandaluese, ndëshkuese dhe ndërgjegjësuere antikorrupsion.

Në fushën e parandalimit, një ndër arritjet më të rëndësishme të vitit 2024 është përgatitja e vlerësimit për kuadrin ligjor dhe institucional antikorrupsion, rishikimi i planeve të integritetit në një sërë institucione të nivelit qendror dhe vendor dëshmon për institucionalizimin e masave parandaluese, në përputhje me standardet e Bashkimit Evropian për integritetin në administratën publike, kontrollit të deklarimit të pasurive dhe përgatitjen e një dokumenti Metodologji të Vlerësimit të Riskut të Korrupsionit në sektorin publik, e cila përbën një mekanizëm të ri për menaxhimin proaktiv të riskut të integritetit në institucionet publike.

Në fushën e ndëshkimit, janë intensifikuar përpjekjet për koordinimin ndërinstitutional ndërmjet strukturave hetimore dhe organeve të kontrollit administrative nëpërmjet forcimit dhe bashkëpunimit ndërmjet Prokurorisë së Posaçme dhe institucioneve të tjera, përfshirë edhe përmirësimin e referimit të rasteve të dyshuara të korrupsionit. Kjo është reflektuar në një numër më të lartë procedimesh të nisura mbi bazën e informacionit të administruar nga iniciativa të tjera pranë prokurorisë. Kjo ndërthurje e mekanizmave parandaluese me ato ndëshkuese është në përputhje me pritshmëritë e Bashkimit Evropian për rritjen e efektshmërisë së ndjekjes penale në rastet e korrupsionit, e cila vjen edhe si rezultat i rritjes së kapaciteteve dhe aftësive profesionale teknike të strukturave ligjzbatuese dhe të drejtësisë.

Në fushën e ndërgjegjësisë, janë ndërmarrë një sërë iniciativash publike që kanë për qëllim edukimin qytetar dhe rritjen e transparencës institucionale. Java e Integritetit 2024 përfshiu një gamë të gjerë aktiviteteve informuese, me përfshirjen e të rinjve, universiteteve, mediave dhe shoqërisë civile. Po ashtu, janë zhvilluar trajnime dhe fushata ndërgjegjësuere për sinjalizimin e korrupsionit, të cilat kanë për qëllim të nxisin pjesëmarrjen qytetare dhe të forcojnë besimin e publikut në mekanizmat institucionale. “Edukimi kundër korrupsionit” mbetet guri i themelit për vendosjen e hapave të rëndësishëm drejt krijimit të një kulture integriteti dhe kundër korrupsionit.

2.3 Komponentët që kanë nevojë për adresimin me qëllim përmirësimin e implementimit

Gjatë vitit të parë të zbatimit të Strategjisë Ndërsektoriale Kundër Korrupsionit 2024 - 2030, janë evidentuar disa aspekte që kërkojnë përmirësim për të rritur efektivitetin dhe koherencën e zbatimit të saj dhe për këtë mbeten ende disa komponentë që kërkojnë ndërhyrje të mëtejshme për të garantuar një zbatim më efektiv dhe të balancuar të objektivave strategjikë.

Së pari, niveli i matjes së rezultateve dhe impaktit të masave mbetet i qendëruar dhe vlerësimi bëhet vetëm nga stafi i Drejtorisë së Përgjithshme të Antikorrupsionit, duke adresuar që ky

vlerësim duhet të vijë nga pikat e kontaktit antikorrupsion, sepse kështu përmirësohet edhe zbatimi në vijim i strategjisë.

Së dyti, mungesa e llogaritjes së plotë të informacionit për buxhetin e përdorur për zbatimin e strategjisë mbetet problem dhe afekton zbatimin.

Së treti, komponenti i ndërgjegjësimit ndaj korrupsionit, megjithëse i mbështetur me aktivitete të vazhdueshme, duhet të matet mbi impaktin sistematik të ndikimit që japin në perceptimin publik dhe angazhimin qytetar.

Së katërti, auditimet e kryera nga strukturat e kontrollit të brendshëm në varësi të Ministrisë së Financave, megjithëse janë të përvitshme dhe të shtrira në shumë institucione, nuk shoqërohen gjithmonë me ndjekje efektive të masave të rekomanduara, duke kufizuar kështu ndikimin e tyre në forcimin e mekanizmave të llogaridhënies dhe uljen e riskut për korrupsion.

Së pesti, përfshirja e sektorit privat dhe shoqërisë civile në zbatimin dhe monitorimin e strategjisë kërkon një rritje të mëtejshme, përmes krijimit të mekanizmave të qëndrueshëm të bashkëpunimit dhe transparencës.

Së fundi, hetimet administrative të kryera nga Drejtoria e Përgjithshme Antikorrupsion, duhet të sigurojnë një qasje parandaluese dhe të sjellin bashkëpunim të strukturave të tjera, gjë që ndikon në efikasitetin e ndjekjes administrative të rasteve të dyshuara për shkelje të rënda të integritetit gjatë ushtrimit të detyrës.

Përmirësimi i këtyre komponentëve do të ndikojë drejtpërdrejt në rritjen e transparencës, llogaridhënies dhe impaktit real të strategjisë përgjatë viteve të zbatimit të saj.

2.4 Ekzekutimi i përgjithshëm i buxhetit

Financimi i Planit të Veprimit mbështetet nga dy burime kryesore: buxheti i shtetit dhe asistenca financiare e partnerëve ndërkombëtarë (donatorëve).

Në kuadër të procesit të monitorimit të zbatimit të masave dhe aktiviteteve të Planit të Veprimit 2024, institucioneve përgjegjëse u është kërkuar të raportojnë mbi buxhetin e planifikuar për vitin përkatës, si dhe mbi fondet e përdorura për realizimin e objektivave specifike të strategjisë, sipas masave (aktiviteteve) të zhvilluara.

Nga monitorim vihet re se për një pjesë të aktiviteteve të zbatuara gjatë vitit 2024, fondet e përdorura raportohen në mënyrë të përgjithshme si “kosto administrative”. Kjo qasje mbizotëron veçanërisht për objektivat e politikës parandaluese (Qëllimi I), si dhe për objektivat 2.1, 2.2 (pjesërisht) dhe 2.3 të politikës ndëshkuese (Qëllimi II). Për sa i përket politikës ndërgjegjësuere (Qëllimi III), financimi ndahet ndërmjet buxhetit të shtetit (përmes kostove administrative) dhe mbështetjes nga donatorët.

Partnerët ndërkombëtarë dhe donatorët që mbështesin institucionet zbatuese të planit të veprimit kanë kontribuar financiarisht në zbatimin e masave të parashikuara në politikën ndëshkuese (p.sh. masat për forcimin e kapaciteteve) dhe në aktivitetet sensibilizuese të politikës ndërgjegjësuere. Megjithatë, vlerat konkrete të kontributit financiar nuk janë të raportuara plotësisht me vlera dhe të dhëna në këtë raport.

Disa të dhëna për buxheti i përdorur sipas qëllimeve të politikës janë:

Qëllimi i politikës I (Parandalimi)

Objektivi 1.1: 41,514 lekë.

Objektivi 1.2: 69,400 lekë.

Objektivi 1.3: 269,416 lekë.

Objektivi 1.5: 665,946 lekë.

Qëllimi i politikës II (Ndëshkimi)

Objektivi 2.2: 1,458.52 lekë.

III. PROGRESI I LIDHUR ME QËLLIMET POLITIKE, OBJEKTIVAT SPECIFIKË, TREGUESIT E PERFORMANCËS DHE MASAT

Ky kapitull përshkruan progresin e arritur në kuadër të përmbushjes së tre politikave të SNNK, në drejtim të secilit qëllim politike¹⁴, objektivi dhe masave (e aktiviteteve) të Planit të Veprimit 2024-2026, për periudhën e monitorimit *1 janar - 31 dhjetor 2024*.

Qëllimet e politikave dhe objektivat specifikë bëhen të realizueshëm nëpërmjet masave dhe aktiviteteve në funksion të zbatimit të masave, të parashikuara për zbatim nga institucionet përgjegjëse edhe bashkëpunëtore të strategjisë dhe Planit të Veprimit.

3.1 Vlerësimi i arritjeve kryesore duke përdorur treguesit e performancës

Në përputhje me SNKK, janë kryer aktivitete dhe realizuar dhe masa të parashikuara në Planin e Veprimit 2024 – 2026 për periudhën raportuese të lidhura me të tre qëllimet e politikës, përkatësisht parandalimin (I), ndëshkimin (II) dhe, ndërgjegjësimin (III).

Politika Parandaluese (I) - Përmbledhje për arritjet në parandalimin e korrupsionit

Përmes **qëllimit të politikës parandaluese**, SNKK synon parandalimin dhe çrrënjosjen e korrupsionit në administratën publike dhe të të gjithë segmenteve shtetërore dhe me fokus të dedikuar nga institucionet që ofrojnë shërbime publike për qytetarët. Kjo qasje përmban numrin më të madh të objektivave specifike dhe për rrjedhojë dhe të masave dhe aktiviteteve të planifikuara për t'u zbatuar nga institucionet e përfshira në këtë dokument strategjik të luftës kundër korrupsionit.

Gjatë periudhës raportuese janë realizuar masat (produktet) dhe kryer aktivitetet (veprimet) sipas tabelës më poshtë.

Qëllimet e Politikës	Masat dhe Aktivitetet	Realizimi i Masave dhe Aktiviteteve			
		Masa dhe aktivitete të parashikuara për vitin 2024	Masa dhe aktivitete plotësisht të realizuara	Masa dhe aktivitete pjesërisht të realizuara ¹⁵	Masa dhe aktivitete të parealizuara ¹⁶


¹⁴ Aneksi nr. 1, Plani i Veprimit, i Strategjisë Ndërsektoriale Kundër Korrupsionit, miratuar me vendim të Këshillit të Ministrave nr. 859, datë 26.12.2024, Fletore Zyrtare 255, <https://qbz.gov.al/eli/vendim/2024/12/26/859>.

¹⁵ Aktivitet "pjesërisht i realizuar" është ai aktivitet që është realizuar në shkallën nga 50 deri në 100 për qind.

¹⁶ Aktivitet "i parealizuar" është ai i cili është realizuar në një shkallë nga 0 në 50 për qind.

Parandaluese (I)	Masa	16	12	2	2
	Aktivitet	43	33	8	2

Rezulton se nga 16 masa dhe 43 aktivitete të parashikuara në Planin e Veprimit 2024 – 2026, për janar-dhjetor 2024, për Politikën Parandaluese (I) janë zbatuar plotësisht 12 masa dhe 33 aktivitete, pjesërisht 2 masa dhe 8 aktivitete si dhe pazbatuar 2 masa dhe 2 aktivitete (masa: 1.2.2 e 1.3.5 dhe aktivitetet: 1.2.2.2 dhe 1.2.2.5).



Nga 15 treguesit e performances për Politikën Parandaluese (I), është arritur vlera e synuar për 13 tregues performance dhe për 2 prej vlera e synuar nuk është arritur. Për këtë vit të parë të zbatimit të Planit të Veprimit, 2024-2026, nuk ka asnjë tregues performance me vlera të pjesshme vjetore, të arritura.


Parandaluese (I)	Treguesit e performancës	Realizimi i Treguesve të Performancës		
		Vlera e synuar është realizuar plotësisht ¹⁷	Vlera e synuar është realizuar pjesërisht ¹⁸	Vlera e synuar nuk është e realizuar ¹⁹
	15	13	-	2 ²⁰

¹⁷ Që është realizuar në shkallën 100 për qind.

¹⁸ Që është realizuar në shkallën nga 50 deri në 100 për qind.

¹⁹ Që nuk është realizuar dhe tregues për të cilin nuk janë mbledhur ose nuk ka qenë e mundur të mbledhen të dhëna.

²⁰ Treguesi 1.3.1 dhe 1.3.2 nuk mund të maten për vitin 2024.



1.1 Forcimi i kornizës ligjore dhe kapaciteteve institucionale në parandalimin e korrupsionit.

Për këtë objektiv janë përcaktuar 2 tregues performance:

1.1.1: Përqindja e akteve ligjore dhe nënligjore (akte te brendshme dhe marrëveshjet ndërkombëtare) të miratuara nga ato të planifikuara për t'u miratuar.

1.1.2: Përqindja e institucioneve publike qendrore dhe vendore që kanë ngritur dhe vënë në funksion strukturat antikorruption.

Plani i Veprimit për Objektivin 1.1, në periudhën Janar-Dhjetor 2024 parashikon 14 aktivitete dhe 4 masa.

1.1.1: Përqindja e akteve ligjore dhe nënligjore (akte te brendshme dhe marrëveshjet ndërkombëtare) të miratuara nga ato të planifikuara për t'u miratuar.

Vlera e synuar për treguesin e performancës 1.1.1 për vitin 2024 është: Përgatitja e vlerësimit dhe vendosja e vlerës bazë për monitorimin.

Për të arritur vlerat e treguesit të performancës në përputhje me pasaportën e treguesve të performancës dhe konkretisht me planin e veprimit 2024-2026, janë parashikuar përkatësisht aktivitetet (5) dhe masat (2), si më poshtë.

1.1.1	Forcimi i kuadrit ligjor për parandalimin e korrupsionit
1.1.1.1	Identifikimi i nevojës dhe parashikimi i projektligjeve dhe akteve nënligjore të nevojshme për parandalimin e korrupsionit, bazuar në rekomandimet e dhëna Shqipërisë (raport vlerësimi)
1.1.1.2	Miratimi i ndryshimeve ligjore dhe akteve nënligjore (të parashikuara) për parandalimin e korrupsionit, duke përmendur: - Ligji për Zyrën e Rekuperimit të Aseteve - Ligjin për Sinjalizimin dhe Mbrojtjen e Sinjalizuesve -Ligji për Parandalimin e Konfliktit të Interesave në Ushtrimin e Funksioneve Publike, si dhe çdo akt tjetër (ligjor dhe nënligjor) lidhur me fushën antikorruption.

1.1.2	Përmirësimi i procedurave administrative në përgatitjen dhe miratimin e legjislacionit të parandalimit të korrupsionit
1.1.2.1	Metodologji (Manual) për Vlerësimin e Hapësirave për Korrupsion në ligje (<i>Corruption Proofing of Legislation</i>), për shërbimet e Kuvendit (miratimi i Manualit)
1.2.2.2	Kryerje e vlerësimit sipas Metodologjisë së hartuar në aktivitetin 1.1.2.1, të ligjeve dhe opinione /analiza të hartuara
1.1.2.3	Kryerje e procesit të Vlerësimit të Hapësirave për Korrupsion gjatë hartimit të akteve nga strukturat e përfshira në proces (në zbatim të Manualit të Hartimit të Legjislacionit)

Realizimi i masave të parashikuara kryhet përmes aktiviteteve që vijnë përgjatë gjithë vitit me vlera të matshme të raportit të analizës së kryer, metodologjive të hartuara dhe procesit të kryer në zbatim të tyre, mbi baza 6-mujore dhe vjetore.

Për janar – dhjetor 2024, është marrë në vlerësim kuadri ligjor dhe institucional i brendshëm i vendit me kompetenca në luftën kundër korrupsionit. Është kryer një dokument/raport vlerësimi, që analizon të gjitha masat ligjore dhe institucionale, duke shqyrtuar efektivitetin e tyre. Dokumenti ofron një pasqyrë gjithëpërfshirëse të kuadrit ligjor antikorrupsion dhe kërkesës për përmirësim dhe pëditësim të tyre, duke vlerësuar fushat dhe sektorët që ndonëse nuk kanë një lidhje të drejtpërdrejtë me korrupsionin janë të ndërlidhura me të dhe ndikojnë në përhapjen e tij, duke e bërë të domosdoshme trajtimin e këtyre çështjeve për të ofruar një analizë sa më të plotë.

Dokumenti përmban një vlerësim tematik të kuadrit ligjor dhe institucional kundër korrupsionit, përfshirë kuadrin rregullator mbi mekanizmat antikorrupsion, si: konflikti i interesave; sinjalizimi dhe mbrojtja e sinjalizuesve; rekuperimi i aseteve; lobimi dhe takimet e instrumentat e zbatimit të tij; kontrolli i financimit të partive politike; korrupsioni dhe format e tij përfshirë zyrtarët e huaj si dhe aspekte të ndërgjegjësimit dhe angazhimit shoqëror për luftën kundër korrupsionit.

Struktura e analizës është e organizuar në mënyrë që për çdo çështje të ofrohet një listë me akte ligjore, me qëllim nevojën dhe adresimin e kërkesave për të shqyrtuar masat ligjore dhe institucionale (nëse do të duhet të ketë). Dhe në vijim, për secilën çështje identifikohen problemet dhe mangësitë, të cilat burojnë nga raportet e Bashkimit Evropian dhe organizmave ndërkombëtarë, qeveritarë, që monitorojnë progresin e Shqipërisë në luftën kundër korrupsionit, si dhe nga raportet e organizatave të shoqërisë civile që ofrojnë perspektivën lokale mbi zbatimin e këtyre masave. Po ashtu, gjetjet e ekspertëve, të cilët kanë evidentuar mangësi dhe hapësira në kuadrin ligjor dhe institucional, janë përfshirë në këtë analizë. Dokumenti analizë vjen në kuadër edhe të nismës së ndërmarrë nga Kuvendi i Republikës së Shqipërisë, në relevancë me aktivitetin e Komisionit të Posaçëm Parlamentar, “Për thellimin e reformave për mirëqeverisjen, sundimin e ligjit dhe antikorrupsionin për Shqipërinë 2030 në Bashkimin Evropian”, miratuar me vendimin nr. 50/2024. Dokumenti analizë i kryer mund të gjendet i botuar edhe në link: www.masl.al dhe në link: <https://masl.al/antikorrupsioni/>.

Raporti ka përcaktuar aktet ligjore, themelore, për luftën kundër korrupsionit dhe ndjekjen e tyre nga strukturat përgjegjëse, që synojnë përmirësime në kuadrin ligjor dhe institucional, forcimin e kapaciteteve dhe përmirësimin e performancës së institucioneve që merren me luftën kundër korrupsionit.

Gjatë vitit 2024, ka filluar procesi i hartimit të disa prej këtyre ligjeve të parashikuara në raportin analizë. Përkatësisht, është caktuar ministri përgjegjës për iniciimin dhe propozimin e ligjit për sinjalizimin, në përputhje me Vendimin e Këshillit të Ministrave nr.818, datë 26.12.2024, që mund të gjendet i publikuar në link: <https://qbz.gov.al/eli/vendim/2024/12/26/818>. Ky ligj do të sigurojë përafrimin e ligjit të brendshëm me direktivën e Bashkimit Evropian (Direktiva (BE) 2019/1937 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e datës 23 tetor 2019 për mbrojtjen e personave që raportojnë shkelje të së Drejtës Evropiane, <https://eur-lex.europa.eu/legal-content/en/TXT/?uri=CELEX%3A32019L1937>).

Ligji për konfliktin e interesave në ushtrimin e funksioneve publike, draft, vijon në jetë i dorëzuar për ndjekje të procedurave parlamentare pranë Kuvendit të Shqipërisë. Ministria e Brendshme ka hartuar projektligjin “Për krijimin e Zyrës së Rikuperimit të Aseteve”, i cili është dakordësuar me institucionet e linjës dhe dërguar për miratim në Këshillin e Ministrave nëpërmjet sistemit e-akte në Departamentin e Akteve Rregullatore në Kryeministri.

Një tjetër akt ligjor, i kryer gjatë vitit 2024 ishte miratimi i ligjit të ri të inspektimeve (ligj nr. 99/2024, “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë”, botuar në Fletoren Zyrtare nr. 192, datë 13 Nëntor 2024). Ligji parashikon disa garanci që synojnë të sigurojnë (ndër të tjera) integritetin e veprimtarisë së inspektimit dhe luftën kundër korrupsionit, sidomos: pavarësia e inspektimit, parimi i informimit të publikut dhe mbrojtjes së konfidencialitetit, transparencë, ligjshmëria dhe parimi i këshillimit dhe informimit të subjektit të inspektimit. Ligji parashikon krijimin e një procesi transparent dhe të besueshëm për shqyrtimin e ankimit administrativ ndaj masave administrative të marra nga trupat inspektuese, me qëllim shmangien e konfliktit të interesit. Po ashtu, planifikimi dhe targetimi më i mirë në procedurat inspektuese, komunikimi me subjektet private dhe promovimi i sjelljes profesionale dhe etike, janë parë si mekanizma për të parandaluar korrupsionin në sistemin e inspektimeve.

Nga ana tjetër, në zbatim të urdhrit të Kryeministrit nr.57, datë 18.04.2024 “Për rishikimin e legjislacioneve e koncesioneve dhe partneriteteve publike private”, ka filluar dhe është në proces hartimi i një projektligji të ri që pritet të përfshijë procedura më transparente, në këtë fushë veprimi.

Gjatë vitit 2024, janë përmirësuar procedurat administrative të institucioneve me kompetenca hartimi dhe ligjbërjeje, në përgatitjen dhe miratimin e legjislacioneve të parandalimit të korrupsionit. Kuvendi i Shqipërisë ka miratuar dokumentin Metodologji për Vlerësimin e Hapësirave për Korrupsion në ligje (*Corruption Proofing of Legislation*), për shërbimet e Kuvendit dhe gjithashtu ka bërë ndërhyrjet përkatëse në rregulloren e tij. Gjatë vitit 2024, është hartuar dhe përgatitur për miratim Metodologjia e Vlerësimit Parandalues për Korrupsionin (CPL) në Kuvendin e Shqipërisë. Miratimi i këtij dokumenti mbeti vetëm për procese formale për t’u kryer finalisht me vendim të Konferencës së Kryetarëve.

Gjithashtu, gjatë vitit 2024 janë kryer nga shërbimet e Kuvendit, në total 10 raporte vlerësimi, në bashkëpunim me asistencën teknike të jashtme pranë Kuvendit. Ndërkohë, përgjatë vitit 2024, ka vijuar procesi i Vlerësimit të Hapësirave për Korrupsion gjatë hartimit të akteve nga njësitë juridike pranë ministrive të linjës.

Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural ka hartuar dhe propozuar për vitin 2024 20 akte ligjore, për të cilat është kryer i plotë procesi i vlerësimit të hapësirave për korrupsion.

Ministria e Brendshme në kuadrin e hartimit të projektligjit “Për krijimin e Zyrës së Rikuperimit të Aseteve”, po ashtu ka kryer procesin e vlerësimit për korrupsion në zbatim të Manualit të Hartimit të Legjislacionit.

Sa më sipër, masat dhe aktivitetet e parashikuara për këtë periudhë zbatimi, kanë ndikuar drejtpërdrejt në vlerën e synuar të treguesit të performanceës 1.1.1. Në përfundim, vlerësohet se gjatë vitit 2024, është hartuar dhe bërë pjesë e këtij raporti monitorimi dokumenti analitik, raportet e vlerësimit për aktet ligjore duhet të përgatiten dhe miratohen përgjatë viteve të zbatimit të Strategjisë Ndërsektoriale Kundër Korrupsionit. Ky tregues performance është realizuar në masën 100%.

Paraqitja e realizueshmërisë së treguesit sipas Pasaportës së Treguesve, paraqitet si vijon:

Vlerat Bazë	2023	
	N/A	
	2024	Përgatitja e vlerësimit dhe vendosja e vlerës bazë për monitorimin
	2025	Të gjitha ligjet (aktet e tjera) e parashikuara për miratim nga Udhërrëfyesi dhe në listën e akteve (Plani Analitik i Akteve), të miratuara
	2026	Të gjitha ligjet (aktet e tjera) e parashikuara për miratim nga Udhërrëfyesi dhe në listën e akteve (Plani Analitik i Akteve), të miratuara
	2027	Të gjitha ligjet (aktet e tjera) e parashikuara për miratim nga Udhërrëfyesi dhe në listën e akteve (Plani Analitik i Akteve), të miratuara
	2028	Të gjitha ligjet (aktet e tjera) e parashikuara për miratim nga Udhërrëfyesi dhe në listën e akteve (Plani Analitik i Akteve), të miratuara
	2029	Të gjitha ligjet (aktet e tjera) duhet të miratohen para vitit 2029, përveç nëse ka të tjera shtesë në vlerësim
	2030	Të gjitha ligjet (aktet e tjera) duhet të miratohen para vitit 2029, përveç nëse ka të tjera shtesë në vlerësim
Vlera synuar/ Targeti	2024 (targeti i synuar)	Raport vlerësimi
	2024 (targeti i arritur)	Raport vlerësimi i kryer

1.1.2: *Përqindja e institucioneve publike qendrore dhe vendore që kanë ngritur dhe vënë në funksion strukturat antikorruption.*

Vlera e synuar për treguesin e performancës 1.1.2 për vitin 2024 është: Përgatitja e vlerësimit dhe përcaktimi i vlerës bazë për monitorim.

Për të arritur vlerat e treguesit në përputhje me pasaportën e treguesve të performancës dhe konkretisht me planin e veprimit 2024-2026, janë parashikuar aktivitetet (10) dhe masat (2) si më poshtë.

1.1.3	Forcimi i kornizës institucionale dhe kapaciteteve profesionale teknike për parandalimin e korrupsionit
1.1.3.1	Vlerësim i kuadrit institucional dhe organizativ të institucioneve me kompetenca në luftën kundër korrupsionit (raport/analizë vlerësimi)
1.1.3.3	Institucionalizimi i Pikave të Kontaktit Antikorrupsion në institucionet publike (nivel qeveritar, të pavarur dhe ligjzbatues), si agjentët e parë të ndryshimit në politikat antikorrupsion
1.1.3.4	Identifikimi i institucioneve në të gjitha nivelet, ku nuk janë emëruar (mungojnë) koordinatorët antikorrupsion, pikat e kontaktit kundër korrupsionit, koordinatorët e integritetit dhe koordinatorët e së drejtës për informim dhe uniformizimi i procesit të caktimit
1.1.3.5	Emërimi i koordinatorëve antikorrupsion, të pikave të kontaktit antikorrupsion, të koordinatorëve të integritetit dhe koordinatorëve të së drejtës për informim
1.1.3.6	Udhëzime dhe takime informuese (2 takime/vit) me Pikat e Kontaktit Antikorrupsion mbi analizat antikorrupsion
1.1.3.7	Identifikimi i nevojave për trajnime të koordinatorëve antikorrupsion, pikave të kontaktit antikorrupsion, koordinatorëve të integritetit dhe koordinatorëve të së drejtës për informim, bashkëpunim dhe koordinim
1.1.3.8	Rritje kapacitetesh dhe kualifikim të vazhdueshëm për koordinatorët antikorrupsion, pikave të kontaktit antikorrupsion, koordinatorëve të integritetit dhe koordinatorëve të së drejtës për informim (trajnime dhe sesione informimi të kryera)
1.1.4	Forcimi i kornizës institucionale dhe kapaciteteve profesionale teknike për parandalimin e korrupsionit
1.1.4.2	Lidhja e marrëveshjeve të bashkëpunimit (dy-palëshe dhe shumë-palëshe) mes institucioneve me kompetenca parandalimi kundër korrupsionit
1.1.4.3	Fuqizim i Ekipit Tematik Antikorrupsioni (anëtar të institucioneve zbatuese të SNKK) për koordinimin të informacioneve dhe të dhënave të raportit të monitorimit
1.1.4.4	Takime dhe forume teknike diskutimi të anëtarëve të Ekipit Tematik Antikorrupsioni (anëtar të institucioneve zbatuese të SNKK) në pararendje të finalizimit të raporteve dhe të dhënave

Realizimi i masave të parashikuara kryhet përmes aktiviteteve që vijnë përgjatë gjithë vitit me vlera të matshme të raportit të analizës së kryer, vlerësimit dhe organikave strukturore të ngritura dhe si dhe kapaciteteve profesionale të forcuar dhe të përmirësuara, mbi baza 6-mujore dhe vjetore.

Për janar – dhjetor 2024, është marrë në vlerësim kuadri ligjor dhe institucional i brendshëm i vendit me kompetenca në luftën kundër korrupsionit. Është kryer një dokument/raport vlerësimi, që analizon të gjitha institucionet me kompetenca antikorrupsioni, duke shqyrtuar efektivitetin e tyre. Dokumenti ofron një pasqyrë gjithëpërfshirëse të strukturave antikorrupsion dhe kërkesës për përmirësim dhe përditësim të tyre, për të synuar mirëorganizimin e tyre dhe rritur efikasitetin. Nga kjo analizë e kryer rezulton se në luftën kundër korrupsionit në Shqipëri, ka disa struktura

përgjegjëse kryesore. Legjislativi, ekzekutivi, gjyqësori dhe një sërë organesh të pavarura luajnë role thelbësore, duke ushtruar funksione dhe detyra specifike në këtë fushë. Kuvendi, miraton ligjet kundër korrupsionit dhe është përgjegjës për vlerësimin e tyre pas miratimit. MAPA, ndër të tjera, luan rol kyç në harmonizimin e politikave kundër korrupsionit, për të promovuar integritetin, transparencën dhe përgjegjshmërinë, duke fuqizuar qeverisjen e mirë dhe duke iu përshtatur kërkesave të procesit të integritetit në Bashkimin Evropian. Në kuadër të reformave në sistemin e drejtësisë, që prej vitit 2016 u krijua Struktura e Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar (SPAK), e cila përfshin Byroën Kombëtar të Hetimit (BKH) si dhe Gjykatat e Posaçme të shkallës së parë dhe të apelit për trajtimin e çështjeve të korrupsionit dhe krimin të organizuar. Po ashtu, disa struktura të pavarura e kushtetuese, luajnë rol të rëndësishëm në parandalimin dhe luftën kundër korrupsionit, ku përmendim KLSH-në dhe ILDKPKI-në.

Kuadri institucional dhe organizativ i institucioneve me kompetenca në luftën kundër korrupsionit mbështetet mjaftueshëm tek veprimtaria e institucioneve/strukturave të tjera me kompetenca për hetimin e rasteve të korrupsionit në autoritetet publike si Drejtoria e Përgjithshme Antikorrupsion së bashku me Koordinatorët kundër Korrupsionit, Agjencinë për Dialog e Bashkëqeverisje, Drejtoria e Investigimit të Brendshëm (Antikorrupsion) pjesë e strukturës së Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve, dhe po ashtu ajo pranë Doganave, Njësia Përgjegjëse për Inspektim Financiar Publik, pjesë e Strukturës së Ministrisë së Financave si dhe struktura të tjera publike që veprojnë në fusha të veçanta (trajtohen më hollësisht në pjesë të dedikuara të këtij dokument analize. Dokumenti analizë i kryer mund të gjendet i botuar edhe në link: www.masl.al dhe në link: <https://masl.al/antikorrupsioni/>, gjithashtu edhe pjesë e dokumentit analitik, publikuar në link: https://masl.al/wp-content/uploads/2025/04/SHTYLLA-I_MIREQEVERISJA_ANALIZA-FINALE_JANAR-2025.pdf.

Aktiviteti i parashikuar për institucionalizimin e pikave të kontaktit antikorrupsion në institucionet publike (nivel qeveritar, të pavarur dhe ligjzbatues), si agjentët e parë të ndryshimit në politikën antikorrupsion, gjatë vitit 2024, ka qenë direkt i ndërruar edhe nga modifikimi dhe parashikimi që do të përfshihej për ta në përmbajtjen e Strategjisë Ndërinstitucionale Kundër Korrupsionit. Në përputhje me Pjesën IV të këtij dokumenti dhe me synimin e krijimit të një rrjeti funksional të pikave të kontaktit antikorrupsion për të ndjekur zbatimin e strategjisë, struktura përgjegjëse pranë Koordinatorit Kombëtar Kundër Korrupsionit, Drejtoria e Përgjithshme e Antikorrupsionit, ka konstituuar një rrjet prej 119 institucioneve me pika kontakti, përfshirë të gjitha Ministrinë e linjës dhe Ministrat e Shtetit, institucionet qendrore, institucionet e gjyqësorit si dhe të gjitha Bashkitë dhe Qarqet e vendit.

Në vitin 2024 u krye ristrukturimi i Drejtorisë së Përgjithshme Antikorrupsion, si një ndër hapat kryesorë, që synoi fuqizimin e kapaciteteve për monitorimin e politikave parandaluese dhe ndërgjegjëse, duke adresuar disa nga rekomandimet e Komisionit Evropian lidhur me zbutjen e rreziqeve të korrupsionit në sektorët më të ndjeshëm. Përmes këtij ristrukturimi, u mundësua edhe një rikonceptim i hartës së vendosjes së Koordinatorëve Antikorrupsion, për të garantuar që masat kundër korrupsionit të jenë të qëndrueshme dhe të zbatohen në mënyrë efikase. Kështu, deri në dhjetor 2024, janë emëruar 22 Koordinatorë Antikorrupsion nga 45 në total²¹.

²¹ Vendim i Këshillit të Ministrave, nr. 436, datë 26.6.2024, kreu III, pika 1.

Në vitin 2024, rezulton se: në nivelin qendror, të gjitha ministritë e linjës (11), ministrat e shtetit (6), 48 institucione varësie të ministrave të linjës, 3 institucione të pavarura (Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, Kuvendi dhe KLP) kanë miratuar Plane Integriteti, si dhe Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve (administrata tatimore). Si rezultat në të gjitha këto institucione publike ku janë miratuar Plane Integriteti, janë gjithashtu të emëruar edhe koordinantët e integritetit.

Në vitin 2024, rezulton se nga komunikimet zyrtare të autoriteteve publike me Zyrën e Komisionerit për të Drejtën e Informimit, si dhe nga publikimi i të dhënave në faqet zyrtare të internetit të autoriteteve publike, rezulton se të gjithë autoritetet publike, gjithsej 355, e kanë të caktuar Koordinatorin për të Drejtën e Informimit.

Në vitin 2024, janë zhvilluar dy takime me pikat e kontaktit antikorrupsion (maj dhe korrik 2024), me qëllim diskutimin e analizës së raportit të monitorimit të Planit të Veprimit (raporti vjetor) dhe evidentimin e rolit të tyre për ecurinë e progresit të dokumentit të ri strategjik.

Gjatë vitit 2024, është përmirësuar edhe promovuar korniza institucionale dhe e kapaciteteve profesionale teknike për parandalimin e korrupsionit. Në dhjetor 2024, është lidhur marrëveshje e bashkëpunimit midis Drejtorisë së Përgjithshme të Antikorrupsionit dhe Agjencisë së Prokurimit Publik, dy autoritete me kompetenca parandalimi në luftën kundër korrupsionit në administratën publike. Marrëveshja mund të gjendet e publikuar dhe lehtësisht e aksesueshme në link: <https://www.app.gov.al/GetData/DownloadDoc?documentId=6a6ecbd4-d0cd-475a-84dd-3698f1484917>.

Gjithashtu, gjatë vitit 2024, Drejtoria e Përgjithshme e Antikorrupsionit në rolin e autoritetit përgjegjës për koordinimin e zbatimit të planit të veprimit antikorrupsion, ka vijuar me informimin dhe lehtësimin e detyrave për zbatim të anëtarëve (teknikë dhe nivelit të lartë drejtues) të Ekipit Tematik Antikorrupsion, duke ofruar udhëzime nëpërmjet takimeve të punës dhe komunikimeve elektronike. Në datë 10.5.2024, është mbajtur takimi (forumi) teknik midis anëtarëve të Ekipit Tematik Antikorrupsion, në pararendje të finalizimit dhe miratimit të raportit vjetor të monitorimit për planin e veprimit antikorrupsion 2023.

Gjatë vitit 2024, është kryer një vlerësim i nevojave për trajnim (VNT) për stafe dhe ekipe pranë administratës publike për kuadrin e parandalimit të korrupsionit, akte dhe njohuri rreth tyre. Analiza mbetet për tu kryer e plotë me përfshirjen e subjekteve të përmendur në aktivitetin 1.1.3.7 në vijim. ASPA ka zhvilluar dhe ofruar njëkohësisht organizimin e trajnimit me temë “Antikorrupsioni: mekanizmat, praktikat, mbrojtjet” me audiencë pikat e kontaktit antikorrupsion. Moduli u zhvillua në 6 seanca dhe me pjesëmarrje 34 persona, përgjatë periudhës 27 mars-19 prill 2024.

Sa më sipër, masat dhe aktivitetet e parashikuara për këtë periudhë zbatimi, kanë ndikuar drejtpërdrejt në vlerën e synuar të treguesit të performancës 1.1.2. Në përfundim, vlerësohet se gjatë vitit 2024, është hartuar dhe bërë pjesë e këtij raporti monitorimi dokumenti analitik, raport vlerësimi për përgatitjen e vlerësimit dhe përcaktimi i vlerës bazë për monitorim referuar strukturave antikorrupsion, përgjatë viteve të zbatimit të Strategjisë Ndërsëktoriale Kundër Korrupsionit. Ky tregues performance është realizuar në masën 100%.

Paraqitja e realizueshmërisë së treguesit sipas Pasaportës së Treguesve, paraqitet si vijon:

Vlerat Bazë	2023	
	N/A	
	2024	Përgatitja e vlerësimit dhe vendosja e vlerës bazë për monitorimin
	2025	80% e institucioneve publike kanë strukturat antikorrupsion
	2026	90% e institucioneve publike kanë strukturat antikorrupsion (kumulative)
	2027	100% e institucioneve publike kanë antikorrupsion (kumulative)
	2028	100% e institucioneve publike kanë strukturat antikorrupsion (kumulative)
	2029	100% e institucioneve publike kanë strukturat antikorrupsion (kumulative)
	2030	100% e institucioneve publike kanë strukturat antikorrupsion (kumulative)
Vlera synuar/ Targeti	2024 (targeti i synuar)	Raport vlerësimi
	2024 (targeti i arritur)	Raport vlerësimi i kryer

Niveli i realizimit të objektivit 1.1

Niveli i realizimit të *Objektivit 1.1 “Forcimi i kornizës ligjore dhe kapaciteteve institucionale në parandalimin e korrupsionit”* në lidhje me realizimin e treguesve të performancës për periudhën janar - dhjetor 2024 është **100%**.

Përllogaritja është kryer duke matur dhe evidentuar raportet e vlerësimit të kryer, në përputhje me parashkrimin e bërë në listën e treguesve të performancës, aneks 2 i Strategjisë Ndërsektoriale Kundër Korrupsionit 2024-2030.

Përllogaritja është kryer sipas formulës së mëposhtme:

$$NR\ 1.1 = \frac{TP\ 1.1.1\ (100\%) + TP\ 1.1.2\ (100\%)}{2\ TP} \times 100\% = 100\%$$

Verifikueshmëria e të dhënave

Të dhënat e raportuara mbi treguesit e performancës janë bazuar në informacionin e raportuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Antikorrupsionit për monitorimin e zbatimit të planit të veprimit për janar - dhjetor 2024. Dokumenti analitik, referuar treguesve të performancës, mbetet i aksesueshëm në link: <https://masl.al/raporte/>.

Risqet për realizimin e Objektivit 1.1

Për vitin 2024, nuk janë evidentuar risqe në realizimin e objektivit specifik. Ecuria e zbatimit të masave, specifikisht të lidhura me miratimin e akteve ligjore dhe ngritjen e strukturave institucionale, paraqet risk të mundshëm, kryesisht në vonesa, që mund të afektohen edhe nga fakti që viti në vijim, 2025, është vit zgjedhor.

1.2 *Forcimi i transparencës, llogaridhënies dhe integritetit të institucioneve publike në të gjitha nivelet e qeverisjes.*

Për këtë objektiv janë përcaktuar 3 tregues performance:

1.2.1: *Përqindja e institucioneve publike qendrore dhe vendore që kanë në përdorim regjistër elektronik të kërkesave dhe përgjigjeve (trend rritës).*

1.2.2: *Përqindja e deklaratave të pasurisë dhe interesave privatë, të dorëzuara dhe të audituara, nga numri total që duhet të dorëzohen.*

1.2.3: *Përqindja e institucioneve publike, qendrore, vendore) që kanë hartuar Plane Integriteti (trend rritës).*

Plani i veprimit për Objektivin 1.2, në periudhën Janar-Dhjetor 2024 parashikon 15 aktivitete dhe 5 masa.

1.2.1: *Përqindja e institucioneve publike qendrore dhe vendore që kanë në përdorim regjistër elektronik të kërkesave dhe përgjigjeve (trend rritës).*

Vlera e synuar për *treguesin e performancës 1.2.1* për vitin 2024 është: Përgatitja e vlerësimit për matjen e treguesit të performancës në vitet në vijim.

Për të arritur vlerat e treguesit në përputhje me pasaportën e treguesve të performancës dhe konkretisht me planin e veprimit 2024-2026, janë parashikuar aktivitetet (5) dhe masa (1) si më poshtë.

1.2.1	Forcimi i transparencës së institucioneve publike në të gjitha nivelet e qeverisjes
1.2.1.1	Identifikimi i institucioneve që kanë shërbime dhe procedura që janë ende të padigjitalizuara (1); mund të digjitalizohen (2) dhe vijimi i digjitalizimit të tyre (3)
1.2.1.2	Statistika përdorimi të platformës e-Albania për shërbimet publike nga qytatërit mbi baza 6-mujore
1.2.1.3	Instalimi i Regjistrat Elektronik të Kërkesave dhe Përgjigjeve për të drejtën e informimit në autoritetet publike përcaktuar sipas vlerësimit të Komisionerit për të Drejtën e Informimit, për të gjitha nivelet e qeverisjes
1.2.1.5	Hartimi i një përmbledhjeje të vendimarrjes së Komisionerit për të Drejtën e Informimit për çështje me interes publik dhe rastet e kufizimit të informacionit, konceptet e konfidencialitetit dhe mbrojtjes së të dhënave personale (vjetore)
1.2.1.6	Trajnime të vazhdueshme/sesione informimi mbi të drejtën e informimit ndaj organeve të administratës dhe publikut

Realizimi i masës së parashikuar kryhet përmes aktiviteteve që vijnë përgjatë gjithë vitit me vlera të matshme të identifikimit të institucioneve, vendosjes së Regjistrat Elektronik të Kërkesave dhe Përgjigjeve për të drejtën e informimit, hartim materialesh, etj., mbi baza 6-mujore dhe vjetore. Këto masa janë me kohëzgjatje përgjatë afatit të zbatimit të këtij plani veprimi 2024-2026 dhe si e tillë matja e tyre do të bëhet respektivisht sipas informacionit të kryer për periudhën e kërkuar.

Për janar – dhjetor 2024, institucione në varësi të MBZHR si: AKU, AKVMB dhe QTTB-të, rezultojnë të kenë shërbime dhe procedura ende të padigjitalizuara, i kanë identifikuar ato dhe janë komunikuar pranë AKSHI për procedime dhe veprime të mëtejshme. AKU ka kryer veprime dhe kërkuar ndërhyrje në procedurat e laboratorit (përmirësimi i sistemit AKU-net), me ndërveprime

me sistemin LIMS që administron ISUVI si dhe me IQ. Gjithashtu, lidhur me proceset e inspektimit në pikat e kalimit kufitar që synojnë përmirësimin e sistemit AKU-net, është kërkuar ndërhyrje nga AKSHI.

Përgjatë 2024, numri total i përdoruesve të regjistruar në portalin e-Albania ka shënuar shifrën e 3.166.983²², duke dëshmuar një rritje kundrejt shifrës së përdoruesve së një viti më parë (viti 2023 ishte 2.979.361 përdorues). Gjatë vitit 2024, janë shtuar gjithsej 187.622 përdorues të rinj, më shumë në platformën e-Albania.

Në vitin 2024, u realizua instalimi i Regjistrimit Elektronik të Kërkesave dhe Përgjigjeve për të drejtën e informimit në 25 autoritete të reja publike, duke e çuar gjithsej në 247 numrin e tyre që kanë instaluar regjistrin. Ky proces ka vijuar njëkohësisht me zhvillimin dhe ofrimin e trajnimeve të rregullta me koordinatorët e të drejtës së informimit dhe mbi mënyrën e përdorimit të tij. Autoritete që përmenden janë: Posta Shqiptare, Sh.a; Universiteti “Aleksandër Moisiu”, Durrës; Universiteti i Arteve, Tiranë; Qendra Kombëtare e Transfuzionit të Gjakut; Sekretariati i Nismës për Transparencë në Industrinë Nxjerrëse; Agjencia Kombëtare e Diasporës; Agjencia Kombëtare e Financimit të Arsimit të Lartë; Agjencia Kombëtare e Rinisë; Agjencia e Inteligjencës Financiare; Enti Kombëtar i Banesave; Enti Rregullator i Energjisë; Këshilli i Qarkut Berat, Këshilli i Qarkut Shkodër, Këshilli i Qarkut Tiranë, Prefekti i Qarkut Durrës, Prefekti i Qarkut Korçë, Prefekti i Qarkut Lezhë, Prefekti i Qarkut Shkodër, Prefekti i Qarkut Vlorë, “Porti Detar Vlorë” Sh.a dhe “Porti Detar Sarandë” Sh.a.

Në vitin 2024, ka filluar puna për hartimin e përmbledhjes mbi vendime të Komisionerit për të Drejtën e Informimit për çështje me interes publik dhe rastet e kufizimit të informacionit, konceptet e konfidencialitetit dhe mbrojtjes së të dhënave personale, duke përzgjedhur rastet e vendimmarrjes më relevante dhe më të dobishme për njoftime dhe informacione (raste të mira).

Gjithashtu, në vitin 2024, KDIMDP zhvilloi dhe ofroi 5 trajnime me koordinatorët për të drejtën e informimit dhe personat e kontaktit për të dhënat e hapura nga të gjitha autoritetet publike/organet e sektorit publik qendrore dhe të strukturave të varësisë, të organeve të vetëqeverisjes vendore, institucioneve të pavarura, atyre të sistemit të drejtësisë (gjykata dhe prokurori), të shoqërive/kompanive me kapital publik. Trajnimet u fokusuan në tre elemente kryesore: (1) përmbushjen e detyrimeve të legjislacionit lidhur me aksesin në informacionin publik dhe publikimi e përditësimi i Regjistrimit të Kërkesave dhe Përgjigjeve; (2) Regjistri Elektronik i Kërkesave dhe Përgjigjeve nëpërmjet portalit pyetshtetin.al, instalimi/përditësimi i tij në autoritete publike të reja apo ku ka patur ndryshim të koordinatorit, si dhe mbi (3) përmbushjen e detyrimeve të legjislacionit lidhur me të dhënat e hapura dhe ripërdorimin e informacionit publik.

Sa më sipër, masa dhe aktivitetet e parashikuara për këtë periudhë zbatimi, kanë ndikuar drejtpërdrejt në vlerën e synuar të treguesit të performancës 1.2.1. Në përfundim, vlerësohet se gjatë vitit 2024, KDIMDP ka të plotë informacionin referuar institucioneve publike qendrore dhe vendore që kanë në përdorim regjistrë elektronik të kërkesave dhe përgjigjeve dhe administron të dhëna për to. Janë hartuar dhe bërë pjesë e këtij raporti monitorimi, të dhënat për përgatitjen e vlerësimit dhe përcaktimi i vlerës bazë për monitorim mbi regjistrin elektronik të kërkesave dhe

²² Në muajin qershor 2024, numri i përdoruesve u shënuar 3.101.636 persona.

përgjigjeve, përgjatë viteve të zbatimit të Strategjisë Ndërsektorale Kundër Korrupsionit. Ky tregues performance është realizuar në masën 100%.

Paraqitja e realizueshmërisë së treguesit sipas Pasaportës së Treguesve, paraqitet si vijon:

Vlerat Bazë	2023	
	N/A	
	2024	Përgatitja e vlerësimit dhe vendosja e bazës për monitorimin
	2025	Të paktën 70% e institucioneve publike të parashikuara, të kenë instaluar dhe në përdorim regjistrin elektronik të kërkesave dhe përgjigjeve
	2026	Të paktën 75% e institucioneve publike të parashikuara, të kenë instaluar dhe në përdorim regjistrin elektronik të kërkesave dhe përgjigjeve
	2027	Të paktën 80% e institucioneve publike të parashikuara, të kenë instaluar dhe në përdorim regjistrin elektronik të kërkesave dhe përgjigjeve
	2028	Të paktën 85% e institucioneve publike të parashikuara, të kenë instaluar dhe në përdorim regjistrin elektronik të kërkesave dhe përgjigjeve
	2029	Të paktën 90% e institucioneve publike të parashikuara, të kenë instaluar dhe në përdorim regjistrin elektronik të kërkesave dhe përgjigjeve
	2030	Të paktën 95% e institucioneve publike të parashikuara, të kenë instaluar dhe në përdorim regjistrin elektronik të kërkesave dhe përgjigjeve
Vlera synuar/ Targeti	2024 (targeti i synuar)	Raport vlerësimi
	2024 (targeti i arritur)	Raport vlerësimi i kryer

1.2.2: *Përqindja e deklaratave të pasurisë dhe interesave privatë, të dorëzuara dhe të audituara, nga numri total që duhet të dorëzohen.*

Vlera e synuar për treguesin e performancës 1.2.2 për vitin 2024 është: Përgatitja e vlerësimit.

Për të arritur vlerat e treguesit në përputhje me pasaportën e treguesve të performancës dhe konkretisht me planin e veprimit 2024-2026, janë parashikuar aktivitetet (4) dhe masa (1) si më poshtë.

1.2.2	Forcimi i llogaridhënies së institucioneve publike në të gjitha nivelet e qeverisjes
1.2.2.1	Monitorimi i vazhdueshëm i dorëzimit të deklaratave të pasurisë dhe interesave private për të gjithë subjektet deklarues nëpërmjet sistemit EACIDS
1.2.2.4	Forcimi i rolit të auditimit të brendshëm të institucioneve nëpërmjet trajnimeve të vazhdueshme për antikorrupsion (1) dhe aksesit në informacion (2)
1.2.2.5	Kualifikimi i stafit të burimeve njerëzore në forcimin e llogaridhënies institucionale për çështje të etikës, informimi, dhe mekanizmat e antikorrupsionit nëpërmjet trajnimeve fillestare dhe të vazhdueshme

1.2.2.6

Sesione informimi për konfliktin e interesit dhe deklarimin e pasurisë për të gjitha nivelet e qeverisjes dhe nëpunësit që kanë detyrimin ligjor për to

Realizimi i masës së parashikuar kryhet përmes aktiviteteve që vijojnë përgjatë gjithë vitit me vlera të matshme dhe specifikisht sic janë monitorimi i vazhdueshëm i dorëzimit të deklaratave të pasurisë dhe interesave private për të gjithë subjektet deklarues nëpërmjet sistemit EACIDS që administrohet nga ILDKPKI, rritjes së rolit të auditimit të brendshëm në institucione dhe kapacitete të rritura të stafëve dhe për njohuri për korrupsionin dhe mekanizma të tij, mbi baza 6-mujore dhe vjetore. Këto masa janë me kohëzgjatje përgjatë afatit të zbatimit të këtij plani veprimi, 2024-2026 dhe si e tillë matja e tyre do të bëhet respektivisht sipas informacionit të kryer për periudhën e kërkuar.

Për periudhën *janar – dhjetor 2024*, ILDKPKI ka vijuar procesin e koordinimit dhe mbështetjes me burimet e nevojshme institucionale, funksionalitetin e plotë të Sistemit Elektronik të Deklarimit të Pasurisë dhe Interesave Privatë (EACIDS). Kështu, ILDKPKI, ka realizuar mirëmbajtjen e sistemit elektronik EACIDS si edhe ka zbatuar masa të shtuara për të rritur sigurinë kibernetike dhe zvogëlimin e rrezikut të depërtueshmërisë në *e-system* duke bërë një riorganizim të infrastrukturës së teknologjisë së informacionit. Në zbatim të kuadrit ligjor në fuqi, subjektet deklarues, edhe përgjatë vitit 2024, vijuan plotësimin e deklaratave të interesave privatë, përmes sistemit elektronik EACIDS. Për vitin 2024 kanë pasur detyrimin për deklarim 4.329 subjekte dhe nga të dhënat e administruara rezulton se vetëm 25 subjekte nuk e kanë përmbushur këtë detyrim në afatet e parashikuara në ligj. Për rrjedhojë, nga këto të dhëna rezulton se 99.4% e subjekteve deklaruese e kanë përmbushur detyrimin për të deklaruar në afat.

Gjithashtu, gjatë vitit 2024, ILDKPKI, ka vijuar zbatimin e skemës së kontrollit, të parashikuar nga neni 25/1 i Ligjit nr. 9049, datë 10.4.2003, *“Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”*, i ndryshuar. Në përmbushje të objektivave të veprimtarisë së tij, lidhur me ushtrimin e kontrollit të plotë dhe hetimin administrativ për verifikimin e saktësisë dhe vërtetësisë së të dhënave të pasurive, të të ardhurave e detyrimeve të deklaruara nga zyrtarët dhe personat e lidhur me ta, si dhe konstatimin e rasteve të konfliktit të interesave, ka miratuar dhe ka kaluar në kontroll të plotë, në total 817 subjekte deklaruese, si për shkak funksioni, ashtu edhe bazuar në informacione të ardhura nga burime të ligjshme.

ASPA ka zhvilluar dhe ofruar përgjatë qershor 2024, një cikël sesionesh informuese me certifikim në fushën e konfliktit të interesit dhe deklarimit të pasurisë, në të cilën kanë marrë pjesë 787 pjesëmarrës, nëpunës të shërbimit civil.

Gjithashtu, përgjatë 2024, ILDKPKI, ka vijuar angazhimin e kapaciteteve administrative në dhënien e asistencës së nevojshme, përfshirë udhëzime specifike, këshilla dhe trajnime organeve përgjegjëse të institucioneve shtetërore për zbatimin e saktë të dispozitave për konfliktin e interesave veçanërisht për evidentimin e saktë të deklarimeve rast pas rasti, duke ofruar asistencë teknike dhe ligjore për autoritetet përgjegjëse apo funksionarët publikë. Konkretisht, për periudhën janar-dhjetor 2024 janë marrë dhe trajtuar rreth 33 kërkesa për dhënie asistence në identifikimin apo trajtimin e situatave të konfliktit të interesave, si dhe janë organizuar takime sqaruese për autoritetet përgjegjëse, lidhur me çështjet institucionale apo individuale, të paraqitura për trajtim.

Gjatë vitit 2024, është kryer Trajnimi i Vazhdueshëm Profesional për audituesit e brendshëm në sektorin publik, bazuar urdhrin e Ministrit të Financave nr.304, date 29.12.2023, “Për miratimin e Programit të Trajnimit të Vazhdueshëm Profesional të audituesve të brendshëm në sektorin publik për vitin 2024”. Seancat e trajnimit u kryen dhe ofruan përgjatë muajve Qershor – Dhjetor 2024 dhe përfitues janë 381 auditues të brendshëm. Trajnimet u përqëndruan në ofrimin dhe informimin e temave specifike për antikorrupsionin, kryesisht. Mbeten në pritje në periudhën në vijim plotësimi i kurrikulave të trajnimit të vazhdueshëm për të drejtën e informacionit dhe aksesin në të.

Aktiviteti 1.2.2.5 referuar shtimit të njohurive për burimet njerëzore për etikën, konfliktin e interesit dhe antikorrupsionin, në formën e trajnimeve fillestare dhe të vazhdueshme, nuk janë arritur të kryhen.

Sa më sipër, masa dhe aktivitetet e parashikuara për këtë periudhë zbatimi, e lidhur direkt me treguesin e performancës vlerësohet se gjatë vitit 2024, ILDKPI ka mbledhur dhe ofron informacion të plotë mbi përqindjen e deklaratave të pasurisë dhe interesave privatë, të dorëzuara dhe të audituara, nga numri total i tyre që duhet të dorëzohen, duke u përmendur në raport monitorimi. Ky tregues performance është realizuar në masën 100%.

Paraqitja e realizueshmërisë së treguesit sipas Pasaportës së Treguesve, paraqitet si vijon:

Vlerat Bazë	2023	
	N/A	
	2024	Përgatitja e vlerësimit
	2025	Për shkak të natyrës së treguesit, koha e zbatimit të aktivitetit nuk mund të ndërpritet dhe vlerësimi do të bëhet sipas kohës së dorëzimit dhe kontrollit sipas detyrimeve ligjore.
	2026	Vlera e treguesve është vendosur në një konstante 100% të deklaratave të paraqitura dhe të audituara sipas detyrimeve ligjore për dorëzim dhe auditim.
	2027	Për shkak të natyrës së treguesit, koha e zbatimit të aktivitetit nuk mund të ndërpritet dhe vlerësimi do të bëhet sipas kohës së dorëzimit dhe kontrollit sipas detyrimeve ligjore.
	2028	Vlera e treguesve është vendosur në një konstante 100% të deklaratave të paraqitura dhe të audituara sipas detyrimeve ligjore për dorëzim dhe auditim.
	2029	Për shkak të natyrës së treguesit, koha e zbatimit të aktivitetit nuk mund të ndërpritet dhe vlerësimi do të bëhet sipas kohës së dorëzimit dhe kontrollit sipas detyrimeve ligjore.
	2030	Vlera e treguesve është vendosur në një konstante 100% të deklaratave të paraqitura dhe të audituara sipas detyrimeve ligjore për dorëzim dhe auditim.
Vlera synuar/ Targeti	2024 (targeti i synuar)	Raport vlerësimi
	2024 (targeti i arritur)	Raport vlerësimi i kryer

1.2.3: Përqindja e institucioneve publike, (qendrore, vendore) - që kanë hartuar Plane Integriteti.

Vlera e synuar për *treguesin e performancës 1.2.3* për vitin 2024 është: 11 ministri, 23 bashki.

Për të arritur vlerat e treguesit në përputhje me pasaportën e treguesve të performancës dhe konkretisht me planin e veprimit 2024-2026, janë parashikuar aktivitetet (6) dhe masat (3) si më poshtë.

1.2.3	Forcimi i integritetit të institucioneve publike në të gjitha nivelet e qeverisjes
1.2.3.1	Vlerësimi i detajuar i numrit të institucioneve që kanë përgatitur vlerësimin e riskut të korrupsionit dhe kanë miratuar Plane Integriteti, në të gjitha nivelet e qeverisjes
1.2.3.2	Përgatitja e ndryshimeve në Kodin Etik Ministror, për plotësimin e rregullave për kuadrin etik dhe të integritetit, lobimin dhe organizimin e tij
1.2.4	Përmirësimi i bashkëpunimit midis AMP dhe Policisë Ushtarake, Drejtorisë së Tatimeve dhe struktura të tjera policore me fokus numrin e sanksioneve (masave) të dhëna për zyrtarët e agjencive të zbatimit të ligjit për shpërdorim detyre dhe korrupsion
1.2.4.1	Trajnime të përbashkëta (vjetore) me pjesëmarrës nga AMP, Policia e Shtetit, Policia Ushtarake, Drejtoria e Doganave, Drejtoria e Tatimeve dhe struktura të tjera policore për integritetin dhe informimin në luftën kundër korrupsionit
1.2.5	Hartimi i një kuadri të harmonizuar dhe në koherencë me kuadrin ligjor dhe institucional në luftën kundër korrupsionit dhe integritetit të zyrtarëve publikë dhe funksionarëve politikë (duke reflektuar rekomandimin “iii” të Raundit V të GRECO për Shqipërinë)
1.2.5.2	Përcaktimi i rregullave të pas-punësimit për funksionarët politikë (përgatitje për ndryshimin e rregullave)
1.2.5.4	Rishikimi i përbërjes së Komisionit të Etikës të Këshillit të Ministrave
1.2.5.5	Zbatimi i Rekomandimeve të Grupit të Shteteve të Këshillit të Evropës kundër Korrupsionit (GRECO) si dhe shtimi i përpjekjeve institucionale për zbatimin në kohë të planit përkatës të veprimit (rekomandimet e mbetura për zbatim pas fazës së parë të vlerësimit të vendit)

Realizimi i masës së parashikuar kryhet përmes aktiviteteve që vijnë përgjatë gjithë vitit me vlera të matshme dhe specifikisht siç janë monitorimi i vazhdueshëm i informacionit për vlerësimin e riskut të korrupsionit dhe miratimin e Planeve të Integritetit, në të gjitha nivelet e qeverisjes. Specifikisht në këto parashikime janë përmendur edhe ndjekja dhe zbatimi i rekomandimeve të GRECO dhe angazhimi i autoriteteve si AMP, dogana e tatime në çështje të integritetit. Këto masa janë me kohëzgjatje të përcaktuar vitin 2024, por ndër to edhe me kohëzgjatje përgjatë gjithë kohës së zbatimit të këtij plani veprimi, 2024-2026.

Për janar – dhjetor 2024, rezulton se të gjitha Ministratë e Linjës dhe Ministrat e Shtetit kanë hartuar dhe miratuar Plane Integriteti. Ministria e Drejtësisë ka nisur zbatimin e Planit të ri të Integritetit²³. Plani është mbështetur tek vlerësimi i riskut të integritetit përfshirë zyrtarët politikë, veçanërisht këshilltarët politikë, në kryerjen e detyrave të tyre. Plani përshkruan masa specifike

²³ Miratuar me urdhër të Ministrit të Drejtësisë, nr. 705, datë 18.12.2023 “Për miratimin e planit të integritetit për Ministrinë e Drejtësisë 2024-2027”.

për monitorimin dhe sigurimin e pajtueshmërisë, duke përfshirë krijimin e një kuadri të brendshëm institucional për të menaxhuar çështjet e integritetit brenda ministrisë, me përditësime të rregullta si për stafin e shërbimit civil, ashtu edhe për nëpunësit politikë. Ministria e Brendshme ka rishikuar Planin e Integritetit për 2022–2024, së bashku me Planin e Veprimit²⁴. Plani përfshin masa shtesë për adresimin e rreziqeve që lidhen me integritetin që mund të ndeshen në detyrë zyrtarët e lartë të ekzekutivit në detyrë. Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale ka rishikuar Planin të saj të Integritetit për periudhën 2022–2025²⁵, i cili prezanton masa shtesë për të adresuar përgjegjësitë që lidhen me çështjet e integritetit. Ministria e Arsimit dhe Sportit ka rishikuar dhe po zbaton në mënyrë aktive Planin e saj të Integritetit për 2022–2025²⁶. Ministria e Turizmit dhe Mjedisit ka rishikuar Planin e saj të Integritetit për 2022–2025²⁷. Me ndryshimet në formatimin e kabinetit qeveritar, Ministria e Financave, si një institucion më vehte ka miratuar Planin e ri të Integritetit 2024-2026²⁸, duke u mbështetur në një vlerësim risku të strukturave operacionale dhe organigramës së institucionit. Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë ka rishikuar Planin e Integritetit²⁹, duke shtuar dhe parashikuar masa dhe aktivitete specifike për kabinetin e ministrit dhe funksionarët politikë. Ministria e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit ka miratuar Planin e Integritetit³⁰, tashmë në cilësinë e një institucioni qendror të ri dhe të riorganizuar dhe që përcakton masat dhe aktivitetet specifike për kabinetin e ministrit. Ministria e Mbrojtjes³¹ e pasur të miratuar dhe ka vijuar përgjatë 2024, zbatimin e Planit të Integritetit. Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme ka rishikuar Planin e Integritetit³², në të cilin parashikohen masat dhe aktivitetet specifike për kabinetin e ministrit. Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural ka miratuar Planin e ri të Integritetit³³, duke evidentuar një analizë të re risku korrupsioni institucional dhe masa për to. Pranë të gjitha ministrive janë caktuar edhe koordinatorët e integritetit.

Me synimin për të rritur masat e integritetit për të gjithë kabinetin qeveritar, plane integriteti janë hartuar dhe miratuar për të gjithë Ministrat e Shtetit si konkretisht: Ministri i Shtetit për Rininë dhe Fëmijët ka miratuar Planin e Integritetit, me urdhër nr.10, datë 29.09.2023, *“Për miratimin e Planit të Integritetit të Ministrit të Shtetit për Rininë dhe Fëmijët dhe Planin e Veprimit të tij 2024-*

²⁴ Miratuar me urdhër të Ministrit të Brendshëm, nr. 195, datë 30.11.2023 *“Për ndryshime në urdhrin nr.12, datë 21.01.2022 “Për miratimin e planit të veprimit të planit të integritetit të Ministrisë së Brendshme”.*

²⁵ Miratuar me urdhër të Ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, nr. 676, datë 09.11.2023 *“Për një ndryshim në urdhrin nr.22, datë 04.2022, “Për miratimin e planit të integritetit të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, 2022–2025”.*

²⁶ Miratuar me urdhër të Ministrit të Arsimit dhe Sportit, nr. 504, datë 08.09.2023 *“Për disa ndryshime dhe shtesat në Planin e Integritetit të Ministrisë së Arsimit”.*

²⁷ Miratuar me urdhër të Ministrit të Mjedisit dhe Turizmit, nr. 268, datë 13.09.2023 *“Për ndryshime dhe shtesa në planin e integritetit të Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit.*

²⁸ Miratuar me urdhër të Ministrit të Financave, nr. 1301 prot, datë 8.2.2024. *“Për miratimin e Planit të Integritetit 2024-2026”.*

²⁹ Miratuar me urdhër të Ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë, nr. 128, datë 16.10.2023, *“Për disa shtesa dhe ndryshime të Planit të Integritetit për Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë, 2022-2025”.*

³⁰ Miratuar me urdhër të Ministrit të Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit, nr. 564, datë 29.07.2024, *“Për miratimin e Planin e integritetit për Ministrinë e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit, 2024-2027”.*

³¹ Miratuar me urdhër të Ministrit të Mbrojtjes, nr. 516, datë 19.4.2022, *“Për miratimin e Planit të Integritetit të Ministrisë së Mbrojtjes, 2022-2025”.*

³² Miratuar me urdhër të Ministrit për Evropën dhe Punët e Jashtme, nr. 707, datë 23.09.2024, *“Për një ndryshim në “Planin e integritetit për Ministrinë për Evropën dhe Punët e Jashtme, 2022-2025”, miratuar me urdhrin nr.150, datë 28.04.2022.*

³³ Miratuar me urdhër të Ministrit për Bujqësinë dhe Zhvillimin Rural, nr. 586, datë 25.07.2024, *“Për miratimin e Planit të Integritetit të Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural dhe Planit të Veprimit të saj 2024-2027”.*

2025”. Zyra e Ministrit të Shtetit ka emëruar një koordinator integriteti dhe ka monitoruar gjithashtu zbatimin e tij, duke përgatitur raportin përkatës. Ministri i Shtetit për Marrëdhëniet me Parlamentin ka miratuar Planin e Integritetit, me Urdhrin nr. 2, datë 28.12.2023, *“Për miratimin e Planit të Integritetit të Ministrit të Shtetit për Marrëdhëniet me Parlamentin dhe Planin e Veprimit të tij 2024-2025”*. Zyra e ministrit ka caktuar një koordinator për integritetin. Ministri i Shtetit për Pushtetin Vendor ka miratuar Planin e Integritetit, me Urdhrin nr. 4, datë 19.12.2023, *“Për miratimin e Planit të Integritetit të Ministrit të Shtetit për Pushtetin Vendor, 2024-2025”*. Zyra e ministrit ka caktuar një koordinator për integritetin. Ministri i Shtetit për Administratën Publike dhe Antikorrupsionit ka miratuar Planin e Integritetit, me Urdhrin nr. 7, datë 26.09.2024, *“Për miratimin e Planit të Integritetit të Ministrit të Shtetit për Administratën Publike dhe Kundër Korrupsionit, 2024-2025”*. Zyra e ministrit ka caktuar një koordinator për integritetin. Ministri i Shtetit për Sipërmarrjen dhe Klimën e Biznesit ka miratuar Planin e Integritetit, me Urdhrin nr. 16, datë 27.06.2024, *“Për miratimin e Planit të Integritetit të Ministrit të Shtetit për Sipërmarrjen dhe Klimën e Biznesit, 2024-2025”* dhe Planin e Veprimit. Zyra e ministrit ka caktuar një koordinator për integritetin. Ministri i Shtetit dhe Kryenegociator ka miratuar Planin e Integritetit, me Urdhrin nr. 2, datë 19.09.2024, *“Për miratimin e Planit të Integritetit të Ministrit të Shtetit dhe Kryenegociatorit, 2024-2025”*. Ky dokument përfshin një sërë masash që synojnë veçanërisht zbatimin nga individë që mbajnë funksione të larta ekzekutive dhe politike pranë ministrit. Zyra e ministrit ka caktuar një koordinator për integritetin.

Rishikimi i planeve të integritetit dhe vlerësimi i riskut të integritetit pranë tyre u realizua nga grupet e brendshme institucionale të punës, bazuar në Metodologjinë e Vlerësimit të Rrezikut të Integritetit për Qeverisjen Qendrore.

Ndër institucionet qendrore rezulton se administrata tatimore, e përfaqësuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve ka miratuar gjithashtu planin e integritetit me nr. 32, datë 4.12.2024.

Gjithashtu, gjatë vitit 2024, katër bashki të tjera si: Shkodër, Fushë-Arrës, Përrenjas dhe Vlorë, kanë miratuar plane integriteti, duke e çuar në 28 numrin e tyre.

Gjatë vitit 2024, administrata doganore ka shtuar në mënyrë të qendrueshme njohuritë e personelit të saj (nëpunës, agjentë doganorë dhe operatorë ekonomikë të interesuar) mbi aktivitetin doganor dhe bashkëpunimi me autoritete të tjera. Janë 15 takime të zhvilluara me 211 pjesëmarrës. Gjithashtu, përmendet edhe bashkëpunimi me Agjencinë Italiane të Doganave dhe Monopolove, dhe me misionin “Guardia di Finanza”, më 20-24 maj 2024, me tematikë vlerësimin e mangësive dhe nevojave për analizën e riskut”. Forumi u ndoq edhe nga staf i Drejtorisë së Antikontrabandës pranë DPD.

Bashkëpunimi me autoritete homologe ndërkombëtare përmenden: - projekti (Sirius) më datat 3-5 Korrik 2024, në Zagreb, Kroaci, u zhvillua workshopi rajonal, për të trajtuar lëvizjen e paligjshme ndërkufitare të mallrave ushtarake, midis Ukrainës dhe vendeve fqinje. Stafi shqiptar (2 Komandantë Grupi të Antikontrabandës Tokësore) iu bashkuan atij të Bosnje dhe Hercegovinës, Bullgarisë, Kroacisë, Kosovës, Malit të Zi, Maqedonisë së Veriut, Rumanisë, Serbisë dhe Ukrainës; në datë 02 - 06 shtator 2024, me asistencë të doganës franceze, u organizua në Durrës, trajnimi me temë “Kontrolli i Anijeve”, ku morën pjesë edhe 5 punonjës të Antikontrabandës Detare; Zyra Qendrore e Evropës Lindore dhe Juglindore për Kontrollin e Armëve të Vogla dhe të Lehta, (SEESAC), më datat 5-6 Nëntor 2024, në Przno, Mal i Zi, zhvilloi “Takimi Rajonal i Përfaqësuesve të Policisë Kufitare dhe Doganore”. Qendra për Zbatimin e Ligjit të Evropës Juglindore (SELEC), më datë 12 Nëntor, në Bukuresht, Rumani organizoi “Takimi i 21-të, në

kuadër të Mashtrimit dhe Kundër Kontrabandës”, i cili shërbeu si forum për pjesëmarrësit mbi qasjet rajonale në parandalimin dhe luftimin e mashtrimeve dhe kontrabandës doganore.

Në vitin 2024, janë përgatitur ndryshimet e nevojshme adresuar në vendimin nr. 830 datë 15.9.2013 “Për miratimin e Kodit Etik Ministror”, i ndryshuar. Ndryshimet përfshijë rregullat për takimet me palët e treta (lobistët) dhe rregullat e pas-punësimit për anëtarin e Këshillit të Ministrave. Përfundimi i tyre me miratim pritet të bëhet në vitin 2025.

Në vitin 2024, ka vijuar bashkëpunimi midis autoriteteve dhe organeve të administratës për informime të shtuara mbi integritetin dhe informimin në luftën kundër korrupsionit. Drejtorja e Përgjithshme e Doganave duke qenë pjesë e programit të EXBS vazhdon të jetë një nga partnerët kryesorë të shërbimit doganor shqiptar në mbështetjen dhe përmirësimin e kontrollit kufitar dhe parandalimin e lëvizjes së mallrave me rrezik. EXBS ka kontribuar gjithashtu në rritjen e përfaqësimit të shërbimit doganor në aktivitet ndërkombëtare, një ndër to për vitin 2024 ishte trajnimi i përbashkët me përfaqësues nga Dogana Shqiptare dhe Agjencia e Mbikqyrjes Policore si dhe homologë nga vendet e rajonit. Trajnimi i zhvilluar në Optajja, Kroaci, u fokusua në rolin e e strukturave administrative hetimore antikorrupsion dhe të policisë nëpërmjet AMP-së, në luftën kundër krimit të organizuar mjedisor. Vlerë e shtuar e trajnimit ishte njohja me metodat më të specializuara nga ekspertë të fushës në luftën kundër korrupsionit, siç përmenden njohuri rreth metodave të hetimit, programeve, legjislacionit, si dhe u krijuan mundësi komunikimi midis agjencive, organizmave ndërkombëtare të mjedisit dhe vendeve pjesëmarrëse në zhvillimin e këtyre mundësive në shërbim të forcimit të vazhdueshëm të luftës kundër krimeve mjedisore.

Viti 2024, ishte viti i avancimit me zbatimin e rekomandimeve të GRECO, të dhëna në raportin e vlerësimit për Raundin V: *Parandalimi i korrupsionit dhe promovimi i integritetit në qeverinë qendrore (në funksionet e larta ekzekutive)*. Në relevancë me afatet e zbatimit dhe dorëzimin e raportit të vendit pranë Sekretariatit të GRECO-s, në 30 shtator 2024 nën koordinimin e Ministrit të Shtetit për Administratën Publike dhe Antikorrupsionin, njëherazi kreu i delegacionit të Qeverisë Shqiptare pranë këtij organizmi, u hartuan propozimet për përcaktimin e rregullave të pas-punësimit për funksionarët politikë. Mbështetur në rekomandimet e GRECO, janë finalizuar propozimet për ndërhyrje në rregullat e pas-punësimit për anëtarët e Këshillit të Ministrave në vendimin nr. 830 datë 15.9.2013 “Për miratimin e Kodit Etik Ministror”, i ndryshuar. Gjithashtu, janë përcaktuar rregullat e pas-punësimit për këshilltarët politikë të kabineteve ministore në ligjin nr. 9131 datë 8.9.2003 “Për rregullat e etikës në administratën publike”. Ndryshimet janë hartuar në formën e projektakteve shoqëruar edhe me relacionet shpjeguese dhe mbeten në pritje për të nisur diskutimin dhe bashkërendimin e tyre në përputhje me parashikimet e Vendimit nr. 584/2003 të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e Rregullores së Këshillit të Ministrave, të ndryshuar”. Në vijim mbeten për tu paraqitur këto ndërhyrje për miratim në Këshillin e Ministrave, dhe më pas në Kuvend (për ligjin nr. 9131/2003).

Në vitin 2024, u finalizuan me miratim të ndryshimeve në urdhrin e Kryeministrit përbërja e Komisionit të Etikës të Këshillit të Ministrave, me nr. 203, datë 23.10.2024, “Për disa ndryshime në urdhrin nr.90, datë 20.5.2022, të Kryeministrit, “Për ngritjen, përbërjen dhe organizimin e Komisionit të Etikës”, duke e kthyer këtë mekanizëm në një organ plotësisht administrativ e teknik e larg ndikimit të politikës.

Referuar detyrimeve të Shqipërisë në GRECO, që adresohen plotësisht në strategjinë antikorrupsion për zbatim në vitin 2024, u punua dhe u raportua për 19 rekomandime të mbetura

për vlerësim nga faza e parë³⁴, nga të cilat 7 i referoheshin pushtetit qendror (funksionet e larta ekzekutive) dhe 12 të tjera referuar parandalimit të korrupsionit dhe promovimi i integritetit në agjencitë e zbatimit të ligjit. Për të siguruar një koordinim efektiv dhe për të demonstruar një përpjekje serioze në zbatimin e rekomandimeve të dhëna, u ngrit një grup pune i kryesuar nga Ministri i Shtetit për Administratën Publike dhe Antikorrupsionin me anëtarë, përfaqësues nga Kryeministria, Ministrinë e Linjës, Drejtoria e Përgjithshme e Antikorrupsionit dhe Shkolla Shqiptare e Administratës Publike si dhe Ministria e Brendshme dhe strukturat e Policisë së Shtetit, Agjencia e Mbikëqyrjes Policore dhe Akademia e Sigurisë.

Më konkretisht të dhëna për zbatimin e rekomandimeve të GRECO-s, të kryera përgjatë 2024, dhe bërë pjesë e raportit të Shqipërisë së dorëzuar në GRECO, janë:

Pjesa 1: Parandalimi i korrupsionit dhe promovimi i integritetit në qeverinë qendrore (në funksionet e larta ekzekutive).

Në të gjitha ministrinë e linjës janë miratuar dhe rishikuar Plane Integriteti, që shoqërohen nga plane konkrete veprimi, bazuar në vlerësime risku për integritetin dhe me masa specifike parandalimi. Të gjitha Planet e Integritetit përmbajnë masa korrigjuese për funksionarët politikë (ministrat edhe anëtarët e kabineteve të tyre). Këto plane monitorohen në mënyrë të rregullt dhe koordinatorët e integritetit janë emëruar në çdo ministri. Plane Integriteti kanë hartuar gjatë vitit 2024 edhe kabinetet pranë ministrave të shtetit, që konsistojnë në një grup masash operacionale dhe rregullatore të drejtuara ndaj ministrave dhe anëtarëve të tyre përfshi si: trajnime periodike mbi etikën dhe antikorrupsionin; paketa informuese mbi aktivitetet dhe ngjarjet ku ata marrin pjesë; trajnim fillestar mbi integritetin dhe antikorrupsionin në fillim të mandatit; përshkrime të detajuara të punës që përcaktojnë përgjegjësitë dhe fushat e mbikëqyrjes; rishikim të kodeve përkatëse të etikës dhe të rregulloreve të brendshme që lidhen me pozicionet e punës dhe detyrat; si dhe marrëdhëniet me drejtoritë teknike dhe funksionet e tjera institucionale. (Rek. ii³⁵)

Projektligji për konfliktin e interesit është hartuar dhe është në shqyrtim në Kuvend. Ligji i ri, i hartuar në konsultim me ekspertët e Këshillit të Europës, synon të përmirësojë parandalimin dhe rregullimin e konfliktit të interesit, duke përfshirë deklarin e interesave, kufizimet për ushtrimin e detyrave publike, dhuratat, premtimet, përfitimet, trajtimin preferencial, rregullat për pasmandatin, masat për parandalimin dhe zgjidhjen e konflikteve të interesit, si dhe dispozitat që lidhen me kompetencat e organit përgjegjës për parandalimin, monitorimin dhe zgjidhjen e tyre. Ligji i ri do të shoqërohet nga një manual për lehtësimin e zbatimit të tij dhe nga seanca trajnime të dedikuara për punonjësit e administratës publike, përfshirë funksionarët politikë. (Rek. iii³⁶)

³⁴ 2022 Raporti i Përputhshmërisë Shqipëria: Roundi V I Vlerësimit Parandalimi i korrupsionit dhe promovimi i integritetit në qeverinë qendrore (në funksionet e larta ekzekutive) dhe agjencitë ligjzbatuese.

³⁵ Rek. ii) Të miratohen dhe zbatohen plane konkrete të integritetit brenda të gjitha ministrive, duke përfshirë një analizë sistematike të rreziqeve të lidhura me integritetin me të cilat mund të përballen ministrat dhe këshilltarët politikë në ushtrimin e detyrave të tyre dhe mekanizmat e monitorimit dhe pajtueshmërisë dhe ii) masat e duhura korrigjuese që synojnë posaçërisht PTEF-të të hartohen dhe zbatohen.

³⁶ Rek.iii) Harmonizimin dhe rritjen e koherencës së natyrshme të kuadrit ligjor dhe institucional në luftën kundër korrupsionit dhe integritetit të zyrtarëve publikë, veçanërisht në lidhje me PTEF-të, për shembull duke përpiluar normat dhe rregulloret në një manual dhe duke ofruar udhëzime mbi detyrimet e çdo kategori dhe mbi rolin e çdo organi përgjegjës.

Është pregatitur dhe publikuar Udhëzuesi mbi Rregullat e Etikës për Anëtarët e Këshillit të Ministrave dhe Zëvendësministrat, me fokus te konfliktet e interesit; Udhëzuesi për Anëtarët e Këshillit të Ministrave mbi Detyrimet që Lidhen me Dhuratat, Përfitimet, Premtimet dhe Trajtimin Preferencial, të cilat janë vënë në dispozicion në mënyrë elektronike për të gjithë funksionarët politikë. Këto manuale ofrojnë një shpjegim të detajuar, me gjuhë të thjeshtuar, të politikave, parimeve, rregullave dhe procedurave që zbatohen për anëtarët e Këshillit të Ministrave, përfshirë Kryeministrin, si dhe të legjislacionit në fuqi mbi konfliktin e interesit. Është publikuar Udhëzuesi mbi Rregullat e Etikës për Këshilltarët Politikë në Administratën Shtetërore. Ky dokument përfshin të gjithë kuadrin ligjor në fuqi, së bashku me shembuj ilustrues dhe mekanizma zbatimi, të hartuara posaçërisht për ndërgjegjësimin dhe zbatimin nga zyrtarët politikë. Dokumenti është shpërndarë në mënyrë elektronike dhe është vënë në dispozicion të të gjitha kabineteve ministrore nga Ministri i Shtetit për Administratën Publike dhe Antikorrupsionin. Gjithashtu, përbërja e Komisionit të Etikës është rishikuar, në mënyrë që të mos ketë asnjë anëtar me përkatësi politike. Komisioni i Etikës drejtohet nga Sekretari i Përgjithshëm i Këshillit të Ministrave dhe përfshin Drejtorin e Përgjithshëm të Departamentit të Përputhshmërisë Rregullatore dhe Drejtorin e Përgjithshëm të Departamentit të Mirëadministrimit. (Rek.iv³⁷)

Trajnime të rregullta, periodike janë zhvilluar për të gjithë anëtarët e Këshillit të Ministrave dhe për të gjithë këshilltarët politikë mbi tematik si: Kodi Ministror i Etikës dhe çështje që lidhen me integritetin, duke përfshirë edhe ushtrime simulimi (dilema etike). Përgjatë, janar - prill 2024 u zhvillua një program trajnime online për këshilltarët politikë mbi parandalimin e korrupsionit, i hartuar me mbështetjen e Programit HELP të Këshillit të Europës. Pas përfundimit të këtij kursi, 35 këshilltarë politikë pranë ministrave u certifikuan për modulën HELP. Gjithashtu, me ndryshimin e anëtarësisë së Komisionit të Etikës³⁸ anëtarët e Këshillit të Ministrave mund të kërkojnë një opinion këshillimor nga ky organ, duke e klasifikuar këtë si një mekanizëm mbrojtës në procedurat disiplinore. Kryeministri mund të kërkojë në mënyrë paraprake një opinion interpretues përpara marrjes së çdo vendimi që mund të jetë në kundërshtim me dispozitat e Kodit Ministror, ndërsa ministrat mund të kërkojnë një opinion këshillimor paraprak për të sqaruar nëse një veprim apo mosveprim i caktuar përbën shkelje të Kodit. (Rek.v³⁹)

Në vitin 2024, ka pasur një rritje të të dhënave të numrit të akteve të shpallura për konsultim publik. Janë përfshirë gjithsej 3.552 pjesëmarrës, prej të cilëve 555 kontribuan me komente dhe sugjerime. Nga komentet e marra, 55% u pranuan plotësisht ose pjesërisht. Ndërkohë që, Platforma e Regjistrat Elektronik për Njoftimet dhe Konsultimet Publike ka shërbyer si dritarja kryesore për konsultimet publike, por janë përdorur edhe metoda të tjera si tryeza të konsultimit dhe diskutime (u organizuan total 21 takime publike në vitin 2024). 98% e akteve të hartuara i nënshtrohen konsultimit dhe u publikuan në regjistër duke u shikuar nga 21,665 vizitorë, me një mesatare prej

³⁷ Rek. iv) Kodi ekzistues i Etikës Ministror të plotësohet me udhëzime konkrete për zbatimin e tij në lidhje me konfliktet e interesit dhe çështje të tjera të lidhura me integritetin (p.sh. dhuratat, kontaktet me palët e treta, lobimi etj.); ii) të sigurohet funksionimi efektiv i Komisionit të Etikës, ose i çdo mekanizmi tjetër të besueshëm mbikëqyrjeje dhe sanksionesh, përfshirë edhe kryeministrin, dhe iii) rregullat etike të plotësohen me shembuj ilustrues dhe mekanizma zbatues për këshilltarët politikë.

³⁸ Urdhër i Kryeministrit nr.203, datë 23.10.2024, “Për ndryshimin e urdhërit 90, datë 20.5.2022, “Për ngritjen, përbërjen dhe organizimin e Komisionit të Etikës”.

³⁹ Rek. v) Anëtarët e Këshillit të Ministrave dhe këshilltarët politikë t'i nënshtrohen ndërgjegjësimit sistematik për çështjet që lidhen me integritetin, duke përfshirë Kodin e Etikës Ministrore dhe legjislacionin dhe kornizën kundër korrupsionit dhe integritetit, nëpërmjet trajnimeve të rregullta, udhëzimeve të dedikuara dhe këshillimit konfidencial.

750 shikimesh për akt. Përgjatë Janar - Shtator 2024, nga Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit janë dërguar 1.200 njoftime automatike për qytetarët dhe ekspertët në lidhje me paraqitjen e projektakteve për konsultim publik në këtë regjistër. Në vitin 2024, të gjitha projektligjet kaluan nëpër procesin e vlerësimit të ndikimit rregullator. Numri i akteve të përjashtuara nga konsultimet publike ishte më i ulët (ulje me 66.3% për aktet në programin e përgjithshëm analitik, me 67% për aktet në Planin Kombëtar për Integrimin Europian dhe me 92.8% për aktet në dokumentet strategjike sektoriale). Afatet për zhvillimin e konsultimit publik u respektuan në 93% të rasteve. (Rek.vi⁴⁰)

Gjatë vitit 2024, të gjitha mbledhjet e Këshillit të Ministrave, diskutimet dhe qëndrimet e ministrave pjesëmarrës ndaj pikave të rendit të ditës janë dokumentuar plotësisht dhe me kujdes. Nuk janë regjistruar raste të pranishme të konfliktit të interesit nga ndonjë ministër dhe të përjashtimit të tij nga votimi i projektakteve. (Rek.viii⁴¹).

Pjesa 2: Parandalimi i korrupsionit dhe promovimi i integritetit në agjencitë e zbatimit të ligjit.

Gjatë vitit 2024 është kryer analiza gjithëpërfshirëse e kuadrit ligjor për donacionet (dhurimet) dhe sponsorizimet për Policinë e Shtetit, e cila është reflektuar plotësisht edhe në kuadrin e ri ligjor, të miratuar, Ligji për Policinë e Shtetit⁴². Ndërhyrjet e bëra në këtë çështje kanë adresuar kufizimin e riskut të korrupsionit dhe konflikteve të interesit në veprimtari të policisë së shtetit këtë drejtim, duke afektuar procedurën standarte të operimit dhe vendosur udhëzime për pranimin, administrimin dhe përdorimin e donacioneve, me synim kufizimin e riskut të korrupsionit dhe konflikteve të interesit, si dhe rritjen e efektivitetit të përdorimit të pasurive të dhuruara. Në përfundim me parashikimet e bëra në Ligjin për Policinë e Shtetit, tashmë policia mund të pranojë donacione vetëm nga organizata përfaqësuese të komunitetit të biznesit dhe, në çdo rast, vetëm pas një shqyrtimi paraprak nga autoriteti kompetent dhe me miratimin e Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit. (Rek.xiii⁴³)

Gjatë vitit 2024 është kryer analiza e plotë mbi ofrimin nga ana e policisë së shtetit të shërbimeve shtesë kundrejt pagesës, mbështetur tek kufizimi i riskut të korrupsionit dhe konflikteve të interesit. Rekomandimet e adresuara në analizë u jetësuan në kuadrin ligjor dhe rregullator për zbatimin e

⁴⁰ Rek. vi) Të merren masa plotësuese për të bërë konsultimin procesi i projektligjeve parësore dhe dytësore me interes të veçantë publik më efektiv për palët e interesuara veçanërisht të interesuara, duke përfshirë përmes zyrtarëve më miqësorë për përdoruesit faqet e internetit.

⁴¹ Rek.viii) Abstenimi i një ministri ose zëvendësministri për të marrë pjesë në një vendim të Këshillit të Ministrave për shkak të një konflikti të mundshëm interesi të regjistrohet në procesverbalet e mbledhjeve të Këshillit të Ministrave, siç e kërkon ligji.

⁴² Ligji Nr. 82/2024, hyrë në fuqi në Gusht 2024.

⁴³ Rek.xiii) (i) Të kryhet një analizë e gjerë mbi kuadrin ligjor dhe praktikën e dhurimeve dhe sponsorizimeve private për Policinë e Shtetit dhe që, nën dritën e gjetjeve të saj, të miratohen rregulla për të hequr dorë nga dhurimet/sponsorizimet private për Policinë, ose si minimum, të kufizohen rreziqet e korrupsionit dhe konfliktet e interesit në këtë drejtim; (ii) që dhurimet dhe sponsorizimet e marra të publikohen në baza të rregullta (përfshirë edhe në internet), duke treguar natyrën dhe vlerën e secilit dhurim si dhe identitetin e donatorit.

shërbimeve me pagesë, Ligji për Policinë e Shtetit dhe përgatitjen e akteve rregullatore në zbatim.⁴⁴ (Rek. xiv⁴⁵)

Gjatë vitit 2024, është vijuar me shpërndarjen, njoftimin dhe ofrimin e trajnimeve specifike të Manualit të Etikës së Policisë, një akt i miratuar dhe në zbatim për të gjithë punonjësit e policisë. Manuali përfshin udhëzime praktike që marrin në konsideratë veçantinë e punës së policisë, larminë e detyrave dhe cenueshmëritë e saj. (Rek. xvi⁴⁶)

Gjatë vitit 2024, miratimi i Ligjit për Policinë e Shtetit rregulloi ngritjen dhe organizimin e organeve të këshillave konfidencialë, një mekanizëm kontrolli dhe zbatimi për këshillimin konfidencial mbi çështje që lidhen me integritetin, përfshirë trajtimin e rasteve të dhunës, ngacmimit dhe ngacmimit seksual në polici. Stafi i policisë dhe strukturat janë informuar mbi funksionimin e tyre. Sipas ligjit të ri “Për Policinë e Shtetit”, Këshillat Konfidencialë funksionojnë brenda strukturës përgjegjëse për burimet njerëzore, me qëllim ofrimin e këshillimit konfidencial për punonjësit e policisë mbi çështje që lidhen me etikën, integritetin dhe korrupsionin. (Rek.xvii⁴⁷)

Ligji për Policinë e Shtetit, gjithashtu përmirësoi konkureshmërinë përzgjedhjen e drejtuesve të policisë, përfshirë Drejtorin e Përgjithshëm, Zëvendës Drejtorin e Përgjithshëm, drejtorët e departamenteve dhe drejtorët e drejtorive vendore të policisë. Ligji i ri krijoi një sistem transparent dhe funksional të promovimit dhe ecurisë në karrierë në polici, vendosi procedura të qarta dhe kriteret aplikimi për rekrutimin, me synim rritjen e cilësisë dhe qëndrueshmërisë së personelit policor, krijoi një mekanizëm efektiv disiplinor për punonjësit e policisë për të siguruar përmbushjen e përgjegjësisë me efikasitet dhe në përputhje me ligjin, zhvilloi një sistem motivues të karrierës për oficerët në role operacionale dhe drejtuese të linjës së parë, si dhe reduktonte lëvizshmërinë e lartë të stafit për të garantuar stabilitetin. Këto risi u panë në procesin e zgjedhjes dhe emërimit të Drejtorit të ri të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit në tetor 2024. Nga ana tjetër, nga një analizë vlerësimi e brër më shtator 2024, rezulton se shumica e drejtorëve të policisë kanë qenë në detyrë prej disa vitesh dhe se qëndrueshmëria e këtij niveli të lartë drejtues është rritur *de facto*. (Rek.xviii⁴⁸).

Zhvillim pozitiv përmendet edhe parashikimi në kuadrin e ri të miratuar ligjor, emërimin e drejtorëve të drejtorive vendore të policisë nga Drejtori i Përgjithshëm i Policisë së Shtetit, si një

⁴⁴ Ligji Nr. 82/2024, (nenet 2, 121 dhe 128); draft urdhër i Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit për shërbimet shtesë me pagesë.

⁴⁵ Rek.xiv) Që politikat për ofrimin e shërbimeve shtesë nga Policia e Shtetit në këmbim të pagesës të marrin parasysh në mënyrën e duhur rreziqet për korrupsion dhe konfliktin e interesit.

⁴⁶ Rek.xvi: Parimet etike dhe rregullat e sjelljes të përfshira në Rregulloren e Policisë së Shtetit të plotësohen me një manual që përmban udhëzime praktike që merr parasysh specifikat e Policisë së Shtetit, shumëllojshmërinë e detyrave dhe dobësitë.

⁴⁷ Rek.xvii) (i) shtimin e trajnimit fillestar dhe gjatë punësimit të punonjësve të policisë në lidhje me çështjet e integritetit, si dhe trajnimin e specializuar të hetuesve që merren me çështjet e korrupsionit dhe krimit ekonomik; (ii) ngritjen e një sistemi dhe caktimin e personave të trajnuar të besimit për të ofruar këshillim konfidencial mbi çështjet e etikës dhe integritetit për të gjithë stafin e policisë.

⁴⁸ Rek.xviii) Marrjen e masave për rritjen e qëndrueshmërisë së drejtuesve të lartë të Policisë së Shtetit, pavarësisht ndryshimeve politike në vend.

garanci më shumë për që policia të mos politizohet së tepërmi dhe që pavarësia e saj në menaxhimin operacional të jetë e garantuar. (Rek. xix⁴⁹)

Gjatë vitit 2024, ka vijuar procesi kalimtar i vlerësimit (vetting) në polici. Procesi kryhet fillimisht për funksione brenda drejtuesve të lartë të policisë, dhe trajton çështje që lidhen me integritetin, dhe jep garanci për të vijuar në mënyrë të rregullt, bazuar në planin e integritetit dhe instrumente të tjera ekzistuese të menaxhimit të riskut. Kuadri i ri ligjor ka gjetur zbatim për verifikimin e integritetit të kandidatëve edhe në rastet e lëvizjeve të detyrës dhe të promovimit, në përputhje me rekomandimin. Verifikime të tilla të integritetit janë parashikuar gjithashtu për punonjësit e policisë në intervale të rregullta gjatë karrierës së tyre, përtej rasteve të ndryshimeve të pozicionit. (Rek.xx⁵⁰)

Miratimi i ligjit të ri “Për Policinë e Shtetit”, vendosi dhe normoi gjithashtu edhe rregullat për pranimin e dhuratave të pajustificuara, si gjatë, ashtu edhe jashtë ushtrimit të detyrës, si shkelje disiplinore. Një mekanizëm efikas kontrolli për regjimin e dhuratave, një regjistër dhuratash që plotësohet dhe përditësohet në mënyrë sistematike, janë vendosur, gjithashtu. Në këtë mënyrë, mund të konsiderohet se regjimi i dhuratave në polici, i nënshtrohet mbikëqyrjes dhe zbatimit të përshtatshëm. (Rek. xxi⁵¹)

“Illyrian Guard” është një njësi e cila kontrollohet dhe organizohet sipas akteve për Policinë e Shtetit. Në vitin 2024, Ministria e Brendshme ka kryer auditim dhe nga i cili rezultuan 14 rekomandime, e nga këto 4 janë zbatuar pjesërisht dhe 10 janë ende në proces. (Rek. xxii⁵²).

Me miratimin e ligjit të ri “Për Policinë e Shtetit” është rregulluar sistemi i pas-punësimit të strukturave të policisë. Ish-punonjësit e policisë tashmë kanë detyrimin të njoftojnë Policinë e Shtetit në rast se punësohen brenda një periudhe njëvjeçare, gjë që mundëson organizimin e një sistemi monitorimi mbi kufizimet pas largimit nga detyra. Për të ngritur një mekanizëm efektiv zbatimi, është vendosur një procedurë e detajuar për monitorimin e punësimit të mëvonshëm të ish-punonjësve të policisë, e shoqëruar me masa të përshtatshme zbatimi. Të gjitha strukturat e Policisë së Shtetit kanë ngritur posaçërisht regjistra për të identifikuar punonjësit që i nënshtrohen kufizimeve pas largimit nga detyra. Çdo ish-punonjës nënshkruan një deklaratë përmes së cilës konfirmon njohjen dhe pranimin e këtyre kufizimeve. Për të monitoruar në mënyrë efektive zbatimin e kësaj mase, Drejtoria e Burimeve Njerëzore raporton në mënyrë sistematike mbi përputhshmërinë dhe mbikëqyrjen e procedurës. (Rek. xxiii⁵³)

⁴⁹ Rek.xix) Drejtuesit e drejtorive të Policisë së Shtetit të emërohen nga Drejtori i Përgjithshëm i Policisë së Shtetit.

⁵⁰ Rek.xx) (i) që funksionet më të ekspozuara ndaj rreziqeve të integritetit të kenë përparësi gjatë procesit të rivlerësimit (vettingut), në lidhje me planin e integritetit dhe mjetet e tjera ekzistuese të menaxhimit të riskut; dhe (ii) që kontrollet për integritetin e kandidatëve të kryhen në kontekstin e ndryshimeve të pozicioneve dhe ngritjes në detyrë dhe në intervale të rregullta gjatë karrierës së punonjësve të policisë.

⁵¹ Rek.xxi) Rregullat për pranimin dhe deklarimin e dhurimeve nga stafi i policisë t'i nënshtrohen mbikëqyrjes dhe zbatimit të duhur.

⁵² Rek.xxii) Punonjësit e “Illyrian Guard” t'i nënshtrohen të njëjtave masa ligjore dhe rregullatore (përfshirë rregullat e zbatueshme të sjelljes dhe rregullat e transparencës në procedurat e prokurimit publik) si punonjësit e Policisë së Shtetit.

⁵³ Rek.xiii) Hartimi i rregullave të qarta për kufizimet pas largimit nga detyra, të shoqëruara nga një mekanizëm efektiv zbatues, për punonjësit e policisë.

Gjatë vitit 2024, janë ndërmarrë zhvillime konkrete për të konsoliduar trajnime të rregullta mbi çështjet e sinjalizimit dhe për të forcuar kapacitetet për zbatimin e ligjit për sinjalizuesit, të cilat synojnë të gjithë zinxhirin komandues brenda Policisë së Shtetit. Një program trajnimi i detyrueshëm në vijim të shërbimit është hartuar dhe përfshin tema specifike mbi etikën në polici dhe sinjalizimin. Në vitin 2024 u zhvillua një sesion trajnimi, në bashkëpunim me Komitetin Shqiptar të Helsinkit, me temë “Për Sinjalizimin, Hetimin Administrativ dhe Mbrojtjen e Sinjalizuesve, si dhe Rregullat e Etikës dhe Sjelljes për Punonjësit e Policisë së Shtetit”, me pjesëmarrjen e 30 punonjësve të Policisë së Shtetit. (Rek. xxiv⁵⁴).

Analiza dhe vlerësimi për ecurinë dhe progresin e rekomandive dhe rezultatet e këtij raundi janë parashikuar për tu vlerësuar në seancën plenare të për Shqipërinë në mars 2025.

Sa më sipër, masa 1.2.3 dhe aktivitetet e parashikuara për këtë periudhë zbatimi, lidhur me këtë masë dhe ato në vijim, kanë ndikuar drejtpërdrejt në vlerën e synuar të treguesit të performancës 1.2.3. Në përfundim, vlerësohet se gjatë vitit 2024, DPAK ka të plotë informacionin referuar institucioneve publike qendrore dhe vendore që kanë plane integriteti të miratuara dhe në zbatim, dhe administron të dhëna për to. Ky tregues performance është realizuar në masën 100%.

Paraqitja e realizueshmërisë së treguesit sipas Pasaportës së Treguesve, paraqitet si vijon:

Vlerat Bazë	2023	
	N/A	
	2024	11 ministri, 23 bashki
	2025	Të paktën 80% e institucioneve publike të parashikuara kanë miratuar Plane të Integritetit (kumulative)
	2026	Të paktën 85% e institucioneve publike të parashikuara kanë miratuar Plane të Integritetit (kumulative)
	2027	Të paktën 90% e institucioneve publike të parashikuara kanë miratuar Plane të Integritetit (kumulative)
	2028	Të paktën 95% e institucioneve publike të parashikuara kanë miratuar Plane të Integritetit ((kumulative)
	2029	Të gjitha institucionet publike kanë miratuar Plane të Integritetit (kumulative)
	2030	Të gjitha institucionet publike kanë miratuar Plane të Integritetit (kumulative)
Vlera synuar/ Targeti	2024 (targeti i synuar)	11 ministri, 23 bashki
	2024 (targeti i arritur)	100%

⁵⁴ Rek. xxiv) Të sigurohet efektiviteti i zbatimit të ligjit për sinjalizuesit, duke përfshirë trajnimin dhe informimin e rregullt të stafit të policisë për masat e mbrojtjes së sinjalizuesve.

Niveli i realizimit të objektivit 1.2.

Niveli i realizimit të *Objektivit 1.2. Forcimi i transparencës, llogaridhënies dhe integritetit të institucioneve publike në të gjitha nivelet e qeverisjes*, në lidhje me realizimin e treguesve të performancës për periudhën janar-dhjetor 2024 **është 100%.**

Përlllogaritja është kryer duke matur dhe evidentuar raportet e vlerësimit të kryer, dhe të dhënat e administruara, në përputhje me parashikimin e bërë në listën e treguesve të performancës, aneks 2 i Strategjisë Ndërsektoriale Kundër Korrupsionit, 2024-2030.

Përlllogaritja është kryer sipas formulës së mëposhtme:

$$NR\ 1.2 = \frac{TP\ 1.2.1\ (100\%)+TP\ 1.2.2\ (100\%)+TP\ 1.2.3\ (100\%)}{3\ TP} \times 100\% = 100\%$$

Verifikueshmëria e të dhënave

Të dhënat e raportuara mbi treguesit e performancës janë bazuar në informacionin e raportuar nga KDIMDP, ILDKPKI dhe Drejtoria e Përgjithshme e Antikorrupsionit, për monitorimin e zbatimit të planit të veprimit për janar - dhjetor 2024. Këto informacione gjenden dhe mund të aksesohen edhe në raportet e tyre vjetore të performancës.

Risqet për realizimin e Objektivit 1.2

Për vitin 2024, nuk janë evidentuar risqe frekvente në realizimin e objektivit specifik. Ecuria e zbatimit të masave, specifikisht të lidhura me forcimin e transparencës, kontrollin e pasurive, instrumentet e integritetit në të gjitha nivelet e qeverisjes, mund të ketë një risk të ulët nëse administrata e këtyre institucioneve do të ulë mekanizmat e kontrollit, përkatësisht.

1.3 Zhvillimi i një qasje të qëndrueshme për parandalimin e korrupsionit në sektorët me risk (prevalencë të lartë të korrupsionit).

Për këtë objektiv janë përcaktuar 2 tregues performance:

1.3.1: Raporti i numrit të vlerësimeve të riskut të korrupsionit të kryera me numrin e sektorëve/institucioneve me rrezik të lartë për korrupsion (trend rritës).

1.3.2: Raporti i numrit të Planeve të Veprimit të hartuara për parandalimin e korrupsionit, nga numri i sektorëve/institucioneve me rrezik të lartë për korrupsion (trend rritës).

Plani i veprimit për Objektivin 1.3, në periudhën Janar-Dhjetor 2024 parashikon 9 aktivitete dhe 4 masa.

Vlera e synuar për *treguesin e performancës 1.3.1 dhe 1.3.2* për vitin 2024, janë: Përgatitja e vlerësimit (metodologjia e vlerësimit) për 1.3.1 dhe Përgatitja e Vlerësimit/metodologjia e planeve të veprimit për 1.3.2.

Për të arritur vlerat e treguesit në përputhje me pasaportën e treguesve të performancës dhe konkretisht me planin e veprimit 2024-2026, janë parashikuar aktivitetet (9) dhe masa (4), si më poshtë.

Analiza dhe vlerësimi i tyre për këtë raport monitorimi do të bëhet në mënyrë kumulative për shkak të lidhjes organike dhe relevante që kanë kryerja dhe zbatimi i aktiviteteve, përkatësisht.

1.3.1	Parandalimi i korrupsionit në sektorin publik
1.3.1.1	Rishikimi i metodologjisë së Vlerësimit të Riskut të Korrupsionit në Sektorin Publik
1.3.2	Parandalimi i korrupsionit në menaxhimin e sektorit të pronave
1.3.2.1	Hartimi i metodologjisë për vlerësimin e risqeve të korrupsionit mbi baza funksionesh/veprimtarie në fushën e pronave, si seksion i Metodologjisë së Vlerësimit të Riskut të Korrupsionit në Sektorin Publik
1.3.2.2	Regjistri i riskut të sektorit të pronës, i publikuar dhe informuar, për publikun (vjetore)
1.3.2.4	Vlerësimi i riskut të integritetit dhe Plani i Integritetit i ASHK, i miratuar dhe i publikuar
1.3.2.6	Hartimi i programeve të trajnimit të dedikuara për personelin e kadastrës
1.3.4	Parandalimi i korrupsionit në fushën e arsimit
1.3.4.4	Vlerësim i kurrikulës arsimore për rishikimin e programit për përfshirjen e tematikave antikorrupsioni
1.3.5	Parandalimi i korrupsionit në fushën e prokurimeve publike
1.3.5.1	Hartimi i metodologjisë për vlerësimin e risqeve të korrupsionit në fushën e prokurimeve publike
1.3.5.2	Vlerësim i riskut të korrupsionit për fushën e prokurimeve publike (faktorët e riskut)
1.3.5.5	Marrëveshje Bashkëpunimi në luftën kundër korrupsionit në administratën publike në fushën e prokurimeve publike (nënshkruar marrëveshje) midis DPAK dhe APP

Realizimi i masave të parashikuara kryhet përmes aktiviteteve që vijnë përgjatë gjithë vitit me vlera të matshme dhe specifikisht siç janë hartimi i metodologjisë bazë dhe të pjesëve përbërëse të saj për sektorë specifikë të adresuar në këtë objektiv, dhe të planit të masave për veprime. Këto masa dhe aktivitete janë me kohëzgjatje të përcaktuar vitin 2024 dhe që vijnë edhe përgjatë gjithë kohës së zbatimit të këtij plani veprimi, 2024-2026.

Për janar – dhjetor 2024, rezulton se ka filluar procesi i hartimit të Metodologjisë së Vlerësimit të Riskut të Korrupsionit në sektorin publik, për t'u finalizuar në qershor 2025, me një vendim miratimi të Koordinatorit Kombëtar Kundër Korrupsionit. Metodologjia ofron përmbledhje të detajuar të procesit për vlerësimin e riskut të korrupsionit, duke e strukturuar në disa faza dhe duke shpjeguar në detaje secilën prej tyre. Metodologjia pritet të ofrojë një prezantim të llojeve të ndryshme të faktorëve të riskut të korrupsionit, si dhe përkufizimin e disa termave të rëndësishëm që janë të lidhura me këtë fushë. Metodologjia do të trajtojë dilemat etike për sektorët publikë në risk korrupsioni dhe vjen si një ndërthurje e vlerësimit të riskut të integritetit dhe riskut të korrupsionit.

Me urdhrin nr.1357, datë 30.7.2024 është miratuar Regjistri i Menaxhimit të Riskut për Drejtorinë e Përgjithshme të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës për vitin 2024. Referuar këtij urdhri, drejtoritë vendore të shërbimit të kadastrës, me synimin dhe arritjen e objektivave institucionale, analizojnë dhe përditësojnë përgjatë një viti kalendarik, mekanizmat e kontrollit brenda strukturave të tyre drejtuese, me qëllimin për të minimizuar risqet e identifikuara dhe reduktuar mundësitë për ndërhyrje të jashtme, duke automatizuar proceset që mund të krijojnë hapësira për korrupsion. Ky aktivitet është replikues për çdo vit zbatimi të planit të veprimit antikorrupsion.

Në vitin 2024, ka nisur procesi i vlerësimit të riskut të korrupsionit në fushën e pronave (identifikimi i faktorëve të riskut). Me urdhrin nr. 1769, datë 14.10.2024 të Drejtorit të Përgjithshëm të ASHK-së, është ngritur grupi i punës “Për hartimin e Planit të Integritetit për Agjencinë Shtetërore të Kadastrës, për periudhën 2025-2026”. Grupi i punës, kryesohet nga drejtoria juridike dhe e kontrollit tekniko-ligjor në ASHK dhe ka në përbërje anëtarë të drejtorive teknike të ASHK-së, në nivel drejtues dhe ekzekutiv. Pjesë e këtij grupi janë edhe staf teknikë dhe operacionalë të Drejtorisë së Përgjithshme të Antikorrupsionit, për të thelluar vlerësimin e riskut të integritetit ndër strukturat teknike të ASHK dhe konkluduar me një plan integriteti që do të mundësojë adresimin e problematikave në sektorin e pronës, për të gjithë administratën e pronave në vend. Procesi pritet të përfundojë brenda vitit 2025.

Në vitin 2024, në zbatim të vlerësimit të nevojave për trajnim për punonjësit e Agjencisë së Kadastrës, Shkolla Shqiptare e Administratës Publike ka vlerësuar nevojat e brendshme dhe gjithashtu të jashtme për trajnim për ta. Drejtorita e Statistikës dhe Performancës bashkërendon veprimtarinë për programet e trajnimit të dedikuar dhe për miratimin e kurrikulave të dedikuara dhe për të nisur nga dhënia e tyre prej vitit 2025.

Në vitin 2024, Ministria e Arsimit dhe Sportit ka vlerësuar përmbajtjen e kurrikulës së lëndës “Qytetaria”, duke analizuar linjat përmbajtësore dhe temat konkrete të lëndës mësimore sipas niveleve arsimore, përkatësisht: (1) studiuar hapësirën kurrikulare për integrimin e plotë të tematikës ose të koncepteve themelore që lidhen me edukimin antikorrupsion, (2) studiuar mundësia e integritetit të koncepteve ose të objektivave që lidhen me edukimin antikorrupsion në tematikat ekzistuese dhe, (3) studiuar mundësia e integritetit të edukimit antikorrupsion në kurrikulat e lëndëve të tjera, për ta kthyer këtë edukim si edukim mbarëshkollor.

Janë zhvilluar kurrikulat për lëndën e edukimit qytetar për klasat 1, 6 dhe 10, të arsimit parauniversitar, të cilat priten të miratohen brenda vitit 2025. Në këto kurrikula është realizuar integrimi i edukimit kundër korrupsionit, i përshtatur në ciklet përkatëse në formën e edukimit për integritet moral (CU) dhe përmes objektivave të edukimit ligjor dhe të të drejtave të njeriut, në kuadrin e kurrikulës së edukimit qytetar për ciklin AMU dhe AML.

Në vitin 2024, Agjencia e Prokurimit Publik në bashkëpunim me Ministrin e Shtetit për Administratën Publike dhe Antikorrupsionin dhe me asistencën e partnerëve ndërkombëtarë ka nisur konceptimin dhe draftimin e dokumentit të parë, që do shërbejë si bazë për miratimin e metodologjisë për vlerësimin e risqeve të korrupsionit në fushën e prokurimeve publike. Në bashkëpunim me ekspertizën e OSBE në Tiranë është hartuar dokumenti, Kuadri Bazë për Metodologjinë e Vlerësimit të Riskut të Korrupsionit, që do të jetë udhërrëfyesi i procesit të vlerësimit dhe me treguesit e performancës në fushën e prokurimit publik. Për këtë qëllim, janë të identifikuar disa faktorë risku për vlerësim.

Në relevancë me hartimin e dokumentit metodologji për prokurimin publik, vlerësimi i riskut të korrupsionit për fushën e prokurimeve publike vijon të mbetet në zbatim dhe në pritje të një dokumenti final.

Lufta kundër korrupsionit në administratën publike në fushën e prokurimeve publike bashkoi me një marrëveshje bashkëpunimi dy autoritete me kompetenca parandalimi, Drejtorinë e Përgjithshme të Antikorrupsionit dhe Agjencinë e Prokurimit Publik. Në datën 30.12.2024, u nënshkrua Marrëveshja e Bashkëpunimit “Për bashkëpunimin e ndërsjellë në luftën kundër

korupsionit”, në të cilën parashikohen të drejta dhe detyrime respektive për të dyja institucionet duke parashikuar objektiva dhe fushat e bashkëpunimit respektiv midis dy institucioneve.

Marrëveshja lehtëson bashkëpunimin midis dy autoriteteve publike në funksion të parandalimit të veprimeve korruptive, përdorimit të mirë dhe eficient të fondeve publike, kontrollit dhe sigurimit të procedurave ligjore të prokurimit publik. Garantimi i procedurave korrekte dhe ligjore të prokurimit publik, ruajtja e integritetit të zyrtarëve publikë, funksionarë të autoriteteve kontraktore, promovimi i rasteve të mira dhe intensifikimi i kontrolleve dhe denoncimi i rasteve të korupsionit në prokurime publike, janë objektivi i marrëveshjes, e cila do të shërbejë si një promotor i lehtësimit të komunikimit mes dy autoriteteve dhe zyrtarëve publikë të tyre. Marrëveshja mund të aksesohet lehtësisht në: <https://www.app.gov.al/GetData/DownloadDoc?documentId=6a6ecbd4-d0cd-475a-84dd-3698f1484917>.

Sa më sipër, masat dhe aktivitetet e parashikuara për këtë periudhë zbatimi, kanë ndikuar drejtpërdrejt në vlerën e synuar të treguesve të performancës 1.3.1 dhe 1.3.2. Në përfundim, vlerësohet se gjatë vitit 2024, mbetet ende në proces konsolidimi përgatitja e vlerësimit (metodologjia e vlerësimit) dhe për ti hapur udhë gjithashtu, matjes së treguesit të dytë, për përgatitja e vlerësimit/ metodologjia e planeve të veprimit.

Si përfundim, në lidhje me matjen e treguesve të performancës 1.3.1 dhe 1.3.2 për vitin 2024, nuk ka qenë e mundur arritja e vlerave të synuara vjetore (raport vlerësimi dhe metodologjia e planit të veprimit) për shkak të disa arsyeve objektive. Kryesisht, masa përkatëse (1.3.1) që do të mundësonte realizimin e këtyre treguesve ka një afat zbatimi që përfundon në qershor 2025, dhe për rrjedhojë, indikatorët nuk mund të maten plotësisht në fund të vitit 2024. Gjithashtu, vlerësimi i riskut dhe përgatitja e Planeve të Veprimit (metodologjia) janë procese shumëdimensionale që kërkojnë ndërveprim të vazhdueshëm ndërinstitucional dhe angazhim teknik të thelluar. Këto procese përfshijnë faza të domosdoshme konsultimi, koordinimi dhe harmonizimi, që kanë një cikël kohor të natyrshëm përtej një viti kalendarik. Për më tepër, treguesit në fjalë janë të lidhur me përfundimin e plotë të ciklit metodologjik, i cili nuk mund të fragmentarizohet për qëllime matjeje të ndërmjetme, pa cënuar cilësinë dhe saktësinë e të dhënave. Në këtë kuadër, pamundësia për të matur këta indikatorë në vitin 2024 nuk reflekton një mungesë përpjekjeje, por është rezultat i objektivave afatmesme që duhet të ndiqen me përpikmëri, në përputhje me kalendarin e përcaktuar të zbatimit të strategjisë. Ndaj sa më sipër, në përputhje me metodologjinë e monitorimit dhe vlerësimit (M&R) të dokumenteve strategjike, sipas së cilës mbi bazën e vlerësimit të vlerës së synuar të treguesit të performancës vlerësohet edhe niveli i zbatimit të objektivit. Për këtë arsye, objektivi specifik 1.3 nuk arrihet të matet për këtë vit zbatimi, 2024.

Paraqitja e realizueshmërisë së treguesve 1.3.1 dhe 1.3.2, sipas Pasaportës së Treguesve, paraqitet si vijon:

Vlerat Bazë	2023	
	N/A	
	2024	Përgatitja e vlerësimit (metodologjia e vlerësimit)
	2025	40% e institucioneve me rrezik të lartë/prevalencë të korrupsionit kanë kryer vlerësimin e rrezikut të korrupsionit
	2026	70% e institucioneve me rrezik të lartë/ prevalencë të korrupsionit kanë kryer vlerësimin e rrezikut të korrupsionit
	2027	100% e institucioneve me rrezik të lartë/ prevalencë të korrupsionit kanë kryer vlerësimin e rrezikut të korrupsionit
	2028	100% e institucioneve me rrezik të lartë/ prevalencë të korrupsionit kanë kryer vlerësimin e rrezikut të korrupsionit
	2029	100% e institucioneve me rrezik të lartë/ prevalencë të korrupsionit kanë kryer vlerësimin e rrezikut të korrupsionit
	2030	100% e institucioneve me rrezik të lartë/ prevalencë të korrupsionit kanë kryer vlerësimin e rrezikut të korrupsionit
Vlera synuar/ Targeti	2024 (targeti i synuar)	1.3.1 Përgatitja e vlerësimit (metodologjia e vlerësimit) 1.3.2 Përgatitja e vlerësimit (metodologjia e planeve të veprimit)
	2024 (targeti i arritur)	Nuk matet

Niveli i realizimit të objektivit 1.3.

Niveli i realizimit të *Objektivit 1.3. Zhvillimi i një qasje të qëndrueshme për parandalimin e korrupsionit në sektorët me risk (prevalencë të lartë të korrupsionit)*, në lidhje me realizimin e treguesve të performancës për periudhën janar-dhjetor 2024 **nuk mund të matet**.

Përllogaritja është në pamundësi për tu matur dhe evidentuar me raportet e vlerësimit të kryer, dhe të dhënat e administruara, në përputhje me parashkrimin e bërë në listën e treguesve të performancës, aneks 2 i Strategjisë Ndërsektoriale Kundër Korrupsionit, 2024-2030.

Risqet për realizimin e Objektivit 1.3

Për vitin 2024, realizimi i objektivit është vënë në risk si rezultat i pamundësisë së miratimit të metodologjisë së vlerësimit dhe me qëllim nisjen e vlerësimit për sektorët e adresuar me prevalencë të lartë korrupsioni.

1.4 Forcimi i mekanizmave të parandalimit të korrupsionit në njësitë e vetëqeverisjes vendore.

Për këtë objektiv është përcaktuar 2 tregues performance:

1.4.1: Raporti i numrit të bashkive dhe qarqeve që kanë kryer vlerësime të riskut të integritetit nga numri i atyre që ende nuk e kanë kryer (trend rritës).

1.4.2: Raporti i numrit të bashkive dhe qarqeve që kanë përgatitur Plane Integriteti nga numri i atyre që ende nuk e kanë përgatitur (trend rritës).

Plani i veprimit për Objektivin 1.4, në periudhën Janar-Dhjetor 2024 parashikon 1 aktivitet dhe 1 masë.

Vlera e synuar për *treguesin e performancës 1.4.1 dhe 1.4.2* për vitin 2024, janë: Përgatitja e Vlerësimit dhe metodologjia e përgatitur për 1.4.1 dhe Përgatitja e Vlerësimit, për 1.4.2.

Për të arritur vlerat e treguesit në përputhje me pasaportën e treguesve të performancës dhe konkretisht me planin e veprimit 2024-2026, janë parashikuar aktiviteti (1) dhe masa (1) si më poshtë. Analiza dhe vlerësimi i tyre për këtë raport monitorimi do të bëhet në mënyrë kumulative për shkak të lidhjes organike dhe relevante që kanë kryerja dhe zbatimi i aktiviteteve, përkatësisht.

1.4.3	Zbatimi i mekanizmave parandalues të përshtatur me specifikat e Vetëqeverisjes Vendore
1.4.3.4	Përmirësimi i aksesit në informacion, transparenca aktive dhe konsultimi me qytetarët e qarqeve dhe bashkive (faqe interneti funksionale, zyra për qytetarët, botime informuese)

Realizimi i masës së parashikuar kryhet përmes aktivitetit që vijon përgjatë gjithë vitit me vlera të matshme dhe specifikisht siç përmendet aksesit në informacion, transparenca aktive dhe konsultimi me qytetarët e qarqeve dhe bashkive (faqe interneti funksionale, zyra për qytetarët, botime informuese). Kjo është një masë me kohëzgjatje të përcaktuar vitin 2024 dhe që do të vijojë edhe për vitet e tjera të zbatimit të Planit të Veprimit, 2024-2026.

Për janar – dhjetor 2024, rezulton se nga Agjencia për Mbështetjen e Vetëqeverisjes Vendore (AMVV) janë asistuar 13 bashki me qëllim konsolidimin e vlerësimit dhe hartimin e miratimit të Planeve institucionale të Integritetit.

Në përfundim, në vitin 2024, katër bashki si: Shkodër, Fushë-Arrëz, Përrenjas dhe Vlorë, kanë miratuar plane integriteti, duke e çuar në 28⁵⁵ numrin total të bashkive që kanë në fuqi dhe për zbatim plane integriteti.

Të gjitha bashkitë e vendit (61) dhe qarqet (12) kanë aktive një faqe zyrtare interneti dhe në to mund të gjendet i kanë publikuar dokumenti Programi i Transparencës, me të gjithë informacionin e parashikuar për të qenë pjesë e tij.

Pesë fushat kryesore për vlerësim sipas metodologjisë janë: 1) llogaridhënia; 2) transparenca; 3) qasja strategjike ndaj integritetit; 4) standardet e integritetit dhe 5) meritokracia e burimeve njerëzore, të cilat vlerësohen sipas dy kriterëve: kontrolli ligjor dhe institucional dhe kontrolli i zbatimit në praktikë. Raporti i vlerësimit rezulton të jetë i përgatitur dhe sidomos duke kryer vlerësim në procedurat e prokurimeve publike, llogaridhënien dhe forcimin e rolit të audituesve të brendshëm, qartësimin e detyrave të personelit, si dhe përmirësim në menaxhimin financiar dhe transparencën me komunitetin, veçanërisht në treguesit financiarë të tyre. Zbatimi i planeve të integritetit gjithashtu ka forcuar transparencën dhe llogaridhënien në pothuajse të gjitha bashkitë, por ato që reflektojnë ndikim më të lartë janë bashkia e Bulqizës, Tiranës, Lezhës dhe Kukësit. Në

⁵⁵ Durrës, Elbasan, Mallakastër, Patos, Mat, Gjirokastrë, Belsh, Përmet, Pogradec, Bulqizë, Berat, Tiranë, Lezhë, Kukës, Pukë, Himarë, Kavajë, Maliq, Shijak, Has, Rroksvec, Lushnjë, Librazhd, Vlorë, Shkodër, Libohovë, Përrenjas dhe Fushë-Arrës.

përgjithësi bashkitë e vogla, për shkak edhe të burimeve teknike (financiare dhe IT), kanë shkallë më të ulët të impaktit të zbatueshmërisë së planeve të integritetit në nivelin e transparencës dhe llogaridhënies. Në vijim, në vitin 2024, bashkitë kanë treguar angazhim dhe dedikim në materializimin e planeve të integritetit dhe si rrjedhojë në zvogëlimin e risqeve të akteve jo-etike dhe korruptive.

Sa më sipër, masat dhe aktivitetet e parashikuara për këtë periudhë zbatimi, kanë ndikuar drejtpërdrejt në vlerën e synuar të treguesve të performancës 1.4.1 dhe 1.4.2. Në përfundim, vlerësohet se gjatë vitit 2024, ka pasur rritje në numrin e bashkive që kanë kryer vlerësim risku të integritetit dhe kanë miratuar plan integriteti, duke e rritur numrin e tyre në 28, përkatësisht përmenden bashkitë: Shkodër, Fushë-Arrëz, Përrenjas dhe Vlorë. Këta tregues performance janë realizuar në masën 100%.

Paraqitja e realizueshmërisë së treguesve 1.4.1 dhe 1.4.2, sipas Pasaportës së Treguesve, paraqitet si vijon:

Vlerat Bazë	2023	
	N/A	
	2024	1.4.1 Përgatitja e Vlerësimit dhe metodologjia e përgatitur 1.4.2 Përgatitja e vlerësimit
	2025	1.4.1 40% e bashkive dhe qarqeve kanë kryer vlerësimin e rrezikut të integritetit 1.4.2 40% e bashkive dhe qarqeve kanë përgatitur (miratuar) Plane të Integritetit
	2026	1.4.1 70% e bashkive dhe qarqeve kanë kryer vlerësimin e rrezikut të integritetit 1.4.2 70% e bashkive dhe qarqeve kanë përgatitur (miratuar) Plane të Integritetit
	2027	1.4.1 100% e bashkive dhe qarqeve kanë kryer vlerësimin e rrezikut të integritetit 1.4.2 100% e bashkive dhe qarqeve kanë përgatitur (miratuar) Plane të Integritetit
	2028	1.4.1 100% e bashkive dhe qarqeve kanë kryer vlerësimin e rrezikut të integritetit 1.4.2 100% e bashkive dhe qarqeve kanë përgatitur (miratuar) Plane të Integritetit
	2029	1.4.1 100% e bashkive dhe qarqeve kanë kryer vlerësimin e rrezikut të integritetit 1.4.2 100% e bashkive dhe qarqeve kanë përgatitur (miratuar) Plane të Integritetit
	2030	1.4.1 100% e bashkive dhe qarqeve kanë kryer vlerësimin e rrezikut të integritetit 1.4.2 100% e bashkive dhe qarqeve kanë përgatitur (miratuar) Plane të Integritetit
	2024 (targeti i synuar)	1.4.1 Përgatitja e Vlerësimit dhe metodologjia e përgatitur 1.4.2 Përgatitja e vlerësimit

Vlera synuar/ Targeti	2024 (targeti i arritur)	100%
--------------------------	--------------------------	------

Niveli i realizimit të objektivit 1.4

Niveli i realizimit të *Objektivit 1.4 Forcimi i mekanizmave të parandalimit të korrupsionit në njësitë e vetëqeverisjes vendore*, në lidhje me realizimin e treguesve të performancës për periudhën janar-dhjetor 2024 është **100%**.

Përllogaritja është kryer duke matur dhe evidentuar raportet e vlerësimit të kryer, dhe të dhënat e administruara, në përputhje me parashkrimin e bërë në listën e treguesve të performancës, aneks 2 i Strategjisë Ndërsektoriale Kundër Korrupsionit, 2024-2030.

Përllogaritja është kryer sipas formulës së mëposhtme:

$$NR\ 1.4 = \frac{TP\ 1.4.1\ (100\%) + TP\ 1.4.2\ (100\%)}{2\ TP} \times 100\% = 100\%$$

Verifikueshmëria e të dhënave

Të dhënat e raportuara mbi treguesit e performancës janë bazuar në informacionin e raportuar nga KDIMDP dhe AMVV për monitorimin e zbatimit të planit të veprimit për periudhën janar - dhjetor 2024.

Risqet për realizimin e Objektivit 1.4

Për vitin 2024, realizimi i objektivit ka rezultuar në risk mesatar, ka pasur trend rritës, por duhet marrë në konsideratë që në vijim trendi të jetë më bindës.

1.5 *Mbrojtja e financave dhe asetëve publike nga keqpërdorimi gjatë ushtrimit të funksionit publik.*

Për këtë objektiv janë përcaktuar 2 tregues performance:

1.5.1: Rritja e auditimeve në fushat me ndjeshmëri publike për të nxitur përdorimin efektiv të fondeve publike, forcimin e llogaridhënies dhe integritetit të administratës.

1.5.2: Përqindja e rekomandimeve të zbatuara nga institucionet publike nga numri total i rekomandimeve të dhëna (trend rritës).

Plani i veprimit për Objektivin 1.5, në periudhën Janar-Dhjetor 2024 parashikon 2 aktivitete dhe 1 masë.

Vlera e synuar për *treguesin e performancës 1.5.1 dhe 1.5.2* për vitin 2024, janë: Përgatitja e vlerësimit, respektivisht.

Për të arritur vlerat e treguesit në përputhje me pasaportën e treguesve të performancës dhe konkretisht me planin e veprimit 2024-2026, janë parashikuar aktiviteti (2) dhe masa (1) si më poshtë. Analiza dhe vlerësimi i tyre për këtë raport monitorimi do të bëhet në mënyrë kumulative për shkak të lidhjes organike dhe relevante që kanë kryerja dhe zbatimi i aktiviteteve, përkatësisht.

1.5.2	Forcimi i rolit të auditimeve të brendshme dhe të jashtme në parandalimin e korrupsionit
1.5.2.1	Identifikimi i sfidave të realizimit të shërbimit të auditimit të brendshëm në të gjitha nivelet e qeverisjes dhe masat për ndërhyrje
1.5.2.5	Organizimi i trajnimeve të përbashkëta për forcimin e aspektit antikorrupsion në punën e audituesve të brendshëm dhe të jashtëm, mënyrën e komunikimit, koordinimit dhe raportimit

Realizimi i masës së parashikuar kryhet përmes aktiviteteve që vijojnë përgjatë gjithë vitit 2024 me vlera të matshme dhe specifikisht siç përmendet identifikimi i sfidave të kryrjes së shërbimit të auditimit në të gjitha nivelet e qeverisjes. Ndërkohë, trajnimet e përbashkëta për forcimin e aspektit antikorrupsion në punën e audituesve të brendshëm dhe të jashtëm, mënyra e komunikimit, koordinimit dhe raportimit është parashikuar përgjatë gjithë planit të veprimit, për çdo vit. Matja për 2024 do të bëhet në informacionin e mbledhur përkatësisht për periudhën.

Për periudhën *janar – dhjetor 2024*, rezulton se KLSH ka vijuar të përfshijë në objektivat e auditimit dhe të kontrollit të saj pranë autoriteteve publike, auditimin e brendshëm në të gjitha sektorët që mbulon dhe është shprehur edhe për Raportin e Ministrisë së Financave “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”. KLSH ka vijuar bashkëpunimin për shkëmbimin e informacionit dhe organizimin e aktiviteteve të përbashkëta, me organet ligjzbatuese në luftën kundër korrupsionit, duke marrë pjesë në aktivitete dhe tryeza të rrumbullakëta të organizuara nga OJF me qëllim luftën kundër korrupsionit. Ndër to përmenden: marrëveshje bashkëpunimi me qëllim luftimin e korrupsionit në administratën publike, e lidhur midis KLSH dhe Prokurorisë së Posaçme. Është nënshkruar dhe Marrëveshja e Bashkëpunimit, midis KLSH dhe Institutit për Demokraci dhe Ndërmjetësim, për rritjen e transparencës e angazhimit në luftën kundër korrupsionit dhe nevojën për një qasje të gjithë shoqërisë për një qeverisje të mirë dhe efektive nga ana e institucioneve publike.

Aktivitete përmenden: KLSH merr pjesë në workshop-in e organizuar nga Qendra Shqiptare për Kërkime Ekonomike ACER dhe Fondacioni Westminster për Demokraci, “Për vlerësimin parandalues të korrupsionit në Projektligjin për Investimet e Huaja direkte në Republikën e Shqipërisë”; KLSH merr pjesë në takimin e organizuar nga Qendra për Studimin e Demokracisë dhe Qeverisjes me temë “Vlerësimi i performancës dhe progresit: Një rishikim gjithëpërfshirës i rolit të SPAK dhe Gjykatave Speciale në luftën kundër Korrupsionit dhe Krimin të organizuar (2020-2023)”; KLSH merr pjesë në takimin e organizuar nga Komiteti Shqiptar i Helsinkit në Shkodër, dita e diskutimit publik me temë: “Pjesëmarrja qytetare dhe bashkëpunimi me institucionet në luftën kundër korrupsionit”, në kuadër të nismës të projektit “Jo Korrupsionit, Po Demokracisë”, mbështetur financiarisht me fonde të qeverisë suedeze; KLSH merr pjesë në prezantimin e raportit “Fuqizimi i rolit të Kuvendit të Shqipërisë në luftën kundër korrupsionit” Instituti Demokratik Amerikan prezantoi gjetjet e raportit “Fuqizimi i rolit të Kuvendit të Shqipërisë në luftën kundër korrupsionit”; KLSH merr pjesë në programin pilot të Akademisë Ndërkombëtare të OECD për Hetimin e Tatimeve dhe Krimin Financiar me temë “Keqpërdorimi i teknologjisë në krimet financiare” të zhvilluar në Ostia.

Në vitin 2024, KLSH ka realizuar programimin periodik të auditimeve në të gjitha institucionet e pavarura që raportojnë në Kuvendin e Shqipërisë dhe gjetjet e këtyre auditimeve u janë paraqitur komisioneve parlamentare bazuar edhe në analizën e risqeve të tyre. KLSH ka rishikuar

organigramën dhe strukturën institucionale duke ngritur në strukturën e saj Drejtorinë e Marrdhënieve me Parlamentin, me të cilën janë zhvilluar dy dëgjesa publike në Nënkomisionin Parlamentar, “Për auditimin në sektorin publik”, në Kuvend, vijueshmëria e impaktit të të cilit do të merret në vitin 2025. Është vijuar me publikimin në faqen zyrtare të institucionit të raporteve të auditimit të kryera, të raporteve të paraqitura nga KLSH në Kuvendin e Shqipërisë (160 raporte auditimi) dhe informuar periodikisht për rezultatet e punës audituese edhe nëpërmjet përcjelljes së buletineve statistikore periodike, raporteve periodike të zbatimit të rekomandimeve, raportit mbi zbatimin e buxhetit të shtetit dhe raportit vjetor mbi performancën e KLSH-së.

Në vitin 2024, në kuadër të riorganizimit të statistikave në funksion edhe të zbatimit të rekomandimeve, KLSH rikonceptoi tërësisht formatin e statistikave të auditimeve duke përdorur formate më të avancuara, të cilat ofrojnë mundësinë e përpunimit të të dhënave sipas kërkesës. Gjithashtu, u rikonceptua në tërësi formati statistikor mbi ndjekjen e zbatimit të rekomandimeve të lëna në auditimet e mëparshme duke mundësuar mbledhje dhe analiza informacioni që ofrojnë mundësinë e përdorimit të përllogaritjeve të avancuara mbi të dhënat.

KLSH ka vijuar me përgatitjen dhe shpërndarjen e buletinit përmbledhës të institucionit. Ka publikuar në faqen web raportet e auditimit me qëllim promovimin e punës audituese dhe informimin e vazhdueshëm të palëve të interesit. Gjithashtu, për auditimet me ndjeshmëri të lartë, ka promovuar rezultatet e auditimit nëpërmjet përgatitjes së broshurave, ku gjatë vitit 2024 janë përgatitur si vijon: përgatitja e materialeve informuese mbi rolin dhe veprimtarinë e KLSH-së, në gjuhën shqipe dhe angleze; mbi aktivitetin e departamenteve të auditimit; mbi auditimet eës performancës “Ndikimi i mjeteve të transportit rrugor në cilësinë e ajrit” dhe auditimin “Fuqizimi ekonomik i gruas në vendin tonë”, në bashkëpunim me zyrën UN Women në Shqipëri.

Në vitin 2024, gjithashtu, në drejtim të forcimit të kapaciteteve audituese për auditimin e PPP-ve dhe kontratave koncesionare, KLSH ka qenë pjesë e projektit “Forcimi i mbikëqyrjes së kontratave të koncesionit dhe partneritetit publik privat në Shqipëri”, financuar nga Sekretariati i Shtetit për Çështjet Ekonomike të Zvicrës Aktiviteti Auditues (SECO) “Mbi forcimin e kapaciteteve audituese për auditimin e koncesioneve/PPP-ve”. Në këtë kuadër përmenden:

- Trajnimi i vazhdueshëm i audituesve në lidhje me metodologjitë dhe teknikat audituese për audituesit e rinj dhe ata me më eksperiencë me 26 ditë trajnime/vit/auditues;
- Përmirësim të dokumentimit të punës audituese në mbështetje të gjetjeve të auditimit, duke pasur parasysh gjithmonë përputhshmërinë e plotë me standardet ndërkombëtare të auditimit, nëpërmjet rishikimit të plotë të Rregullores së Procedurave të Auditimit si dhe letrave të punës pjesë e kësaj rregulloreje.

Në vitin 2024, KLSH ka hartuar dokumentin Metodologji e Planifikimit Vjetor të Auditimeve, miratuar me vendimin e Kryetarit të KLSH-së. Ky dokument unifikon procesin e planifikimit të auditimeve duke përcaktuar indikatorët më të rëndësishëm, të cilët mbahen në konsideratë dhe vlerësohen për përzgjedhjen e temave.

Gjatë vitit 2024, Ministria e Financës ka kryer shërbimin e auditimit të brendshëm në të gjitha nivelet e qeverisjes. Kështu, pjesa më e madhe e njërive publike mbulohen me shërbimin e auditimit të brendshëm, me përjashtim të 6 njërive të pushtetit vendor dhe 27 institucione të pavarura (gjithsej 33 njësi publike).

Në vitin 2024, është vijuar me bashkëpunimet me institucionet homologe dhe ndërkombëtare të fushës si: KLSH të Norvegjisë, Kroaci, Maqedonisë së Veriut, Turqisë me fokus për të zhvilluar

dhe rritur me tej bashkëpunimet dhe shkëmbyer eksperiencia në fushën e auditimeve. KLSH në shqyrtimin e zbatimit të rekomandimeve, ka rikërkuar nga të gjitha subjektet zbatimin e masave të pazbatuara, si dhe ka inkurajuar zbatimin e masave që kanë rezultuar në proces ose të zbatuara pjesërisht.

Sa më sipër, masa dhe aktivitetet e parashikuara për këtë periudhë zbatimi, kanë ndikuar drejtpërdrejt në vlerën e synuar të treguesve të performancës 1.5.1 dhe 1.5.2, duke përgatitur raporte vlerësimi me qëllim lehtësimin e të procesit për matjet në vitet në vijim.

Treguesi 1.5.1: vlerësohet se gjatë vitit 2023⁵⁶, KLSH ka kryer 195 auditime, një vlerë e rritur kundrejt viteve të mëparshme (viti 2021: 205 auditime dhe viti 2022: 205 auditime). Fushat dhe sektorët ku janë kryer auditimet e KLSH janë: Institucione të qeverisjes qendrore (30); Njësi të vetëqeverisjes vendore (68); Shoqëri publike dhe investime të huaja (17); Institucione të administrimit të aseteve dhe mbrojtjes së mjedisit (8); Institucionet ku janë kryer auditime IT (8) dhe institucione ku janë kryer auditime performance, gjithsej 64. Ministria e Financës ka kryer gjithsej 127 auditime në njësitë e qeverisjes së përgjithshme.

Referuar matjes së treguesit të performancës 1.5.2: vlerësohet se rekomandimet e lëna nga KLSH për vitin 2023⁵⁷, janë në total në total 5 759. Janë pranuar 4 273 masa (99.6%) të rekomanduara nga subjektet e audituara dhe nuk janë pranuar 18 masa (4%) të rekomanduara. Referuar të dhënave nga Ministria e Financës, në monitorimin e nivelit të zbatimit të rekomandimeve të dhëna nga ana e audituesve të brendshëm, rezulton se niveli i pranueshmërisë nga subjektet e audituara është në masen 99.4% dhe i zbatueshmërisë në masën 53.5%. Auditimi i brendshëm pranë Ministrisë së Financës ka dhënë 6 935 rekomandime dhe nga këto janë zbatuar 3 709 rekomandime (53.5%) dhe 2 694 rekomandime mbeten në proces zbatimi. Sa më sipër, këta tregues performance janë realizuar në masën 100%.

Paraqitja e realizueshmërisë së treguesve 1.5.1 dhe 1.5.2, sipas Pasaportës së Treguesve, paraqitet si vijon:

Vlerat Bazë	2023	
	N/A	
	2024	1.5.1 Përgatitja e vlerësimit 1.5.2 Përgatitja e vlerësimit
	2025	1.5.1 5% rritje e numrit të auditimeve të brendshme dhe të jashtme të kryera 1.5.2 80% e rekomandimeve të auditimit të brendshëm dhe të jashtëm zbatuar
	2026	1.5.1 10% rritje e numrit të auditimeve të brendshme dhe të jashtme të kryera (kumulative) 1.5.2 90% e rekomandimeve të auditimit të brendshëm dhe të jashtëm zbatuar
	2027	1.5.1 15% rritje e numrit të auditimeve të brendshme dhe të jashtme të kryera (kumulative)

⁵⁶ Raporti do të marrë në vlerësim të dhënat e vitit 2023 (viti paraardhës).

⁵⁷ Raporti do të marrë në vlerësim të dhënat e vitit 2023 (viti paraardhës).

		1.5.2 95% e rekomandimeve të auditimit të brendshëm dhe të jashtëm zbatuar
	2028	1.5.1 20% rritje e numrit të auditimeve të brendshme dhe të jashtme të kryera (kumulative) 1.5.2 100% e rekomandimeve të auditimit të brendshëm dhe të jashtëm zbatuar
	2029	1.5.1 25% rritje e numrit të auditimeve të brendshme dhe të jashtme të kryera (kumulative) 1.5.2 100% e rekomandimeve të auditimit të brendshëm dhe të jashtëm zbatuar
	2030	1.5.1 30% rritje e numrit të auditimeve të brendshme dhe të jashtme të kryera (kumulative) 1.5.2 100% e rekomandimeve të auditimit të brendshëm dhe të jashtëm zbatuar
Vlera synuar/ Targeti	2024 (targeti i synuar)	1.5.1 Përgatitja e Vlerësimit 1.5.2 Përgatitja e vlerësimit
	2024 (targeti i arritur)	100%

Niveli i realizimit të objektivit 1.5

Niveli i realizimit të *Objektivit 1.5 Mbrojtja e financave dhe asetëve publike nga keqpërdorimi gjatë ushtrimit të funksionit publik* në lidhje me realizimin e treguesve të performancës për periudhën janar - dhjetor 2024 është **100%**.

Përllogaritja është kryer duke matur dhe evidentuar raportet e vlerësimit të kryer, dhe të dhënat e administruara, në përputhje me parashkrimin e bërë në listën e treguesve të performancës, aneks 2 i Strategjisë Ndërsektoriale Kundër Korrupsionit, 2024-2030.

Përllogaritja është kryer sipas formulës së mëposhtme:

$$NR\ 1.5 = \frac{TP\ 1.5.1\ (100\%) + TP\ 1.5.2\ (100\%)}{2\ TP} \times 100\% = 100\%$$

Verifikueshmëria e të dhënave

Të dhënat e raportuara mbi treguesit e performancës janë bazuar në informacionin e raportuar nga KLSH dhe MF për të dhëna për procese auditimi (të jashtme) dhe auditime të brendshme, të kryera dhe rekomandime të zbatuara.

Risqet për realizimin e Objektivit 1.5

Për vitin 2024, realizimi i objektivit është ka rezultuar në risk të ulët.

1.6 Forcimi i kornizës së sinjalizuesve për zbulimin e hershëm të korrupsionit.

Për këtë objektiv është përcaktuar 1 tregues performance:

1.6.1: Përqindja e akteve ligjore dhe nënligjore për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve, të miratuara, nga ato që janë planifikuar të miratohen (trend rritës).

Plani i veprimit për Objektivin 1.6, në periudhën Janar-Dhjetor 2024 parashikon 1 aktivitet dhe 1 masë.

Vlera e synuar për *treguesin e performancës 1.6.1* për vitin 2024, është: Përgatitja e vlerësimit.

Për të arritur vlerën e treguesit në përputhje me pasaportën e treguesve të performancës dhe konkretisht me planin e veprimit 2024-2026, janë parashikuar aktiviteti (1) dhe masa (1) si më poshtë.

1.6.2	Forcimi i kuadrit institucional për sinjalizimin
1.6.2.2	Ngritja e njësive të sinjalizimit (aty ku mungojnë) dhe plotësimi i stafit të tyre

Realizimi i masës së parashikuar kryhet përmes aktivitetit që vijon përgjatë gjithë vitit 2024 dhe viteve të tjera të planit të veprimit siç përmendet ngritja e njësive të sinjalizimit dhe plotësimi i stafit të tyre, informacion që duhet të vijë nga të gjithë autoritetet publike dhe të koordinohet nga ILDKPKI. Matja për 2024 do të bëhet në informacionin e mbledhur përkatësisht për periudhën.

Për janar – dhjetor 2024, rezulton se janë ngritur njësitë e sinjalizimit dhe gjithashtu plotësuar me staf 36 njësi përgjegjëse nga sektori privat dhe 4 njësi përgjegjëse nga sektori publik. ILDKPKI, ka vijuar të monitorojë rregullisht procesin e krijimit të Njësive Përgjegjëse për Sinjalizimin pranë institucioneve publike dhe në sektorin privat. Me mbledhjen e informacionit të dërguar nga autoritetet publike, ILDKPKI, përfundoi procesin e rishikimit të Regjistrit Kombëtar të Njësive Përgjegjëse në Autoritetet Publike, në të cilin janë pasqyruar të dhënat dhe funksioni i personave të ngarkuar për të zbatuar ligjin për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve. Nga të dhënat statistikore, rezulton se, në total janë ngritur dhe funksionojnë 194 Njësi Përgjegjëse në sektorin publik. Po ashtu, ILDKPKI, koordinoi punën me Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve, për identifikimin e organizatave private, të cilat kishin të punësuar mbi 100 punonjës, për të vendosur kontaktet përkatëse për ngritjen e Njësive Përgjegjëse dhe raportimin e tyre pranë ILDKPKI. Në vijim të informacionit të marrë, u rishikuan dhe u përditësuan të dhënat e Regjistrit Kombëtar të Njësive Përgjegjëse në Sektorin Privat, në të cilin janë pasqyruar të dhënat dhe funksioni i personave të ngarkuar, për të zbatuar ligjin për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve. Në total, në mbarë vendin janë ngritur dhe funksionojnë 540 Njësi Përgjegjëse në sektorin privat.

Autoritete publike dhe private me njësi përgjegjëse sinjalizimi në funksion të plotë rezultojnë të jenë 734.

Gjithashtu, disa të dhëna të shtuara për këto njësi si më konkretisht pranë MBZHR, janë ringritur dhe konfirmuar njësitë përgjegjëse pranë AKU, AZHBR, ISUV dhe në DSHPA e cila mbështetet nga njësia e sinjalizimit në MBZHR.

Në lidhje me rritjen e kapaciteteve të Njësive Përgjegjëse, si në sektorin publik ashtu dhe atë privat, në vitin 2024, ILDKPKI, ka realizuar një sërë trajnimesh dhe rritjen e ndërgjegjësimit në lidhje me implementimin e ligjit Nr. 60/2016 “Për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve”, i ndryshuar, me mbështetjen e KiE, BE, OSBE dhe donatorë të tjerë. ILDKPKI, në bashkëpunim me Komitetin Shqiptar të Helsinkit, ka marrë pjesë në sesione të organizuara me institucionet publike në lidhje me rritjen e ndërgjegjësimit mbi sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve. Në këtë kuadër, janë trajnuar 200 punonjës nga institucionet e ndryshme të tilla si: Agjencia e Prokurimeve Publike, Drejtoria e Doganave, Drejtoria e Përgjithshme e Policisë, Drejtoria e Burgjeve, Universiteti i Tiranës, Universiteti Politeknik i Tiranës, etj., mbi parashikimet e ligjit nr. 60/2016. Duhet theksuar se përgjatë periudhës 2018-2024, progresivisht, janë trajnuar 1 870 punonjës, në sesione

trajnimi dhe rritjen e ndërgjegjësimit në lidhje me implementimin e ligjit Nr.60/2016 “Për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve”, si në sektorin publik ashtu dhe në sektorin privat.

Në kuadër të aktiviteteve të sipërmenduara është krijuar ndër të tjera një “paketë digjitale” e cila përmban: (i) një broshurë mbi konceptin e sinjalizuesit dhe mbrojtjen nga hakmarrja, (ii) manual praktik mbi legjislacionin dhe procedurat mbi sinjalizimin, (iii) të dhëna cilësore dhe sasiore për rastet e sinjalizimit dhe shembuj pozitivë në rastet e mbrojtjes nga hakmarrja. Kjo paketë digjitale është publikuar duke rritur ndërgjegjësimin publik në lidhje me sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesit. Vlen për t’u theksuar që në faqen zyrtare të ILDKPKI ka një seksion të veçantë në lidhje me legjislacionin në fuqi mbi “sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesit”, përfshirë dhe publikime të ndryshme, ky seksion është informues, efektiv dhe mund të aksesohet lehtësisht nga vizitorët.

Nga ana tjetër, ka filluar procesi i përgatitjes së kuadrit të ri ligjor (rishikimi) i tij në përputhje me direktivën e BE. Përafrimi synon përmirësimin e mëtejshëm të kuadrit ligjor për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve. Është përgatitur një analizë kuadër për ligjin e brendshëm dhe qasja e tij kundrejt 21 standardeve ndërkombëtare për mbrojtjen e sinjalizuesve, të nxjerra nga rekomandimet e Këshillit të Evropës dhe Direktiva e BE-së.

Shqipëria përmbush pjesërisht standardet dhe ka disa elemente pozitive, si: Detyrimi për të krijuar kanale të qarta raportimi për sinjalizuesit në të gjitha institucionet kryesore; Mbrojtja ndaj të gjitha formave të hakmarrjes në vendin e punës; Mbrojtja për gabimet e paqëllimshme të sinjalizuesve; Garantimi kundër politikave që do të pengonin sinjalizimin e ligjshëm; Ruajtja e konfidencialitetit të sinjalizuesve; Zhvendosja e barrës së provës te punëdhënësi në rastet e ankimeve për hakmarrje dhe Akses në mjete administrative dhe gjyqësore për të kërkuar ndihmë; Një agjenci përgjegjëse për promovimin e të drejtave të sinjalizuesve dhe ofrimin e udhëzimeve për ta dhe transparencë në zbatimin e ligjit.

Analiza identifikon edhe disa mangësi dhe dobësi, si: Mungesa e përfshirjes së sjelljeve të këqija përveç korrupsionit, si objekt sinjalizimi; Dobësitë në mbrojtjen ligjore të atyre që ndihmojnë në përgatitjen e raportimeve të sinjalizimit dhe atyre që zbulojnë informacion si pjesë e detyrave të punës; Testi i besimit për motivet e sinjalizuesve; Kanale të papërshtatshme për sinjalizuesit anonimë; Shkaqe të paqarta për mos-hetimin e raportimeve të sinjalizimit; Mungesa e mbrojtjes nga përgjegjësitë civile dhe penale; Mungesa e ndihmës së përkohshme dhe ndihmës ligjore për sinjalizuesit që fitojnë çështje në gjyq.

Sa më sipër, masa dhe aktiviteti i parashikuara për këtë periudhë zbatimi, kanë ndikuar drejtpërdrejt në vlerën e synuar të treguesit të performancës 1.6.1. Gjithashtu, vlerësohet informacioni dhe analiza e kryer për të përgatitur një raport vlerësimi, që do ti japë udhë procesit të rishikimit të ligjit në vijim, sipas parashikimeve të bëra në strategji. Sa më sipër, mbështetur në të dhënat e administruara ky tregues performance është realizuar në masën 100%.

Paraqitja e realizueshmërisë së treguesve 1.6.1 sipas Pasaportës së Treguesve, paraqitet si vijon:

Vlerat Bazë	2023	
	N/A	
	2024	Përgatitja e vlerësimit
	2025	Përgatitja dhe miratimi i ligjit për mbrojtjen e sinjalizuesve
	2026	Përgatitja dhe miratimi i akteve nënligjore lidhur me ndryshimet në Ligjin për Sinjalizimin dhe Mbrojtjen e Sinjalizuesve
	2027	Zbatimi i ligjit dhe akteve nënligjore për mbrojtjen e sinjalizuesve
	2028	Zbatimi i ligjit dhe akteve nënligjore për mbrojtjen e sinjalizuesve
	2029	Zbatimi i ligjit dhe akteve nënligjore për mbrojtjen e sinjalizuesve
	2030	Zbatimi i ligjit dhe akteve nënligjore për mbrojtjen e sinjalizuesve
Vlera synuar/ Targeti	2024 (targeti i synuar)	Përgatitja e Vlerësimit
	2024 (targeti i arritur)	100%

Niveli i realizimit të objektivit 1.6

Niveli i realizimit të *Objektivit 1.6 Forcimi i kornizës së sinjalizuesve për zbulimin e hershëm të korrupsionit* në lidhje me realizimin e treguesit të performancës për periudhën janar - dhjetor 2024 është **100%**.

Përllogaritja është kryer duke matur dhe evidentuar raportet e vlerësimit të kryer, dhe të dhënat e administruara, në përputhje me parashkrimin e bërë në listën e treguesve të performancës, aneks 2 i Strategjisë Ndërsektoriale Kundër Korrupsionit, 2024-2030.

Shkalla e realizimit të objektivit 1.6 për këtë periudhë raportimi është **100%**.

Verifikueshmëria e të dhënave

Të dhënat e raportuara mbi treguesit e performancës janë bazuar në informacionin e raportuar nga ILDKPKI dhe të dhëna të tjera që administron dhe koordinon Drejtoria e Përgjithshme e Antikorrupsionit.

Risqet për realizimin e Objektivit 1.6

Për vitin 2024, realizimi i objektivit është ka rezultuar në risk të ulët, duke garantuar kryerjen e analizës që do të udhëheqë kryerjen e rishikimit ligjor.

1.7 Forcimi i transparencës financiare dhe integritetit të partive politike.⁵⁸

Për këtë objektiv është përcaktuar 1 tregues performance:

⁵⁸ Objektivi 1.7 nuk ka masa dhe aktivitete për vitin 2024 për tu zbatuar dhe për pasojë për monitorim e vlerësim impakti.

1.7.1: Hartimi i draftit të Ligjit për Financimin e Partive Politike

Plani i veprimit për Objektivin 1.7, në periudhën Janar-Dhjetor 2024 nuk parashikon Aktivitete dhe Masa për zbatim.

Vlera e synuar për *treguesin e performancës 1.7.1* për vitin 2024, është: Përgatitja e vlerësimit.

Objektivi specifik për 2024 do të mbështetet vetëm në disa informacione të mbledhura përkatësisht për periudhën janar-dhjetor 2024, por lidhur me punën paraprake në kuadër të përgatitjes së ndërhyrjeve për kuadrin ligjor shqiptar për rregullimin e financimit politik, për t'u finalizuar brenda vitit 2027, duhet përgatitur një raport vlerësimi.

Kuadri ligjor mbështetet në dy akte themelore: ligji nr. 8580, datë 17.2.2000, “Për Partitë Politike” dhe Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë. Këto dy instrumente ligjore synojnë të garantojnë transparencën, llogaridhënien dhe integritetin e proceseve demokratike në vend. Ligji për Partitë Politike përcakton bazën mbi të cilën mbështetet financimi i partive politike, duke theksuar rëndësinë e transparencës në administrimin e burimeve financiare. Ndërkohë, Kodi Zgjedhor i Shqipërisë përmban dispozita të hollësishme për të parandaluar abuzimin me burimet publike gjatë periudhave zgjedhore. Rregullimi ligjor i financimit të subjekteve zgjedhore gjatë fushatave elektorale synon të forcojë transparencën dhe integritetin e proceseve zgjedhore.

Por, sërish referuar këtyre rregullimeve, ligji i brendshëm duhet të përcaktojë rregulla që parandalojnë abuzimet nga burime të fshehta financimi për subjektet politike. Kuadri ligjor duhet të parashikojë rregullime të fushatave të palëve të treta dhe reklamave digjitale; Vetëfinancimi i kandidatëve dhe donatorët për të shmangur çdo formë të ndikimit të tepruar mbi procesin zgjedhor nga interesa të mëdha financiare. Transparenca dhe roli i medias duhet të përcaktohet në mënyrë të tillë që të përfshijë të gjitha format e mbështetjes financiare apo mediatike si dhe gjithashtu të ketë rregullime për monitorimin e mediave dhe rrjeteve sociale, duke pasur parasysh ndikimin e tyre në opinionin publik dhe për të garantuar barazi në mbulimin e partive politike.

Në përgatitjen paraprake të këtij vlerësimi kanë ndikuar angazhimet e marra nga shteti shqiptar në aktet të tilla si: raporti për Shqyrtimin Analitik të Grupkapitujve I “Themeloret” (2023), që ka pranuar nevojën për rregullimin ligjor dhe limitimin e donacioneve dhe shpenzimeve të cilat kanë nevojë për t'u zgjeruar tek palët e treta. Rritja e kapaciteteve të KQZ-së për të garantuar monitorimin e duhur të financave të partive politike duke përfshirë një regjim auditimi më rigoroz, është gjithashtu një kërkesë për tu adresuar. Open Data Albania, në një analizë të publikuar në vitin 2022, ka vënë në dukje se, edhe pse ka një përmirësim në raportimet publike të partive politike për shpenzimet e tyre gjatë fushatave, ekzistojnë ende boshllëqe të mëdha në raportimin e saktë të të ardhurave dhe shpenzimeve reale, sepse partitë shpesh minimizojnë raportimet e tyre për donacionet private, duke krijuar një mungesë të qartë transparence në aktivitetet financiare të fushatave zgjedhore.

Komisioni Evropian gjithashtu thekson në Raportin për Shqyrtimin Analitik të Grupkapitujve I “Themeloret” (2023) se mungesa e kontrollit efektiv mbi fondet e fushatave minon integritetin e proceseve zgjedhore. E po ashtu, rekomandimi i ODIHR për mungesën e informacionit të të ardhurave të fushatës dhe shpenzimeve përpara ditës së votimit. Në Raportin e KE-së për Shtetin e së Drejtës në Shqipëri (2024), përmendet nevoja për reforma të mëtejshme në këtë fushë për të

siguruar një sistem të mbikëqyrjes më të fortë dhe për të parandaluar abuzimet me financimet e fushatave politike.

Gjithashtu, pjesë e përgatitjes së këtij raporti vlerësimi është bërë edhe raporti rajonal i “*Transparency International*” (2024)⁵⁹ dhe janë evidentuar problematikat kryesore lidhur me financimin politik dhe mbikëqyrjen e tij në Ballkanin Perëndimor dhe Turqi. Veçanërisht për Shqipërinë gjetjet kryesore të raportit, përmenden:

- *Mungesa e raportimit të detajuar të fushatave dhe aktiviteteve digjitale*: Ndërsa kandidatët politikë janë të detyruar të raportojnë aktivitetet dhe shpenzimet e fushatës përmes partive të tyre politike, mungon një rregullore specifike për raportimin e fushatave digjitale dhe në mediat sociale. Kjo përbën një hendek të rëndësishëm në transparencën e financimit të fushatave politike.
- *Transparenca e kufizuar në raportet vjetore*: Në Shqipëri, detajet e shpenzimeve individuale janë të disponueshme vetëm në raportet e fushatave zgjedhore, por jo në raportet vjetore të partive politike, të cilat ofrojnë vetëm përmbledhje të kategorive të shpenzimeve. Kjo mungesë transparence në raportimin vjetor pengon kontrollin e plotë të shpenzimeve të partive.
- *Mbikëqyrja e financave politike dhe mungesa e sanksioneve të rrepta*: Mediat kanë raportuar se disa shkelje të rregullave të financimit të fushatave, si mosdeklarimi i shpenzimeve dhe tejkalimi i kufijve të shpenzimeve të vendosura nga Kodi Zgjedhor, kanë mbetur të pashqyrtuara apo të padënuara nga organet e menaxhimit zgjedhor. Kjo nënvizon nevojën për një mbikëqyrje më të fortë dhe për masa më të ashpra sanksionuese.

Sa më sipër, për të pasur përmirësimin e rregullimit ligjor, do të ishte e nevojshme që të përfshihen dispozita të mëtejshme që specifikojnë ndalimin e dhurimeve jo-financiare, duke përfshirë shërbime mediatike apo ulje çmimesh që mund të favorizojnë subjektet politike në fushata.

Nga ana tjetër, OECD thekson domosdoshmërinë që qeveritë të përmirësojnë mekanizmat e mbikëqyrjes për të garantuar transparencë në financimin politik.

Sa më sipër, për këtë periudhë zbatimi, është arritur të kryhet një raport vlerësimi duke ndikuar drejtpërdrejt në vlerën e synuar të treguesit të performancës 1.7.1. Si rezultat, mbështetur në të dhënat e administruara ky tregues performance është realizuar në masën 100%.

Paraqitja e realizueshmërisë së treguesve 1.7.1 sipas Pasaportës së Treguesve, paraqitet si vijon:

Vlerat Bazë	2023	
	N/A	
	2024	Përgatitja e vlerësimit
	2025	Përgatitja e vlerësimit (analizë e kryer) për ligjin për Financimin e Partive Politike
	2026	Hartimi i kuadrit të ri ligjor për Financimin e Partive Politike
	2027	Miratimi i kuadrit të ri ligjor për Financimin e Partive Politike

⁵⁹ Analizë: “*Between anti-corruption reform and decline*”.

	2028	Miratimi i akteve nënligjore të nevojshme dhe zbatimi i ligjit
	2029	zbatimi i ligjit
	2030	zbatimi i ligjit
Vlera synuar/ Targeti	2024 (targeti i synuar)	Përgatitja e Vlerësimit
	2024 (targeti i arritur)	100%

Niveli i realizimit të objektivit 1.7

Niveli i realizimit të Objektivit 1.7 *Forcimi i transparencës financiare dhe integritetit të partive politike* në lidhje me realizimin e treguesit të performancës për periudhën janar - dhjetor 2024 është **100%**.

Përlllogaritja është kryer duke matur dhe evidentuar përmbatjen dhe rekomandimet e raportit të vlerësimit të kryer, në përputhje me parashkrimin e bërë në listën e treguesve të performancës, aneks 2 i Strategjisë Ndërsektoriale Kundër Korrupsionit, 2024-2030.

Shkalla e realizimit të objektivit 1.7 për këtë periudhë raportimi është **100%**.

Verifikueshmëria e të dhënave

Të dhënat e raportuara mbi treguesit e performancës janë bazuar në informacionin e raportuar nga KQZ dhe të dhëna të tjera që administron dhe koordinon Drejtoria e Përgjithshme e Antikorrupsionit.

Risqet për realizimin e Objektivit 1.7

Për vitin 2024, realizimi i objektivit ka rezultuar në risk të ulët, duke garantuar kryerjen e analizës që do të udhëheqë kryerjen e rishikimit ligjor.

1.8 Ngritja e kuadrit ligjor dhe institucional për lobimin si instrument i parandalimit të korrupsionit.⁶⁰

Për këtë objektiv është përcaktuar 1 tregues performance:

1.8.1: Raporti i numrit të akteve ligjore dhe nënligjore për lobimin të hartuara nga numri i atyre të planifikuara për miratim (trendi rritës).

Plani i veprimit për Objektivin 1.8, në periudhën Janar-Dhjetor 2024 nuk parashikon Aktivitete dhe Masa, për zbatim.

Vlera e synuar për treguesin e performancës 1.8.1 për vitin 2024, është: Përgatitja e vlerësimit. Objektivi specifik për 2024 do të mbështetet vetëm në disa informacione të mbledhur përkatësisht për periudhën janar-dhjetor 2024, por lidhur me punën paraprake në kuadër të përgatitjes së

⁶⁰ Objektivi 1.8 nuk ka masa dhe aktivitete për vitin 2024 për tu zbatuar dhe për pasojë për monitorim e vlerësim impakti.

ndërhyrjeve për kuadrin ligjor shqiptar për lobimin si instrument antikorrupsioni, për tu finalizuar brenda vitit 2027, dhe për të cilën duhet pregatitur një raport vlerësimi.

Qëllimi i lobimit është të formësojë politikat publike në mënyrë që të përfitojë një grup i caktuar ose në të kundërt të parandalojë hartimin ose miratimin e një politike në mënyrë që të ruajë *status quo*-në e administrimit të aktivitetit publik të administratës publike dhe zyrtarëve të saj.

Për të siguruar një kuadër më të fortë ligjor dhe institucional në rregullimin e lobimit, raportet ndërkombëtare rekomandojnë për vendet që synojnë të forcojnë transparencën dhe integritetin në proceset e vendimmarrjes parandalimin e ndikimeve të padrejta dhe abuzimeve në politikat publike. Një angazhim i tillë është marrë dhe evidentohet nga Shqipëria në raportin për Shqyrtimin Analitik të Grupkapitujve I “Themeloret” (2023).

Shqipëria përveç dispozitave të kodeve të sjelljes apo etikës që përcaktojnë mënyrën se si duhet të veprojnë zyrtarët publikë në rast të ndikimit nga aktorë të tjerë të jashtëm, nuk ka aktualisht asnjë akt ligjor ose të një natyre tjetër që të rregullojë veprimtarinë e lobistëve.

Transparenca dhe llogaridhënia në proceset e lobimit janë thelbësore për të siguruar një qeverisje të ndershme dhe për të shmangur ndikimin e padrejtë të interesave të veçanta mbi vendimmarrjen politike. Ndaj është thelbësore që të ketë rregullim për të dy palët, sikurse prekëm edhe pak më sipër, Kodet e Sjelles së Deputetit dhe ai Etik Ministror në vend kanë norma për rregullimin e sjelljes që duhet të ndjekë zyrtari ndaj të cilit llobohet, por mungon dhe nuk ka asnjë rregullim specifik për grupin e rregullave për lobuesit (lobistët).

Nga ana tjetër, raporti i Këshillit të OECD të vitit 2021 përmban një analizë të hollësishme mbi zhvillimet dhe tendencat në zbatimin e rekomandimeve të saj për transparencën në lobim dhe qasjen e barabartë në vendimmarrje publike. Raporti vë në dukje sfidat e reja që lidhen me mënyrat e ndryshme me të cilat grupet e interesit të veçantë përpiqen të ndikojnë në politikat publike, duke përfshirë edhe financimin politik dhe këto mund të gjejnë vend në kuadrin ligjor të fushës që mund të hartohet me këtë qëllim.

Disa parashikime që ligji mund të ketë përmenden: Parashikime rregullatore në proceset e vendimmarrjes publike: Një masë e rëndësishme është krijimi i një sistemi për të dokumentuar të gjitha palët e interesuara që llobojnë ose ndikojnë në proceset vendimmarrëse. Kjo përfshin aktorët dhe grupet e interesit që marrin pjesë në këto procese, duke përmirësuar llogaridhënien e institucioneve publike dhe duke rritur besimin e qytetarëve; Përkufizim i qartë i lobimit dhe lobistëve: Ligji duhet të japë një përkufizim të qartë të aktiviteteve të lobimit dhe të identifikojë kush konsiderohet lobist (individë, shoqëri tregtare, ose organizata jofitimprurëse që ndikojnë vendimet e institucioneve publike); Rregullimi i marrëdhënieve: Ligji duhet të përcaktojë sesi funksionarët e lartë dhe zyrtarët e zgjedhur mund të angazhohen me lobistët, duke përfshirë kufizime dhe udhëzime për të mos cënau integritetin publik të tyre; Krijimi i një Regjistri Publik të Lobistëve, ku të gjithë lobistët dhe firmat e lobimit duhet të regjistrohen, të deklarojnë interesat e tyre dhe të listojnë zyrtarët e kontaktuar; Publikimi i informacionit mbi aktivitetet e lobimit në një platformë elektronike publike, ku qytetarët dhe organizatat të kenë qasje për të parë raportet dhe aktivitetet e lidhura me lobimin; Të përfshihen detaje si qëllimi i lobimit, burimet financiare dhe përfitimet e pritura nga aktivitetet dhe Raportimi periodik i aktiviteteve të lobimit si dhe mbikëqyrja apo monitorimi i veprimtarisë së lobuesve nga një autoritet publik.

Sa më sipër, për këtë periudhë zbatimi, është arritur të kryhet një raport (paraprak) vlerësimi duke ndikuar drejtpërdrejt në vlerën e synuar të treguesit të performancës 1.8.1. Si rezultat, mbështetur në të dhënat e administruara ky tregues performance është realizuar në masën 100%.

Paraqitja e realizueshmërisë së treguesve 1.8.1 sipas Pasaportës së Treguesve, paraqitet si vijon:

Vlerat Bazë	2023	
	N/A	
	2024	Përgatitja e vlerësimit
	2025	Përgatitja e Ligjit për lobim (fazat e vlerësimit dhe analizës paraprake)
	2026	Përgatitja e Ligjit për lobim (fazat hartimit – konsultimit)
	2027	Miratimi i Ligjit për lobim
	2028	Miratimi i akteve nënligjore lidhur me Ligjin për lobim
	2029	Zbatimi i ligjit dhe akteve nënligjore për lobimin
	2030	Zbatimi i ligjit dhe akteve nënligjore për lobimin
Vlera synuar/ Targeti	2024 (targeti i synuar)	Përgatitja e Vlerësimit
	2024 (targeti i arritur)	100%

Niveli i realizimit të objektivit 1.8

Niveli i realizimit të Objektivit 1.8 *Ngritja e kuadrit ligjor dhe institucional për lobimin si instrument parandalimi korrupsioni*, në lidhje me realizimin e treguesit të performancës për periudhën janar - dhjetor 2024 është **100%**.

Përlllogaritja është kryer duke matur dhe evidentuar përmbatjen dhe rekomandimet e raportit të paraprak të vlerësimit të kryer, në përputhje me parashkrimin e bërë në listën e treguesve të performancës, aneks 2 i Strategjisë Ndërsektoriale Kundër Korrupsionit, 2024-2030.

Shkalla e realizimit të objektivit 1.8 për këtë periudhë raportimi është **100%**.

Verifikueshmëria e të dhënave

Të dhënat e raportuara mbi treguesit e performancës janë bazuar në informacionin që administron dhe koordinon Drejtoria e Përgjithshme e Antikorrupsionit.

Risqet për realizimin e Objektivit 1.8

Për vitin 2024, realizimi i objektivit ka rezultuar në risk të ulët, duke garantuar kryerjen e analizës që do të udhëheqë kryerjen e rishikimit ligjor.

1.9 Promovimi i integritetit në sektorin privat.⁶¹

Për këtë objektiv është përcaktuar 1 tregues performance:

1.9.1: Përqindja e subjekteve të sektorit privat me të cilat institucionet publike kanë vendosur bashkëpunime për ngritjen dhe promovimin e integritetit në sektorin privat nga numri i bashkëpunimeve të vendosura vitin e kaluar (trend rritës)

Plani i veprimit për Objektivin 1.9, në periudhën Janar-Dhjetor 2024 nuk parashikon Aktivitete dhe Masa, për zbatim.

Vlera e synuar për treguesin e performancës 1.9.1 për vitin 2024, është: Përgatitja e vlerësimit.

Për periudhën *janar – dhjetor 2024*, janë ndërmarrë hapa të rëndësishëm përgatitorë për forcimin e bashkëpunimit midis institucioneve publike dhe përfaqësuesve të sektorit privat, përfshirë organizatat dhe shoqatat e biznesit si dhe vetë kompanitë. Ky bashkëpunim synohet të formalizohet në vitet e ardhshme të zbatimit të strategjisë përmes marrëveshjeve konkrete dhe mekanizmave institucionalë që rrisin llogaridhënien, transparencën dhe besimin reciprok.

Në këtë kuadër, është përgatitur një raport paraprak vlerësimi që shërben si bazë për orientimin e politikave dhe masave të ardhshme për përfshirjen efektive të sektorit privat në mekanizmat kundër korrupsionit. Ky vlerësim synon të ndihmojë në ndërtimin e standardeve minimale që bizneset mund të hartojnë dhe zbatojnë, në përputhje me praktikat ndërkombëtare, si: rregullat e integritetit, kodet e sjelljes, programet e përputhshmërisë, kontrollet e brendshme, edukimin dhe trajnimin mbi etikën, si dhe vendosjen e kanaleve të sigurta për raportim.

Qasja e ndjekur është në përputhje me angazhimet që rrjedhin nga Konventa e Kombeve të Bashkuara Kundër Korrupsionit (UNCAC), si dhe me përfshirjen e objektivit për sektorin privat në dokumentin strategjik, 2024 - 2030. Shqipëria mbetet palë e kësaj konvente dhe, ndonëse ende nuk ka ratifikuar Konventën e OECD për luftën kundër ryshfetit të zyrtarëve publikë të huaj në transaksionet ndërkombëtare, janë ndërmarrë hapa për përputhshmëri me parashikimet e saj.

Ndër nismat konkrete të ndërmarra gjatë vitit 2024, veçohet forumi i organizuar më 29 prill 2024 nga Ministri i Shtetit për Administratën Publike dhe Antikorrupsionin me përfaqësues të Dhomave të Tregtisë dhe Shoqatave të Biznesit. Qëllimi i këtij takimi ishte nxitja e partneritetit midis administratës publike dhe sektorit privat për raportimin e rasteve të korrupsionit dhe vendosjen e standardeve të etikës në ofrimin e shërbimeve publike. Si rezultat, u ra dakord për ngritjen e një grupi të përbashkët pune për të ndjekur angazhimet në fushën e integritetit dhe pa lënë pas rastet dhe indiciet për korrupsion të zyrtarëve publikë.

Gjithashtu, është konsideruar prioritet për periudhën e ardhshme formalizimi i bashkëpunimit me organizatat përfaqësuese të biznesit, përmes memorandumeve të bashkëpunimit dhe platformave të dialogut të rregullt. Këto nisma synojnë përfshirjen e sektorit privat jo vetëm si grup interesi,

⁶¹ Objektivi 1.9 nuk ka masa dhe aktivitete për vitin 2024 për tu zbatuar dhe për pasojë për monitorim e vlerësim impakti.

por edhe si aktor zbatues dhe kontribuues aktiv në realizimin e objektivave të strategjisë dhe të planit të veprimit.

Sa më sipër, për këtë periudhë zbatimi, është arritur të kryhet një raport (paraprak) vlerësimi duke ndikuar drejtpërdrejt në vlerën e synuar të treguesit të performancës 1.9.1. Si rezultat, mbështetur në të dhënat e administruara ky tregues performance është realizuar në masën 100%.

Paraqitja e realizueshmërisë së treguesve 1.9.1 sipas Pasaportës së Treguesve, paraqitet si vijon:

Vlerat Bazë	2023	
	N/A	
	2024	Përgatitja e vlerësimit
	2025	5% rritje e numrit të subjekteve të sektorit privat me të cilat institucionet publike kanë krijuar bashkëpunim
	2026	10% rritje e numrit të subjekteve të sektorit privat me të cilat institucionet publike kanë krijuar bashkëpunim
	2027	15% rritje e numrit të subjekteve të sektorit privat me të cilat institucionet publike kanë krijuar bashkëpunim
	2028	20% rritje e numrit të subjekteve të sektorit privat me të cilat institucionet publike kanë krijuar bashkëpunim
	2029	25% rritje e numrit të subjekteve të sektorit privat me të cilat institucionet publike kanë krijuar bashkëpunim
	2030	30% rritje e numrit të subjekteve të sektorit privat me të cilat institucionet publike kanë krijuar bashkëpunim
Vlera synuar/ Targeti	2024 (targeti i synuar)	Përgatitja e Vlerësimit
	2024 (targeti i arritur)	100%

Niveli i realizimit të objektivit 1.9

Niveli i realizimit të Objektivit 1.9 *Promovimi i integritetit në sektorin privat*, në lidhje me realizimin e treguesit të performancës për periudhën janar - dhjetor 2024 është **100%**.

Përllogaritja është kryer duke matur dhe evidentuar përmbatjen dhe rekomandimet e raportit të paraprak të vlerësimit të kryer, në përputhje me parashkrimin e bërë në listën e treguesve të performancës, aneks 2 i Strategjisë Ndërsektoriale Kundër Korrupsionit, 2024-2030.

Shkalla e realizimit të objektivit 1.9 për këtë periudhë raportimi është **100%**.

Verifikueshmëria e të dhënave

Të dhënat e raportuara mbi treguesit e performancës janë bazuar në informacionin që administron dhe koordinon Drejtoria e Përgjithshme e Antikorrupsionit.

Risqet për realizimin e Objektivit 1.9

Për vitin 2024, realizimi i objektivit ka rezultuar në risk të ulët, duke garantuar kryerjen e analizës që do të udhëheqë edhe masat për veprim dhe bashkëpunim me sektorin privat.

Realizueshmëria e objektivave specifike të qëllimit strategjik për parandalimin e korrupsionit (Politika Parandaluese - I)

Mbështetur në të dhënat e raportuara nga institucionet përgjegjëse për administrimin dhe përpunimin e të dhënave të treguesve të performancës tabela më poshtë paraqet shkallën e realizimit të ⁶² objektivave specifike të qëllimit strategjik për parandalimin e korrupsionit.

Duke aplikuar të njëjtën formulë të nxjerrjes së shkallës së realizimit të objektivave - duke mbledhur realizueshmërinë në përqindje të treguesve të performancës dhe pjesuar me numrin e treguesve – realizueshmëria e qëllimit strategjik për parandalimin e korrupsionit është 100%.

Objektivi Specifik	Realizueshmëria
1.1 Forcimi i kornizës ligjore dhe kapaciteteve institucionale në parandalimin e korrupsionit	100 %
1.2 Forcimi i transparencës, llogaridhënies dhe integritetit të institucioneve publike në të gjitha nivelet e qeverisjes	100 %
1.3 Zhvillimi i një qasjeje të qëndrueshme për parandalimin e korrupsionit në sektorët me risk (prevalencë të lartë korrupsioni)	Nuk matet
1.4 Forcimi i mekanizmave të parandalimit të korrupsionit në njësitë e vetëqeverisjes vendore	100%
1.5 Mbrotjtja e financave dhe asetëve publike nga keqpërdorimi gjatë ushtrimit të funksionit public	100%
1.6 Forcimi i kornizës së sinjalizuesve për zbulimin e hershëm të korrupsionit	100%
1.7 Forcimi i transparencës financiare dhe integritetit të partive politike	100%
1.8 Ngritja e kuadrit legjislativ dhe institucional për lobimin si instrument parandalimi korrupsioni	100%
1.9 Promovimi i integritetit në sektorin privat	100%

Realizueshmëria e qëllimit strategjik për parandalimin e korrupsionit, e cila është në masën 100%, dhe tregon për një rezultat të qëndrueshëm përgjatë periudhës janar – dhjetor 2024.

Si rezultat, u shënuan përparime të rëndësishme në analizimin dhe parashikimin për forcimin e kuadrit ligjor dhe institucional për parandalimin e korrupsionit, në përputhje me objektivat e Strategjisë Ndërsektoriale Kundër Korrupsionit. Është hartuar një analizë gjithëpërfshirëse e legjislacionit dhe strukturave ekzistuese antikorrupsion, e cila do të udhëheqë përgatitjen e projektligjeve të reja për sinjalizimin, konfliktin e interesave dhe rikuperimin e asetëve, dhe është miratuar ligji i ri për inspektimet. Po ashtu, ka filluar përgatitja e metodologjisë për riskun e korrupsionit në sektorin publik dhe procesi i vlerësimit në sektorët e pronës dhe prokurimeve publike. U konstituua rrjeti kombëtar i pikave të kontaktit antikorrupsion në 119 institucione publike, duke përfshirë nivelin qendror dhe vendor.

Në kuadër të forcimit të transparencës dhe integritetit, të gjitha ministritë dhe ministrat e shtetit miratuan (rishikuan) plane integriteti, shoqëruar me caktimin e koordinatorëve përkatës, dhe numri

⁶² Nuk llogaritet në vlerësim objektivi 1.3.

i bashkive me plane të miratuara arriti në 28. Është rritur përdorimi i sistemeve elektronike për deklarimin e pasurisë dhe të drejtën e informimit, ndërkohë që janë organizuar trajnime dhe ofruar asistencë teknike për zbatimin e standardeve të integritetit. U intensifikua zbatimi i rekomandimeve të GRECO dhe bashkëpunimi ndërinstitucional për parandalimin e korrupsionit në sektorët me risk. Raporte vlerësimi për të nisur shkrimin e kuadrit ligjor për lobimin dhe rritjen e bashkëpunimit për promovimin e integritetit në sektorin privat kanë filluar.

Realizimi i plotë i treguesve të performancës për objektivat 1.1-1.9⁶³, dëshmon angazhimin e qendrueshëm institucional në luftën kundër korrupsionit dhe promovimin e qeverisjes së mirë.

Politika Ndëshkuese (II) - Përmbledhje për arritjet në ndëshkimin e korrupsionit

Përmes **qëllimit të politikës ndëshkuese** SNKK, ka për qëllim që institucionet ligjzbatuese dhe veçanërisht ato të pavarura, të cilat kanë një rol thelbësor në këtë proces, duhet të monitorojnë zbatimin e ligjit dhe sundimin e shtetit të së drejtës, duke siguruar kështu transparencën dhe integritetin e organeve shtetërore. Gjatë periudhës raportuese janë realizuar masat (produktet) dhe kryer aktivitetet sipas tabelës më poshtë.


Qëllimet e Politikës	Masat dhe Aktivitetet	Realizimi i Masave dhe aktiviteteve			
		Masa dhe aktivitete të parashikuara për vitin 2024	Masa dhe aktivitete plotësisht të realizuara	Masa dhe aktiviteteve pjesërisht të realizuara ⁶⁴	Masa dhe aktivitete të parealizuara ⁶⁵
Ndëshkuese (II)	Masa	9	5	4	-
	Aktivitete	21	16	4	1

Rezulton se nga 9 masa dhe 21 aktivitete të parashikuara në Planin e Veprimit 2024 – 2026, për janar-dhjetor 2024, për Politikën Ndëshkuese (II) janë zbatuar plotësisht 4 masa dhe 16 aktivitete, pjesërisht 5 masa dhe 4 aktivitete si dhe pazbatuar vetëm 1 aktivitet (2.2.3.2).

⁶³ Nuk është përfshirë në vlerësim objektivi 1.3.


⁶⁴ Aktivitet "pjesërisht i realizuar" është ai aktivitet që është realizuar në shkallën nga 50 deri në 100 për qind.

⁶⁵ Aktivitet "i porealizuar" është ai i cili është realizuar në një shkallë nga 0 në 50 për qind.



Nga 5 treguesit e performances për Politikën Ndëshkuese (II), është arritur vlera e synuar për të gjithë treguesit e performancës, për të cilët janë hartuar raporte vlerësimi dhe bërë pjesë e këtij raporti.

Ndëshkuese (II)	Treguesit e performancës	Realizimi i Treguesve të Performancës		
		Vlera e synuar është realizuar plotësisht ⁶⁶	Vlera e synuar është realizuar pjesërisht ⁶⁷	Vlera e synuar nuk është e realizuar ⁶⁸
	5	5	-	-



⁶⁶ Që është realizuar në shkallën 100 për qind.

⁶⁷ Që është realizuar në shkallën nga 50 deri në 100 për qind.

⁶⁸ Që nuk është realizuar dhe tregues për të cilin nuk janë mbledhur ose nuk ka qenë e mundur të mbledhen të dhëna.

2.1 Forcimi i kuadrit legjislativ, institucional dhe kapaciteteve për hetim efektiv administrativ të korrupsionit.

Për këtë objektiv është përcaktuar 1 tregues performance:

2.1.1: Përqindja e analizave në vijim të hetimeve administrative me qëllim marrjen e masave sistematike kundër korrupsionit (në rritje).

Plani i veprimit për Objektivin 2.1, në periudhën Janar-Dhjetor 2024 parashikon 7 aktivitete dhe 3 masa.

Vlera e synuar për *treguesin e performancës 2.1.1* për vitin 2024 është: Përgatitja e vlerësimit.

Për të arritur vlerën e treguesit në përputhje me pasaportën e treguesve të performancës dhe konkretisht me planin e veprimit 2024-2026, janë parashikuar aktivitetet (7) dhe masa (3) si më poshtë.

2.1.1	Forcimi i kuadrit institucional dhe koordinimit për hetimin dhe verifikimin administrativ të korrupsionit
2.1.1.1	Ngritja dhe funksionimi i Drejtorisë së Përgjithshme të Antikorrupsionit si ent juridik, publik dhe buxhetor më vehte
2.1.1.2	Përgatitja e rregullores së brendshme të Drejtorisë së Përgjithshme të Antikorrupsionit; rregullat për veprimtarinë operacionale të koordinatorëve të rrjetit kundër korrupsionit dhe vlerësimin e riskut të korrupsionit
2.1.1.3	Përmirësim i bashkëpunimit midis koordinatorëve kundër korrupsionit, pikave të kontaktit antikorrupsion dhe koordinatorëve të integritetit, në lidhje me marrjen dhe raportimin e rasteve të korrupsionit në administratën publike (takime periodike, shkëmbim informacioni)
2.1.2	Forcimi i kapaciteteve institucionale për hetimin e verifikimin administrativ të korrupsionit
2.1.2.1	Identifikimi i nevojës (raport vlerësimi) për ekspertizë dhe aftësi të shtuara të koordinatorëve kundër korrupsionit dhe përgatitja e kurrikulave specifike për trajnime (vjetore)
2.1.2.2	Organizimi i trajnimeve për rritjen e ekspertizës dhe aftësive të koordinatorëve kundër korrupsionit
2.1.3	Rritja e performancës së strukturave përgjegjëse për hetimin e verifikimin administrativ të korrupsionit
2.1.3.1	Përmirësimi i shkëmbimit të informacionit, bashkëpunimit dhe koordinimit mes DPAK dhe ILDKPKI për denoncimet dhe raportimet e korrupsionit, veçanërisht për raste që vijnë nga njësitë e sinjalizimit
2.1.3.3	Kryerja e analizës për zbatueshmërinë e rekomandimeve të dërguara nga DPAK tek institucionet ku janë konstatuar parregullsi

Realizimi i masës së parashikuar kryhet përmes aktiviteteve që vijnë përgjatë gjithë vitit 2024 dhe viteve të tjera të planit të veprimit siç përmendet ngritja e Drejtorisë së Përgjithshme të Antikorrupsionit si një autoritet më vehte, përgatitja e akteve të brendshme rregullatore të saj, roli koordinues dhe i ndjekjes së rekomandimeve që jep dhe ndjek dhe kapacitetet tekniko-profesionale të saj. Matja dhe ecuria do të bëhet mbi baza 6-mujore dhe vjetore.

Për janar – dhjetor 2024, me vendim të Këshillit të Ministrave, me nr. 436, datë 26.06.2024⁶⁹, u ngrit, u organizua dhe filloi nga funksionimi Drejtoria e Përgjithshme e Antikorrupsionit, si person

⁶⁹ Botuar në fletore zyrtare: <https://qbz.gov.al/eli/fz/2024/107>.

juridik, publik, buxhetor në varësi të ministrit përgjegjës për antikorrupsionin (pika 1). Në vijim dhe zbatim të këtij vendimi u miratua urdhri nr. 146, datë 1.08.2024, i Kryeministrit, “Për miratimin e strukturës dhe të organikës së Drejtorisë së Përgjithshme të Antikorrupsionit”. DPAK u riorganizua me një strukturë prej 27 punonjës, nëpunës civilë dhe punonjës të shërbimeve, pjesë e së cilës janë dy drejtori me kompetenca teknike të fushës dhe një sektor shërbimesh, konkretisht:

- Drejtor i Përgjithshëm (1);
- Drejtoria e Zbatimit të Politikave në Fushën e Antikorrupsionit (9);
- Drejtoria e Analizës, Kontrollit dhe Hetimit Administrativ (12); si dhe
- Sektori i Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse (5).

Në vitin 2024, ka nisur nga hartimi dhe përgatitja rregullorja e brendshme e Drejtorisë së Përgjithshme të Antikorrupsionit, në të cilën do të parashikohen rregullat dhe procesi për veprimtarinë operacionale të autoritetit. Një pjesë e posaçme e saj është edhe bashkëpunimi me mekanizmin e Koordinatorëve Antikorrupsion, kudo ku ata e ushtrojnë detyrën e tyre funksionale për ndjekje të ankesave dhe rasteve të korrupsionit si dhe vlerësimin e riskut të korrupsionit në sektorin publik. Rregullorja është për konsultim me stafin e brendshëm të drejtorisë dhe me kabinetin e ministrit përgjegjës për antikorrupsionin.

Në vitin 2024, DPAK ka nisur me procesin e identifikimit të nevojave për trajnim dhe ekspertizë të shtuar të stafit të saj, të Koordinatorëve antikorrupsion, me qëllim rritjen e kapaciteteve koordinuese dhe specifikisht të hetimit administrativ. DPAK e ka kryer këtë vlerësim nëpërmjet takimeve periodike për të siguruar bashkëpunimin ndërmjet coordinatorëve antikorrupsion, coordinatorëve të integritetit dhe pikave të kontaktit antikorrupsion.

Në datë 17.09.2024, u zhvillua një takim i dedikuar (trajnim) me pjesëmarrës stafin teknik të Drejtorisë së Përgjithshme të Antikorrupsionit dhe Koordinatorët Antikorrupsion, me fokus “Korrupsioni në kontekstin aktual dhe mekanizmat efektivë për parandalimin e tij”, të profesorit të lëndës “Antikorrupsioni” i Universitetit të Harvardit, SHBA, Dr. Ermal Frashëri. Takimi (leksion i hapur) u realizua në kuadër të projektit “Kronikat e integritetit: Rrëfimi për luftën kundër korrupsionit”, një nismë shumëvjeçare që ka për synim rritjen e ndërgjegjësimit dhe përmirësimin e strategjive antikorrupsion. Projekti zbatohet nga Meridian International Center dhe ka mbështetjen e plotë të Departamentit të Shtetit të SHBA-së dhe Ambasadës Amerikane në Tiranë, duke përforcuar angazhimin ndërkombëtar për rritjen e transparencës dhe ndershmërisë në vend. Gjatë orës së leksionit u analizuan faktorët kryesorë që mund të kontribuojnë në përhapjen e korrupsionit, duke përfshirë sfidat institucionale, boshllëqet ligjore dhe faktorët socialë dhe ekonomikë. Pjesëmarrësit shqyrtuan gjithashtu modele të suksesshme nga vende të ndryshme për parandalimin e korrupsionit duke u ndalur në mekanizmat më efektivë që mund të përshtaten dhe zbatohen në nivel kombëtar, në fusha të ndjeshme si: shëndetësia, pronat, arsimi, duke synuar kështu informimin dhe ndërgjegjësimin e publikut të gjerë.

Në vitin 2024, stafi i Drejtorisë së Analizës, Kontrollit dhe Hetimit Administrativ pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Antikorrupsionit, dhe Koordinatorët kundër Korrupsionit ndoqën *online*, kursin HELP të Këshillit të Evropës mbi “Hyrjen në parandalimin e korrupsionit”. Ky kurs u zhvillua nga Divizioni i Krimit Ekonomik dhe Bashkëpunimit në Këshillin e Evropës, në bashkëpunim me Programin e Edukimit për të Drejtat e Njeriut për Profesionistët Ligjorë, në vitin 2021 dhe u përshtat në shqip në vitin 2024 me mbështetjen e Bashkimit Evropian dhe Këshillit të Evropës.

Ai përbëhet nga 13 module, që mbulojnë një gamë të gjerë temash duke përfshirë sjelljen etike, konfliktet e interesit, rregullimin e menaxhimit të dhuratave, qëllimet e sistemeve të deklarimit të

pasurisë, rolin e qasjes së lirë në informacion në parandalimin e korrupsionit dhe shumë të tjera, konkretisht: Moduli 1: Kuptimi i korrupsionit; Moduli 2: Instrumentet për parandalimin e korrupsionit; Moduli 3: Parimet etike dhe kodet e sjelljes; Moduli 4: Konflikti i interesit dhe papajtueshmëritë; Moduli 5: Kufizimet pas largimit nga detyra; Moduli 6: Dhuratat dhe përfitimet e tjera; Moduli 7: Deklarimi i pasurisë; Moduli 8: Qasja e lirë në informacion; Moduli 9: Lobimi; Moduli 10: Financimi i partive politike; Moduli 11: Sinjalizimi; Moduli 12: Prokurimi publik dhe Moduli 13: Auditimi i veprimtarisë publike.

Drejtorja e Përgjithshme e Antikorrupsionit ka nisur në vitin 2024 hartimin e një vlerësimi nevojash për stafin e saj me kompetenca hetimi administrative dhe për Koordinatorët Antikorrupsion me qëllim përgatitjen e kurrikulave specifike për trajnime. Konsolidimi i një dokumenti vlerësimi mbetet ende në proces.

Në vitin 2024, mbështetur edhe Marrëveshjes së Bashkëpunimit KKKK - ILDKPKI, ka vijuar koordinimi ndërmjet stafit të DPAK dhe ILDKPKI për shkëmbim informacioni dhe raportimin e rasteve sipas fushës së përgjegjësisë.

Në vitin 2024, DPAK ka kryer ndjekjen e zbatimit të rekomandimeve, dhe në bashkëpunimin me institucionet ku funksionon dhe janë vendosur mekanizmi i Koordinatorëve Antikorrupsion ka mbledhur informacionin e nevojshëm sa i përket zbatueshmërisë së tyre. Deri brenda dhjetor 2024, është konsoliduar i gjithë informacioni ku ka pasur raste hetimi dhe verifikimi administrativ nga DPAK, për të cilat rezulton se: janë administruar 163 ankesa/denoncime; përfunduar me raport përfundimtar 7 raste, për të cilat janë propozuar: 6 masa administrative e 16 rekomandime. Një raport përmbledhës monitorimi do të finalizohet në vijim me qëllim vlerësimin e efektivitetit të masave dhe rekomandimeve të dhëna për institucionet, si dhe identifikimin e problematikave e sfidave kryesore që hasen gjatë zbatimit të tyre. Ky raport monitorimi synon të: Klasifikojë të gjitha rekomandimet dhe masat bazuar në llojin dhe institucionin marrës; Tregojë statusin e zbatimit; Identifikojë sfidat kryesore dhe boshllëqet institucionale dhe, Vlerësojë efektivitetin dhe ndikimin e përgjithshëm të veprimeve të propozuara në parandalimin e korrupsionit.

Sa më sipër, masat dhe aktivitetet e parashikuara për këtë periudhë zbatimi, kanë ndikuar drejtpërdrejt në vlerën e synuar të treguesit të performancës 2.1.1. Të dhënat për raportin e vlerësimit janë mbledhur dhe analizuar të dhënat e masave dhe rekomandimeve të dhëna nga DPAK. Periudha tranzitore e kalimit të përgjegjësisë së fushës antikorrupsion pranë një ministri linje, dhe organizimi i DPAK si një autoritet më vehte (me strukturë, buxhet dhe staf) ka krijuar vetëm një vonesë në finalizimin e raportit për dorëzim, por të dhënat mbeten në funksion të analizës. Në përfundim, vlerësohet se gjatë vitit 2024, DPAK ka të plotë informacionin referuar institucioneve publike qendrore dhe vendore që plane integriteti të miratuara dhe në zbatim, dhe administron të dhëna për to. Ky tregues performance është realizuar në masën 100%.

Paraqitja e realizueshmërisë së treguesve 2.1.1 sipas Pasaportës së Treguesve, paraqitet si vijon:

Vlerat Bazë	2023	
	N/A	
	2024	Përgatitja e vlerësimit
	2025	Koordinim dhe verifikime të plota të denoncimeve të marra për korrupsionit, analiza të kryera
	2026	Koordinim dhe verifikime të plota të denoncimeve të marra për korrupsionit, analiza të kryera
	2027	Koordinim dhe verifikime të plota të denoncimeve të marra për korrupsionit, analiza të kryera
	2028	Koordinim dhe verifikime të plota të denoncimeve të marra për korrupsionit, analiza të kryera
	2029	Koordinim dhe verifikime të plota të denoncimeve të marra për korrupsionit, analiza të kryera
	2030	Koordinim dhe verifikime të plota të denoncimeve të marra për korrupsionit, analiza të kryera
Vlera synuar/ Targeti	2024 (targeti i synuar)	Përgatitja e vlerësimit
	2024 (targeti i arritur)	100%

Niveli i realizimit të objektivit 2.1

Niveli i realizimit të *Objektivit 2.1. Forcimi i kuadrit legjislativ, institucional dhe kapaciteteve për hetim efektiv administrativ të korrupsionit*, në lidhje me realizimin e treguesit të performancës për periudhën janar - dhjetor 2024 është **100%**.

Përllogaritja është kryer duke matur dhe evidentuar mbledhen dhe analizimin në funksion të përmbatjes së raportit të vlerësimit të kryer, në përputhje me parashkrimin e bërë në listën e treguesve të performancës, aneks 2 i Strategjisë Ndërsektoriale Kundër Korrupsionit, 2024-2030.

Shkalla e realizimit të objektivit 2.1 për këtë periudhë raportimi është **100%**.

Verifikueshmëria e të dhënave

Të dhënat e raportuara mbi treguesit e performancës janë bazuar në informacionin që administron dhe koordinon Drejtoria e Përgjithshme e Antikorrupsionit.

Risqet për realizimin e Objektivit 2.1

Për vitin 2024, realizimi i objektivit ka rezultuar në risk të ulët, duke garantuar kryerjen e analizës që do të udhëheqë edhe masat për veprim dhe bashkëpunim në vitet në vijim të zbatimit të planit të veprimit antikorrupsion.

2.2 Forcimi i kapaciteteve, burimeve dhe performancës për hetim penal efektiv dhe ndjekjen penale të korrupsionit.

Për këtë objektiv janë përcaktuar 3 tregues performance:

2.2.1: Përqindja e akteve ligjore dhe nënligjore të miratuara për hetimin penal të korrupsionit nga ato të planifikuara për tu miratuar.

2.2.2: Raporti i hetimeve penale të përfunduara për korrupsion nga hetimet ende në vijim (zvogëlimi i backlogut) (trend rritës).

2.2.3: Përqindja e vlerës së pasurive të sekuestruara si rezultat i hetimit të rasteve të korrupsionit nga vlera mesatare e pasurive të sekuestruara në tre vitet e fundit (trend rritës).

Plani i veprimit për Objektivin 2.2, në periudhën Janar-Dhjetor 2024 parashikon 11 aktivitete dhe 4 masa.

2.2.1: Përqindja e akteve ligjore dhe nënligjore të miratuara për hetimin penal të korrupsionit nga ato të planifikuara për tu miratuar.

Vlera e synuar për treguesin e performancës 2.2.1 për vitin 2024 është: Përgatitja e vlerësimit.

Për të arritur vlerat e treguesit në përputhje me pasaportën e treguesve të performancës dhe konkretisht me planin e veprimit 2024-2026, janë parashikuar aktiviteti (1) dhe masa (1) si më poshtë.

2.2.1	Forcimi i kornizës legjislative për garatimin e një veprimtarie eficiente për hetimin e ndëshkimit penal të korrupsionit
2.2.1.4	Miratimi i kuadrit ligjor për fushën e rikuperimit të aseteve

Realizimi i masës së parashikuar kryhet përmes aktivitetit të parashikuar për zbatim në vitin 2024, siç përmendet miratimi i kuadrit ligjor për rikuperimin e aseteve. Matja dhe ecuria do të bëhet mbi bazë vjetore.

Për janar – dhjetor 2024, vlen të përmendet fillimisht që Shqipëria ka njohur dhe ka adresuar nevojën për të forcuar kuadrin ligjor dhe institucionet që merren me parandalimin dhe ndjekjen penale të pastrimit të parave. Në këtë mënyrë, legjislacioni shqiptar do të jetë në përputhje me standardet ndërkombëtare dhe do të mundësojë një mbrojtje më të mirë kundër kërcënimeve financiare të paligjshme. Në funksion të kësaj është parashikuar edhe forcimi i masave për rikuperimin e pasurive të përfituara nga veprimtaritë kriminale, ku përmendet edhe miratimi i kuadrit ligjor për ngritjen dhe funksionimin e Zyrës së Rikuperimit të Aseteve. Nisur nga fakti që edhe në Progres Raportin e KE-së (2024) përmendet fakti që draft-ligji për ngritjen e Zyrës për Rikuperimin e Aseteve, i hartuar dhe proceduar me të gjitha fazat e tij paraprake, duhet të shkojë drejt miratimit të tij duke marrë në konsideratë dhe Direktivën më të re të BE për zyrën për rikuperimin dhe konfiskimin e aseteve. Ngritja e kësaj Zyre (ZRA) do të përmirësojë ndjeshëm kapacitetet për menaxhimin e aseteve të ngrira apo të konfiskuara që mos të humbasin vlerën e tyre ekonomike.

Në vitin 2024, u përparua me hartimin (përgatitjen) e kuadrit ligjor dhe atë institucional për të adresuar mangësitë dhe problematikat e identifikuara nga vetë institucionet e brendshme dhe nga raportet vjetore të Komisionit Evropian, me Zyrën e Rikuperimit të Aseteve. Ligji i hartuar sanksionon qëllimin e ngritjes së Zyrës së Rikuperimit të Aseteve që është gjurmimi dhe identifikimi i të ardhurave, pasurive ose përfitimeve të tjera pasurore që lindin nga një veprë penale, veprimtari kriminale ose që janë të lidhura me to, të cilat mund t'i nënshtrohen sekuestrimit ose konfiskimit nga organet kompetente. (neni 2 i projektligjit).

Ky kuadër ligjor, vendos bazat dhe forcon hetimin, ndjekjen penale, gjykimin dhe dënimin përfundimtar të çështjeve të korrupsionit lidhur me rikuperimin e pasurive që vijnë nga veprat penale të lidhura me korrupsionin. Po ashtu në kuadrin institucional do të rregullojë bashkëpunimin midis institucioneve përkatëse për të garantuar verifikimin e duhur të të dhënave të deklaruara. Zyra e Rikuperimit të Aseteve do ta shtrijë veprimtarinë e saj në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë dhe gjithashtu, do të bashkëpunojë me zyrat homologe jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë dhe rrjetet ndërkombëtare për rikuperimin e asetëve. (neni 4 i projektligjit).

Ministria e Brendshme, në cilësinë e institucionit propozues të këtij akti, ka kryer njëkohësisht procesin e Vlerësimit të Hapësirave për Korrupsion (CPL) në zbatim të Manualit të Hartimit të Legjislacionit, duke garantuar një kuadër ligjor sipas standardeve ndërkombëtare të kohës. Akti ligjor mund të gjendet i publikuar në link <https://konsultimipublik.gov.al/Konsultime/Detaje/708>, por i parritur të miratohet nga KM dhe Kuvendi.

Në vitin 2024, hartimi i këtij kuadri ligjor është shoqëruar me një dokument/raport vlerësimi, që analizon të gjitha nevojat për ndërhyrje për këtë qëllim dhe synon të përmirësojë rezultatet e luftës kundër krimit të organizuar, korrupsionit dhe pastrimit të parave në Shqipëri.

Raporti evidenton se krijimi dhe funksionimi i ZRA lidhet me një serë përparësish që do ti japë zgjidhje disa problemeve të bashkëpunimit të pamjaftueshëm kombëtar dhe ndërkombëtar të Policisë së Shtetit në luftën kundër krimit të organizuar, në gjetjen dhe identifikimin e asetëve kriminale. Sipas raportit, ZRA do të duhet të krijohet si strukturë e posaçme qendrore në Policinë e Shtetit, ku mund të shfrytëzojë me efektivitet data bazën e të dhënave të saj të konsiderueshme mbi subjektet e veprimtarisë kriminale dhe pasuritë e tyre dhe gëzon pavarësi operacionale.

ZRA përfaqëson autoritetin kombëtar, në nivel qendror për realizimin e procesit të gjurmimit dhe identifikimit të asetëve kriminale që rrjedhin nga një vepër penale ose veprimtarisë kriminale të cilat mund ti nënshtrohen ngrirjes së përkohshme, sekuestrimit dhe konfiskimit nga autoritetet kompetente.

Raporti i vlerësimit është bërë pjesë e hartimit të këtij akti ligjor dhe trupëzuar në relacionin shoqërues të tij, për miratim.

Sa më sipër, masat dhe aktivitetet e parashikuara për këtë periudhë zbatimi, kanë ndikuar drejtpërdrejt në vlerën e synuar të treguesit të performancës 2.2.1. Në përfundim, vlerësohet se gjatë vitit 2024, është hartuar dhe bërë pjesë e këtij raporti monitorimi dokumenti analitik, raport vlerësimi, për këtë akt ligjor. Ky tregues performance është realizuar në masën 100%.

Paraqitja e realizueshmërisë së treguesit sipas Pasaportës së Treguesve, paraqitet si vijon:

Vlerat Bazë	2023	
	N/A	
	2024	Përgatitja e vlerësimit
	2025	Ligje dhe akte nënligjore të planifikuara për t'u miratuar dhe të miratuara
	2026	Ligje dhe akte nënligjore të planifikuara për t'u miratuar dhe të miratuara
	2027	Ligje dhe akte nënligjore të planifikuara për t'u miratuar dhe të miratuara

	2028	Ligje dhe akte nënligjore të planifikuara për t'u miratuar dhe të miratuara
	2029	Ligje dhe akte nënligjore të planifikuara për t'u miratuar dhe të miratuara
	2030	Ligje dhe akte nënligjore të planifikuara për t'u miratuar dhe të miratuara
Vlera synuar/ Targeti	2024 (targeti i synuar)	Raport vlerësimi
	2024 (targeti i arritur)	Raport vlerësimi i kryer

2.2.2: Raporti i hetimeve penale të përfunduara për korrupsion nga hetimet ende në vijim (zvogëlimi i backlogut) (trend rritës).

Vlera e synuar për *treguesin e performancës* 2.2.2 për vitin 2024 është: Përgatitja e vlerësimit.

Për të arritur vlerat e treguesit në përputhje me pasaportën e treguesve të performancës dhe konkretisht me planin e veprimit 2024-2026, janë parashikuar aktivitetet (10) dhe masat (3) si më poshtë.

2.2.2	Forcimi i kornizës institucionale dhe kapaciteteve profesionale të organeve ligjzbatuese dhe stafeve pranë tyre, me fokus hetimin dhe ndjekjen penale të korrupsionit
2.2.2.1	Konsolidimi dhe përmirësimi i vazhdueshëm i burimeve tekniko-profesionale të seksioneve të krimit ekonomik dhe të pastrimit të parave në strukturën qendrore në Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit si dhe në drejtoritë vendore të Policisë së Shtetit
2.2.2.2	Identifikimi i nevojave për njohuri teknike (trajtime) për stafet dhe profesionistët e organeve të hetimit dhe ndjekjes penale (prokuroritë) dhe të gjykimit (gjyqësorit) (Raport për kërkesa për trajtime, i miratuar) /vjetor
2.2.2.3	Trajnime të vazhdueshëm/vjetor të punonjësve të policisë mbi hetimet proaktive, për veprat penale në fushën e korrupsionit, krimeve ekonomike e financiare, të pastrimit të parave dhe aseteve kriminale (trajtime të kryera)
2.2.2.4	Trajnime të specializuara me pjesëmarrje ndër-institucionale (agjencitë e zbatimit të ligjit dhe gjyqësorit) për të siguruar veprimtari proaktive mbi hetimin financiar, ndjekjen penale dhe gjykimin e korrupsionit në tema si: prokurimi publik, partneriteti publik-privat, koncesionet, pronësia përfituese, pastrimi i parave, etj.
2.2.3	Konsolidimi i qendrueshëm i strukturave të agjencive ligjzbatuese për të siguruar hetime proaktive kundër korrupsionit (përmirësim i performancës)
2.2.3.1	Identifikimi i nevojave për ekspertizë teknike për stafet dhe profesionistët e organeve të hetimit dhe ndjekjes penale (prokuroritë) dhe të gjykimit (gjyqësorit) (Plan i miratuar për ekspertizë dhe rritje performance) (vjetor)
2.2.3.2	Konsolidimi dhe forcimi i vazhdueshëm i seksioneve të krimit ekonomik dhe të pastrimit të parave në strukturën qendrore në Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit si dhe në drejtoritë vendore të Policisë së Shtetit (burime njerëzore dhe tekniko-profesionale të përgatitura dhe efikase)
2.2.3.3	Planifikimi i mekanizmave për ngritjen e infrastrukturës digjitale për sistemin e menaxhimit të çështjeve të SPAK, duke evidentuar hapat e ngritjes së tij brenda vitit 2024 (I); ngritjen dhe testimin brenda vitit 2025 (II); përdorimin e sistemit brenda vitit 2026 (III). (në relevancë me parashikimin e kreut II: lufta kundër korrupsionit, pjesa 3 (hetimi penal dhe dënimi) të Udhërrëfyesit Shteti i së Drejtës).

	(Shënim: ky aktivitet është në relevancë të plotë zbatimi me parashikimet e bëra në PV të SND). (Shënim: ky aktivitet është në relevancë të plotë zbatimi me parashikimet e bëra në PV të SND).
2.2.4	Rritja e performancës të agjencive ligjzbatuese të hetimit penal të korrupsionit nëpërmjet bashkëpunimit institucional, komunikimit me publikun dhe administrimit të informacionit statistikor
2.2.4.1	Forcimi i qasjes proaktive në zbulimin e korrupsionit duke përdorur raportet e mediave, analizën e raporteve të auditimit, gjetjet e inspektimeve dhe bashkëpunimin me koordinatorët kundër korrupsionit (raste hetimesh inicuar kryesisht)
2.2.4.2	Veprime në zbulimin e korrupsionit, në bazë të deklaratave të pasurisë dhe kontrollit të tyre
2.2.4.3	Konsolidimi i të dhënave statistikore për veprat penale të korrupsionit nëpërmjet përdorimit të vazhdueshëm të e-platformës

Realizimi i masave së parashikuar kryhet përmes aktiviteteve të parashikuar për zbatim në vitin 2024 dhe që vijnë edhe përgjatë viteve të tjera të zbatimit të planit të veprimit. Matja dhe ecuria do të bëhet mbi baza 6-mujore dhe vjetore.

Për periudhën *janar – dhjetor 2024*, me miratimin e ligjit të ri “Për Policinë e Shtetit”, u reflektuan edhe ndërhyrjet në funksion të konsolidimit të burimeve tekniko-profesionale të seksioneve të krimit ekonomik dhe të pastrimit të parave në strukturën qendrore në Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit dhe në drejtoritë vendore të Policisë së Shtetit. Me urdhër të Ministrit të Brendshëm, nr.233, datë 5.12.2024, është bërë ndryshimi i strukturës së Drejtorisë për Hetimin e Krimeve Ekonomike e Financiare me 44 punonjës oficer policie. Drejtoria për Hetimin e Krimeve Ekonomike dhe Financiare, në nivel qendror, rezulton të jetë e përberë nga 4 sektorë: Sektori për Hetimin e Korrupsionit (1 shef sektori dhe 14 specialistë); Sektori për Hetimin e Pastrimit të Parave dhe Aseteve Kriminale (1 shef sektori dhe 7 specialistë); Sektori për Hetimin e Krimeve të tjera ekonomike dhe financiare (1 shef sektori dhe 15 specialistë); Sektori për Analiza Financiare dhe ARO (1 shef sektori dhe 3 specialistë). Në zbatim të urdhrit nr.47, datë 14.04.2023, të Ministrit të Brendshëm “Për miratimin e strukturës dhe të organikës në nivel qendror, vendor dhe strukturave të veçanta të Policisë së Shtetit”, ZRA është një strukturë e veçantë në Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit. Zyra e Rikuperimit të Aseteve, nën emërtimin “Sektori i Analizës Financiare dhe ARO” është ngritur në Drejtorinë për Hetimin e Krimeve Ekonomike dhe Financiare, në Departamentin për Policinë Kriminale, në Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit. Kjo mbetet një strukturë e përkohshme, pasi me miratimin e ligjit për rikuperimin e asetëve, edhe ZRA me vehte, do të ndikohet nga ky organizim.

Po ashtu, në nivel vendor janë ngritur 11 njësi për hetimin e krimit ekonomik dhe financiar. Drejtoria Vendore e Policisë Tiranë ka një njësi për krimin ekonomik dhe financiar me dy seksione: seksion për hetimin e krimit ekonomik dhe financiar, dhe seksioni për hetimin e pastrimit të parave dhe asetëve kriminale.

Në vitin 2024, Drejtoria për Hetimin e Krimeve Ekonomike e Financiare, në Policinë e Shtetit, ka mundësuar trajnime të përbashkëta me struktura të tjera të policisë, për stafet pranë sektorit të Hetimit të Krimeve Ekonomike e Financiare, sektorit të Hetimit të Korrupsionit, sektorit për Hetimin e Pastrimit të Parave dhe Aseteve Kriminale si dhe Sektorin e Analizës Financiare dhe

ARO. Janë kryer gjithsej 12 trajnime me tema të ndryshme për hetimet proaktive të veprave penale në fushën e korrupsionit, krimeve ekonomike e financiare, të pastrimit të parave dhe aseteve kriminale, përfitues të të cilave kanë qenë 98 punonjës policie (77 meshkuj dhe 21 femra). Policia e Shtetit ka qenë gjithashtu përfituese edhe e trajnimeve antikorrupsion, ku gjithsej përmenden 9 trajnime me 32 punonjës, pjesëmarrës.

Akademia e Sigurisë, ka zhvilluar gjatë vitit 2024, në kuadër të Strategjisë Antikorrupsion gjithsej, 5 trajnime dhe me pjesëmarrje 101 punonjës.

Shkolla e Magjistraturës ka identifikuar nevojat për trajnime (mbledhur, analizuar dhe vlerësuar) nevojat për trajnime për subjektet (gjyqtarë dhe prokurorë) që mund të përfitojnë nga programet që ofrohen prej saj. Organe si KLP, PP, Prokurori e Posaçme dhe GJKKO janë bërë pjesë e këtij planifikimi, gjithashtu. Në muajin maj 2024, Shkolla e Magjistraturës miratoi programin 3-vjeçar (2024-2027) të trajnimeve, ku një vend të posaçëm e zë edhe moduli që lidhet me korrupsionin, i cili ka filluar të zbatohet në vitin akademik, 2024-2025 dhe për të vijuar në vitet e ardhshme. Programi Tematik i Aktiviteteve të Formimit Vazhdues, 2024-2027, është miratuar nga Këshilli Drejtues i Shkollës së Magjistraturës me vendimin nr.18, datë 16.5.2024.

Prokuroria e Posaçme (drejtuesi) me urdhrin nr. 679, datë 09.10.2023 ka vendosur miratimin e planit të trajnimit të personelit administrativ sipas kategorive për vitin 2023-2026. Gjatë vitit 2024, të gjithë prokurorët, oficerët e policisë gjyqësore dhe hetuesit financiarë kanë ndjekur sesionet e trajnimeve vazhdues pranë Shkollës së Magjistraturës.

Hetuesit financiarë gjatë vitit 2024 janë trajnuar për një sërë temash nga agjenci të specializuara ndërkombëtare, si konkretisht: në 5-9 Shkurt 2024 “Përmirësimi i aftësive financiare dhe të kontabilitetit për gjyqtarët dhe prokurorët” ku kanë marrë pjesë 6 hetues financiar; në 13-14 Shkurt 2024 “*Roundtable on AML/CFT Communications*” ku kanë marrë pjesë 3 hetues financiar; në 4-8 Mars 2024 me OPDAT “Teknikat e Hetimit Financiar” ku kanë marrë pjesë 12 hetues financiar; në 28-29 Mars 2024 - “Marrëdhëniet me publikun/shtypin mbi luftën kundër financimit të terrorizmit – FSVC” ku kanë marrë pjesë 3 hetues financiar; në 15-19 Prill 2024 - “*Strategic Leadership Programme*” ku ka marrë pjesë 1 hetues financiar. 8-9 Maj 2024 - “*Supporting Asset Recovery in the Western Balkans*” zhvilluar në Romë, ku ka marrë pjesë 1 hetues financiar; në 22 Maj 2024 “Provat digjitale” ku kanë marrë pjesë 12 hetues financiar; në 11-15 Shtator 2024 me OPDAT “Lufta kundër pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit” ku kanë marrë pjesë 12 hetues financiar; në 9-13 Dhjetor 2024 me OPDAT “Hetimi financiar i korrupsionit publik” ku kanë marrë pjesë 12 hetues financiar.

Në vitin 2024, staf të njësive tekniko-profesionale pranë Prokurorisë së Posaçme kanë marrë pjesë në konferenca si: në 25-27 Qershor 2024, zhvilluar konferenca e dytë e platformës rajonale “*Fast Tracking the Implementation of the United Nations Convention Against Corruption*” ku ka marrë pjesë 1 hetues financiar dhe në 12 Shtator 2024 me FBI, “Prezantimi i analizës qelizore në telefoninë celulare” ku kanë marrë pjesë 12 hetues financiar.

Në vitin 2024, nuk ka pasur ndërhyrje në strukturat të krimit ekonomik dhe të pastrimit të parave në strukturat e policisë i njohur si sektori “ARO”.

Në vitin 2024, stafi administrativ i Prokurorisë së Posaçme ka ndjekur trajnime të ndryshme për krimin e korrupsionit pranë Shkollës Shqiptare të Administratës Publike.

Në vitin 2024, të gjithë gjyqtarët e Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, kanë marrë pjesë vazhdimisht në trajnimet vazhduese të organizuara nga Shkolla e Magjistraturës me tema të ndryshme. Këto trajnime janë mbuluar financiarisht nga Shkolla e Magjistraturës. Më 8.11.2024, Zv/Kryetari i Gjykatës, në cilësinë e ekspertit, ka marrë pjesë së bashku me gjyqtarë të tjerë të GJKKO dhe prokurorë të Prokurorisë së Posaçme në trajnimin e organizuar nga OSBE, me temë “Elementët e përgjegjësisë penale në procedurat e koncesionit dhe partneritetit publik privat”. Ky trajnim është mbuluar financiarisht nga OSBE.

Gjithashtu, nga Gjykata e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar i është kërkuar Agjencisë së Prokurimit Publik (shkresë nr. 3992 prot., datë 12.11.2024) trajnimi i disa punonjësve të gjykatës, në lidhje me prokurimet publike. Më konkretisht, trajnimi është kërkuar për: Kancelarin, Drejtorin e Buxhetit dhe Menaxhimit Financiar, Përgjegjësin e Sektorit të Burimeve Njerëzore, Shërbimeve Mbështetëse dhe Prokurimeve, Përgjegjësin e Sektorit të Protokoll/Arkivës, Specialistin e Buxhetit dhe Financës, Specialistin pranë Sektorit të Burimeve Njerëzore, Shërbimeve Mbështetëse dhe Prokurimeve, si dhe specialistin e IT-së. Trajnimi i kërkuar është dakordësuar nga Agjencia e Prokurimit Publik, e cila ka konfirmuar organizimin e tij me ASPA-n, për trajnimet e planifikuara të rradhës (me shkresën nr. 7761/1 prot., datë 19.11.2024).

Gjatë vitit 2024 nga Shkolla e Magjistraturës janë zhvilluar këto tematika trajnimi: Korrupsioni me përfitim të parregullt dhe aferat me tendera (26 Janar 2024); Korrupsioni aktiv i personave që ushtrojnë funksione publike (5 Prill 2024); Korrupsioni aktiv i dëshmitarit, ekspertit, përkthyesit (25 Prill 2024); Korrupsioni aktiv në zgjedhje. Korrupsioni pasiv në zgjedhje (8 Maj 2024); Hetimi dhe gjykimi i veprave penale në fushën e zgjedhjeve. Korrupsioni aktiv në zgjedhje (7 Tetor 2024); Pastrimi i parave (16 Shkurt 2024); Hetimi ndjekja penale dhe gjykimi veprave penale te pastrimit te parave (28 Mars 2024) dhe Hetimi dhe gjykimi i veprave penale në fushën e zgjedhjeve. Korrupsioni aktiv në zgjedhje (7 Tetor 2024). Gjithashtu, pranë Shkollës së Magjistraturës, janë zhvilluar edhe dy trajnime të tjera mundësuar nga partnerë pranë saj, si: Manual për pastrimin e parave-EU4OCAL (8-9 Prill 2024) nga DBE dhe Trajnim për Hetimin dhe gjykimin e veprave penale lidhur me prokurimin publik dhe korrupsionin (7- 8 Nëntor 2024) nga OSBE. Pjesëmarrës përfitues në këto trajnime janë 270 persona staf (gjyqtarë dhe prokurorë).

Në vitin 2024, në Prokurorinë e Përgjithshme janë rritur kapacitetet dhe përmirësuar funksionimi dhe organizimi i Zyrës së Ekspertizës, me ekspertë kontabël të cilët asistojnë prokurorët dhe oficerët e policisë gjyqësore në kryerjen e hetimeve komplekse për çështje që lidhen me korrupsionin apo shpërdorimin e detyrës. Kapacitete të rritura dhe përgatitje e shtuar për hetime të veprave penale kundër krimit ekonomik janë evidentuar edhe pranë seksioneve të posaçme në prokuroritë e juridiksioneve të përgjithshëm, me prokurorë me eksperiencë profesionale mbi 4 vjet. Njëkohësisht, Prokuroria e Përgjithshme ka asistuar me fonde shtesë për kryerjen e ekspertizave financiare të gjitha prokuroritë e shkallës së parë për trajtimin financiar të ekspertëve kontabël të miratur në hetimin e këtyre veprave penale.

Në vitin 2024 është miratuar Strategjia e Burimeve Njerëzore në Prokurorinë e Posaçme, për vitet 2024-2026. Në vitin 2024, Prokuroria e Posaçme ka emëruar Koordinatorin për Marrëdhënien me Median. Koordinatorin përgjigjet për çdo kërkesë për informacion të ardhur nga qytetarët, gazetarët, media, shoqëria civile, si dhe organizon takime periodike ndërmjet Drejtuesit të Prokurorisë së

Posaçme dhe gazetarëve. Prokuroria e Posaçme mban me korrektesë rregjistrin e kërkesave për informacion dhe përgjigjet e tyre, i cili publikohet çdo një muaj në faqen zyrtare të institucionit. Prokuroria e Posaçme ka të dedikuar në faqen e saj zyrtare Programin e Transparencës, i cilin azhurnohet me informacione lidhur me veprimtarinë publike të Prokurorisë së Posaçme, në funksion të informimit të publikut, aksesit në drejtësi dhe rritjes së besimit të publikut. Gjatë vitit 2024, Prokuroria e Posaçme ka qenë mjaft bashkëpunuese në marrëdhënie me institucionet shtetërore si dhe me publikun dhe rezulton se nga totali prej 4 422 kërkesa të përcjella nga institucionet shtetërore, organizata, avokatë, media, qytetarë, 982 kërkesa kanë ardhur nga institucionet shtetërore dhe 894 prej tyre kanë marrë përgjigje. Këtu përfshihen mendime dhe përcjellje të dhënash për projekt-akte ligjore dhe nënligjore si dhe për strategji ndërsektoriale në luftën kundër korrupsionit, krimin të organizuar dhe pastrimit të parave tek Ministria e Drejtësisë, Ministria e Brendshme, Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme, Ministria e Financave, etj.

Raportet e mediave të ndryshme të publikuar analizohen paraprakisht nga Prokuroria e Posaçme dhe vijon procedimi sipas ligjit. Gjithashtu, të gjitha raportet e auditimit apo gjetjet e inspektimeve të bëra publike nga media apo të dërguara nga institucionet kompetente vlerësohen nga Prokuroria e Posaçme në kuadër të nisjes së hetimeve penale. Për vitin 2024 numri i hetimeve të filluara nga referimet e institucioneve publike është 24 (ndërkohë që për vitin 2023 ishte 12), duke shënuar trend rritës (dyfishim). Për vitin 2024 procedimet e filluara nga referimet e dhëna nga institucionet publike mbetet i ulët me vetëm 19,8% të totalit, ndërkohë që ato të nisura referimet e ardhura nga shtetasit përbëjnë rreth 37,9 % të totalit. Krahasuar me vitin 2023, numri i procedimeve të nisura në raport me referimet e ardhura nga shtetasit është rritur në masën rreth 36%.

Në vitin 2024, Prokuroria e Përgjithshme në bashkëpunim me Shkollën e Magjistraturës është angazhuar në organizimin e aktiviteteve të përbashkëta me pjesëmarrjen e prokurorëve dhe oficerëve të policisë gjyqësore, për forcimin e kapaciteteve profesionale nëpërmjet trajnimeve me synim rritjen e efektivitetit në luftën kundër korrupsionit dhe veprave penale lidhur me detyrën. Në kuadrin e trajnimit vazhdues, për vitin 2024 në Shkollën e Magjistraturës janë zhvilluar 9 trajnime lidhur me temat në fushën e korrupsionit, apo në fushën e krimeve me natyrë ekonomike e financiare me pjesëmarrjen e 98 prokurorëve dhe 54 oficerëve të policisë gjyqësore si më poshtë: Përgjegjësia penale e personave juridikë", ku kanë marrë pjesë 7 prokurorë dhe 9 oficerë të policisë gjyqësore; Veprat penale të kryera nga zyrtarët dhe ish zyrtarët e nivelit të lartë", ku kanë marrë pjesë 2 prokurorë; Korrupsioni aktiv i personave që ushtrojnë funksione publike" ku kanë marrë pjesë 6 prokurorë dhe 7 oficerë të policisë gjyqësore; Përgjegjësia penale e personave juridik", ku kanë marrë pjesë 6 prokurorë dhe 6 oficerë të policisë gjyqësore; Korrupsioni aktiv i dëshmitarit, ekspertit, përkthyesit", ku kanë marrë pjesë 10 prokurorë; Manual për pastrimin e parave", ku kanë marrë pjesë 22 prokurorë dhe 3 oficerë të policisë gjyqësore; 2 sesione trajnimi me temë, "Hetimi ndjekja penale dhe gjykimi i veprave penale të pastrimit të parave dhe krimeve ekonomike", ku kanë marrë pjesë 22 prokurorë dhe 29 oficerë të policisë gjyqësore dhe "Për Hetimin dhe gjykimin e veprave penale lidhur me prokurimin publik dhe korrupsionin ", ku kanë marrë pjesë 23 prokurorë.

Në kuadër të projekteve të ndryshme ku prokuroritë e juridiksionit të përgjithshëm janë përfitues në vitin 2024, janë zhvilluar aktivitetet e mëposhtme: Konferencë rajonale me temë "Korrupsioni dhe pastrimi i parave si dhe risqet që lidhen me krimin mjedisor", organizuar nga Këshilli i Evropës në datat 7-8 mars 2024 me pjesëmarrjen e një prokurori; Trajnim mbi hetimet financiare, organizuar nga GIZ në datat 5-7 shkurt 2024, Tiranë, me pjesëmarrjen e 2 prokurorëve dhe trajnim

mbi "Pastrimin e parave si vepër e pavarur", organizuar nga GIZ në datat 25-26 qershor 2024 me pjesëmarrjen e 5 prokurorëve.

Në vitin 2024, Prokuroria e Posaçme në bashkëpunim me ICITAP, ka përfunduar ndërtimin, pilotimin dhe testimin e pjesës kryesore të moduleve të Sistemit të Menaxhimit të Çështjeve dhe konkretisht modulet: Protokolli, Regjistri, Prokurorët, Hetuesit, Drejtuesi. Fazat e tjera të procesit priten të vijnë përgjatë vitit 2025 me qëllimin për të vendosur sistemin në funksion të plotë me të gjitha modulet e tij: raporte e statistika, regjistri i ekzekutimeve dhe regjistri i letërporosive.

Në prokuroritë e shkallës së parë në kuadër të organizimit të punës janë ngritur seksione të posaçme për hetimin e krimit financiar, pastrimit të parave dhe shpërdorimit të detyrës. Në këto seksione ushtrojnë hetimin prokurorë të specializuar, të cilët në zbatim dhe të udhëzimit të Prokurorit të Përgjithshëm nr. 10/2020 "Për masat administrative dhe procedurale për rritjen e efektivitetit në luftën kundër pastrimit të parave, krimeve financiare dhe financimin e terrorizmit, dhe në hetimet pasurore në prokuroritë me juridiksion të përgjithshëm", u kërkohej që të kenë eksperiencë punë mbi 4 vite në këtë fushë. Në prokuroritë më të vogla ku nuk ka seksione, ka prokurorë të dedikuar, me eksperiencë të cilët merren me hetimin e këtyre veprave penale. Gjithashtu, edhe për vitin 2024 mbetet në zbatim udhëzimi i përgjithshëm nr.5/2019, i Prokurorit të Përgjithshëm, "Për marrëdhëniet me publikun në prokuroritë me juridiksion të përgjithshëm" ku janë unifikuar veprimtaritë e prokurorëve me juridiksion të përgjithshëm në marrëdhëniet me publikun dhe median për dhënien e informacionit në lidhje me hetimin e ndjekjen penale dhe për aktivitete të tjera të prokurorëve në forcimin dhe lehtësimin e komunikimit ndërmjet prokurorisë dhe publikut; Promovimin dhe inkurajimin e pjesëmarrjes së publikut në parandalimin e krimit dhe në procesin e reformave në të cilat prokuroria është e përfshirë, si dhe transparenca dhe llogaridhënia publike e prokurorisë duke ruajtur integritetin, pavarësinë dhe paanësinë e saj.

Në vitin 2024, në faqen zyrtare të Prokurorisë së Përgjithshme, www.pp.gov.al janë publikuar 153 njoftime për median. Njoftimet janë publikuar në faqen kryesore dhe në prokuroritë e juridiksionit të përgjithshëm në rrethet përkatëse në gjuhën shqipe dhe angleze. Informacioni shpërndahet gjithashtu edhe në rrjetin social X. Prokuroria e Përgjithshme u është përgjigjur rreth 100 kërkesave për informacion të ardhura në adresën elektronike info@pp.gov.al, ashtu edhe në adresat e koordinatorit, këshilltarit të medias, apo edhe nëpërmjet postës.

Në vitin 2024, Agjencia e Mbikëqyrjes Policore, ka vijuar me veprimtarinë e hetimit procedural penal, në kuadër të përpjekjeve për të parandaluar dhe luftuar korrupsionin si dhe kontaktet e papërshtatshme të punonjësve të veçantë të policisë së shtetit dhe të strukturave të tjera, me persona me precedentë kriminalë dhe penalë. AMP ka qenë e fokusuar në rritjen e efikasitetit të hetimeve proaktive në funksion të goditjes së paligjshmërisë, në radhët e punonjësve të Policisë së Shtetit, duke synuar nivelet e larta, të mesme e parë drejtues të menaxhimit policor, jo vetëm ato në nivelet zbatuese/operacionale. Gjithashtu fokusi është vënë në strukturat me risk të lartë korrupsioni, si kufiri, policia rrugore, hetimi i krimit, shërbimet ndaj të tretëve, etj. Për vitin 2024 dhe krahasueshmërisht me vitin e mëparshëm 2023, veprimtaria hetimore penale rezulton në trend rritjeje në të gjitha zërat e saj: 23 % rritje të numrit të referimeve të kryera nga strukturat e hetimit të Agjencisë pranë Prokurorisë së Juridiksionit të Përgjithshëm dhe Prokurorisë së Posaçme (307 referimeve viti 2024 – kundrejt 249 referimeve viti 2023); 35 % rritje të numrit të punonjësve të referuar (463 punonjës viti 2024 - kundrejt 342 punonjësve viti 2023); 40 % rritje e numrit të hetimeve proaktive në aplikim të metodave dhe teknikave speciale të hetimit (105 hetime proaktive viti 2024 kundrejt 75 hetimeve viti 2023), dhe 33 % rritje e numrit të personave të arrestuar në

flagrancë/masa personale me vendime gjyqësore (165 persona viti 2024 - kundrejt 124 personave viti 2023).

Punonjës të strukturave të policisë, të arrestuar në kushtet e flagrancës/ndaluar e me masa sigurie me vendim gjykatë, evidentojnë gjithashtu orientimin e veprimtarisë hetimore gjithnjë e më shumë në nivelet e larta të menaxhimit policor, duke zbuluar, dokumentuar me prova ligjore dhe goditur veprimtarinë e kundërligjshme të kryer nga ana tyre, siç janë rasti i: 1 drejtuesi të rolit madhor, në funksionin e Drejtorit të Departamentit për tendencën e *“shpërdorimit të detyrës dhe hyrjes së paautorizuar kompjuterike”*; 2 drejtues të rolit të mesëm, në funksionet e ish-drejtuesve të DVKM-së për tendencën e *“falsifikimit të dokumenteve dhe vjedhjes duke shpërdoruar detyrën”*, dhe 34 drejtues të rolit të parë, në funksionet shefa sektorësh/seksionesh/shef stacioni policie, kryesisht në strukturat e qarkullimit rrugor; në strukturat e kufirit dhe strukturat e rendit për tendencat e: *“shpërdorim detyre & korrupsionit pasiv”*, *“vjedhjes duke shpërdoruar detyrën”*, *“shpërdorim detyre duke favorizuar kalimin e paligjshëm të kufirit”*, dhe *“shpërdorim detyre duke favorizuar kultivimin e bimëve narkotike”*.

Veprimtaria hetimore procedurale e AMP është në këto shifra falë bashkëpunimit të ngushtë me prokurorët, të Prokurorisë së Posaçme apo dhe të prokurorive të juridiksionit të përgjithshëm, për çështjet penale të referuara nga OPGJ-të pranë AMP, në ndjekjen dhe kryerjen në kohë dhe cilësi të detyrave të deleguara, ka qenë një vlerë e shtuar, në përpjekjet për të arritur dokumentimin ligjor dhe goditjen e veprimtarisë së kundërligjshme të kryer nga punonjës policie apo të strukturave mbikëqyrëse.

Veprimtaria administrative e cila përmbledh hetimin administrativ të ankesave të qytetarëve dhe kryerjen e inspektimeve, në aspekt krahasimor viti 2023/2024, rezulton të jetë: 12 % rritje të numrit të ankesave që qytetarët kanë depozituar vetë apo nëpërmjet të gjitha portave të komunikimit që AMP ka venë në dispozicion të tyre, si Zyra e Ankesave, linja jeshile 08009090, posta elektronike e zyrtare, formulari on-line i ankesave, rrjetet sociale, medias së shkruar & elektronike, kutive postare, në whatsapp. etj. (1704 ankesa, viti 2024 – kundrejt 1522 ankesa, viti 2023); 23 % rritje e numrit të inspektimeve të kryera (63 inspektime viti 2024 – kundrejt 51 inspektime, viti 2023). Në vitin 2024, ka një rritje 7 herë më shumë (29 inspektime të planifikuara kundrejt 4 inspektimeve të planifikuara) – janë inspektimet e planifikuara në fillim të vitit mbi bazën e analizës së riskut për strukturat me risk më të lartë korrupsionit apo veprimeve të tjera të kundërligjshme, njëkohësisht dhe për të kontrolluar dhe mbikëqyrur realizimin e rekomandimeve të lëna në inspektimet e kryera në vitet apo periudhat e mëparshme. 63 % rritje numri i punonjësve të policisë, për të cilët në përfundim të hetimit administrativ janë rekomanduar për fillim të hetimit disiplinor për *“shkelje të rënda”* pranë Komisionit të Hetimit Disiplinor të Agjencisë dhe për *“shkelje të lehta”*, në Drejtorinë e Standardeve Profesionale të Policisë së Shtetit, (283 punonjës policie viti 2024 - kundrejt 177 punonjësve viti 2023).

Në lidhje me veprimtarinë e hetimit disiplinor të subjekteve mbikëqyrëse për shkelje të rënda, produkti i siguruar nga hetimi administrativ i ankesave dhe kryerjes së inspektimeve shërben si indicie për fillimin e *“Hetimit Disiplinor për Shkelje të Rënda të punonjësve të strukturave mbikëqyrëse”* nga Komisioni i Hetimit Disiplinor të AMP. Komisioni i Hetimit Disiplinor të AMP për vitin 2024, ka administruar në total 63 praktika për 130 punonjës policie. Deri në fund të vitit janë shqyrtuar praktikat dhe marrë vendime për 88 punonjës policie, nga të cilët 34 punonjës policie niveli i parë drejtues dhe 54 punonjës policie niveli zbatues. Komisioni ka konkluduar, që:

Për 2 punonjës jepet masa disiplinore “*Përrjashtim nga Policia e Shtetit*”; Për 3 punonjës jepet masa disiplinore “*shtyrje afatit të gradimit 2 vite*”; Për 7 punonjës jepet masa disiplinore “*shtyrje afatit të gradimit 1 vit*”; Për 7 punonjës jepet masa disiplinore “*shtyrje afatit të gradimit 6 muaj*”; Për 23 punonjës dhënia e masës për “*shkelje të lehtë disiplinore*”; Për 22 punonjës “*përfundimi i hetimit disiplinor – pa shkelje disiplinore*”; Për 23 punonjës “*mosfillimi i hetimit disiplinor – nuk konstatohej shkelja*” dhe Për 1 punonjës “*pezullimi i hetimit disiplinore – deri në përfundim të hetimit penal*”. Për 42 punonjës, praktikantët e ardhura nga strukturat e vendore dhe qendrore të AMP vijnë të jenë në proces shqyrtimi, nga Komisioni i Hetimit Disiplinor deri në fund të dhjetor 2024.

Në vitin 2024, ILDKPKI ka marrë 101 masa administrative gjobë dhe ka kryer në total 23 referime penale ose referime të tjera, nga të cilat 1 rast është referuar pranë Prokurorisë së Posaçme. Ka vijuar kontrolli sipas skemës së parashikuar në nenin 25/1 të ligjit nr. 9049/2003 i ndryshuar, duke vlerësuar rast pas rasti nevojën e marrjes së masave administrative apo kryerjes së referimeve pranë organeve ligjzbatuese.

Platforma e re e unifikuar për Ballkanin Perëndimor, *e-Tracking*, e mundësuar nga Komisioni Evropian për mbledhjen e të dhënave në kohë reale si dhe krijimin e një historiku të ndjekjeve dhe dënimeve penale, referuar vetëm kompetencave të prokurorive të juridiksionit të përgjithshëm, raporton për çështjet (*track*) në hetim për veprën penale të pastrimit të parave si dhe statistika për grupvepra të caktuara penale lidhur me krimin ekonomik dhe krime të rënda si narkotikët, trafiqet, etj., është ngritur në kuadër të konsolidimit të të dhënave statistikore për veprat penale të korrupsionit. Prokuroria e Përgjithshme në rolin e koordinuesit dhe monitoruesit dhe prokuroritë e shkallës së parë të juridiksionit të përgjithshëm si përdorues parësor të platformës ka vijuar me procesin e hedhjes dhe të raportimit të të dhënave lidhur me sa kërkon kjo platformë. Gjithashtu, Prokuroria e Përgjithshme vijon të bashkërendojë punën dhe me Koordinatorin Kombëtar në Ministrinë e Drejtësisë ashtu dhe me shërbimet e Komisionit Evropian në funksion të mbarëvajtjes së të gjithë procesit. Prokurori i Përgjithshëm ka miratuar Udhëzimin e Përgjithshëm nr. 3, datë 25.4.2024 “Për përdorimin e platformës elektronike për raportimin e të dhënave për korrupsionin dhe krimin e organizuar”, në të cilin është kërkuar marrja e masave administrative dhe procedurale nga drejtuesit në prokuroritë me juridiksion të përgjithshëm, lidhur me hedhjen e saktë, të plotë dhe periodike të të dhënave të Platformën Elektronike me dy kategori të dhënash:

- Të dhëna për çështjet penale lidhur me pastrimin e produkteve të veprës penale, me vijueshmërinë e këtyre procedimeve penale, deri në fazën e përfundimit të hetimeve;
- Statistika periodike për grupvepra të caktuara penale të cilat vlerësohen të nevojshme dhe ndryshojnë sipas prioriteteve të procesit të integritetit lidhur me krimin ekonomik dhe krime të rënda.

Në vitin 2024, ka përfunduar hedhja e të dhënave statistikore për periudhën e viteve 2018-2023 dhe në vijim do të përditësohen të dhënat për vitin 2024, për grupveprat lidhur me korrupsionin, pastrimin e parave etj si dhe vijon puna për hedhjen dhe përditësimin e çështjeve konkrete të veprës penale të parashikuar nga neni 287 i Kodit Penal “Pastrimi i produkteve të veprës penale”, nga viti 2022 e në vijim.

Si rezultat, grupveprën e korrupsionit, (nenet 124/a, 164/a, 164/b, 244, 245/1, etj.), brenda kompetencës së prokurorive të juridiksionit të përgjithshëm, për vitin 2024 janë regjistruar 140 procedime penale dhe 88 të pandehur. Janë dërguar për gjykim 87 procedime penale me 104 të pandehur.

Sa më sipër, masat dhe aktivitetet e parashikuara për këtë periudhë zbatimi, kanë ndikuar drejtpërdrejt në vlerën e synuar të treguesit të performancës 2.2.2. Të dhënat e marra pranë Prokurorisë së Posaçme dhe Prokurorisë së Përgjithshme, rezultojnë se përkatësisht:

- Prokuroria e Posaçme ka mbartur nga viti 2023, 324 procedime për korrupsionin. Janë regjistruar çështje të reja gjatë vitit 2024, 186 procedime, dhe në total për vitin 2024 janë në hetim 510 procedime penale, të dhëna që gjenden në raportin vjetor të Prokurorisë së Posaçme, të publikuar në link: <https://spak.gov.al/wp-content/uploads/2025/04/Raporti-vjetor-SPAK-2024.pdf>.
- Prokuroritë e juridiksionit të përgjithshëm kanë mbartur për grupveprën penale të korrupsionit 99 çështje, nga viti i mëparshëm, në relevancë me afatet procedurale të Kodit të Procedurës Penale. Për vitin 2024 janë përfunduar 140 çështje në hetim, të dhëna që gjenden në raportin vjetor të Prokurorisë së Përgjithshme, të publikuar në link: <https://www.pp.gov.al/Dokumente/>.

Në përfundim, vlerësohet se gjatë vitit 2024, është hartuar dhe bërë pjesë e këtij raporti monitorimi dokumenti analitik, raport vlerësimi mbi të dhënat e marra për hetime penale të përfunduara për korrupsion nga hetimet ende në vijim. Ky tregues performance është realizuar në masën 100%.

Paraqitja e realizueshmërisë së treguesit sipas Pasaportës së Treguesve, paraqitet si vijon:

Vlerat Bazë	2023	
	N/A	
	2024	Përgatitja e vlerësimit
	2025	Trend rritës i përfundimit të hetimeve penale për korrupsion (<i>backlog</i> i ulur)
	2026	Trend rritës i përfundimit të hetimeve penale për korrupsion (<i>backlog</i> i ulur)
	2027	Trend rritës i përfundimit të hetimeve penale për korrupsion (<i>backlog</i> i ulur)
	2028	Trend rritës i përfundimit të hetimeve penale për korrupsion (<i>backlog</i> i ulur)
	2029	Nuk ka <i>backlog</i>
Vlera synuar/ Targeti	2030	Nuk ka <i>backlog</i>
	2024 (targeti i synuar)	Raport vlerësimi
	2024 (targeti i arritur)	Raport vlerësimi i kryer

2.2.3: Përqindja e vlerës së pasurive të sekuestruara si rezultat i hetimit të rasteve të korrupsionit nga vlera mesatare e pasurive të sekuestruara në tre vitet e fundit (trend rritës).

Vlera e synuar për treguesin e performancës 2.2.3 për vitin 2024 është: Përgatitja e vlerësimit.

Plani i veprimit për Objektivin 2.2, në periudhën Janar-Dhjetor 2024 nuk parashikon aktivitete dhe masa me impakt të drejtpërdrejtë për zbatim, dhe në arritjen e vlerave të këtij treguesi të performancës.

Sa më sipër, për këtë periudhë zbatimi, është arritur të kryhet një raport (paraprak) vlerësimi duke ndikuar drejtpërdrejt në vlerën e synuar të treguesit të performancës 2.2.3. Si rezultat, mbështetur në të dhënat e administruara dhe të raportuara nga AAPSK, rezulton se: Për vitin 2021 përqindja e pasurive të sekuestruara për veprën penale të korrupsionit është 30.72%, dhe e konfiskuar për korrupsion është 24.83%; Për vitin 2022 përqindja e pasurive të sekuestruara për veprën penale të korrupsionit është 88.44% dhe e konfiskuar është 15.8%; dhe për vitin 2023 përqindja e pasurive të sekuestruara për veprën penale të korrupsionit është 28.61% dhe e konfiskuar është 2.54%. Mesatarja për 3 vitet është gjithsej 49.98% për pasuritë e sekuestruara dhe 24.83% për pasuritë e konfiskuara. Ky tregues performance është realizuar në masën 100%.

Paraqitja e realizueshmërisë së treguesit sipas Pasaportës së Treguesve, paraqitet si vijon:

Vlerat Bazë	2023	
	N/A	
	2024	Përgatitja e vlerësimit
	2025	Trend rritës i raportit ndërmjet vlerës së aseteve të sekuestruara në korrupsion kundrejt çështjeve të tjera penale
	2026	Trend rritës i raportit ndërmjet vlerës së aseteve të sekuestruara në korrupsion kundrejt çështjeve të tjera penale
	2027	Trend rritës i raportit ndërmjet vlerës së aseteve të sekuestruara në korrupsion kundrejt çështjeve të tjera penale
	2028	Trend rritës i raportit ndërmjet vlerës së aseteve të sekuestruara në korrupsion kundrejt çështjeve të tjera penale
	2029	Trend rritës i raportit ndërmjet vlerës së aseteve të sekuestruara në korrupsion kundrejt çështjeve të tjera penale
	2030	Trend rritës i raportit ndërmjet vlerës së aseteve të sekuestruara në korrupsion kundrejt çështjeve të tjera penale
Vlera synuar/ Targeti	2024 (targeti i synuar)	Përgatitja e Vlerësimit
	2024 (targeti i arritur)	Raport vlerësimi i kryer

Niveli i realizimit të objektivit 2.2

Niveli i realizimit të *Objektivit 2.2. Forcimi i kapaciteteve, burimeve dhe performancës për hetim penal efektiv dhe ndjekjen penale të korrupsionit*, në lidhje me realizimin e treguesve të performancës për periudhën janar - dhjetor 2024 është **100%**.

Përlllogaritja është kryer duke matur dhe evidentuar raportet e vlerësimit të kryer, në përputhje me parashkrimin e bërë në listën e treguesve të performancës, aneks 2 i Strategjisë Ndërsektoriale Kundër Korrupsionit, 2024-2030.

Përlllogaritja është kryer sipas formulës së mëposhtme:

$$NR\ 2.2 = \frac{TP\ 2.2.1\ (100\%)+TP\ 2.2.2\ (100\%)+TP\ 2.2.3\ (100\%)}{3\ TP} \times 100\% = 100\%$$

Verifikueshmëria e të dhënave

Të dhënat e raportuara mbi treguesit e performancës janë bazuar në informacionin e raportuar nga autoritetet përgjegjëse si prokuroritë, AMP dhe AAPSK, për monitorimin e zbatimit të planit të veprimit për janar - dhjetor 2024.

Risqet për realizimin e Objektivit 2.2

Për vitin 2024, paraqitet risk mesatar në realizimin e objektivit specifik, mbështetur tek një kufizim të dhënash dhe pasja e një planifikimi më të mirë të masave dhe aktiviteteve të planit të veprimit, për vitet.

2.3 *Forcimi i bashkëpunimit ndërkombëtar të agjencive ligjzbatuese dhe organeve gjyqësore në luftën kundër korrupsionit, krimit ekonomik dhe pastrimit të parave*

Për këtë objektiv është përcaktuar 1 tregues performance:

2.3.1: Raporti i numrit të operacioneve të nisura nga Europol dhe Interpol në fushën e luftës kundër krimit financiar dhe ekonomik ku Shqipëria merr pjesë nga numri mesatar i këtyre operacioneve në tre vitet e fundit (trend rritës)

Vlera e synuar për treguesin e performancës 2.3.1 për vitin 2024 është: Përgatitja e vlerësimit.

Plani i veprimit për Objektivin 2.3 parashikon 3 aktivitete dhe 2 Masa.

Për të arritur vlerat e treguesit në përputhje me pasaportën e treguesve të performancës dhe konkretisht me planin e veprimit 2024-2026, janë parashikuar aktivitetet (3) dhe masat (2) si më poshtë.

2.3.1	Përmirësimi dhe evidentimi i bashkëpunimit ndërkombëtar të organeve ligjzbatuese (të juridiksionit të posaçëm dhe ato të juridiksionit të zakonshëm), për hetimin dhe sanksionimin e krimit të korrupsionit dhe të krimeve me natyrë ekonomike
2.3.1.1	Marrëveshje bashkëpunimi me autoritete të huaja (ndërkombëtare) dhe të dhëna për zbatimin e tyre (platforma rajonale bashkëpunimi))
2.3.1.2	Shkëmbime informacioni në kuadër të bashkëpunimit ndërkombëtar, veçanërisht në ndihmën e ndërsjellë juridike për të lehtësuar shkëmbimin e informacionit dhe provave në rastet e korrupsionit dhe krimit ekonomik
2.3.3	Ngritja e kapaciteteve, shkëmbimi i informacionit dhe aktivitete të përbashkëta në kuadër të bashkëpunimit ndërkombëtar në fushën e luftës kundër korrupsionit
2.3.3.1	Rritja e bashkëpunimit dhe koordinimit të agjencive të zbatimit të ligjit me Interpolin dhe Europolin (tryeza pune të përbashkëta; forume diskutimi; takime dhe konferenca)

Realizimi i masave së parashikuara kryhet përmes aktiviteteve të parashikuara për zbatim në vitin 2024 dhe që vijojnë edhe përgjatë viteve të tjera të zbatimit të planit të veprimit. Matja dhe ecuria do të bëhet mbi baza 6-mujore dhe vjetore.

Për janar – dhjetor 2024, Prokuroria e Posaçme ka nënshkruar 3 marrëveshje të reja bashkëpunimi konkretisht:

1. Marrëveshja e Bashkëpunimit ndërmjet Drejtorit të Përgjithshëm të Agjencisë Kombëtare kundër Krimit të Mbretërisë së Bashkuar të Mbretërisë së Madhe dhe Irlandës së Veriut (NCA) dhe Strukturës së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar, nënshkruar më datë 22.02.2024;
2. Memorandumi i Mirëkuptimit mbi bashkëpunimin ndërmjet Strukturës së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar dhe Prokurorisë së Përgjithshme të Mbretërisë së Spanjës, nënshkruar më datë 11.04.2024;
3. Memorandumi i Mirëkuptimit mbi bashkëpunimin ndërmjet Prokurorisë së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar dhe Prokurorisë Speciale të Malit të Zi, nënshkruar më datë 17.12.2024.

Në vitin 2024, Prokuroria e Përgjithshme dhe Prokuroria Federale të Mbretërisë së Belgjikës, kanë lidhur në datë 7.11.2024 një marrëveshje bashkëpunimi. Tematika e marrëveshjes është rritja e bashkëpunimit ekzistues në nivel strukturor, për të përmirësuar mirëkuptimin e ndërsjellë të palëve përmes shkëmbimit të informacionit për sistemet ligjore, praktikatat e mira të njëri-tjetrit dhe për të nxitur bashkëpunimin e drejtpërdrejtë ndërmjet të dy institucioneve brenda fushës përkatëse të kompetencës, për çështjet penale të krimeve të rënda, trafikimin e paligjshëm dhe pastrimin e parave.

Po ashtu, një Memorandum Mirëkuptimi ndërmjet Prokurorisë së Përgjithshme dhe Prokurorisë së Përgjithshme të Republikës së Azerbajxhanit, është lidhur në datë 1.10.2024, me fokus forcimin e bashkëpunimit ekzistues në luftën kundër krimit ndërkombëtar, përfshirë çështjet e rikuperimit të aseteve, duke garantuar mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të njeriut, identifikimin e fushave të bashkëpunimit ndërmjet dy institucioneve si dhe planifikimin, përgatitjen dhe zhvillimin e programeve të trajnimit me qëllim rritjen e kapaciteteve të prokurorëve.

Në vitin 2024 në kuadër të kërkesave për ndihmë juridike të ndërsjellë janë regjistruar nga prokurorët e posaçëm 5 kërkesa për verifikim pasuror. Këto verifikime pasurore, për të cilat vazhdojnë hetimet, janë bërë bazuar në 1 kërkesë për ndihmë juridike e ardhur nga Gjermania dhe në 4 kërkesa për ndihmë juridike të ardhura nga Belgjika. Është rritur ndjeshëm komunikimi i drejtpërdrejtë i Prokurorisë së Posaçme me autoritetet homologe evropiane, të rajonit dhe amerikane, gjithashtu edhe me autoritetet homologe të vendeve të Amerikës Jugut. Është rritur ndjeshëm shkëmbimi i informacionit edhe nëpërmjet rrjeteve dhe kanaleve të sigurta të komunikimit si Eurojust, Interpol, Europol, etj. Gjatë 2024, midis organeve ligjzbatuese janë shkëmbyer 103 informacione. Komunikim intensiv dhe në rritje ka midis prokurorëve dhe oficerëve ndërlidhës që mbulojnë Shqipërinë, të atashuar pranë ambasadave të huaja në Tiranë apo jashtë Shqipërisë. Ky lloj komunikimi i drejtpërdrejtë ndikon në forcimin e bashkëpunimit dhe rritjen e efektivitetit në luftën kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar.

Në vitin 2024, janë ngritur 10 skuadra të përbashkëta hetimore me autoritetet e huaja të drejtësisë dhe kanë vijuar hetimet me 27 skuadra aktive të përbashkëta hetimore në Prokurorinë e Posaçme, që nga krijimi i saj.

Sa më sipër, për këtë periudhë zbatimi, është arritur të kryhet një raport (paraprak) vlerësimi duke ndikuar drejtpërdrejt në vlerën e synuar të treguesit të performancës 2.3.1. Si rezultat, mbështetur në të dhënat e administruara dhe të raportuara nga prokuroritë dhe Policia e Shtetit rezultojnë se:

Për vitin 2024: Prokuroria e Posaçme ka shënuar një rritje prej 21 kërkesash për ndihmë juridike të ardhura nga jashtë për vitin 2024 krahasuar me mesataren e 3 viteve të fundit që është 59. Numri i kërkesave për ndihmë juridike të dërguara jashtë për vitin 2024 krahasuar me mesataren e 3 viteve të fundit që është 78, ka një rritje prej 85 kërkesash. Skuadra të përbashkëta hetimore për vitin 2024 krahasuar me mesataren e 3 viteve të fundit që është 8, ka një rritje prej 2 skuadrash dhe kërkesa për ekstradim për vitin 2024 krahasuar me mesataren e 3 viteve të fundit që është 22, ka një rritje prej 18 kërkesash për ekstradim.

Policia e Shtetit raporton këto të dhëna për operacione të përbashkëta policore në kuadër të bashkëpunimit ndërkombëtar, si përkatësisht: në vitin 2022 ka zhvilluar 3 operacione policore; në vitin 2023 ka zhvilluar 5 operacione policore dhe në vitin 2024 ka zhvilluar 7 operacione policore. Në total janë 15 operacione bashkëpunimi të kryera dhe që llogaritet një mesatare prej 5 operacionesh.

Më konkretisht operacione bashkëpunimi në vitin 2024, të ndërmarrë nga Policia e Shtetit janë: (1) Operacioni policor “DVOJNIK”, në bashkëpunim me Policinë në Maqedoninë e Veriut, për hetime për veprën penale “Falsifikim i dokumenteve të udhëtimit”, parashikuar nga Kodi Penal i Maqedonisë së Veriut, për subjekte zyrtare të Ministrisë së Brendshme në Maqedoninë e Veriut, duke abuzuar me detyrën, kanë lëshuar pasaporta të rregullta maqedonase në emra të shtetasve maqedonas që nuk janë pajisur asnjëherë me dokumente, por që fotoja e pasaportës ju përket personave të tjerë (shumë prej të cilëve shqiptarë); (2) Operacioni policor “INFRA ZAJIL” - në bashkëpunim me Policinë në Spanjë, për hetime për kapjen e një personi në kërkim ndërkombëtar, D.GJ., në kërkim për veprën penale “pastrim i produkteve dhe si pjesë e një grupi të krimit të organizuar; (3) Operacioni policor “SENEGAL” - në bashkëpunim me Policinë në Itali, për hetime që lidhet me një investigim (criminal case n. 8015/2021 RGNR Prosecution Office Torino) kundër një grupi të krimit të organizuar, OCG, të përfshirë në trafik droge, ku përfshihen dhe pesë shtetas shqiptarë; (4) Operacioni policor “HAECHI V” përbën ciklin e dytë të Projektit HAECHI (CEFIN Faza II), një nismë trevjeçare që ka qenë e suksesshme në lehtësimin e bashkëpunimit ndërkombëtar policor në luftën kundër krimeve kibernetike financiare. Operacioni HAECHI ka si qëllim luftën ndaj shtatë llojeve specifike të krimeve kibernetike financiare, si: Tjetërsimi i zërit, Mashtrime dashurie/Romantike, Mashtrime në Investime, Shpërndarje dhe pastrim parash të lidhura me lojërat e paligjshme në internet, kompromis me email biznesi (BEC) dhe mashtrim në tregtinë elektronike; (5) Operacioni policor “THUNDER 2024” - në bashkëpunim me Sekretariatën e Përgjithshëm të INTERPOL- Environmental Security Programme (ESP kundër tregtisë së paligjshme të florës dhe faunës; (6) Në bashkëpunim me INTERPOL Illicit Goods and Global Health (IGGH) ka filluar koordinimi i veprimeve për operacionin Policor “PANGAEA XVII”, në bashkëpunim me krimin financiar, për produktet farmaceutike të falsifikuara, dhe (7) Operacioni policor “POWER” në bashkëpunim me NCA (United Kingdom) dhe strukturat e tjera të Policisë së Shtetit, lidhur me disa persona, shtetas

Shqiptare, të deportuar në Shqipëri, nën hetim për pastrim të produkteve të veprës penale në Mbretërinë e Bashkuar.

Numri i operacioneve policore të kryera nga strukturat e Policisë së Shtetit me Europol dhe Interpol, për vitet 2021-2024, paraqitet:

	2021	2022	2023	2024
Europol	28	44	55	49
Interpol	26	34	54	68

Ky tregues performance është realizuar në masën 100%.

Paraqitja e realizueshmërisë së treguesit sipas Pasaportës së Treguesve, paraqitet si vijon:

Vlerat Bazë	2023	
	N/A	
	2024	Përgatitja e vlerësimit
	2025	Trend rritës i numrit të operacioneve ndërkombëtare ku Shqipëria ka marrë pjesë
	2026	Trend rritës i numrit të operacioneve ndërkombëtare ku Shqipëria ka marrë pjesë
	2027	Trend rritës i numrit të operacioneve ndërkombëtare ku Shqipëria ka marrë pjesë
	2028	Trend rritës i numrit të operacioneve ndërkombëtare ku Shqipëria ka marrë pjesë
	2029	Trend rritës i numrit të operacioneve ndërkombëtare ku Shqipëria ka marrë pjesë
	2030	Trend rritës i numrit të operacioneve ndërkombëtare ku Shqipëria ka marrë pjesë
Vlera synuar/ Targeti	2024 (targeti i synuar)	Përgatitja e Vlerësimit
	2024 (targeti i arritur)	Raport vlerësimi i kryer

Niveli i realizimit të objektivit 2.3

Niveli i realizimit të *Objektivit 2.3 Forcimi i bashkëpunimit ndërkombëtar i agjencive ligjzbatuese dhe organeve gjyqësore në luftën kundër korrupsionit, krimit ekonomik dhe të pastrimit të parave*, në lidhje me realizimin e treguesve të performancës për periudhën janar - dhjetor 2024 është **100%**.

Përlllogaritja është kryer duke matur dhe evidentuar raportet e vlerësimit të kryer, dhe të dhënat e administruara, në përputhje me parashkimin e bërë në listën e treguesve të performancës, aneks 2 i Strategjisë Ndërsektoriale Kundër Korrupsionit, 2024-2030.

Shkalla e realizimit të objektivit 2.3 për këtë periudhë raportimi është **100%**.

Verifikueshmëria e të dhënave

Të dhënat e raportuara mbi treguesit e performancës janë bazuar në informacionin e raportuar nga prokuroritë dhe Policia e Shtetit.

Risqet për realizimin e Objektivit 2.3

Për vitin 2024, realizimi i objektivit është ka rezultuar në risk të ulët, referuar vetëm ecurisë së marrëveshjeve dhe shkëmbimit të informacionit mes autoriteteve.

Realizueshmëria e objektivave specifike të qëllimit strategjik për ndëshkimin e korrupsionit (Politika Ndëshkuese - II)

Mbështetur në të dhënat e raportuara nga institucionet përgjegjëse për administrimin dhe përpunimin e të dhënave të treguesve të performancës tabela më poshtë paraqet shkallën e realizimit të 3 objektivave specifike të qëllimit strategjik për ndëshkimin e korrupsionit.

Duke aplikuar të njëjtën formulë të nxjerrjes së shkallës së realizimit të objektivave - duke mbledhur realizueshmërinë në përqindjes të treguesve të performancës dhe pjesuar me numrin e treguesve – realizueshmëria e qëllimit strategjik për ndëshkimin e korrupsionit është 100%.

Objekti	Realizueshmëria
2.1. Forcimi i kuadrit legjislativ, institucional dhe kapaciteteve për hetim efektiv administrativ të korrupsionit	100%
2.2. Forcimi i kapaciteteve, burimeve dhe performancës për hetim penal efektiv dhe ndjekjen penale të korrupsionit	100%
2.3. Forcimi i bashkëpunimit ndërkombëtar i agjencive ligjzbatuese dhe organeve gjyqësore në luftën kundër korrupsionit, krimit ekonomik dhe të pastrimit të parave	100%

Realizueshmëria e qëllimit strategjik për ndëshkimin e korrupsionit, e cila është në masën 100%, tregon për një rezultat mjaft të mirë dhe të qëndrueshëm përgjatë periudhës janar – dhjetor 2024.

Si rezultat, vihet re përparim i konsiderueshëm në forcimin e mekanizmave institucionale dhe kapaciteteve të hetimit administrativ dhe penal kundër korrupsionit. U ngrit dhe filloi funksionimi i Drejtorisë së Përgjithshme e Antikorrupsionit si një strukturë e posaçme me rol qendror në ndjekjen administrative të rasteve të korrupsionit, me një strukturë prej 27 punonjësish dhe dy drejtori teknike. U realizua trajnim i gjerë i stafit antikorrupsion përmes bashkëpunimeve me institucione kombëtare dhe ndërkombëtare, përfshirë kursin HELP të Këshillit të Evropës dhe leksione të hapura nga Universiteti i Harvardit. DPAK administroi 163 ankesa dhe përfundoi hetime për 7 raste me 6 masa administrative dhe 16 rekomandime, duke rritur efektivitetin e përgjigjes administrative ndaj korrupsionit.

Në fushën e ndjekjes penale, u avancua ndjeshëm procesi për ngritjen e Zyrës së Rikuperimit të Aseteve (ZRA), me një kuadër ligjor të harmonizuar me direktivat e BE-së. Forcimi i strukturave të Policisë së Shtetit dhe krijimi i njësive të specializuara për hetimin e korrupsionit, pastrimit të parave dhe krimeve financiare, shoqërohet me intensifikim trajnimesh për oficerët e policisë dhe prokurorët, me mbi 100 aktivitete trajnuese dhe pjesëmarrje të gjerë në bashkëpunime rajonale. Prokuroria e Posaçme përmbylli 186 çështje të reja për korrupsion, ndërsa prokuroritë e

juridiksionit të përgjithshëm përfunduan 140 çështje. AMP shtoi me 40% hetimet proaktive dhe me 33% numrin e arrestimeve. Janë realizuar gjithashtu 10 skuadra të përbashkëta hetimore dhe është rritur ndjeshëm ndihma juridike dhe bashkëpunimi me agjenci ndërkombëtare. Këto zhvillime kanë çuar në përmbytjen e plotë të treguesve të performancës në kuadër të objektivave strategjikë për ndëshkimin efektiv të korrupsionit. Referuar vlerave të aseteve të sekuestruara dhe të konfiskuara në vlera mesatare për tre vitet e fundit (2021-2023) është gjithsej 49.98% për pasuritë e sekuestruara dhe 24.83% për pasuritë e konfiskuara.

Realizimi i plotë i treguesve të performancës për objektivat 2.1-2.3, dëshmon angazhimin e organizuar institucional në luftën kundër korrupsionit për efektivitet dhe efikasitet në verifikime dhe ndjekje penale të krimit të korrupsionit.

Politika Ndërgjegjëse (III) - Përmbledhje për arritjet në ndërgjegjësimin mbi korrupsionin

Përmes **qëllimit të politikës ndërgjegjëse SNKK**, synon të rrisë pjesëmarrjen e publikut në luftën kundër korrupsionit duke e denoncuar atë dhe duke qenë aktiv në iniciativat e parandalimit të korrupsionit, edukimi i të rinjve mbi çështjet e etikës, përfshirja proaktive e organizatave të shoqërisë civile, sektorit privat dhe grave në luftën kundër korrupsionit janë fokusi i qasjes ndërgjegjëse të SNKK 2024-2030.


Gjatë periudhës raportuese janë realizuar masat (produktet) dhe kryer aktivitetet sipas tabelës më poshtë.

Qëllimet e Politikës	Masat dhe Aktivitetet	Realizimi i Masave dhe aktiviteteve			
		Masa dhe aktivitete të parashikuara për vitin 2024	Masa dhe aktivitete plotësisht të realizuara	Masa dhe aktiviteteve pjesërisht të realizuara ⁷⁰	Masa dhe aktivitete të parealizuar ⁷¹
Ndërgjegjëse (III)	Masa	10	5	4	1
	Aktivite	19	14	2	3

Rezulton se nga 10 masa dhe 19 aktivitete të parashikuara në Planin e Veprimit 2024 – 2026, për janar-dhjetor 2024, për Politikën Ndërgjegjëse (III) janë zbatuar plotësisht 5 masa dhe 14 aktivitete, pjesërisht 4 masa dhe 2 aktivitete si dhe pazbatuar 1 masë dhe 3 aktivitete (masa: 3.4.1 dhe aktivitetet: 3.3.3.3, 3.3.4.1 dhe 3.4.1.1)


⁷⁰ Aktivitet "pjesërisht i realizuar" është ai aktivitet që është realizuar në shkallën nga 50 deri në 100 për qind.

⁷¹ Aktivitet "i parealizuar" është ai i cili është realizuar në një shkallë nga 0 në 50 për qind



Nga 4 treguesit e performances për Politikën Ndërgjegjëse (III), është arritur vlera e synuar për 2 tregues performance, për të cilët janë hartuar raporte vlerësimi dhe bërë pjesë e këtij raporti, pjesërisht arritur vlera për 1 tregues performance dhe vetëm 1 i parealizuar.

Ndërgjegjëse	Treguesit e performancës	Realizimi i Treguesve të Performancës		
		Vlera e synuar është realizuar plotësisht ⁷²	Vlera e synuar është realizuar pjesërisht ⁷³	Vlera e synuar nuk është e realizuar ⁷⁴
	4	2	1	1



⁷² Që është realizuar në shkallën 100 për qind.

⁷³ Që është realizuar në shkallën nga 50 deri në 100 për qind.

⁷⁴ Që nuk është realizuar dhe tregues për të cilin nuk janë mbledhur ose nuk ka qenë e mundur të mbledhen të dhëna.

3.1 Rritja e ndërgjegjësimit të qytetarëve për pasojat negative të korrupsionit dhe nxitja e tyre për të kundërshtuar, denoncuar dhe raportuar korrupsionin.

Për këtë objektiv është përcaktuar 1 tregues performance:

3.1.1: Informim i shtuar i qytetarëve për mekanizmat veprues në luftën kundër korrupsionit.

Vlera e synuar për treguesin e performancës 3.1.1 për vitin 2024 është: Përgatitja e metodologjisë së vlerësimit dhe vendosja e nivelit bazë për fillimin e matjes.

Plani i veprimit për Objektivin 3.1 parashikon 5 aktivitete dhe 2 masa.

Për të arritur vlerat e treguesit në përputhje me pasaportën e treguesve të performancës dhe konkretisht me planin e veprimit 2024-2026, janë parashikuar aktivitetet (5) dhe masat (2) si më poshtë.

3.1.1	Rritja e ndërgjegjësimit dhe komunikimit të vazhdueshëm të qytetarëve për pasojat negative të korrupsionit në shoqëri
3.1.1.2	Plan (vjetor) Vizibiliteti dhe Komunikimi i Drejtorisë së Përgjithshme të Antikorrupsionit, i hartuar dhe i publikuar
3.1.1.3	Organizimi i fushatës vjetore të ndërgjegjësimit të luftës kundër korrupsionit "Java e Integritetit"
3.1.1.4	Marrëveshje bashkëpunimi me TV publik për transmetime televizive (emisione, intervista, rubrika, njoftime)
3.1.1.5	E-buletin mujor DPAK
3.1.2	Promovimi i mënyrave të raportimit të korrupsionit dhe inkurajimi i qytetarëve për ta denoncuar atë
3.1.2.1	Marrëveshje bashkëpunimi me ADB për mbledhjen dhe koordinimin e raportimeve dhe ankesave kundër korrupsionit nga qytetarët

Realizimi i masave të parashikuara kryhet përmes aktiviteteve të parashikuara për zbatim në vitin 2024 dhe që vijnë edhe përgjatë viteve të tjera të zbatimit të planit të veprimit. Matja dhe ecuria do të bëhet mbi baza 6-mujore dhe vjetore.

Për janar – dhjetor 2024, Drejtoria e Përgjithshme e Antikorrupsionit, në cilësinë e autoritetit përgjegjës për ideimin dhe planifikimin e aktiviteteve me bazë ndërgjegjësimin dhe informimin e luftës kundër korrupsionit përgatiti dhe hartoi planin Planin e Komunikimit dhe Vizibilitetit, 2024. Dokumenti përmban një listë të larmishme me aktivitete publike për të promovuar luftën kundër korrupsionit dhe me qëllim ndërgjegjësimin e tij dhe edukimin e publikut të gjerë. Dokumenti përmban në total 15 aktivitete, të shpërndara për zhvillim përgjatë gjithë vitit 2024 (6M1 – 6M2, 2024). Plani (vjetor) i Komunikimit dhe Vizibilitetit konsistoi në aktivitete me audiencë shkollat e arsimit parauniversitar (cikël leksionesh të hapura), konferencë ndërkombëtare, aktivitete pranë auditoreve kulturore dhe artistike, njoftimi dhe shpërndarja e e-buletinit mujor në rrjetet e grupeve të interesit dhe aktive kundër korrupsionit, aktivitetet e Javës së Integritetit 2024. Publikimi i këtij dokumenti nuk u mundësua për shkak të riorganizimit të Drejtorisë së Përgjithshme të Antikorrupsionit dhe në pritje të ngritjes së website zyrtar të saj.

Në vitin 2024, Ministri i Shtetit për Administratën Publike dhe Antikorrupsionin në rolin e Koordinatorit Kombëtar Kundër Korrupsionit organizoi dhe udhëhoqi edicionin e VI të Javës së Integritetit 2024. Fushata vjetore e ndërgjegjësimit kundër korrupsionit u zhvillua në periudhën 2-13 dhjetor 2024. Pjesë e aktiviteteve të fushatës Java e Integritetit 2024, përmenden aktivitete publike me pjesëmarrje të grupeve të ndryshme të interesit për çështje që prekin dhe ndikojnë në pjesëmarrjen dhe promovimin e dukurive të luftës kundër korrupsionit. Java e Integritetit 2024, pati një kalendar të plotë takimesh dhe aktiviteteve komunikimi dhe ndërgjegjësimi, pjesë e së cilës u bënë edhe organizata të interesuara të shoqërisë civile, misione dhe autoritete të huaja në vend. Partneri kryesor i KKKK edhe për këtë edicion ishte, ICC Albania.

Java e Integritetit 2024, filloi me cikël të hapur leksionesh në auditoret e universiteteve publike dhe jo-publike; takime rajonale të agjencive antikorrupsion anëtare pranë RAI; lançim të modulit antikorrupsionit për administratën publike, kursi “Hyrje në Parandalimin e Korrupsionit”; konferenca “Forcimi i Integritetit përmes edukimit, kërkimit dhe digjitalizimit” me fokus rëndësinë e edukimit, kërkimit dhe digjitalizimit në forcimin e integritetit, në zhvillimin e vendit dhe rritjes së nivelit të ekspertizës të stafeve të administratës publike; aktiviteti “Kronikat e Integritetit” me fokus promovimin e videove me mesazhe të drejtpërdrejta për të luftuar korrupsionin dhe lartësuar integritetin në vendimmarrjen e përditshme; forumi - hapësirë diskutimi për masat për ndërhyrje për luftën kundër korrupsionit në prokurimet publike. Fushata Java e Integritetit 2024 u mbyll me promovimin e platformës së transparencës publike. Një përmbledhje e plotë e fushatës vjetore, Java e Integritetit 2024, mund të gjendet në numrin 43, të e-buletinit dhjetor 2024, promovuar në rrjetet sociale të Drejtorisë së Përgjithshme të Antikorrupsionit, facebook e LinkedIn.

Në vitin 2024, Ministri i Shtetit për Administratën Publike dhe Antikorrupsionin ka zhvilluar dhe marrë pjesë në edicione televizive kronikash për informimin publik dhe të dhëna të luftës kundër korrupsionit në media dhe transmetime televizive, duke përmendur kanale televizive si: RTSH⁷⁵, Top-Channel⁷⁶, Euronews⁷⁷, Vizion Plus⁷⁸, Klan News⁷⁹, A2 CNN⁸⁰.

Në vitin 2024, Drejtoria e Përgjithshme e Antikorrupsionit ka vijuar rregullisht me hartimin, shpërndarjen dhe publikimin e e-buletinit mujor “Antikorrupsioni”. E-buletini “Antikorrupsioni” është një mjet i gjerë komunikimi që synon të informojë nëpërmjet pasqyrit të përmbledhjeve të aktiviteteve kryesore të zhvilluara nga Ministri i Shtetit për Administratën Publike dhe Antikorrupsionin dhe Drejtoria e Përgjithshme e Antikorrupsionit në fushën antikorrupsion, mbi baza mujore. Për vitin 2024 janë publikuar numrat 32-43, të muajve janar-dhjetor 2024. Buletinët mund të gjenden të publikuar dhe aksesohen lirisht në link: <https://www.drejtesia.gov.al/e-buletin/>; dhe profilet sociale të Drejtorisë së Përgjithshme të Antikorrupsionit në facebook dhe LinkedIn.

⁷⁵ <https://lajme.rtsh.al/artikull/ministrja-antikorrupsion-pirdeni-4-fushat-me-rrezikun-me-te-larte-dhe-masat-e-geverise>.

⁷⁶ <https://top-channel.tv/video/fryrja-e-administrates-publike-ministrja-adea-pirdeni-ja-si-do-luftohet-korrupsioni-wake-up/>.

⁷⁷ <https://euronews.al/lufta-kunder-korrupsionit-pirdeni-po-skanojme-sektoret-me-risk-per-fenomenin/>.

⁷⁸ <https://www.vizionplus.tv/rama-krijon-ministrine-e-re-adea-pirdeni-ne-krye-te-administrates-dhe-antikorrupsionit/>.

⁷⁹ <https://tvklan.al/shqiperia-progres-te-kenaqshem-pirdeni-per-negociatat-viti-2030-jo-slogan-politik-e-deklarate-e-pabaze>.

⁸⁰ https://www.youtube.com/watch?v=_bKNhKsF7kY.

Kjo drejtori përdor gjithashtu një adresë emaili posaçërisht për dërgimin e e-buletinit nga infoak@dpak.gov.al.

Në vitin 2024, është pregatitur dhe konsultuar teksti i Marrëveshjes së Bashkëpunimit, midis Drejtorisë së Përgjithshme të Antikorrupsionit me Agjencinë për Dialog dhe Bashkëqeverisje. Marrëveshja pritet të lehtësojë komunikimin dhe ndjekjen e rasteve të ankesave dhe kërkesave për raste të mundshme korrupsioni në administratën publike, ndërkohë që ADB delegon e përcjell ato për dyshime për praktika abuzive/arbitrare apo korruptive.

Sa më sipër, masat dhe aktivitetet e parashikuara për këtë periudhë zbatimi, kanë ndikuar drejtpërdrejt në vlerën e synuar të treguesit të performancës 3.1.1. Të dhënat e administruara nga Drejtoria e Përgjithshme e Antikorrupsionit dhe Ministri i Shtetit për Administratën Publike dhe Antikorrupsionin, dëshmojnë për një qasje proaktive informimi dhe ndërgjegjësimi mbi bazën e së cilat mbështetet edhe raporti i vlerësimit që vendos bazat e vlerave për rritje në vitet në vijim të zbatimit të strategjisë. Gjithashtu, në 2024 DPAK në bashkëpunim me qendrën ALTRI ka konsultuar dokumentin Metodologji e Matjes së Perceptimit të Publikut⁸¹ për impaktin e masave antikorrupsion, matjen e formave të tij dhe metodat nxitëse të tij. Ky tregues performance është realizuar në masën 100%.

Paraqitja e realizueshmërisë së treguesit sipas Pasaportës së Treguesve, paraqitet si vijon:

Vlerat Bazë	2023	
	N/A	
	2024	Përgatitja e metodologjisë së vlerësimit dhe vendosja e nivelit bazë për fillimin e matjes
	2025	Informim i shtuar i qytetarëve për mekanizmat veprues në luftën kundër korrupsionit
	2026	Informim i shtuar i qytetarëve për mekanizmat veprues në luftën kundër korrupsionit
	2027	Informim i shtuar i qytetarëve për mekanizmat veprues në luftën kundër korrupsionit
	2028	Informim i shtuar i qytetarëve për mekanizmat veprues në luftën kundër korrupsionit
	2029	Informim i shtuar i qytetarëve për mekanizmat veprues në luftën kundër korrupsionit
	2030	Informim i shtuar i qytetarëve për mekanizmat veprues në luftën kundër korrupsionit
Vlera synuar/ Targeti	2024 (targeti i synuar)	Përgatitja e metodologjisë së vlerësimit
	2024 (targeti i arritur)	Metodologji e hartuar

⁸¹ <https://altri.al/wp-content/uploads/2024/09/Draft-Metodologjia-mbi-matjen-e-perceptimit-te-publikut-Version-ne-konsultim-me-MAPA.pdf>.

Niveli i realizimit të objektivit 3.1

Niveli i realizimit të Objektivit 3.1 *Rritja e ndërgjegjësisë së qytetarëve për pasojat negative të korrupsionit dhe nxitja e tyre për të kundërshtuar, denoncuar dhe raportuar korrupsionin*, në lidhje me realizimin e treguesit të performancës për periudhën janar-dhjetor 2024 është **100%**.

Përlllogaritja është kryer duke matur dhe evidentuar përmbatjen dhe rekomandimet e raportit të paraprak të vlerësimit të kryer, në përputhje me parashkrimin e bërë në listën e treguesve të performancës, aneks 2 i Strategjisë Ndërsektoriale Kundër Korrupsionit, 2024-2030.

Shkalla e realizimit të objektivit 3.1 për këtë periudhë raportimi është **100%**.

Verifikueshmëria e të dhënave

Të dhënat e raportuara mbi treguesit e performancës janë bazuar në informacionin që administron dhe koordinon Drejtoria e Përgjithshme e Antikorrupsionit.

Risqet për realizimin e Objektivit 3.1

Për vitin 2024, realizimi i objektivit ka rezultuar në risk të ulët, duke garantuar kryerjen e analizës që do të udhëheqë edhe masat për veprim dhe për të garantuar më shumë informim dhe ndërgjegjësim në luftën kundër korrupsionit.

3.2 Edukimi i të rinjve mbi etikën, integritetin dhe angazhimin proaktiv në luftën kundër korrupsionit.

Për këtë objektiv është përcaktuar 1 tregues performance:

3.2.1: Përqindja e shkollave në të cilat është zbatuar kurrikula e etikës dhe integritetit nga mesatarja e shkollave ku këto kurrikula janë zbatuar në tre vitet e fundit (trend rritës)

Vlera e synuar për treguesin e performancës 3.2.1 për vitin 2024 është: Përgatitja e metodologjisë së vlerësimit dhe vendosja e nivelit bazë për fillimin e matjes.

Plani i veprimit për Objektivin 3.1 parashikon 3 aktivitete dhe 2 masa.

Për të arritur vlerat e treguesit në përputhje me pasaportën e treguesve të performancës dhe konkretisht me planin e veprimit 2024-2026, janë parashikuar aktivitetet (3) dhe masat (2) si më poshtë.

3.2.2	Forcimi i aspektit të etikës dhe integritetit në programet edukative të medias (TV dhe radio)
3.2.2.3	Programe radio-televizive për luftën kundër korrupsionit
3.2.3	Promovimi i rëndësisë së angazhimit proaktiv të të rinjve në antikorrupsion
3.2.3.1	Fushata ndërgjegjëse, të angazhimit proaktiv i të rinjve në luftën kundër korrupsionit
3.2.3.2	Intensifikimi i përdorimit të rrjeteve sociale dhe opinionistëve të njohur si bashkëpunëtor me të rinjtë për iniciimin e angazhimit proaktiv të tyre në luftën kundër korrupsionit

Realizimi i masave të parashikuara kryhet përmes aktiviteteve të parashikuara për zbatim në vitin 2024 dhe që vijnë edhe përgjatë viteve të tjera të zbatimit të planit të veprimit. Matja dhe ecuria do të bëhet mbi baza 6-mujore dhe vjetore.

Për periudhën *janar – dhjetor 2024*, Ministri i Shtetit për Administratën Publike dhe Antikorrupsionin ka promovuar direkt dhe me ndërmjetësimin e tij pjesëmarrje në programe dhe emisione në radio dhe TV me qëllim rritjen e informimit publik kundër korrupsionit. Përmendet, pjesëmarrja në emisionin televiziv në datë 27.12.2024 të Ministrit të Shtetit për Administratën Publike dhe Antikorrupsionin, në RTSh, emisioni “Pa Censurë”⁸². Ministri Pirdeni evidentoi rolin dhe funksionin e DPAK në parandalimin e korrupsionit dhe në ndërmarrjen e masave sistematike për të adresuar sektorët më të ndjeshëm publikë në risk korrupsioni. Rëndësia e edukimit etik në sistemin arsimor, dhe bashkëpunimi me Ministrinë e Arsimit dhe Sportit, për të integruar në kurikulën parauniversitare elementë të dilemave morale etike dhe me elementë korruptivë. Tematika e emisionit mbetet synimi për të ndërtuar një kulturë integriteti që nga mosha e hershme, në mënyrë që qytetarët e ardhshëm të kenë vetëdije të lartë për shmangien e sjelljeve korruptive.

Në vitin 2024, çeli takimet projekti “Edukimi kundër korrupsionit”⁸³ në 12 shkolla të arsimit parauniversitar të mesëm, në Tiranë (6 shkolla) dhe në Durrës, Shkodër, Vlorë, Korçë dhe Vlorë (2 shkolla). Prej 11 prill - 2 maj, 2024 u zhvilluan 12 takime në shkollat “Qemal Stafa”, “Ismail Qemali”, “Petro Nini Luarasi”, “Asim Vokshi”, “Eqerem Cabej” dhe “Myslym Keta” në Tiranë, me nxënës të klasave të 10-ta. Takimet e projektit u zhvilluan pranë shkollave, “29 Nëntori” të Shkodrës, “Themistokli Gërmenji” në Korçë, “Halim Xhelo” dhe “Ali Demi” në Vlorë, “Asim Zeneli” në Gjirokastrë dhe “Naim Frashëri” në qytetin e Durrësit.

Nxënësit ishin partnerët e parë, të rinj, të përkushtuar, me dëshira e ide për të promovuar luftën kundër korrupsionit për forcimin e standardeve të integritetit në shoqëri. Nxënësit përmes takimeve patën mundësinë të takohen me ekspertë në fushën e luftës kundër korrupsionit nga të 3 institucionet nismëtare të marrëveshjes së bashkëpunimit, për kulturën e ligjshmërisë në shkolla dhe edukimin kundër korrupsionit, Ministria e Drejtësisë, e Arsimit dhe Sportit dhe të Ambasadës Italiane në Tiranë me trupat e misionit “Guardia di Finanza”.

Janë zhvilluar takime të posaçme prezantimi mbi eksperiencat e luftës kundër korrupsionit nga specialistë të fushës së drejtësisë dhe të antikorrupsionit. Java e Integritetit 2024 rezervoi një cikël të hapur leksionesh për integritetin dhe luftën kundër korrupsionit në auditoret studentore, disa-ditore përgjatë datave 4-12.12.2024. Ekspertë të fushës të ftuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Antikorrupsionit, funksionarë të nivelit të lartë drejtues, profesorë nga academia e media zhvilluan orë të hapura leksioni, me studentë të universiteteve publik të Tiranës, dhe pranë universiteteve jo-publike EPOKA e LUARASI.

Punonjësit e rinj në pritje të diplomimit të shkencave sociale, sociologji dhe punë sociale, u njohën me mekanizma të parandalimit të korrupsionit dhe zhvilluan një bisedë interaktive për mekanizma të denoncimit të korrupsionit; studentë të fakultetit të ekonomisë u njohën me mekanizmat antikorrupsion në funksion të procesit të integritetit; studentë të shkencave të komunikimit u njohën me rolin e etikës në komunikim; studentë të shkencave juridike pranë universiteteve jo-publike u

⁸² <https://www.youtube.com/watch?v=5NuzZBehXWM>.

⁸³ <https://www.drejtesia.gov.al/wp-content/uploads/2024/05/AK-Newsletter-Prill-2024.pdf> dhe <https://www.drejtesia.gov.al/wp-content/uploads/2024/06/AK-Newsletter-Maj-2024.pdf>.

njohën me instrumentet e integritetit dhe angazhimet antikorrupsion në kuadrin institucional. Këto takime ishin mekanizmi ndërgjegjësues proaktiv kundër korrupsionit për vitin 2024.

Në datat 17-31.11.2024, Drejtoria e Përgjithshme e Antikorrupsionit falë një bashkëpunimi me shoqërinë civile, organizatën ALTRI, zhvilloi një cikël leksionesh të hapura me universitetet e Tiranës, Durrësit e Shkodrës pranë fakulteteve juridike. Leksioni i parë u zhvillua më 17 tetor 2024 në Fakultetin e Drejtësisë të Universitetit të Tiranës, ku u diskutua mbi mekanizmat e luftës kundër korrupsionit në institucionet e administratës publike dhe roli kyç që luan Drejtoria e Përgjithshme e Antikorrupsionit, si i pari dhe i vetmi organ me kompetenca parandalimi në nivel ekzekutiv. Gjatë këtij aktiviteti u theksua rëndësia e strategjisë antikorrupsion si një dokument kyç dhe strategjik që bashkon të gjitha institucionet publike në luftën për të minimizuar dhe eliminuar korrupsionin. Pjesëmarrësit u njohën gjithashtu me procedurën e hetimit administrativ dhe me msat që merren nga drejtoria në përfundimin të hetimeve, duke sjellë një shembull të qartë të angazhimit institucional për të siguruar përgjegjëshmëri dhe trasparencë në administratën publike.

Në 25 tetor 2024 u zhvillua leksioni i dytë në fakultetin e Drejtësisë të Universitetit “Aleksandër Moisiu” në Durrës. Ky aktivitet solli diskutime të shumta dhe të thelluara mbi kompetencat dhe funksionet e Drejtorisë së Përgjithshme e Antikorrupsionit, veçanërisht në lidhje me parandalimin dhe luftën kundër korrupsionit.

Në datën 31 tetor 2024 në Fakultetin e Drejtësisë të Universitetit të Shkodrës “Luigj Gurakuqi”, ku pas një prezantimi mbi funksionet dhe rolin e drejtorisë, u diskutuan raste praktike të hetimit administrativ për krimin e korrupsionit në administratën publike. Gjatë këtij leksioni, studentët morën njohuri të rëndësishme, të dhëna statistikore të prodhuara nga DPAK, si dhe mbi përpjekjet e vazhdueshme për të krijuar një sistem më të mirë dhe më të drejtë për të parandaluar korrupsionin në administratën publike.

Në vitin 2024, Drejtoria e Përgjithshme e Antikorrupsionit ka pasur një ndërveprim të rregullt dhe aktiv me publikun dhe ndjekësit e rrjeteve sociale në dy platforma komunikimi Facebook dhe LinkedIn. Aktivitete për t’u kryer dhe aktivitete të kryera janë promovuar në këto platforma duke rritur komunikimin dhe shpërndarjen e të dhënave, si përkatësisht: <https://www.linkedin.com/company/88693364/admin/dashboard/>, <https://www.facebook.com/profile.php?id=100089045846232>.

Sa më sipër, masat dhe aktivitetet e parashikuara për këtë periudhë zbatimi, kanë ndikuar drejtpërdrejt në vlerën e synuar të treguesit të performancës 3.2.1. Drejtoria e Përgjithshme e Antikorrupsionit në bashkëpunim me ekspertë të fushës së arsimit kanë avancuar me takimet për promovimin e etikës dhe integritetit në shkolla, ndërkohë që dokumenti i vlerësimit për kurrikulën antikorrupsion vijon të përgatitet për t’u ndarë në 12 shkolla e arsimit parauniversitar në vend. Ky tregues performance mbetet në proces hartimi dhe vlera e arritur është në masën 50%.

Paraqitja e realizueshmërisë së treguesit sipas Pasaportës së Treguesve, paraqitet si vijon:

Vlerat Bazë	2023	
	N/A	
	2024	Përgatitja e metodologjisë së vlerësimit dhe vendosja e nivelit bazë për fillimin e matjes
	2025	5% rritje vjetore e numrit mesatat të shkollave ku kurrikula e etikës është zbatuar

	2026	10% rritje vjetore e numrit mesatat të shkollave ku kurrikula e etikës është zbatuar (kumulative)
	2027	15% rritje vjetore e numrit mesatat të shkollave ku kurrikula e etikës është zbatuar (kumulative)
	2028	20% rritje vjetore e numrit mesatat të shkollave ku kurrikula e etikës është zbatuar (kumulative)
	2029	25% rritje vjetore e numrit mesatat të shkollave ku kurrikula e etikës është zbatuar (kumulative)
	2030	30% rritje vjetore e numrit mesatat të shkollave ku kurrikula e etikës është zbatuar (kumulative)
Vlera synuar/ Targeti	2024 (targeti i synuar)	Përgatitja e metodologjisë së vlerësimit
	2024 (targeti i arritur)	Metodologji e draftuar, në proces për tu konkluduar

Niveli i realizimit të Objektivit 3.2

Niveli i realizimit të *Objektivit 3.2 “Edukimi i të rinjve mbi etikën, integritetin dhe angazhimin proaktiv në luftën kundër korrupsionit”*, në lidhje me realizimin e treguesit të performancës për periudhën janar-dhjetor 2024 është **50%**.

Përllogaritja është kryer duke matur dhe evidentuar përmbatjen dhe rekomandimet e raportit të paraprak të vlerësimit të kryer, në përputhje me parashkrimin e bërë në listën e treguesve të performancës, aneks 2 i Strategjisë Ndërsektoriale Kundër Korrupsionit, 2024-2030.

Shkalla e realizimit të objektivit 3.2 për këtë periudhë raportimi është **50%**.

Verifikueshmëria e të dhënave

Të dhënat e raportuara mbi treguesit e performancës janë bazuar në informacionin që administron dhe koordinon Drejtoria e Përgjithshme e Antikorrupsionit.

Risqet për realizimin e Objektivit 3.2

Për vitin 2024, realizimi i objektivit ka rezultuar në risk mesatar, e lidhur me konkludimin e programit të kurrikulës së etikës dhe integritetit, dhe nisjen nga zbatimi të saj në shkollat e arsimit parauniversitar.

3.3 Përfshirja e sektorit privat, organizatave të shoqërisë civile dhe akademisë me rol ndërgjegjësues luftën kundër korrupsionit.

Për këtë objektiv është përcaktuar 1 tregues performance:

3.3.1: *Përqindja e fushatave të përbashkëta kundër korrupsionit të institucioneve publike me sektorin privat, organizatat e shoqërisë civile, akademinë dhe median, nga mesatarja e regjistruar në tre vitet e fundit (trend rritës).*

Vlera e synuar për treguesin e performancës 3.3.1 për vitin 2024 është: Përgatitja e metodologjisë së vlerësimit dhe vendosja e nivelit bazë për fillimin e matjes.

Plani i veprimit për Objektivin 3.3 parashikon 9 aktivitete dhe 4 masa.

Për të arritur vlerat e treguesit në përputhje me pasaportën e treguesve të performancës dhe konkretisht me planin e veprimit 2024-2026, janë parashikuar aktivitetet (9) dhe masat (2) si më poshtë.

3.3.1	Përfshirja aktive dhe e zgjeruar e sektorit privat në luftën kundër korrupsionit
3.3.1.3	Përmirësimi i mekanizmave për raportimin dhe denoncimin e korrupsionit nga sektori privat, promovimi i mekanizmave dhe nxitja e sektorit privat dhe shoqatave (platforma bashkëpunimi)
3.3.2	Përfshirja aktive dhe e zgjeruar e organizatave të shoqërisë civile në luftën kundër korrupsionit
3.3.2.1	Ngritja e një Koalicioni Bashkëpunimi Kundër Korrupsionit midis KKKK dhe Rrjetit Kombëtar të OSHC-ve Kundër Korrupsionit si dhe OSHC-ve të tjera aktive të fushës
3.3.2.2	Forume konsultimi, të zhvilluara me OSHC për raportet dhe propozimet e politikave kundër korrupsionit
3.3.2.3	Përmirësimi i ndërveprimit midis autoriteteve publike dhe OSHC-ve mbështetur tek parimet e Partneritetit për Qeverisje të Hapur (OGP)
3.3.3	Përfshirja e akademisë në luftën kundër korrupsionit
3.3.3.1	Ngritja e një ekipi kërkuesish dhe ekspertësh nga radhët e universitetit, pedagogë, si bashkëpunëtorë të vazhdueshëm të DPAK
3.3.3.2	Konsultimi i rregullt i dokumenteve të politikave dhe raporteve me ekipin e ekspertëve nga akademia
3.3.3.3	Aktivitet vjetor, i rregullt, me pjesëmarrje të pedagogëve dhe ekspertëve nga akademia, për çështje lidhur me luftën kundër korrupsionit, etikën dhe mekanizma kundër korrupsionit
3.3.4	Përfshirja e medias dhe gazetarisë në luftën kundër korrupsionit
3.3.4.1	Ngritja e një Rrjeti të Gazetarisë Aktive të interesuar në politikat dhe mekanizmat e luftës kundër korrupsionit, si bashkëpunëtorë të KKKK
3.3.4.2	Takime periodike (3-mujore) me Rrjetin e Gazetarisë Aktive kundër Korrupsionit

Realizimi i masave të parashikuar kryhet përmes aktiviteteve të parashikuar për zbatim në vitin 2024 dhe disa prej tyre si: 3.3.1, 3.3.3 dhe 3.3.4 dhe disa prej aktiviteteve të tyre kanë afat zbatimi vetëm vitin 2024. Matja dhe ecuria do të bëhet mbi baza 6-mujore dhe vjetore.

Për janar – dhjetor 2024, janë zhvilluar disa forume bashkëpunimi me sektorin privat, nëpërmjet Dhomave të Bizneseve dhe shoqatave të bizneseve. Në 29.4.2024, Ministri i Shtetit për Administratën Publike dhe Antikorrupsionin, znj. Adea Pirdeni zhvilloi një takim me drejtues dhe përfaqësues të Dhomave të Tregtisë dhe shoqatat e biznesit, për të ridërguar ftesën ndaj partnerësve të sektorit privat për të raportuar dhe denoncuar raste korrupsioni në zyrat e administratës publike, të cilat ata marrin dhe shkëmbejnë shërbime. Praktikën e rasteve të korrupsionit në funksion të rritjes së standardit të integritetit dhe luftës antikorrupsion në institucionet shtetërore – sektorin privat, u evidentuan nga palët në këtë forum dhe duke promovuar ngritjen e një ekipi të përbashkët pune për të ndjekur angazhimet për rritjen e integritetit në sektorin publik dhe privat.

Në 23.7.2024, në prezencë të dy ministrave të shtetit, Pirdeni dhe Ibrahimaj, u zhvillua takimi me sektorin privat, i dyti për këtë vit me qëllim vendosjen e urave të bashkëpunimit dhe avancimin e vlerave të integritetit. Korrupsioni, në legjislacionin shqiptar konsiderohet një vepër penale që kërkon dy palë andaj edhe angazhimi për të pasur mekanizma për t'i denoncuar ato, mekanizma të sektorit publik dhe të sektorit privat, mbetet prioritet. Java e Integritetit, 2024, gjithashtu rezervoi evente dhe bashkëpunime me sektorin privat dhe bashkëorganizator i të cilit në këtë edicion ishte sërish ICC Albania.

Në vitin 2024, janë vetëm 3 raste denoncimi për korrupsion ardhur nga sektori privat, pranë DPAK. Ndërkohë pranë ADB, nëpërmjet platformës “Shqipëria që duam” janë administruar në total 20 ankesa, nga të cilat, 18 raste të raportuar nga qytetarët dhe vetëm 4 raste nga bizneset.

Koordinatori Kombëtar Kundër Korrupsionit ka avancuar me bashkëpunimin me organizata të shoqërisë civile, aktive në luftën kundër korrupsionit përgjatë vitit 2024. Matja e reformave kundër korrupsionit, vlerësimi i zbatimit të politikave, projekteve dhe programeve, përfshirja e OSHC-ve në tryeza vlerësimi të brendshme dhe me partnerët të huaj siç përmendet cikli i dytë i vlerësimit të Shqipërisë nga UNCAC, i zhvilluar në 9-11 tetor 2024, dhe bashkëpunimi në fushën e informimit, edukimit dhe ndërgjegjësimin promovuan konfigurimin e Rrjetit (koalicionit) me OSHC në luftën kundër korrupsionit. Drejtoria e Përgjithshme e Antikorrupsionit ka bashkëpunuar me iniciativën e organizatës ALTRI në hartimin e një metodologjie për matjen e perceptimit publik për nivelin e korrupsionit. Më 7 dhe 25 nëntor 2024 u zhvillua një takim pune me qëllim diskutimin e draftit të metodologjisë e cila, përmban rubrika vlerësimi të perceptimit mbi nismat antikorrupsion. OSHC-të dhe koalicioni që ato kanë ngritur mes tyre janë kthyer në auditorin bashkëpunues për DPAK dhe KKKK dhe të gatshme për të këmbyer dhe ndarë opinione profesionale, siç përmendet strategjia antikorrupsion 2024-2030 dhe raportet në kuadër të procesit të integritetit evropian (platforma PPIE). Gjithashtu, ky koalicion organizatash u kthye në bashkëpunëtorin e Komisionit Parlamentar “Për thellimin e reformave për mirëqeverisjen, sundimin e ligjit dhe antikorrupsionin për Shqipërinë 2030 në Bashkimin Evropian” në Kuvendin e Shqipërisë. Komponenti antikorrupsioni i këtij komisioni evidentoi një bashkëpunim të mirë dhe efektiv në hartimin e raportit të analizës dhe planit të veprimit.

Në vitin 2024, u vijua me takimet e Grupit Tematik Antikorrupsion nën drejtimin e Ministrit të Shtetit për Administratën Publike dhe Antikorrupsionin (Koordinator Kombëtar Kundër Korrupsionit). Në 23 maj 2024, u zhvillua takimi ku u miratua raporti i monitorimit 2023 për strategjinë antikorrupsion, dhe draft strategjia antikorrupsion 2024-2030. OSHC si pjesë e koalicionit antikorrupsion morrën pjesë në këtë takim⁸⁴.

Në vitin 2024, u konsolidua dhe u miratua Strategjia Ndërsektoriale Kundër Korrupsionit, 2024-2030⁸⁵. Dokumenti strategjik iu nënshtrua një procesi gjithëpërfshirës konsultimi, ku pjesë e këtij cikli ishte edhe shoqëria civile. Në takimin e datës 23.7.2024, auditori ishin OSHC, aktive të fushës. OSHC paraqitën komente në tryezë, të cilat u evidentuan në vijim dhe inkorporuar në tekstin e strategjisë. Gjithashtu, një tjetër përfshirje e tyre është edhe pjesëmarrja në takimin e ciklit të dytë të vlerësimit të Shqipërisë për UNCAC, në 10 tetor 2024. Ky ishte takimi i parë edhe në kuadër të zbatimit të Angazhimit të Transparencës (*Transparency Pledge*) të UNCAC, i nënshkruar në vitin 2023.

⁸⁴ <https://www.drejtesia.gov.al/wp-content/uploads/2024/06/AK-Newsletter-Maj-2024.pdf> dhe <https://www.facebook.com/share/p/1FvAR8RsnD/?mibextid=wwXlfr>.

⁸⁵ Miratuar me Vendim të Këshillit të Ministrave, nr. 859, datë 26.12.2024.

Në 3 tetor 2024, u zhvillua në Tiranë forumi rajonal mbi Qeverisjen e Mirë dhe Politikën Antikorrupsion, ku fokus special iu dha strategjisë ndërsektoriale kundër korrupsionit në administratën publike, në prezencë të drejtuesve të agjencive antikorrupsion të rajonit të Ballkanit Perëndimor⁸⁶.

Në 13 nëntor 2024, u zhvillua në Tiranë, Ministeriali i Qeverisjes së Hapur “Fuqizimi i Qeverisjes së Hapur: Takimi i OGP për Ballkanin Perëndimor 2024”, me pjesëmarrjen e ministrave nga rajoni dhe përfaqësues nga sektori publik (administratën publike) me OSHC të rajonit. Ministeriali (konferenca) i inicuar nga Ministri i Shtetit për Administratën Publike dhe Antikorrupsionin, solli në Tiranë sekretariatit e OGP për Evropën dhe Ballkanin dhe vendet e rajonit, 60 përfaqësues nga rajoni dhe vendet partnere, përfshirë institucionet qeveritare, shoqëria civile, akademikët dhe sektorin privat. Panele diskutimi për parimet e OGP ishin me një prezencë aktorësh dhe me role aktivë në administratën publike dhe në fushën civile⁸⁷.

Pranë DPAK, ka një forum dhe network me anëtarë nga akademia dhe universiteti, që luajnë një rol konsulentit dhe ofrojnë mendime dhe opinione për dokumente politikash dhe nisma në luftën kundër korrupsionit. Ky grup ekspertësh qëndrojnë të informuar për aktivitete dhe shpërndarje të raporteve të akteve të tjera, rregullisht dhe për çdo muaj nga DPAK. Grupi i ekspertëve nga akademia (pedagogë) u bënë pjesë e konsultimit të strategjisë së re antikorrupsionin në vitin 2024, dhe gjithashtu pjesë e dokumentit analitik të politikës pranë Kuvendit të Shqipërisë, në komponentin antikorrupsionit. Ekipi i ekspertëve nga akademia dhe shoqëria civile mund të gjendet i publikuar në link: <https://masl.al/antikorrupsioni/>.

Në vitin 2024, KDIMDP ka vijuar me zhvillimin e takimit periodik vjetor të Zyrës së Komisionerit me gazetarët lidhur me veprimtarinë e kësaj të fundit dhe problematikat e konstatuara në zbatimin e ligjit për të drejtën e informimit për vitin 2024.

Aktivitetet 3.3.3.3 dhe 3.3.4.1 mbetet të pazbatuara për këtë periudhë monitorimi.

Sa më sipër, masat dhe aktivitetet e parashikuara për këtë periudhë zbatimi, kanë ndikuar drejtpërdrejt në vlerën e synuar të treguesit të performancës 3.3.1. Drejtoria e Përgjithshme e Antikorrupsionit ka të hartuar një dokument vlerësimi për mënyrën sesi duhet të bëjë bashkë këta partnerë (sektor privat, shoqëri civile, akademinë) për të realizuar ndërhyrje me fokus bashkëpunimin dhe informimin kundër korrupsionit. Ky tregues performance është realizuar në masën 100%.

Paraqitja e realizueshmërisë së treguesit sipas Pasaportës së Treguesve, paraqitet si vijon:

Vlerat Bazë	2023	
	N/A	
	2024	Përgatitja e metodologjisë së vlerësimit dhe vendosja e nivelit bazë për fillimin e matjes
	2025	5% rritje e numrit të fushatave të përbashkëta kundër korrupsionit të ndërmarra nga autoritetet publike me sektorin privat, organizatat e shoqërisë civile, akademisë dhe media
	2026	10% rritje e numrit të fushatave të përbashkëta kundër korrupsionit të ndërmarra nga autoritetet

⁸⁶ <https://www.facebook.com/share/p/1Srnie7oT2/?mibextid=wwXlfr>.

⁸⁷ <https://www.facebook.com/share/p/15K5NNH4Nb/?mibextid=wwXlfr>.

		publike me sektorin privat, organizatat e shoqërisë civile, akademisë dhe media (kumulative)
	2027	15% rritje e numrit të fushatave të përbashkëta kundër korrupsionit të ndërmarrë nga autoritetet publike me sektorin privat, organizatat e shoqërisë civile, akademisë dhe media (kumulative)
	2028	20% rritje e numrit të fushatave të përbashkëta kundër korrupsionit të ndërmarrë nga autoritetet publike me sektorin privat, organizatat e shoqërisë civile, akademisë dhe media (kumulative)
	2029	25% rritje e numrit të fushatave të përbashkëta kundër korrupsionit të ndërmarrë nga autoritetet publike me sektorin privat, organizatat e shoqërisë civile, akademisë dhe media (kumulative)
	2030	30% rritje e numrit të fushatave të përbashkëta kundër korrupsionit të ndërmarrë nga autoritetet publike me sektorin privat, organizatat e shoqërisë civile, akademisë dhe media (kumulative)
	2024 (targeti i synuar)	Përgatitja e metodologjisë së vlerësimit
Vlera synuar/ Targeti	2024 (targeti i arritur)	Metodologji e hartuar

Niveli i realizimit të Objektivit 3.3

Niveli i realizimit të *Objektivit 3.3. Përfshirja e sektorit privat, organizatave të shoqërisë civile dhe akademisë me rol ndërgjegjësues luftën kundër korrupsionit*, në lidhje me realizimin e treguesit të performancës për periudhën janar-dhjetor 2024 është **100%**.

Përllogaritja është kryer duke matur dhe evidentuar përmbatjen dhe rekomandimet e raportit paraprak të vlerësimit të kryer, në përputhje me parashkimin e bërë në listën e treguesve të performancës, aneks 2 i Strategjisë Ndërsektoriale Kundër Korrupsionit, 2024-2030.

Shkalla e realizimit të objektivit 3.3 për këtë periudhë raportimi është **100%**.

Verifikueshmëria e të dhënave

Të dhënat e raportuara mbi treguesit e performancës janë bazuar në informacionin që administron dhe koordinon Drejtoria e Përgjithshme e Antikorrupsionit.

Risqet për realizimin e Objektivit 3.3

Për vitin 2024, realizimi i objektivit ka rezultuar në risk mesatar, e lidhur me marrjen e masave dhe aplikimin e rregullt të bashkëpunimit me grupet e përmendura të interesit për fushatat e ndërgjegjësimit.

3.4 Forcimi i pjesëmarrjes së grave për të identifikuar dhe luftuar korrupsionin në nivele dhe sektorë të ndryshëm.

Për këtë objektiv është përcaktuar 1 tregues performance:

3.4.1: *Raporti i numrit i projekteve kundër korrupsionit me orientim gjinor në krahasim me numrin tyre në tre vitet e fundit.*

Vlera e synuar për *treguesin e performancës 3.4.1* për vitin 2024 është: Përgatitja e metodologjisë së vlerësimit dhe vendosja e nivelit bazë për fillimin e matjes.

Plani i veprimit për Objektivin 3.4 parashikon 2 aktivitete dhe 2 masa.

Për të arritur vlerat e treguesit në përputhje me pasaportën e treguesve të performancës dhe konkretisht me planin e veprimit 2024-2026, janë parashikuar aktivitetet (2) dhe masat (2) si më poshtë.

3.4.1	Përfshirja e komponentit gjinor në termat e referencës dhe përcaktimi i një buxheti specifik për projektet e integritetit dhe të antikorrupsionit, të shpallura nga AMSHC
3.4.1.1	Tryezë vjetore me pjesëmarrje gratë dhe vajzat mbi rolin e tyre dhe angazhimin në forcimin e integritetit të administratës publike dhe luftën kundër korrupsionit
3.4.2	Organizimi i aktiviteteve komunikuese dhe ndërgjegjësuere me palë të interesuara me fokus perspektivën gjinore në forcimin e integritetit dhe luftën kundër korrupsionit
3.4.2.1	Veprimtari kundër korrupsionit të qytetareve/qytetarëve, aktivisteve/aktivistëve të të drejtave të njeriut dhe grupeve të interesit të grave dhe vajzave si pjesë përbërëse e kalendarit të aktiviteteve gjatë “Javës së Integritetit”

Realizimi i masave të parashikuar kryhet përmes aktiviteteve të parashikuar për zbatim në vitin 2024 dhe që vijojnë edhe përgjatë viteve të tjera të zbatimit të planit të veprimit. Matja dhe ecuria do të bëhet mbi baza 6-mujore dhe vjetore.

Për janar – dhjetor 2024, Koordinatori Kombëtar Kundër Korrupsionit finalizoi Strategjinë Ndërsektoriale Kundër Korrupsionit, 2024-2030 dhe planin e veprimit për vitet 2024-2026. Duke qenë një risi përfshirja e qasjes gjinore dhe rolit të grave në nismat antikorrupsion, përmendet pjesëmarrja e organizatës UN Women Albania në takimet e konsultimit të strategjisë dhe ndarjen dhe komunikimin e një dokumenti me komente dhe sugjerime për t’u përfshirë në të. Në korrik 2024, u diskutua në një platformë (forum) online dokumenti *Masat Antikorrupsion - Udhëzues për integrimin gjinor*⁸⁸, në prezencë të përfaqësuesve të Koordinatorit Kombëtar Kundër Korrupsionit dhe drejtuesve të Drejtorisë së Përgjithshme të Antikorrupsionit. Dokumenti i ndarë parashikon masat për ndërhyrje në aktivitete me përfshirjen specifike për rolin e grave në luftën kundër korrupsionit.

Në vitin 2024, ndër aktivitetet e fushatës vjetore Java e Integritetit, në konferencën hapëse të saj, Forcimi i integritetit përmes edukimit, kërkimit dhe digjitalizimit, organizatat e grave ishin pjesëmarrëse aktive dhe përbënë auditorin e posaçëm të saj.

Aktiviteti 3.4.1.1 mbetet i pazbatuar për këtë periudhë monitorimi.

Sa më sipër, përpos të dhënave për masa dhe aktivitete të zbatuara gjatë vitit 2024, mungojnë ende të dhënat për raporte projektsh dhe projekte të zbatuara, kundër korrupsionit, me orientim gjinor, për të vlerësuar treguesin e performancës 3.4.1. Ky tregues performance nuk është realizuar.

⁸⁸ https://albania.unwomen.org/sites/default/files/2024-03/web_masat_kunder_korrupsionit_final_09082023.pdf.

Paraqitja e realizueshmërisë së treguesit sipas Pasaportës së Treguesve, paraqitet si vijon:

Vlerat Bazë	2023	
	N/A	
	2024	Përgatitja e metodologjisë së vlerësimit dhe vendosja e nivelit bazë për fillimin e matjes
	5% rritje vjetore e projekteve kundër korrupsionit me bazë gjinore	5% rritje vjetore e projekteve kundër korrupsionit me bazë gjinore
	10% rritje vjetore e projekteve kundër korrupsionit me bazë gjinore (kumulative)	10% rritje vjetore e projekteve kundër korrupsionit me bazë gjinore (kumulative)
	15% rritje vjetore e projekteve kundër korrupsionit me bazë gjinore (kumulative)	15% rritje vjetore e projekteve kundër korrupsionit me bazë gjinore (kumulative)
	20% rritje vjetore e projekteve kundër korrupsionit me bazë gjinore (kumulative)	20% rritje vjetore e projekteve kundër korrupsionit me bazë gjinore (kumulative)
	25% rritje vjetore e projekteve kundër korrupsionit me bazë gjinore (kumulative)	25% rritje vjetore e projekteve kundër korrupsionit me bazë gjinore (kumulative)
	30% rritje vjetore e projekteve kundër korrupsionit me bazë gjinore (kumulative)	30% rritje vjetore e projekteve kundër korrupsionit me bazë gjinore (kumulative)
Vlera synuar/ Targeti	2024 (targeti i synuar)	Përgatitja e metodologjisë së vlerësimit
	2024 (targeti i arritur)	Mungon metodologjia

Niveli i realizimit të Objektivit 3.4

Niveli i realizimit të *Objektivit 3.4. Forcimi i pjesëmarrjes së grave për të identifikuar dhe luftuar korrupsionin në nivele dhe sektorë të ndryshëm*, në lidhje me realizimin e treguesit të performancës për periudhën janar-dhjetor 2024 është **0%**.

Përlllogaritja është kryer duke matur dhe evidentuar përmbatjen dhe rekomandimet e raportit të paraprak të vlerësimit të kryer, në përputhje me parashkimin e bërë në listën e treguesve të performancës, aneks 2 i Strategjisë Ndërsektoriale Kundër Korrupsionit, 2024-2030.

Shkalla e realizimit të objektivit 3.4 për këtë periudhë raportimi është **0%**.

Verifikueshmëria e të dhënave

Të dhënat e raportuara mbi treguesit e performancës janë bazuar në informacionin që administron dhe koordinon Drejtoria e Përgjithshme e Antikorrupsionit.

Risqet për realizimin e Objektivit 3.4

Për vitin 2024, realizimi i objektivit ka rezultuar në risk të lartë si pasojë e moszbatimit të aktivitetit që ndikon në arritjen e vlerës së synuar të treguesit të performancës dhe si pasojë edhe të rezultatit të objektivit.

Realizueshmëria e objektivave specifike të qëllimit strategjik për ndërgjegjësimin e qytetarëve kundër korrupsionit

Mbështetur në të dhënat e raportuara nga institucionet përgjegjëse për administrimin dhe përpunimin e të dhënave të treguesve të performancës tabela më poshtë paraqet shkallën e realizimit të 4 objektivave specifike të qëllimit strategjik për ndërgjegjësimin dhe edukimin e qytetarëve kundër korrupsionit.

Duke aplikuar të njëjtën formulë të nxjerrjes së shkallës së realizimit të objektivave - duke mbledhur realizueshmërinë në përqindjes të treguesve të performancës dhe pjesuar me numrin e treguesve – realizueshmëria e qëllimit strategjik për ndërgjegjësimin e korrupsionit është 62.5%.

Objekti	Realizueshmëria
3.1. Rritja e ndërgjegjësimit të qytetarëve për pasojat negative të korrupsionit dhe nxitja e tyre për të kundërshtuar, denoncuar dhe raportuar korrupsionin	100%
3.2. Edukimi i të rinjve mbi etikën, integritetin dhe angazhimin proaktiv në luftën kundër korrupsionit	50%
3.3. Përfshirja e sektorit privat, organizatave të shoqërisë civile dhe akademisë me rol ndërgjegjëses luftën kundër korrupsionit	100%
3.4 Forcimi i pjesëmarrjes së grave për të identifikuar dhe luftuar korrupsionin në nivele dhe sektorë të ndryshëm	0%

Realizueshmëria e qëllimit strategjik për ndëshkimin e korrupsionit, e cila është në masën 62.5%, tregon për një rezultat të mirë përgjatë periudhës janar – dhjetor 2024.

Si rezultat, u ndërmorën një sërë aktivitete me synim ndërgjegjësimin dhe edukimin e publikut për pasojat e korrupsionit dhe nxitjen e pjesëmarrjes aktive në parandalimin dhe raportimin e tij. U hartua Plani i Komunikimit dhe Vizibilitetit antikorrupsion për vitin 2024, i cili përfshinte 15 aktivitete ndërgjegjëse, me fokus edukimin e të rinjve dhe përfshirjen e publikut të gjerë përmes aktiviteteve në shkolla, universitete, media, rrjete sociale dhe përmes e-buletinit mujor “Antikorrupsioni”. U organizua me sukses edicioni i VI-të i Javës së Integritetit, një fushatë kombëtare ndër-institucionale që përfshiu leksione të hapura, forume, konferenca dhe aktivitete ndërgjegjëse me përfshirjen e aktorëve institucionalë, akademikë, shoqërisë civile dhe sektorit privat.

Përmes projekteve si “Edukimi kundër korrupsionit” dhe bashkëpunimit me Ministrinë e Arsimit dhe Ambasadës Italiane në Tiranë nëpërmjet përfshirjes së ekipeve të Guardia di Finanza, u zhvilluan takime informuese në shkollat parauniversitare dhe universitete, me theks në ndërtimin e një kulture integriteti që në moshë të hershme. U konsoliduan marrëdhëniet me shoqërinë civile dhe u avancua bashkëpunimi me sektorin privat dhe akademinë, përmes forumeve konsultative, pjesëmarrjes në proceset strategjike dhe vlerësuese, si dhe hartimit të metodologjive për matjen e

perceptimit mbi korrupsionin. Një hap i rëndësishëm ishte integrimi i qasjes gjinore në politikat antikorrupsion, ku për herë të parë u përfshinë organizatat e grave në hartimin e strategjisë 2024–2030 dhe në promovimin e rolit të tyre në luftën kundër korrupsionit.

Këto zhvillime të objektivëve 3.1-3.4, dëshmojnë një qasje gjithëpërfshirëse dhe të koordinuar në rritjen e ndërgjegjësimit publik si një shtyllë thelbësore e strategjisë.

IV. PROGRESI LIDHUR ME OBJEKTIVAT, REZULTATET DHE IMPAKTIN

4.1 Vlerësimi i arritjeve kryesore duke përdorur treguesit

Mbështetur në informacionin mbi vlerat e synuar të aktiviteteve dhe masave të realizuara, të treguesve të performances, realizimi i objektivave për *janar - dhjetor 2024* është si më poshtë.

Realizimi sipas aktiviteteve/masave	Realizimi sipas treguesve ⁸⁹
Mjaftueshëm - 2 objektiva	Dobët - 1 objektivë
Mirë - 4 objektiva	Mjaftueshëm - 2 objektivë
Shumë mirë - 7 objektiva	Shumë mirë - 12 objektiva
Nuk maten sepse nuk ka masa për zbatim – 3 objektiva	

Histori suksesi (përmes masave prioritare)

Arritjet kryesore më të rëndësishme për periudhën *janar - dhjetor 2024*, në zbatim të Planit të Veprimit 2024 - 2026, të Strategjisë Ndërsektoriale Kundër Korrupsionit, mbështetur në realizueshmërinë e masave prioritare evidentuar në pjesën III të saj, janë si më poshtë vijon:

1. Gjatë vitit 2024, u hartua një analizë gjithëpërfshirëse e kuadrit ligjor dhe institucional ekzistues në fushën e antikorrupsionit, e cila synon të orientojë përgatitjen e projektligjeve të reja për sinjalizimin e rasteve të korrupsionit, konfliktin e interesave dhe rikuperimin e aseteve të përfituara në mënyrë të paligjshme.
2. Gjatë vitit 2024, janë ngritur dhe funksionojnë 734 Njësi Përgjegjëse për sinjalizimin në sektorin publik dhe privat. Ka filluar procesi paraprak i rishikimit të ligjit për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve, dhe me qëllim përafrimin me Direktivën e BE.
3. Gjatë vitit 2024, në funksion të krijimit të një arkitekture funksionale për parandalimin e korrupsionit, u ngrit rrjeti kombëtar i pikave të kontaktit antikorrupsion në 119 institucione publike, në nivel qendror dhe vendor.
4. Gjatë vitit 2024, të gjitha ministratë dhe ministrat e shtetit rishikuan e miratuan Planet e Integritetit dhe caktuan koordinatorët përkatës, ndërsa numri i bashkive me plane integriteti të miratuara u rrit në 28.
5. Gjatë vitit 2024, numri i hetimeve të filluara nga Prokuroria e Posaçme mbështetur tek referimet e institucioneve publike është 24 (ndërkohë që për vitin 2023 ishte 12), duke shënuar trend rritës

⁸⁹ Objektivi specifik 1.3 është në pamundësi matjeje për shkak të dy vlerës së synuar të indikatorëve të tij.

(dyfishim). Krahasuar me vitin 2023, numri i procedimeve të nisura në raport me referimet e ardhura nga shtetasit është rritur në masën rreth 36%.

6. Gjatë vitit 2024, në fushën penale, Prokuroria e Posaçme përmbylli 186 çështje për korrupsion.

7. Gjatë vitit 2024, u hodhën themelet për funksionimin e Zyrës së Rikuperimit të Aseteve me bazë ligjore të përafruar me direktivat e BE-së.

8. Gjatë vitit 2024, forcimi i strukturave të Policisë së Shtetit dhe trajnimi i vazhdueshëm i oficerëve dhe prokurorëve (mbi 100 aktivitete trajnuese) kanë kontribuar ndjeshëm në rritjen e efektivitetit të ndjekjes penale dhe bashkëpunimit ndërkombëtar përmes ngritjes së 10 skuadrave të përbashkëta hetimore të Prokurorisë së Posaçme.

9. Gjatë vitit 2024, forcimi i mekanizmave institucionalë për ndjekjen e rasteve të korrupsionit u konkretizua me krijimin e Drejtorisë së Përgjithshme të Antikorrupsionit, një strukturë qendrore e posaçme me mandat për hetimin administrativ, e cila administroi 163 ankesa dhe finalizoi hetime për 7 raste, dhënë 6 masa administrative dhe 16 rekomandime.

10. Gjatë vitit 2024, përmes një qasjeje gjithëpërfshirëse dhe të koordinuar ndërinstitutionale, u organizuan mbi 15 aktivitete informuese e sensibilizuese në kuadër të Planit të Komunikimit dhe Vizibilitetit Antikorrupsion, me fokus në edukimin qytetar dhe përfshirjen e të rinjve.

11. Gjatë vitit 2024, u zhvilluan leksione të hapura, aktivitete në shkolla e universitete, fushata në rrjetet sociale dhe u përgatit dhe u shpërnda në mënyrë të rregullt buletini elektronik “Antikorrupsioni”.

12. Gjatë vitit 2024, një nga momentet kulmore ishte organizimi i edicionit VI-të të Javës së Integritetit dhe zhvillimi i projektit “Edukimi kundër korrupsionit” në bashkëpunim me Ministrinë e Arsimit dhe Ambasadën Italiane në Tiranë nëpërmjet Guardia di Finanza, në kultivimin e një kulture integriteti në moshë të hershme.

4.2 Vlerësimi i sfidave, boshllëqeve dhe joefikasitetit

Mbështetur në rezultatet e monitorimit të kryer për periudhën 1 janar - 31 dhjetor 2024, rezulton se mbështetur në ecurinë e zbatimit të Strategjisë Ndërsektoriale Kundër Korrupsionit dhe të angazhimeve të Planit të Veprimit për vitin 2024, rezulton se:

- Sfida në përmbushjen e parashikimeve ligjore janë:

Pavarësisht përgatitjes së një analize gjithëpërfshirëse të kuadrit ekzistues ligjor dhe institucional kundër korrupsionit, procesi i miratimit të projektligjeve të reja për sinjalizimin, konfliktin e interesave dhe rikuperimin e asetëve nuk u përmbyll brenda vitit 2024. Analizat e vlerësimit për secilën prej tyre duhet të ndjekin prioritizimin e proceseve dhe ndërhyrjeve të planifikuara për të garantuar harmonizimin e legjislacionit me rekomandimet e GRECO-s dhe standardet e BE-së, dhe për pasojë miratimin e tyre në afat, deri në vitin 2027.

- Sfida në hartimin dhe zbatimin praktik të instrumenteve të integritetit janë:

Miratimi dhe/ose rishikimi i planeve të integritetit në të gjitha ministritë dhe në 28 bashki përbën një hap pozitiv dhe domethënës drejt institucionalizimit të standardeve të integritetit. Megjithatë, zbatimi i qëndrueshëm i këtyre planeve në praktikë mbetet një proces në zhvillim. Niveli i

angazhimit, burimeve dhe kapaciteteve institucionale, veçanërisht në nivel vendor, nuk është i njëtrajtshëm dhe paraqet problematika referuar procesit të vlerësimit të riskut real dhe faktorëve të tij të brendshëm. Në disa raste, nevojitet forcim i mëtejshëm i mekanizmave të brendshëm të monitorimit, trajnimi i stafit dhe instrumente më të qarta për matjen e performancës, në mënyrë që planet të shndërrohen plotësisht në mjete efektive për parandalimin e korrupsionit. Nga ana tjetër, vlerësohet të trajtohet me kujdes monitorimi i zbatimit të planeve të integritetit mbështetur mbi baza faktike zbatimi (evidenca dhe prova).

- *Nevoja për forcim të koordinimit dhe matjes së impaktit të ndërgjegjësimit janë:*

Aktivitetet ndërgjegjëse të realizuara gjatë vitit, siç përmendet Java e Integritetit dhe projektet edukative me të rinjtë, dhe komunikimi dhe vizibiliteti antikorrupsion kanë shënuar një përfshirje të gjerë institucionale dhe publike. Megjithatë, mbetet e nevojshme ndërtimi i një sistemi të standardizuar për matjen e ndikimit të këtyre ndërhyrjeve në perceptimin publik dhe në sjelljen qytetare. Po ashtu, ndërtimi i një platforme të përbashkët ndërinstitutionale për komunikimin antikorrupsion do të ndihmonte në përmirësimin e koordinimit të mesazheve, ndarjen e praktikave të mira dhe përf forcimin e pjesëmarrjes së qytetarëve në mënyrë më të strukturuar.

Si përfundim, mbështetur në këto sfidave të evidentuara, viti i dytë i zbatimit të Strategjisë Ndërsektoriale Kundër Korrupsionit dhe planit të saj të veprimit, duhet të fokusohet në përmirësimin e bashkëpunimit ndërinstitutional dhe adresimin e boshllëqeve të mbetura ligjore e strukturore. Prioritet duhet t'i jepet finalizimit të reformave ligjore të planifikuara, fuqizimit të kapaciteteve zbatuese në nivel vendor, standardizimit të mekanizmave të monitorimit të brendshëm dhe matjes së impaktit, si dhe institucionalizimit të një qasjeje të qëndrueshme për ndërgjegjësimin publik. Këto ndërhyrje janë thelbësore për të garantuar funksionimin e plotë dhe të koordinuar të sistemit antikorrupsion, si dhe për të forcuar besimin publik ndaj institucioneve.

4.3 Konkluzione dhe rekomandime

Ky raport monitorimi është në përputhje me strukturën e dokumenteve strategjike sektorialë dhe ndërsektorialë për agjendën e mirëqeverisjes në kuadër të programimit IPSIS. Raporti jep një informacion mbi zbatueshmërinë e qëllimeve të politikës (qasjeve të strategjisë), të objektivave specifike të strategjisë, të realizueshmërisë së treguesve të performancës sipas vlerave të synuara dhe ato të arritura, të zbatueshmërisë së masave (produkte) të parashikuara për arritjen e këtyre objektivave e të aktiviteteve konkrete të parashikuara. Raporti jep një informacion specifik mbi realizueshmërinë e masave prioritare të planit të veprimit, problematika të hasura gjatë zbatimit, sfidat e institucioneve si dhe një identifikim të masave të nevojshme korrigjuese për periudhat në vijim.

Raporti i monitorimit *janar – dhjetor 2024*, përmban të dhëna statistikore dhe analitike bazuar mbi evidenca të matshme dhe të verifikueshme, mbi raportimin e drejtpërdrejtë të institucioneve zbatuese, mbi raporte dhe informacione të publikuara, konsultim me të gjithë faktorët (zbatues dhe vlerësues të procesit) e të dhëna mbi raport progresin e treguesve mbi baza krahasimore për çdo objektiv të strategjisë.

Në përfundim të këtij raporti, rekomandimet për ndjekje dhe përmirësim procesi dhe zbatimi të masave antikorrupsion janë:

1. Planifikimi i kujdesshëm dhe me afate i miratimit të projektligjeve të planifikuara, përfshirë ligjin për sinjalizimin, konfliktin e interesave dhe rikuperimin e aseteve, me qëllim përmbushjen e afateve të përcaktuara strategjike dhe përafrimin me standardet ndërkombëtare.

2. Fuqizimi i kapaciteteve institucionale në nivel vendor, përmes trajnimeve të dedikuara, mbështetjes teknike dhe instrumenteve të matjes së zbatimit të planeve të integritetit në bashki dhe institucione të tjera vendore. AMVV duhet të rrisë kapacitetet e saj dhe ndërveprimin me njësitë e vetëqeverisjes vendore (bashkitë) për më shumë koordinim dhe bashkërendim referuar instrumenteve të integritetit.

3. Zhvillimi i një metodologjie të unifikuar për matjen e riskut të korrupsionit në sektorin publik, me qasje sektoriale dhe të shënjestruar për raste korrupsioni, si dhe ngritja e kapaciteteve teknike profesionale për vlerësimin dhe zbatimin e saj.

4. Standardizimi i procedurave për hetimin administrativ, dhe forcimi i bashkëpunimit ndërinstitutional për ndarjen e qartë të kompetencave, përfshirjen e institucioneve të pavarura dhe ndjekjen e zbatimit të rekomandimeve, nëpërmjet miratimit të një akti rregullator për Drejtorinë e Përgjithshme të Antikorrupsionit.

5. Përmirësimi i sistemit të monitorimit të brendshëm të strategjisë antikorrupsion, përmes indikatorëve të matshëm dhe të lidhur drejtpërdrejt me rezultatet e pritshme, duke garantuar transparencë dhe llogaridhënie në çdo fazë të zbatimit të strategjisë.

6. Kujdes dhe planifikim më i mirë në parashikimin e buxhetit të përdorur të strategjisë, për të siguruar një vlerësim të impaktit financiar që zbatimi i planit të veprimit sjell për politikat antikorrupsion.

V. RISQET DHE HAPAT PËR TU ADRESUAR

5.1 Vlerësimi i riskut duke përdorur dhe treguesit

Në këtë raport monitorimi, *janar - dhjetor 2024*, është kryer vlerësimi i riskut për çdo objektiv në përputhje me analizën e riskut të sjellë prej institucioneve përgjegjëse ose në mungesë të kësaj analize, të vlerësimit që vetë stafi i Drejtorisë së Përgjithshme Antikorrupsion i ka bërë riskut në përputhje me nivelin e realizueshmërisë së objektivave.

Një listë të risqeve potenciale për vijimësinë e zbatimit të Strategjisë Ndërsektoriale Kundër Korrupsionit, të strukturuar sipas natyrës së tyre mund të jenë:

Risqe ligjore dhe rregullatore

Vonesat e mundshme në miratimin e projektligjeve kyçe (sinjalizimi, konflikti i interesave, rikuperimi i aseteve) mund të ndikojnë në mospërmbushjen e afateve strategjike dhe në mosrespektimin e rekomandimeve ndërkombëtare.

Risqe institucionale dhe operacionale

Mungesa e kapaciteteve institucionale, veçanërisht në nivel vendor, mund të ndikojë në përgatitjen dhe zbatimin real të planeve të integritetit dhe operacjonalitetin e rrjetit të pikave të kontaktit antikorrupsion.

Risqe në bashkëpunimin ndërinstitutional

Nivel i pabarabartë i angazhimit dhe koordinimit ndërmjet institucioneve mund të çojë në zbatime të fragmentuara ose jo të harmonizuara të masave të strategjisë.

Mospërfshirja aktive e institucioneve të pavarura, shoqërisë civile dhe sektorit privat në procesin e zbatimit mund të dobësojë legjitimitetin dhe efektivitetin e qasjes gjithëpërfshirëse.

5.2 Hapat e radhës

Në përmbyllje të këtij raporti monitorimi për periudhën për periudhën *janar-dhjetor 2024* të gjetjeve që ky dokument na ofron, të të dhënave analitike që institucionet kanë raportuar dhe të analizës së kryer, adresohen të ndërmerren këto hapa në vijim:

Së pari, është prioritet përfundimi i procesit të hartimit dhe miratimit të projektligjeve të planifikuara, përfshirë ligjin për sinjalizimin, ligjin për konfliktin e interesave dhe ligjin për rikuperimin e aseteve, si edhe përgatitja e kuadrit ligjor për lobimin. Këto instrumente janë thelbësore për të garantuar bazën ligjore të nevojshme për zbatimin efektiv të masave të strategjisë dhe për të forcuar koherencën me standardet ndërkombëtare.

Së dyti, të vijojë forcimi i rrjetit të pikave të kontaktit antikorrupsion dhe mbështetja për zbatimin e planeve të integritetit, me fokus të veçantë tek njësitë e qeverisjes vendore. Do të intensifikohen përpjekjet për rritjen e kapaciteteve administrative dhe burimeve për zbatimin e masave të integritetit, duke promovuar përfshirjen e këtyre instrumenteve në planifikimin dhe menaxhimin institucional të përditshëm.

Së treti, është e nevojshme ngritja e një mekanizmi të qendrueshëm për monitorimin dhe matjen e impaktit të zbatimit të strategjisë përfshirë një platformë të përbashkët ndërinstitutionale për komunikimin publik, edukimin qytetar dhe ndërveprimin me shoqërinë civile dhe sektorin privat.

Së katërti, të thellohet bashkëpunimi me partnerët ndërkombëtarë për ngritjen e kapaciteteve të strukturave hetimore dhe për ndjekjen administrative e penale të korrupsionit, duke garantuar zbatimin e standardeve të drejtësisë dhe luftës kundër korrupsionit.

Dhe së fundi, të vijojë përmirësimi i mekanizmave të brendshëm të monitorimit dhe raportimit, duke theksuar përdorimin e indikatorëve të matshëm të performancës dhe vlerësimin cilësor të impaktit, në mënyrë që strategjia të jetë një dokument i gjallë dhe i orientuar drejt rezultateve konkrete.

Aneks 1: Metodologjia e monitorimit

1.1.1 Koordinimi institucional për hartimin e Raportit të Monitorimit dhe Performancës

Në zbatim të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.436, datë 26.06.2024 dhe Urdhrit të Kryeministrit Nr.146, datë 01.08.2024, është miratuar struktura dhe organika e Drejtorisë së Përgjithshme të Antikorrupsionit dhe është ngritur Sektori i Monitorimit dhe Koordinimit të Politikave Prioritare, pranë Drejtorisë së Zbatimit të Politikave në Fushën Antikorrupsion, në Drejtorinë e Përgjithshme të Antikorrupsionit, e cila është struktura përgjegjëse për procesin monitorues dhe për hartimin e raporteve periodike të monitorimit të Strategjisë Ndërsektoriale Kundër Korrupsionit, 2024 - 2030.

Drejtorja e Përgjithshme e Antikorrupsionit kryen koordinimin dhe organizimin e takimeve me të gjitha institucionet kontribuese, si dhe më pas vijon me hartimin e raportit të monitorimit. Raporti i monitorimit për zbatimin e SNKK, për periudhën *1 janar deri më 31 dhjetor 2024* është hartuar mbi bazën e kontributit të dhënë nga institucionet përgjegjëse të planit të veprimit dhe informacioneve të administruara nga njësia e monitorimit (Sektori i Monitorimit dhe Koordinimit të Politikave Prioritare).

1.1.2 Periodiciteti i hartimit të Raportit të Monitorimit dhe Performancës

Drejtorja e Përgjithshme e Antikorrupsionit harton raporte gjashtëmujore dhe vjetore për monitorimin dhe raportimin e strategjisë antikorrupsion, të cilët do të prodhojnë informacion të nevojshëm dhe në kohë për politikëbërësit mbi progresin e zbatimit të masave që janë parashikuar në planin e veprimit të SNKK-së në vijueshmëri.

1.1.3 Manuali i Raportimit sipas sistemit IPSIS

Drejtorja e Përgjithshme e Antikorrupsionit harton raportin e monitorimit dhe të performancës për periudhën përkatëse sipas manualit të hedhjes së të dhënave në sistemin IPSIS⁹⁰. Sipas këtij dokumenti strategjik, secili institucion raporton mbi nivelin e zbatimit të çdo objektivi dhe mase, mbi buxhetin e caktuar, problemet e hasura dhe vlerësimin e progresit të strategjisë në përgjithësi. Bashkërendimi për respektimin e manualit të hedhjes së të dhënave në sistemin IPSIS do të kryhet me Agjencinë SASPAC.

1.1.4 Përputhshmëria e raporteve të monitorimit dhe performancës me parimet e Mirëqeverisjes

Drejtorja e Përgjithshme e Antikorrupsionit harton raportin e monitorimit dhe të performancës për periudhën përkatëse në përputhje me parimet e mirëqeverisjes.

Parimet e Mirëqeverisjes përmbajnë një kornizë të vlerësimit të Raporteve të Monitorimit dhe të Performancës e cila mundëson analizën e rregullt të progresit të arritur në zbatimin e Parimeve dhe caktimin e standardeve që duhet të përmbush vendi.

Parimet janë të hartuara për vendet që duan të anëtarësohen në BE dhe që marrin ndihmë nga BE-ja përmes Instrumentit të Para-Anëtarësimit (IPA). Kushtet e *acquis*, si dhe direktivat dhe udhëzimet e tjera të BE-së, janë thelbi i Parimeve në fushat ku ekzistojnë *acquis*. Në fushat e tjera, parimet rrjedhin nga standardet dhe kërkesat ndërkombëtare, si dhe nga praktikatat e mira në shtetet anëtare të BE-së dhe në vendet e OECD-së. Si standard minimal për një administratë të mirë të orientuar drejt performancës, vendet duhet të sigurojnë respektimin e këtyre parimeve themelore. Bashkërendimi për vlerësimin e raportit të monitorimit⁹¹ dhe të performancës lidhur me përmbushjen e këtyre parimeve do të kryhet me Njësinë e Mirëqeverisjes, Departamenti i Politikave dhe Mirëqeverisjes në Kryeministri.

1.1.5 Mekanizimi i Integruar i Politikave

Në zbatim të Urdhrit të Kryeministrit Nr.90, datë 01.08.2023 “*Për marrjen e masave për zbatimin e qasjes së gjerë sektoriale/ndërsektoriale, si dhe ngritjen dhe funksionimin e Mekanizmit sektorial/ndërsektorial të integruar*”, janë krijuar 8 Ekiye Tematike, të cilat janë pjesë e Grupit të Menaxhimit të Integruar të Politikave (GMIP) për “Demokracia, Sundimi i ligjit dhe Qeverisja e mirë”. Konkretisht, për Ministrin e Shtetit për Administratën Publike dhe Antikorrupsionin është ngritur Ekipi Tematik Antikorrupsion (ETA).⁹²

GMIP do të sigurojë një strukturë të menaxhimit të nivelit të lartë, lidhur me:

⁹⁰ Metodologjia e përdorimit dhe administrimit të të dhënave dhe sipas të cilave hartohet ky raport, që ka formatin dhe analizën e informacionit sipas IPSIS.

⁹¹ Para se raporti i monitorimit dhe performancës të aprovohet në strukturat vendimmarrëse.

⁹² Këtë rol e luan Komiteti Koordinator për zbatimin e Strategjisë Ndërsektoriale Kundër Korrupsionit.

- vendimmarrjen politike dhe menaxheriale të nivelit të lartë në planifikimin dhe monitorimin e reformave sektoriale, politikave dhe kuadrit strategjik;
- koordinimin e planifikimit, programimit dhe monitorimit për sektorët e përfshirë, nëpërmjet organizimit të dialogut të rregullt me partnerët për zhvillim;
- ofrimin e mbështetjes në kuadrin e procesit të anëtarësimit në Bashkimin Evropian;
- dialogun qeveritar mbi politikat me partnerët për zhvillim, qeverisjen vendore, shoqërinë civile dhe sektorin privat, zbatimin e masave brenda fushës dhe sektorëve përkatës dhe promovimin dhe mbështetjen e iniciativave të koordinuara.

1.1.6 Fazat për hartimin e Raportit të Monitorimit dhe Performancës

Fazat që ndiqen për përgatitjen dhe konsolidimin e raportit të monitorimit dhe performancës, paraqiten si më poshtë:

Faza 1: dërgimi i kërkesës për kontribut në datë 21.2.2025 për të gjitha institucionet raportuese dhe konsolidimi i paketës në përputhje me standardet e sistemit IPSIS dhe Parimet e Mirëqeverisjes;

Faza 2: dërgimi i paketës së plotë për vlerësim më datë 24.4.2025 pranë Njesisë e Mirëqeverisjes, Departamenti i Politikave dhe Mirëqeverisjes në Kryeministri për vlerësim të raportit të performancës në përputhje me parimet e mirëqeverisjes.

Faza 3: konsolidimi i paketës pas marrjes dhe reflektimit të komenteve të sjella nga Njësia e Mirëqeverisjes, Departamenti i Politikave dhe Mirëqeverisjes në Kryeministri;

Faza 4: organizimi i mbledhjes së GTA-së më datë, për konsultimin e paketës së konsoliduar, marrjen e komenteve nga aktorët, si dhe miratimi i tij;

Faza 5: reflektimi i komenteve dhe finalizimi i paketës së raportit të monitorimit dhe performancës;

Faza 6: publikimi i raportit vjetor në faqen zyrtare të Ministrit të shtetit për Administratën Publike dhe Antikorrupsionin

Faza 7: dërgimi i procedurave (minutat e takimit, konkluzionet operacionale, raporti i konsultimit publik) të mbledhjes së GTA-së dhe paketa finale, së bashku me linkun për njohje Njesisë së Mirëqeverisjes, Departamenti i Politikave dhe Mirëqeverisjes në Kryeministri.

Faza 8: dërgimi i procedurave (minutat e takimit, konkluzionet operacionale, raporti i konsultimit publik) të mbledhjes së GTA-së dhe paketa finale, së bashku me linkun për njohje Agjencisë SASPAC.

1.1.7 Parimet e Mirëqeverisjes që do të merren në konsideratë për hartimin e Raportit të Monitorimit dhe Performancës

Raporti i Monitorimit dhe Performancës do të zbatojë parimet e mirëqeverisjes që do të duhet të ndiqen në zbatimin e një sistemi të mirë dhe efektiv të M & R-së:

- **EFIKASITETI:** Agregimi i niveleve të dokumenteve. Ky parim duhet të lejojë shfrytëzimin e sinergjive mes raporteve të dokumenteve të ndryshme. Nëse dokumentet janë të lidhura ngushtë në aspektin e përmbajtjes, atëherë sistemi i M & R-së duhet ta marrë këtë parasysh për të mundësuar zhvillimin e mëtejshëm të njëri-tjetrit dhe jo mbivendosjen e njëri-tjetrit. Elementet bazë të raporteve të M & R-së (p.sh. objektivat, aktivitetet, indikatorët) në dokumentin e nivelit më të ulët do të zhvillohen drejt përmbajtjes së M & R-së në dokumentet e nivelit në të lartë. Duhet të merren parasysh lidhjet. Ky parim duhet të përmirësojë frekuencën dhe përmbajtjen e raporteve të M & R-së.
- **LLOGARIDHËNIA:** Respektimi i përmbajtjes së dokumenteve të planifikimit. Raportet e monitorimit duhet të përqendrohen në elementet e dokumenteve të planifikimit për të siguruar llogaridhënie lidhur me reformat dhe ndërhyrjet e planifikuara.
- **RËNDËSIA:** Respektimi i nevojave të përdoruesve të monitorimit dhe performancës. Raportet e M & R-së duhet të jenë të përshtatura për nevojat e përdoruesit në aspektin e përmbajtjes, gjatësisë dhe frekuencës. Për më tepër, raportet duhet të japin llogari për arritjen e rezultateve në mënyrë të verifikueshme dhe në raport me treguesit SMART.

Komponentët kryesorë që Raportet e Monitorimit dhe Performancës do të vlerësohen për përputhshmërinë me Parimet e Mirëqeverisjes lidhen me komponentët e mëposhtëm:

Qasja analitike e strukturuar bazuar në evidenca dhe konsultim

- Informacioni i dhënë shpjegon kuadrin metodologjik në përputhje me procedurat dhe standartet e sistemit.
- Progresi ndaj secilit qëllim politik dhe objektivi specifik të strategjisë bazuar në tregues si dhe zbatimin e reformave kryesore në sektor është paraqitur qartë.
- Shkalla në të cilën palët kryesore të interesit janë përfshirë në procesin e hartimit të raportit dhe raporti i monitorimit është konsultuar me të gjithë grupet si dhe publikuar në ëëbin respektiv të institucionit (evidencë kryesore është raporti i konsultimit publik për procesin si dhe evidentimi që komentet janë marrë në konsideratë).
- Shkalla e paraqitjes analitike të zhvillimeve të sektorit globalisht ose në rajon.
- Shkalla e paraqitjes analitike të zbatimit të strategjisë me efekte në axhendën e integritetit evropian.
- Shkalla e paraqitjes analitike lidhur me identifikimin e fushës e cila adresohet për përmirësim si dhe efektet në ekzekutimin përgjithshëm të buxhetit.

Progresi i arritur vs qëllimet e politikave, objektivat specifike dhe masat

- Shkalla në të cilën progresi shpreh qartë vlerësimin e arritjeve kryesore duke përdorur treguesit e performancës. Është vlerësuar analiza përmes grafikëve, dashboards, analizës së thelluar dhe vizualisht përmes tabelave). Gjithashtu paraqitet qartë identifikimi i shkallës së performancës.
- Shkalla në të cilën progresi adreson vlerësimin e sfidave, boshllëqeve dhe jo efikasitetit (identifikohet qartë në raportin e monitorimit se cilat fusha (bazuar në qëllimet e politikave / objektivat specifike) tregojnë performancën më të dobët/ jo rezultative, vs performancën më të lartë të objektivave, duke përdorur treguesit e rezultateve, përmes grafikëve, dashboards, analizës së thelluar dhe vizualisht përmes tabelave.
- Treguesit e Performancës janë pjesë e analizës për çdo qëllim politike dhe çdo objektiv specifik dhe jepen me premisa krahasueshmërie në vite apo për periudha të caktuara.
- Konkuluzionet dhe rekomandimet janë të bazuara në përputhje me evidencat e raportit dhe japin masa konkrete për korrektim/përmirësim për t'u adresuar në vendimmarrje.

Performanca e kategorizuar sipas standardeve

- Përcaktimi i nivelit të arritjes së objektivit të secilit tregues të performancës është identifikuar. Është kryer mbledhja e të dhënave të disponueshme. Është llogaritur norma e realizimit të treguesit: 1) vlera e synuar, 2) vlera bazë dhe 3) të dhënat për arritjen e synimit.
- Niveli i arritjes së objektivit është përcaktuar. Gjithashtu është llogaritur norma mesatare e zbatimit të të gjithë treguesve të performancës lidhur me çdo objektiv të veçantë. (është kryer hedhja e të dhënave të niveleve të realizimit të çdo treguesi të lidhur me performancën dhe pjesëtimin me numrin e treguesve të performancës)
- Niveli i përcaktimit të shkallës së realizimit të objektivit për një nga katër (4) intervalet e sistemit të performancës është kryer dhe analizuar. Gjithashtu intervali është përcaktuar në bazë të nivelit të tolerancës. (i.dobët, ii. Mjaftueshëm, iii. Mirë, iv. Shumë mirë, v.Tejkaluar)

Risqet

- Shkalla në të cilën identifikohen risqet në nivel qëllimi politike dhe objektiv specifik në zbatim të Ligjit Nr.10 296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”.
- Shkalla në të cilën analizohen risqet në nivel qëllimi politike dhe objektiv specifik.
- Vlerësimi i riskut është kryer në përputhje me kategorizimet i.ulët; ii. mesëm dhe iii.lartë.
- Vlerësimi i mundësisë së ndodhjes së riskut është kryer në përputhje me kategorizimet i.ulët; ii. mesëm dhe iii.lartë.

Analizat financiare

- Shkalla e analizës së kryer lidhur me (i) në buxhetin e përdorur në periudhën e monitorimit, (ii) hendekun e financimit dhe (iii) nevojat e ardhshme.
- Analiza e buxhetit të përdorur është analizuar e lidhur me programet buxhetore (identifikohen saktë numri total i programeve buxhetore) në tre (3) nivele: (i) qëllimi i politikave (ii) objektivi specifik (iii) masat/ produktet si dhe totali për strategjinë.
- Shkalla e analizës financiare është kryer ku janë identifikuar dhe shkaqet e mungesës së fondeve dhe se si ky hendek do të trajtohet në të ardhmen.

Plani i Veprimit

- Plani është zbrëthyer në realizueshmërinë e masave/produkte/aktivitete.
- Janë identifikuar institucionet zbatuese dhe kodet referuese për programet buxhetore.
- Janë identifikuar qartë periudha e realizueshmërisë.
- Institucionet e tjera/bashkëpunuese janë identifikuar.
- Masat/produktet janë të përputhura me produktet e programeve buxhetore (identifikohen qartë programet buxhetore)

1.1.8 Procedura për analizimin e të dhënave për raportin e monitorimit dhe performancës

Analiza e të dhënave është bërë në përputhje me parimet e mirëqeverisjes dhe strukturës vlerësuese për arritjen e performancës në Kryeministri.

Së pari është analizuar zbatimi i masave duke dhënë një rezultat sasior dhe cilësor të realizimit të tyre përkundrejt kryerjes së aktiviteteve respektive të lidhura me to.

Së dyti, është analizuar arritja e vlerës së synuar për këtë periudhë e përcaktuar në treguesit e performancës, duke vlerësuar gjithashtu edhe shkallën e ndikimit të masave të realizuara në arritjen e vlerës së synuar.

Së treti është analizuar realizimi i objektivëve specifike përmes përllogaritjes së realizimit të treguesve të performancës dhe përqindjes së masave të lidhura me objektivin përkatës të realizuara.

Zbatueshmëria e masave dhe aktiviteteve të Planit të Veprimit klasifikohet me vlerat si më poshtë:

E zbatuar: është raportuar statusi “E zbatuar” për ato masa/aktivitete të cilat janë përmbyshur.

Pjesërisht e zbatuar/Në proces: është raportuar statusi “Në proces” për ato masa/aktivitete, të cilat në periudhën e raportimit kanë pasur zbatim të pjesshëm dhe/apo që vijnë të jenë në zbatueshmëri prej tyre.

E pazbatuar: Të pazbatuara janë raportuar ato masa/aktivitete të cilat nuk kanë regjistruar zhvillim për periudhën raportuese si dhe gjithashtu ato masa/aktivitete për të cilat nuk ka pasur progres.

Për përllogaritjen e realizimit të objektivëve specifike sipas arritjes së vlerës vjetore të treguesit të performancës është përdorur formula si më poshtë⁹³:

$$NR = \frac{TP\ 1\ NR + TP\ 2\ NR}{2\ TP} \times 100\%$$

Përllogaritja e realizimit të objektivit përkundrejt zbatimit të masave është kryer në bazë të 4 intervaleve të sistemit të performancës si në tabelën dhe kodin e ngjyrave më poshtë:⁹⁴

Kategoria	Niveli i Tolerancës	Pikët (110)
Dobët	Nga 0 deri në 30 për qind e masave të realizuara	30
Mjaftueshëm	Nga 31 në 50 për qind e masave të realizuara	20
Mirë	Nga 51 në 85 për qind e masave të realizuara	35
Shumë mirë	Nga 86 në 110 për qind e masave të realizuara	25
Tejkaluar	111 dhe më lart	N/A

Niveli tjetër i analizës është realizuar sipas qëllimeve të politikës. Bazuar në të dhënat e realizueshmërisë për secilin nivel analitik (masa, tregues performance, objektiv specifik) është vlerësuar secili nga tre qëllimet e politikave të SNKK 2024-2030.

Gjatë fazës së analizës janë dërguar për konsultim draftet e raportit dhe kërkuar plotësime informacioni për masat/aktivitetet dhe performancën e treguesve me përfaqësues të institucioneve zbatuese (pikat e kontaktit antikorupsion).

⁹³ Formula e përllogaritjes është marrë nga guida metodologjike e hartimit të raporteve të monitorimit të dokumenteve strategjike IPSIS.

⁹⁴ Vlerësimi është realizuar në përputhje me Guidën Metodologjike “Struktura e raporteve të monitorimit për dokumentet strategjike sektoriale dhe ndërsektoriale për agjendën e mirëqeverisjes”.

Matrica e Riskut

Në raportin e monitorimit vlerësohet identifikim i risqeve me qëllim identifikimin e hapave që do të duhen të ndiqen për t'u adresuar në kuadër të implementimit të objektivëve të Strategjisë Ndërsektoriale Kundër Korrupsionit. Vlerësimi i riskut është kryer në përputhje me tabelën më poshtë⁹⁵:

Mundësia	E lartë	3	6	9	
	E mesme	2	5	8	
	E ulët	1	4	7	
		E ulët	E mesme	E lartë	
		Ndikimi			

Aneks 2: Plani i Veprimit 2024-206 i SNKK 2024-2030 (referohu tek Aneksi nr. 1 i Strategjisë Ndërsektoriale Kundër Korrupsionit 2024-2030)

Aneks 3: Pasaporta e Treguesve të Performancës të SNKK 2024-2030 (referohu tek Aneksi nr. 2 i Strategjisë Ndërsektoriale Kundër Korrupsionit 2024-2030)

⁹⁵ Analiza dhe vlerësimi i riskut është kryer referuar Guidës Metodologjike për hartimin e raporteve të monitorimit për Agjendën e Mirëqeverisjes.

